



YLLI POLOVINA

RUSJA E
BUKUR
NATALJA

2022

Ylli Polovina

*Tetor 1960-maj 1961. Partitë komuniste të botës
tronditen nga përçarja-Në një shkollë
ndërkombëtare aviacioni në Bashkimin Sovjetik,
biri i një ambasadori shqiptar dashuron
rusen e bukur...*

Natalja

roman

UEGEN

© Copyright Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij vëllimi nuk mund të riprodhohet, memorizohet apo përcillet në ndonjë formë a me ndonjë mjet elektronik, mekanik, me anë të fotokopjes, në disk ose në mënyra të tjera, përfshirë dhe kinemanë, radion, televizionin, pa autorizimin me shkrim nga autori.

Libri është gratis. Secili që e dëshiron për ta lexuar t'ia bëjë kërkesën autorit në adresën elektronike: yllipolovina@gmail.com

PASQYRA E LËNDËS

Qiell dimri

Za Stalina, protiv Stalinu

(Me Stalinin, kundër Stalinit)

Lenini ishte i mirë, Stalini i mirë ishte, por ja hodhën pas vdekjes, kurse për Hrushovin do themi si është vetëm kur të vdesë

Natalja

Bombat bërthamore, armë të frikshme

Janë telefona të KGB-së

Hedhje me parashutë

Veturat janë ideologjia me katër rrota

Aristokratja

Polemika

"Gjithçka në rregull"

Sytë e Larisës

Dy ngjarje

Moskoviti elegant

Koka e gjarprit

Çfarë thotë radio "Zëri i Amerikës"

28 Nëntor

Moldaviana Tamara

"Vollga" bishë

Ju lejoj uljen!

Në tancoplloshadkë

"Unë jam shqiptar"

Kastriot Leka në tabelën e nderit

"Fjodor, Fjodor"

Puthjet e Leleçkës

Një ekspozitë e papritur
Svjetllana
Familje cariste
Ekspozita e sëmundjeve nga infektimet radioaktive
Borë Krishtlindjesh
Babushka
Vallëzim me të gjithë të dashurat e tyre
Çimçakiz
Ngricë
“U nas zabota takaja”
Ljubov maja (dashuria ime)
Sërish për Svjetllanën
Mes kapitull
Po vij!
Mësuesi im, ku je?
Moskë, Çikago, Los Anxhelos u bashkuan në një kolkoz
Një kryq hitlerian
Studenti rumun Kosta
Atasheu ushtarak i ambasadës shqiptare në Moskë
Si gjithnjë natë pa yje
“Pravda” njofton
BBC (Projenij Vozdushnij Sill-Forcat Ushtarake Ajrore)
Zampoliti Lisenko bën diversion
Shumëfishohen rojet
Përvjetori i Ushtrisë së Kuqe
“Mos më shaj Enver Hoxhën!”
Albina
Fillim marsi
Ditari i Nataljes
Afër mesnatës
“Dua të ble...”
Larisa me veturën “Zim”
Dekoratë e refuzuar
Intriga me avionin stërvitor Mig-17

Dy buzë të nxehta
Provim në historinë e Partisë Komuniste të Bashkimit
Sovjetik
Zheleznjaku
“I dyzetë e njëjti”
Statuja e Paqes dhe skulptori Cigarjev
Dy ikje të dyshimta
Ardhja e mareshalit
Ishte një prill
Cili ishte modeli i femrës së statujës së paqes
Njeriu me borsalinë
Më jep një fëmijë!
Karantinë
Pastruesja e konviktit Maria Listova
Tek hekurat e portës rrinte Natalja
Spiuni
Shqiptari nga Saporizha e Ukrainës
Vjen statuja
Li-ri-da-lje
Jurij Gagarini fluturon rreth tokës
Unë e ti, e dashur, kemi dy atdhe
Ptu!
Dita tjetër
Ndarja e dhimbshme, Natalja, Tamara, Irina, Albina,
Svjetllana, Ljuba...
Në Moskë
Ja Shqipëria

Qiell dimri

Kastriot Leka ishte ngujuar tek dritarja e dhomës dhe shihte qiellin e ftohtë të asaj vjeshte ta vonë ruse që po mbushej me grumbuj resh të hirta e si të hutuara.

Kjo prishje kohe ishte fare e natyrshme për këtë stinë dhe ai po mendonte sa së shpejti shirat që do të rridhnin nga barqet e reve, nëpër eterin a akullt do të ktheheshin menjëherë në borë.

“Dimri rus” mendoi ai si të kujtonte një njeri, të cilin nuk e kishte takuar prej shumë kohësh.

Përtej, atje ku ishte aerodromi luftarak, me një klithmë të lodhur, që u dilte me gulç nga turboreaktorët, uleshin avionët MIG-19.

Ajo kishte qenë një ditë intensive stërvitjeje dhe Kastrioti e pati ndjekur me kërshtëri që nga dritaret e auditorit ku zhvillonin mësim.

Së shpejti do të bëhej në Moskë mbledhja e partive komuniste të të gjithë botës dhe propaganda ruse po fliste përditë për paqen dhe për fuqinë e kampit socialist.

Ishte një kohë e çuditshme, një stinë politike që i ngjante një mëngjesi plot mjegull të dendur e ku, megjithatë, ndihej prania e afërt e diellit.

Ftohtë dhe ngrohtë, mornica gëzimi dhe dridhja të ftohti.

Duam paqe, por edhe jemi të fortë ta mundim Amerikën dhe kapitalizmin.

Kjo quhej nga politikanët “ulje tensioni”.

Kish kohë që në Bashkimin Sovjetik më tepër se një milion ushtarakë qenë nxjerrë në lirim dhe “Pravda” botonte foton

simbolike, ku dy oficerë përshëndetnin në rrugë një kolegun e tyre tashmë civil.

Shteti sa një e gjashta e botës kishte gjetur gjuhën e asaj fotoje për të treguar se u kishte hequr uniformat një të tretës së ushtrisë së vet.

Megjithatë këta MIG-19, që fare para pak kohësh kishin ardhur, ngriheshin përditë.

Ishin avionët më modernë që kishte ushtria sovjetike dhe për epërsinë e tyre në ajër patën folur ditë të tëra që nga komandanti i shkollës, Smirnov, e deri tek instruktorët e specialiteteve.

Tashmë nuk ishte sekret se ky avion që dekonspiruar nga një agjent turk.

Kastrioti i nguli sytë një avioni që u ul keq dhe u detyrua të hapte parashutën për të frenuar shpejtësinë.

Para pak kohësh këta avionë ndodheshin në aerodromet sekrete të Gardës së Moskës a gjetkë në lindje, thellë misterit siberian.

Por turku, i cili kishte qenë një teknik katërsheje, i pati hipur një ditë një MIG-u të tillë dhe kish fluturuar drejt vendit të vet.

E kishin ndjekur me tërbim, e patën qëlluar, por nuk e kishin goditur dot.

MIG-u i ri nuk kapej aq lehtë as nga ajri dhe as nga raketat tokë-ajër.

Turku i kishte peshuar të gjitha veprimet e rrëmbimit.

I arratisur nga Turqia gjatë kohës që Bashkimi Sovjetik ndodhej në pik të Luftës Patriotike, ai kishte mbaruar aty një shkollë të mesme teknike, ishte bërë instruktor avioni, kish njohur dhe kish mësuar mirë MIG-19 dhe ditën e mezi pritur, pasi që bërë një nga njerëzit më të padyshimtë të aerodromeve sekrete, pa fluturuar asnjëherë, i kishte hipur avionit modern dhe pati ikur.

“Imperializmi nuk do paqe” kishin thënë disa autoritete të larta sovjetike dhe e patën futur avionin e ri, sekret dalë, në armatimin e ushtrisë.

-Kush e ka sjellë këtë trëndafil? - dëgjoi Kastrioti mbrapa shpinës zërin e Rexhepit.

U kthye vrulltas, sepse në çast u kujtua se bashkëfolësi kishte një alergji të lemerishme nga lulet.

-Unë - tha dhe hapi sirtarin e komodinës ta fuste atje gotën e qelqtë, ku rrinte trëndafili.

-Lëre! - i kapi dorën tjetri - qenka shumë i bukur.

-I ka bërë rublat lule - ndërhyri Janaqi që po krihej para një pasqyre të vogël - Sa kushtoi?

-Një rubël-u përgjigj Kastrioti - Ia bleva një plake që vinte nga Soçi. Më ka premtuar që të më gjejë edhe dy tulipanë.

-Dy tulipanë?!

Janaqit i ngriu krehri në dorë dhe vështroi me sy të hutuar fytyrën indiferente dhe qetësisht ëndërrimtare të Kastriotit.

-Po dy tulipanë janë një darkë e fortë me birrë në “Boçka”?!

-Dashuria vëlla - tha Bujari tashmë i veshur shik e i gatshëm të nisej për të parë filmin “Qielli i pastër” - Ajo bën çudira.

Za Stalina, protiv Stalinu

(Me Stalinin, kundër Stalinit)

-Dal me shkrepëse - u përgjigj Rexhepi dhe shkoi në dhomë të vishte kapotën e të dilte bashkë me Janaqin e Bujarin.

Tek postblloku i shkollës roje ishte Sherifjevi, roja më xhahil që kishte i gjithë gorodoku (qyteti) ushtarak.

Përgjegjës ndërrese ishte gjeorgjiani Ekvtime.

Ky duhet të kishte kthyer disa gota vodkë se qelte erë që atje tutje.

Ndërkohë që Janaqi me Bujarin dolën, ky i fundit nxori shkrepësen nga xhepi dhe futi atje fletë liridaljen e tij.

Pastaj e hodhi në katin e parë të ndërtesës së konviktit, ku rrinin rusët e ku priste Rexhepi.

Pas pesë minutash postbllokun e kaloi fare i qetë edhe ai.

Uçjelishe (shkollë e madhe) bashkë me fjetinat dhe anekset e tjera i ngjante një kutie gjigande, nga e cila nuk ishte aq e lehtë të dilje.

Ndërtesat trekatëshe e mbyllnin atë nga të katër anët dhe për t'i shpëtuar kësaj gracke kishin mbetur vetëm marifeti i shkrepëses, një mur gati tre metra, por pak i rrëzuar në njërin qoshk të kutisë-shkollë dhe shkallët e ngushta e të rrezikshme të ullukut të shiut.

Ky marifet i fundit ishte monopol i vitit të tretë, kurse murin rrethues e kapërcenin më së shumti kursantë të vitit të parë dhe ta dytë.

Ata të dy zunë një elektrikë (trolejbus elektrik) dhe ajo, pasi bëri një gjysmë rrethi nëpër qytet, u ndal para kinemasë, e cila gati po i mbyllte dyert.

Portieri plak i dalloj shpejt dhe priti edhe një çast me derën

gjysmë të mbyllur.

Ata kaluan nëpër sallonin e madh e të heshtur, ku nëpër mure e kolonat e shumta kishte njolla të mëdha lagështie. U bëri përshtypje heshtja e thellë e sugjestionuese e atij ambienti, të cilin e prisnin me zhurmë dhe me ndonjë zënkë huliganësh.

Kur u futën në sallë e kuptuan se cili ishte shkaku i kësaj qetësie të pazakontë për një kinema sovjetike.

Në sallë nuk kishte më shumë se njëzetë vetë.

Me sa dukej filmi e kishte kapërcyer pikën kulmore të famës së tij dhe tani që kthyer në një gjë të rëndomtë.

Ata që rrinin në heshtje nëpër karrige, më së shumti ishin të moshuar.

Tre të ardhurit i panë me ca sy të qelqtë e që e kishin mendjen gjetiu. Bujari donte t'i thoshte dika Janaqit por menjëherë u shuan dritat dhe u projektua filmi.

E ndoqën në heshtje gjer në fund.

Vetëm një herë Bujari lëvizi me nervozizëm dhe kërcitja e karriges së tij prishi shurdhërinë e asaj heshtjeje të rëndë.

Qe momenti kur protagonistin e filmit, një aktor, të cilin e kishin parë të luante tek filmi “Komunisti”, pas peripecive të shumta nga burokracia staliniste i tregonte të shoqes, që po e priste prej nëntë orësh përmatanë Kremlinit yllin e artë të heroit dhënë nga udhëheqësit e rinj të shtetit sovjetik.

Kur filmi mbaroi, heshtja në sallë ishte po aq e madhe sa edhe dy orë më parë.

Ata dolën jashtë, mes errësirës së asaj nate të ftohtë.

Papritmas një zë i ngjirur bërtiti “Rroftë Stalini!”

Me pak vonesë dhe tepër i eksituar një zë tjetër iu përgjigj klithshim: Poshtë Stalini!

Ata ecën një copë rrugë bashkë, të pazotë të gjenin një fjalë që do të kishte misionin të thyente atë heshtje.

Filmi “Qielli i pastër” ishte ndjekur vërtet me interes nga rinia sovjetike por kishte provokuar edhe polemika të shumta mes saj.

-Ishte një paçavure - mermëriti Rexhepi.

-Nuk mund t'i thuash paçavure - kundërshtoi qetësisht Bujari- Ai është një film tërheqës.

~Ai akuzon Stalinin,-foli vrulltas dhe nervoz Rexhepi.

Ra heshtje.

-Si është e mundur që po ai aktor, i cili luan komunistin bolshevik me aq patos sa tronditi Bashkimin Sovjetik, të luajë tani me kaq pasion politik një figurë të kundërt me rolin e tij të dashur të disa vjetëve më parë? - shtoi me ton pajtues Janaqi.

-Ai mbetet sërish komunist, por jo stalinist - i dha tonit të tij gjallëri Bujari.

-Ku ndryshon komunisti nga stalinisti? Po na çuditni tani!

-hungëriti Rexhepi.

-Mos çaj kokën! - ndërhyri me të shpejtë Bujari, duke menduar se në ato çaste kjo ishte mënyra më e mirë për të fikur debatin që po nervozohej.

Ai nuk i duronte dot gjendjet jo komode të shpirtit, kështu që edhe këtë rast preferoi për zgjidhje formulën e tij të njohur "mos çaj kokën".

Kishte raste kur këtë formulë magjike e pasuronte duke e zëvendësuar fjalën kokë me një pjesë tjetër të trupit dhe atëherë vërtet gjendej menjëherë i çliruar.

-Shihni llapushët e Bremenit! - tha pas pak, duke treguar një xham të madh të një klubi të veshur nga fryma njerëzore e ku dukej portreti i profesorit të tyre të teorisë së fluturimit.

-Pika vodkë edhe çifuti sa u shqepka! - shfryu Rexhepi – Kur ky na jep mësim me dy llafet e para shan vodkën!

Mbi borë, pak më tutje, i ndriçuar zbehtësisht nga një fener rruge, rrinte shtrirë një njeri dhe nuk lëvizte nga vendi.

-Ç'bëhet, more, ç'bëhet në këtë Bashkim Sovjetik?! – thirri Bujari dhe vrapoi drejt njeriut të shtrirë.

Janaqi e ndoqi nga pas me hap të ngadaltë dhe moskokëçarës.

Pamje të tilla ishin krejtësisht të zakonshme nëpër rrugët e qyteteve sovjetike dhe ai ishte mësuar në këto dy vjet e ca që vazhdonte studimet për shturman helikopteri.

Vetëm Bujari nuk u mësua asnjëherë.

Janaqi përpiqej ta kuptonte këtë njeri, i cili para disa vjetësh kishte qenë bujk dhe plugonte arën e tij.

Ndërkohë Bujari e kishte përfshirë në krahët e tij të fuqishëm të pirin dhe po përpiqej ta mbështeste në stol.

Por sapo kujtonte se e kish arritur ta rregullonte në një farë mënyre për t'i dhënë një pamje njerëzore, ai menjëherë lëkundej si nga një ngërç dhe rrëzohej përdhe, duke zënë pozicionin e parë.

-Më ndihmo ta ngremë edhe një herë! - shqiptoi ai me zë ankues e çuditërisht aq të lodhur.

Që të tre e ngritën edhe një herë rusin e rrëzuar.

E vendosën në një stol aty afër.

Ai dukej si i vdekur.

Por pikërisht kur po hiqnin pëllëmbët nga peliçja e tij e pistë, trupi u rrëqeth si të kishte kaluar nëpër të një rrymë elektrike.

-Ja ky është Bashkimi Sovjetik - rënkoj nëpër dhëmbë Rexhepi - Shtet i bërë tapë dhe i shtrirë në mes të rrugës.

Lenini ishte i mirë, Stalini i mirë ishte, por ja hodhën pas vdekjes, kurse për Hrushovin do themi si është vetëm kur të vdesë

Po kalonin para gazetës lokale të qytetit.

Roja e saj, një milicioner, ishte i mbështjellë mes avullit kapitës të kaloriferit.

Në sallon dukej portreti i Leninit, i madh dhe i vendosur në një kornizë me ngjyrë ari.

-Ej! - thirri Janaqi -Shihni portretin e Leninit!

Dy të tjerëve iu desh ca kohë të orientoheshin.

Lenini ishte pikturuar tamam si një njeri që sapo kishte dalë nga burgu.

Nofullat e mëdha e një mjekër e zgjatur përpara si nga një kërcëllitje dhëmbësh, sytë e ashpër e kërcënues, vetullat e mbledhura si nga një mendim i zi në kokë të bënin të mos i ngrije sytë e ta shihje edhe njëherë.

-Ç'bëhet me këtë Bashkimin Sovjetik, ç'bëhet?! - psherëtiu Bujari.

Në fakt në korridoret e kësaj gazete për herë të parë ata shihnin me vëmendje.

Ndërtesa ishte solide, e punuar me kujdes dhe me trill arkitekturor, ashtu siç ishin në të gjithë Bashkimin Sovjetik zyrat e partisë e të qeverisë.

Ato qenë ndërtesat më të mira, më të fortat, më të pajisurat dhe dukeshin sikur qenë ndërtuar enkas për të ushtruar pushtet.

-Marrim një elektrinë dhe ikim! - kishte folur Rexhepi.

-Kemi kohë gjer më njëmbëdhjetë, dalim edhe pak, - ishte përgjigjur Janaqi.

-Mirëpo nuk do të ikim në këmbë pastaj.

-Dakord.

Ora po i afrohej dhjetës dhe u mbetej edhe jo pak kohë për të shëtitur nëpër qytetin që po boshatisej me shpejtësi. Pranë kaloi një grua e bukur dhe Janaqi e ndoqi për një kohë të gjatë me sy.

Në heshtje kishin kaluar qendrën e qytetit dhe tanimë po barisnin afër periferisë së tij.

Janaqit iu kujtua se aty afër ishte një birrari dhe mund të kthenin nga një gotë.

Qenë fare pranë saj, kur panë të dilte prej andej bashkë me një vajzë Aleksej Leonidoviç, një shok i kursit të tyre.

Ai i qarkonte belin, ajo hiqte nëpër tokë një çantë të vogël dhe elegante.

Në anën tjetër të rrugës rrinte në pritje një “Vollga” blu.

-Kjo është Leleçka Besonovna - tha Janaqi me një emocion të lehtë në zë.

Aleksej hungëriti dhe i bëri një të puthur të rrëmbyer mikeshës së tij.

Ata të tre shihnin si të nemitur.

Leleçka po rënkonte.

-Më duket se po e kafshon - psherëtiu Rexhepi.

Bujari kishte kthyer kokën mënjanë për të mos e parë skenën.

Janaqit iu qesh. Pastaj ngriti dorën për të përshëndetur sovjetikun e kursit të tyre, por Alekseji nuk e vuri re.

-Aliosha nuk të përshëndet kurrë jashtë shkolle - u skërmit Rexhepi - Vetëm atje të lëpihet.

-Se mos ka ndonjë nevojë - u përgjigj disi i zhgënjyer Janaqi - ai është djali i vetëm i një njeriu që është dy herë hero i Bashkimit Sovjetik. Dashnore ka plot, aq më tepër ketë Leleçkën. Këtij njeriu nuk i mungon asgjë.

Bujari lëkundi kokën e rëndë e të madhe krejt i pakënaqur.

por tashmë pa la hequr vështrimin përbuzës “Vollgës”, ku Aleksej sërish po puthej.

Ai ndonjëherë nuk e kuptonte Janaqin.

Pas pak vetura lëshoi një fjolle të hollë tymi dhe u largua nëpër natë.

-Qenkeni ju! - dëgjuan befaz mbrapa shpine një zë të trashur nga pija e shumtë.

Të tre u kthyen menjëherë, nën një alarm të dukshëm.

Përpara tyre rrinte një djalë trupmadh me një fytyrë si vajzë.

Ai po u buzëqeshte dashamirësisht.

-Borisi! - thirri me një mall të pa fshehur Bujari.

Sakaq u përçafuan pak çaste dhe ata dy trupa të mëdhenj u dukën të stërmadhuar jashtë çdo përfytyrimi.

-Dëgjova shqip - tha tjetri - dhe me shkoi mendja se mos ishte ti.

Janaqi dhe Rexhepi pritën sa rusi i quajtur Boris t'i vinte re edhe ata.

Të dyve iu krijua përshtypja se para tyre ndodhej një huligan, veç jo si të shumtit që merreshin me plaçkitje xhepush a të ndonjë ore dore.

Borisi i bënte lëvizjet re shpenguara si të një njeriu që s'do tia dijë fare si mendojnë të tjerët për të.

Ai iu zgjati dorën me entuziazëm.

-Hajde të pimë nga një birrë!

Al i kapi qe të dy prej krahu pa kërkuar përgjigje.

Bujari ia shkrepiti te qeshurit.

-Jemi vonë për në shkollë - ia bëri me zë ankonjës Rexhepi.

-Vërtet jemi vonë - ndërhyri Bujari.

Ai me Borisin qenë njohur fare rastësisht në një grusht që kishte plasur në tancoplloshadkën (shesh vallëzimi) e sheshit Nahimov.

Zënka pati shpërthyer mes civilëve dhe ushtarakëve e Bujari, i gjendur pa dëshirën e tij, kishte bërë kërدينë mes

civilëve dhe pati tërhequr vëmendjen e të gjithë huliganëve që vërtiteshin aty.

Por Borisi i kishte pranguar me krahët e tij të gjatë e të fuqishëm e sakaq i kishte futur në lokal.

Në të vërtetë Janaqi nuk po kundërshtonte.

Klubi ku i futën, ishte një vend i ngushtë, një banak i thjeshtë e disa tavolina, në të cilat po pinin në heshtje tre të rinj dhe po kaq pleq.

-Nga një birrë të treve! - thirri Borisi dhe kamerieri mbushi katër kriklla.

Të parën ia zgjati rusit.

-Për Shqipërinë! Bud Zdarov! (Me shëndet!).

Borisi pasi shqiptoi këto fjalë përplasi gotën e tij me të tjerat.

-Për shëndetin e Bashkimit Sovjetik! - thirri Rexhepi.

Janaqit i erdhi për të qeshur. -

-Bashkimi Sovjetik ka shëndet plot - buzëqeshi gati në zgërdhije Borisi - Ne jemi një e gjashta e botës.

Bujari donte të thoshte se shëndetet e shteteve nuk janë njëlloj si të njerëzve, por hoqi dorë shpejt.

Ai e dinte se në mes të mjaft sovjetikëve ishte ngulitur, kush e di përse - se Shqipëria ishte një lagje e Moskës.

Ndërsa kthenin gllënjkat e para në tavolinën e pleqve u pëshpërit kokë më kokë diçka dhe më në fund njëri prej tyre u çua dhe erdhi drejt banakut:

-Shqiptarë?

-Shqiptarë - u përgjigj krenar Borisi.

Plakushi me një gëzim që i lodronte në të gjithë fytyrën, gati klithi: Edhe nga një birrë prej meje!

Pastaj pasi pagoi paratë, nderoi ushtarakisht. i

-Ju lutem, kemi pirë shumë - belbëzoi kot më kot Janaqi.

-Pini edhe një nga unë, për Stalinin!

Plakut i vezulluan lot në sy.

Tha: Kam luftuar për çlirimin e Jugosllavisë.

Të tre u ndjenë më intim me të.

Ai kishte kaluar fare pranë atdheut të tyre.

-Për Stalinin do ta pimë-tha Rexhepi.

Ata rrëkëllyen krikllat e plaku, pasi nderoi sërish ushtarakisht, shkoi për në tavolinën e tij.

Pak më tej tre të rinjtë e kishin ndjekur skenën me sy të xhamtë.

-Ne e pimë për Hrushovin - thirri njëri prej tyre.

Sytë i kishte të kuq.

Nën këmbë u rrokullisën disa shishe vodke bosh.

Borisi e vështroi ngulshëm. Pastaj shkrofëtini dhe ja dha të qeshurit

-Mos u çuditni – tha - Këtej nga ne thonë se xhaxhi Lenini ishte i mirë, Stalini i mirë ishte, por ja hodhën pas vdekjes, kurse për Hrushovin do themi si është vetëm kur të vdesë.

Natalja

Kastrioti u nis për në teatrin “Gorki”, ku i patën premtuar dy tulipanë.

Pranë godinës kishte njerëz dhe atij iu desh për një kohë të kërkonte plakën nga Soçi. Atë e gjeti më në fund në një qoshe të trotuarit.

Ajo sa e pa qeshi me gëzim dhe tundi kokën si vajzë e vogël. “

-Të prisja, bir. Vetëm dy tulipanët e t’u më kanë mbetur. Të tjerat i shita. Me sa duket njerëzit do të kenë rënë keq në dashuri sot se m’i përulanë dhe më vajti pazari mbarë.

Tulipanët në shportën e saj ishin me të vërtetë shumë të bukur.

-Sa? - pyeti Kastrioti.

-Sot unë i shita dy rubla njërin, por ti merri të dyja tre rubla.

Kastrioti pagoi dhe mori dy tulipanët e mbështjellë me kujdes në letër të tejdukshme.

Sakaq vrapoi drejt stacionit të tramvajit.

Ai të çonte drejt periferisë së qytetit, atje ku në një shtëpizë të bukur e të thjeshtë prej druri rrinte Natalja e tij.

Në tramvaj bëhej një zhaurimë e lehtë, si në një botë tjetër.

Kastrioti e kapi befas veten duke ëndërruar dhe buzëqeshi.

Ndjeu se ca sy po e shihnin dhe u skuq. Dashuria ishte një ndjenjë e kapshme lehtë nga kureshtarët.

Më në fund tramvaji kishte dalë në periferi dhe me të qëndruar një çast, Kastrioti kërceu përtokë.

Tani i duhej të ecte vetëm dhjetë minuta në këmbë që të arrinte tek shtëpia e Nataljes dhe instinktivisht nxitoi.

Njerëzit qenë të rrallë dhe atij i dukeshin të largët, si prapa një mjegulle të ftohtë.

Me Nataljen ai ishte takuar në një nga kodrat e qytetit.

Pati ndodhur siç ngjan më shpesh, kur dashuritë marrin flakë nga ndonjë takim a ndodhi e rastit.

Ajo ishte me disa shoqe e shokë të saj të Fakultetit të Shkencave Politike dhe po shëtisnin në një nga orët e pushimit.

Ajo vetë vazhdonte për letërsi dhe biseda që ishte hapur pati qenë për luftën e klasave në socializëm.

Polemizonte një djalë i gjatë i vitit të tretë të Fakultetit me dy shokë të tij.

Vajzat e ndiqnin me indiferencë debatin dhe preferonin të këndonin “Podmaskovskije veçjera”.

Vetë Natalja përkëdhelte me pëllëmbët e duarve degët e varura e të gjelbra të shelgjeve lotues.

Kastriotin me dy shqiptarë të tjerë e kishin ndeshur përballë dhe me uniformat e tyre të bukura të aviacionit ata kishin tërhequr kërshërinë e vajzave.

Djemtë që po polemizonin, kishin heshtur për një çast, por më pas u pleksën sërish në diskutimin e tyre.

Kurse grumbulli i vajzave ruse me atë të shqiptarëve për një moment u gjendën pranë njëri-tjetrit.

Ai edhe sot e kësaj dite nuk e mbante mend se si e përse kishte nisur biseda e atij takimi.

Kastrioti pati vënë re dhe e mbante të pashlyeshme vetëm atë çka shfaqej në sytë e saj: ujëvarat e bukura të degëve të shelgjeve lotues.

Pikërisht në këtë çast të dy grumbujt e të rinjve i kapi edhe ai i debutuesve të luftës së klasave.

Pas kësaj gjithçka u bë rutinë.

Studenti i gjatë rus tashmë i qe drejtuar Kastriotit dhe po i thoshte se lufta e klasave në një socializëm të zhvilluar shndërrohet në një faktor të dorës së dytë dhe se atë

aktualisht në Bashkimin Sovjetik e shihnin si një proces që po shkonte drejt shuarjes.

Shqiptari kundërshtoi e këmbënguli se lufta e klasave mbetet edhe në periudhën e ndërtimit të socializmit.

Madje si faktor kyç dhe se as që mund të flitej për një shuarje të saj.

Kaq mjaftoi për të ndezur e nervozuar debatin.

Vetëm kur dalluan indiferencën e vajzave ata ranë në kompromis.

Rusi i gjatë tha se, në fund të fundit, Shqipëria ndryshonte shumë nga Bashkimi Sovjetik.

Atje sa kishte filluar ndërtimi i socializmit, kurse tek ata socializmi që ndërtuar dhe me kohë kish filluar ndërtimi i shoqërisë komuniste.

Ishte radha e vajzave tani të ndërhyenin gati në një goje, duke folur për kohën e bukur, për lulet dhe për këngët.

Kastrioti riktheu vështrimin tek vajza me sytë plot ujëvara shelgjesh.

Ajo dukej ende e zhytur në kozmosin e saj.

Pas këtij çasti Kastrioti nuk mbante mend më hollësitë e mëpasshme.

Kishte qenë Natalja që në takimet e tyre të mëvonshme dashurore do të saktësonte detajet e asaj dite.

Ajo pati përmendur disa vargje të Nekrasovit, pastaj të Pushkinit dhe më vonë ishte bërë shumë llafazane.

Kastrioti po e shihte me një dritë të veçante në sy dhe ajo ishte skuqur e hutuar. Atëherë ai i kish buzëqeshur dhe asaj iu vesh me dritë verbuese e gjithë bota.

Ndërkohë Kastrioti i kishte shtrënguar lehtë bërrylin.

Pas asaj dite gjithçka kishte qenë më e zakonshme, bile ndonjëherë fare e zakonshme: takimi i dytë, i treti, i katërti, pastaj vajtja në shtëpi.

Kastrioti pati hyrë në një botë ëndrrash, në të cilën po ecte si somnambul, pa u përmendur e zgjuar asnjëherë.

Kur dashuria e tyre u bë objekt i diskutimit edhe në dhomat e shqiptarëve të shkollës së Aviacionit, dikush kishte thënë se Natalja ishte vajza më e bukur e atij qyteti.

”Ylli i tij” kishte shqiptuar një i dytë.

Kastrioti u shkëput nga ajo gjeratore marramendëse mendimesh.

Kishte arritur tek shtëpia e Nataljes dhe hapi deriçkën e oborrit.

Ai kopsht i vogël kishte lakra të mbjella pa ndonjë rregull.

Kishte gjithashtu një pemë vishnje dhe një berjozkë me lëkurën e saj pulla-pulla.

Kishte hedhur vetëm pak hapa në oborr, kur Natalja u dha tek dera.

Rrinte me duart e kryqëzuara në gjoks, sikur të donte të mbante zemrën se mos i delte nga kraharori.

-Kastriot! - thirri ajo me një dridhje malli në sy.

Ai kërceu shkallët drejt Nataljes dhe ajo mjegull e trashë që e kishte shoqëruar si ankth gjatë gjithë rrugës për këtu, u duk sikur ra mbi shpatullat e saj dhe u tret sakaq.

Ajo ishte e ngrohtë.

-Natasha! – bërbëlitë dhe ndjeu aromën e trëndafiltë të trupit të saj.

Ajo kishte dalë hollë, ashtu siç pati qenë në dhomën e ndënies.

-Sa u vonove? - tha me një dëshpërim gazmor dhe e mbështeti kokën në supin e tij.

Letra e tejdukshme e luleve kërciti mes tyre.

-Tulipanë!! - Klithi ajo hareshëm dhe e puthi në faqe.

Hynë në shtëpi të kapur për dore dhe ai, pa hequr as kapelën, u gjend mes Sergejit dhe Ninës.

Burrë e grua qenë çuar në këmbë.

-Biri im! - shqiptoi Sergei dhe i hodhi krahët e fortë mbi supe.

Nina i shihte të dy të përqaftuar dhe buzëqeshte.

Ky qe një rit që zhvillohej gjithnjë në shtëpinë e tyre kur vinte Kastrioti. Sergei do të bënte gjeste dashurie gjithmonë më tepër nga ç'e parafytyronte masën e nevojshme Nina.

Kur i shoqi e lëshoi nga krahët shqiptarin, ky ishte bërë i kuq flakë.

Punëtori pesëdhjetë vjeçar në një nga uzinat e qytetit i kishte krahët si një morsë.

Kastrioti i pyeti me pak fjalë se si qenë me shëndet dhe ata iu përgjigjën me gëzim se e kishin pasur mendjen gjithë javës tek ai. I thanë se ndonjëherë mund të vinte edhe në mes të javës, Natalja sikur mërzitej...

Kastrioti përmendi rregullat e rrepta ushtarake dhe se ai nuk mund t'i thyente ato.

Edhe Sergei dukej i çarmatosur: Kastrioti bën shumë mirë që nuk i thyen rregullat.

Ky gjeti me vend ta pyeste se si i kishte nga shtëpia në Shqipëri dhe veçanërisht si ishte i ati.

Sergei gjithnjë ndihej krenar për të atin e Kastriotit.

Ai punonte ambasador në një vend të perëndimit.

Pastaj biseda hyri në neutralitetin e saj.

Teksa po gatuante që Nina ajo që i dha ritëm të pazakonshëm.

-Edhe sot punuam një orë për Kubën - tha me zë të lartë.

Natalja, që po i vinte përpara Kastriotit disa moll, u duk sikur ngriu.

Ajo e njihte këtë natyrë të së ëmës.

Kur nuk pritej fare, ajo hapte një temë që dukej krejt e paimagjinueshme.

-Kështu na thonë të punojmë çdo të shtunë - vazhdoi ajo - Se kur do të mbarojmë së punuari për botën!

-Duhet të ndihmojmë revolucionin – e ngriti zërin si refren kënge Sergei.

-Po a e di ti se sheqeri për këtë ëmbëlsirë që po bëjmë sot, ka kushtuar edhe një orë radhë për Nataljen?

-Jemi në luftë me imperializmin - shqiptoi ceremonial i shoqi.

-Ç'luftë - tha Nina - Nuk e di të jemi në ndonjë luftë?!

Balli i Sergeit rrinte si nën një rrudhosje.

-Këtë gjë e di partia - shqiptoi vendosmërisht.

-Domethënë e di Hrushovi - vazhdoi Nina, tashmë pa fshehur zemërimin - Hrushovit i është bërë mendja misër.

-Prandaj nuk bëhet misri tre metër i lartë?! - thirri Sergei.

-Misrit i duhet parë kalliri dhe jo kashta.

-Ehu! - ja bëri më në fund i shoqi - Ti e ke inat Hrushovin.

-Po qe për inat unë më shumë kam Mikojanin - e ktheu furishëm përgjigjen Nina.

Biseda kishte shkuar larg.

Mbase nuk ishte vonë të kthehej paqja mbi zallahinë e saj.

Natalja hapi televizorin dhe në pritje të pamjes që do të dilte në ekran, biseda e nxehtë u ftoh njëherësh.

Kur qelqi i konkavët u mbush me dritë, u shfaqën dy boksierë që ndesheshin egërsisht.

-Gjithë bota u grindka! - qeshi Natalja dhe gazi i saj qëlloi si grip.

Ja shkrepri zërit të tij si bubullimë edhe Sergei.

Nuk vonoi edhe Nina.

Lumit të rrëmbyeshëm të gazit befas iu shtua klithja e Nataljes:

-Po fasulet, mama?

Nina brofi tek soba.

Rrezikonte të digjej gjella e preferuar e shqiptarit Kastriot, duke rrezikuar edhe vetë humorin e asaj mbrëmjeje.

Bombat bërthamore, armë të frikshme

Kishte rënë me kohë nata e thellë, kur Sergei, që sapo kishte dalë me Ninën në dhomën tjetër, hynë të veshur dhe u thanë se do të bënë një vizitë tek prindërit e Ninës, jo shumë larg prej andej.

Ata të dy le të rrinin në shtëpi, se jashtë bënte ftohtë.

Kastrioti u skuq.

Gjithnjë ai do të skuqej, kur do të vinte ky çast.

Rusët e kishin zakon që në një moment të caktuar të pasdites a mbrëmjes, sajnin ndonjë “vizitë” për ta lënë vetëm për vetëm vajzën me të dashurin e saj.

Sergei me të shoqen po iu thoshin se do të largoheshin për një vizitë dhe ata mund të bënë ç’të donin.

Kastrioti ndjeu valën e re të të nxehtit në fytyrë dhe nuk e deshi veten.

Me këtë zakon liberal të rusëve kishte jo pak bashkëkombës të tij që kishin abuzuar.

Por shpërdoruesit më të mëdhenj ishin ata që vendasit i quanin “demokratët tanë”, studentët e demokracive popullore të Evropës Qendrore.

Sergei me të shoqen dolën e Natalja i përcolli deri tek deriçka e oborrit.

Kur hyri ajo kish një ngjyrë të purpurt ndezur në fytyrë.

Iu hodh në krahë dhe u puthën për një kohë që dukej e pafund.

Kur përqaftimi i tyre i gjatë dha shenjat e shkëputjes, flokët e Nataljes ishin krejtësisht të shprishura.

Ajo u pa në pasqyrë dhe qeshi si e dalë mendsh.

Pastaj iu hodh sërish në krahë Kastriotit.

Se çfarë po transmetonte televizioni ata e vunë re shumë, shumë vonë.

Në ekran panë një dhomë të çuditshme ose më saktë një dhomë tunel me disa oxhaqe.

Atje kishte disa kostume kundërgaz e ca enë të tjera të sistemuara ftohtë e frikshëm.

Kamera po tregonte edhe një qoshe të dhomës-tunel ku ishin grumbulluar disa shishe vere.

U desh jo pak kohe që ata të kuptonin se përse po fliste spikeri i televizionit sovjetik.

Ishte një emision mbi mënyrën se si duhej të mbroheshin njerëzit nga bomba atomike.

Shtëpia e çuditshme, që nga jashtë dukej si sferë, qe një strehim antiatomik.

Ata e ndoqën emisionin gjer në fund.

Spikeri thoshte se nga një goditje bërthamore e Shteteve të Bashkuara të Amerikës e një kundërgoditje nga Bashkimi Sovjetik globit do t'i humbnin njëherësh, në pak minuta, rreth treqind milionë njerëz.

-Gjëra të frikshme - rënkoi Natalja - Po ndodhi Kjo unë do të vij të rri me ty.

Janë telefona të KGB-së

Në dhomën e tyre hyri Palushi.

Mbante gazetën lokale në dorë.

Rexhepi i ndoqi me vëmendje lëvizjet e tij automatike.

Kur hynte me gazete në dorë ai patjetër do të kishte botuar ndonjë artikull.

Në pritje që shokët e tij ta vinin re surprizën, Palushi shfrynte.

-Ke botuar ndonjë gjë? - nxitoi t'i jepte fund teatrit Rexhepi.

-Ma kanë shkurtuar fare - bëri tonin e zemëruar ardhësi dhe ua zgjati për ta parë.

-Petja Bardhosh!!

Ishte Bujari që pickoi zërin në mënyrë habitore.

-Qenka shkrim për revolucionin e tetorit, shtoi.

-Po afron festa e revolucionit të madh - shqiptoi me entuziazëm Palushi.

-Petja, o Petja, o Petja! Petja, Petja, Petja! - përqeshi Bujari. E paske rusifikuar emrin.

-E ka bërë gazeta. Ju e dini që unë firmos gjithnjë me emrin shqiptar.

Palushi ktheu kokën nga Kastrioti, heshtja e të cilit i theri më shumë.

-Ju betohem, marifete të tilla i ka bërë gazeta.

Sakaq në derë u dha Janaqi.

~Urra, djem! Në korridor po montohen telefona të rinj. Gati në çdo dy dritare ka nga një aparat.

Janaqi lëshoi këto fjalë dhe priti brohoritjet.

-"Tani mund t'i marrim vajzat në telefon kur të duam.

-Janë telefona të KGB-së - kërciti fjalët Kastriot Leka.

Hedhje me parashutë

Kishte qenë më saktë jo një alarm luftarak se sa një rreshtim i shkollës në alarm.

Smirnovi e kishte fantazinë të ndezur për alarmet dhe të gjithë njerëzit i deshi përherë në këmbë.

Në rreshtim kubanët u vonuan gati një gjysmë ore, por hungarezët e kapërcyen dyfishin e tyre.

Ndoshta me një fillim të zakonshëm stërvitor të ditës ata do të ishin treguar më të shkathët, por iu mjaftonte vetëm një sinjal alarmi dhe në çast të ngatërroheshin aq keq sa nuk arrinin dot të çliroheshin nga pizhamet.

Kjo gjë shkaktonte të qeshura tek të gjithë.

Nuk ngatërroheshin se nxitonin, por sepse iu dridheshin duart nga paniku.

Ndërsa tabori i oficerëve rusë po jepte urdhra që vietnamezët, para se të hahej mëngjesi të shkonin të pastronin banjat, dikush në rreshtat e shqiptarëve tha se një ditë më parë Smirnovi pati përjashtuar nga partia shoferin e tij, sepse ky ia kishte sjellë veturën në shtëpi me dhjetë minuta vonesë.

Të shpëtuar nga pizhamet më në fund hungarezët dolën dhe të gjithë i çuan të hanin mëngjesin.

Në mensën e madhe erdhi edhe Fjodori, një pilot rus i MIG-19, miqësuar kohët e fundit me shqiptarët.

-Sa zhurmë që bëjnë këta demokratët tanë! - psherëtiu Fjodori, tashmë i ulur pranë Kastriotit - Fricët!

Kështu rusët i thërrisnin hungarezët.

Pas kryengritjes së Budapestit më 1956 oficerët sovjetikë e kishin tepër të shpeshtë përbuzjen për ta.

Kastrioti nuk u përgjigj.

-Të kam sjellë një libër - pëshpëriti shurdhët rusi – Merre, por kujdes!

Ai i Ia një pako të hollë

-Është vëllimi i trembëdhjetë i Stalinit – vazhdoi pëshpërimën e tij Fjodori.

Kastrioti tundi kokën në heshtje.

Nuk e kishte kërkuar atë libër.

Flitej se piloti rus kishte fshehur pas bibliotekës së tij të gjitha veprat e Stalinit dhe shfrytëzonte rastet për t'i propaganduar.

Tani Fjodori ishte bërë më vigjilent, sepse një kolonel rus i kësaj shkolle që njihej për pikëpamjet e tij prostaliniane, ishte gjetur i vrarë në mes të rrugës me një tullë në kokë.

U vunë përsëri në rresht që të shkonin në aerodromin e shkollës ku edhe do të bëheshin hedhje me parashutë.

Ndërkohë që sovjetikët nisën këngën rreshtore “Hej, pjehota, nasha rota“ togat e shqiptarëve filluan marshin e Brigadës së Njëzetë Sulmuese.

Tek kalonin me hap të bukur tek postblloku, Misha, një rus ukrainas, të cilin e kishin mik të vjetër, nisi të zgërdhihej e t'i shante në shqip.

Rexhepit që s'i rrihej, ja ktheu me një sharje më të rëndë. Kjo u mirëprit aq shumë nga Misha sa iu lut në ecje e sipër t'ia përsëriste edhe një herë që ai ta mësonte mirë.

Kur mbërritën në aerodrom, para veturave të tyre po i prisnin Smirnovi dhe Lisenkua.

”Zimi” i madh dhe i zi i komandantit të shkollës ishte lënë mënjanë rrugës me derën e hapur.

Vetë Smirnovi që mbështetur tek ajo dhe po shihte ngultas ardhjen e kursantëve shumëkombësh.

Kur kaluan shqiptarët ai pati një tik nervor në cepin e buzës.

Lisenkua kishte mbyllur përgjysmë sytë dhe në picrimin e tyre derdhej me vrull një dritë e keqe.

Ndërsa parakalonte rreshti i gjatë i kursantëve, Smirnovi mori nga ndenjëset e “Zimit“ një kamxhik dhe nisi t’u bjerë çizmeve të verdha si për t’u shkundur pluhurin.

Në atë çast Kastrioti pa brenda veturës një dritë stopi të ndezur, ku dukej portreti i Hrushovit.

Kish dëgjuar që vite më parë ai atje mbante portretin e Stalinit.

Ndërsa nisën të vinin me veturat e tyre edhe instruktorët e specialiteteve, Maminkini, specialisti i lëndës parashutë, i doli përpara kolonës së kursantëve.

Fjalimi i rastit ishte i shkurtër.

Pastaj filloi kontrollin mjekësor.

Kastrioti bashkë me Rexhepin e Bujarin shkuan tek toga e vitit të parë. Të gjithë ata po i ndiqnin me frymën pezull lëvizjet e avionit të madh, prej të cilit do të hidheshin me parashutë.

-Kur të hapet dera e avionit dhe do të hidheni, ky është edhe momenti kyç - shpjegonte Bujari - Se atëherë sheh sa lart je mbi tokë dhe të zë frika e fillimit. Po kjo sa të mësohesh.

-Kapni njëri-tjetrin -porosiste Rexhepi.

-Kështu do të bëjmë - u përgjigj një nga kursantët e rinj shqiptarë - Të paktën vetëm të fundit të shtyjë instruktori.

Një pjesë qeshën.

Ndërkaq në avionin e hedhjes po hipnin hungarezët. Të gjithë i kishin ngulur sytë atje.

Pas pak avioni u shkëput rëndë nga pista dhe u kacavar pas qiellit.

Bënte një zhurmë të mbytur, si plak.

Tre minuta më vonë ai barkmadh ishte kthyer e po fluturonte mbi aerodrom. Tani hungarezët duhej të hidheshin.

Nga poshtë u duk edhe dera e avionit që u hap, por kurrkush nuk po dukej.

Aeroplani u largua përsëri si me përtim dhe u kthye sërish. Të gjithë panë përsëri derën e hapur, por asnjë nuk u hodh.

Asnjë parashutë nuk u hap.

Qielli ishte mbushur me ca re të ftohta dhe të largëta.

Në aerodrom ra ankth.

Pranë kursantëve të rinj në shesh erdhi edhe tekniku Mamaj i avionit MIG, i cili kishte vënë syze dielli.

Ai binte era vodkë.

Për Mamajin kishte plot thashetheme e po kaq edhe barsoleta. Po të vinte syze dielli prej kauçuku, kjo donte të thoshte se kishte pirë shumë dhe fshihte sytë e skuqur.

Mamaj ishte edhe tekniku më i mirë i avionëve MIG në aerodromin ushtarak që ishte aty pranë.

Avioni i parashutimit po kthehej për herën e tretë.

Smirnovi me mikrofon në dorë po bërtiste, kurse Lisenkua seç thoshte me nervozizëm dhe vërtitej si fugë rreth vetes.

Me sa duket ishte dhënë urdhri që hungarezët të shtyheshin me forcë. Dhe me të vërtetë nga dera e hapur fluturoi hungarezi i parë, pas pak i dyti...

Parashutat u hapën me një nxitim të marrë dhe vrapuan drejt tokës. Avioni mori edhe një kthesë tjetër dhe nisi të flakë ngarkesën e fundit, që i kish mbetur.

Kur aeroplani mori kursin e uljes, dikush me zë të lartë thirri: Të bëhen gati shqiptarët!

Kursantët e rinj shtrënguan dorën e njeri-tjetri dhe u nisën për kontrollin mjekësor. Tani tek grumbulli i shqiptarëve qenë mbledhur shumë të huaj.

Kubani Kutinjo shtrëngonte pëllëmbët e duarve dhe i tundte të bashkuara në ajër. Bullgari Josip u shkelte syrin, rumuni Dimitru u buzëqeshte, çeku Jaresllav Pupak u thërriste “kurajë”, kinezi Hu Shi dhe një kordon të tjerësh

pas tij, nxirrnin gjoksin përpara, ndoshta në shenjë solidariteti.

Kur shqiptarët kishin hipur dhe avioni po bënte fluturimin e parë në aerodrom, prej derës së tij kërceu parashuta e parë, më pas e dyta, e treta, e katërta.

Për një moment u duk sikur pëlhurat e bardha të mëndafshhta deshën të krijonin një tufë lulësh.

-Urra!-brohoriti turma e kursantëve në pistë.

Smirnovi tundi kokën me pëlqim dhe diçka i tha Lisenkos.

Veturat janë ideologjia me katër rrota

Janaqi ndjeu parfumin e saj.

Deri tani i kishte thënë vetëm se quhej Larisa.

Manikyrin e gishtave e kishte të purpurt e shndritës.

-Veturat janë ideologjia me katër rrota - buzëqeshi rusja.

Janaqi ende ndihej i tronditur.

Pak çaste më parë maja e këpucës së saj e kishte prekur poshtë tavolinës.

-Kush e ka thënë këtë gjë? - pyeti ai sa për të mbuluar turbullimin e tij.

-Dallesi - u përgjigj ajo.

Tani gishtat e saj të manikyrta po kërkonin duart e tij.

Aristokratja

Bujari nuk i kishte thënë kurrkujt se kish njohur më në fund edhe ai një vajzë.

Me të ngrënë drekën në mensë ai iku, duke u përpjekur të mos bjerë në sy. Më tepër i ruhej shpotive të Rexhepit. Iku vjedhurazi me një ndjenjë pendimi e vetëqortimi që nuk iu nda gjithë kohën.

Svjetllanën e mori në telefon nga një kabinë.

Zëri i saj iu duk për disa çaste shumë i largët.

Hajde, i kishte thënë ajo, hajde se po të pres.

Po vij, iu përgjigj dhe doli si furtunë nga kabina telefonike.

Një njeri që kish zënë radhën pas tij për të folur, e pa me habi atë ushtarak trupmadh e tmerrësisht të hutuar.

Bujari e kishte njohur Svjetllanën në bibliotekën e qytetit. Ai po përpiqej të gjente disa novela të Çehovit dhe ajo, me një

buzëqeshje marramendëse, por gjithsesi të përmbajtur, i premtoi se do t'ia gjente në botimin e tyre të parë, mjaft luksoz.

Pasi kishte kërkuar për pak minuta në fond, ajo ia kish sjellë, por tashmë Bujarit nuk i bëhej të largohej.

Buzëqeshja e ruses e mpinte.

Kështu Bujari i pati kërkuar edhe një libër tjetër, “Ana Kareninën”.

Svjetllana përsëri kishte hyrë në fond dhe sërish pati dalë me librin e ri në duar.

Çfarë t'i kërkonte më tani?

Ajo buzëqeshte dhe kishte një vështrim të pjerrët në sy.

E kish falënderuar dhe qe larguar.

Që atëherë sa herë që kish liridalje, ai shkonte në bibliotekë dhe kërkonte sa më shumë libra.

Pak nga pak Svjetllana e zbuloi dëshirën e saj:

,donte ta njihte më nga afër.

Ky vendosi t'i bënte ato hapa më tutje, por askujt nuk i tha në dhomë.

Në shtëpinë e Svjetllanës Bujari sot po shkonte për herë të parë. Ajo i kishte thënë se qe vajzë e vetme, se kishte gjyshen, të atin e të ëmën.

I pati dhënë edhe adresën e sot po e priste.

Deri tek ajo Bujarit iu desh të ndërronte dy trolejbusë.

Shtëpia e saj ishte dykatëshe, e futur mes një kopshti me vishnje.

Ai shkeli butonin e ziles elektrike dhe shtyu ngadalë portën e madhe të hekurt, e cila iu duk e rëndë dhe e një stili të vjetër.

Eci fare pak në kopsht dha sakaq u gjend para Svjetllanës.

Ajo po rrinte tek shkallët e mbushura plot me disa spërdredhje lulësh të çuditshme.

Svjetllana buzëqeshi.

Vetullat e hequra ndoshta pak çaste më parë, bënë një lakim të vogël.

-Mirë se të gjej, Svjetllana! - tha Bujari dhe u skuq i tëri.

Ajo binte një erë të mirë parfumesh e ai i pamësuar me to, ndjeu se u trullos.

Svjetllana i mori dorën dhe e futi në shtëpi.

Ishte një korridor i gjatë dhe disi i errët, në të cilin duhej të ecje me kujdes që të mos përplaseshe tek gardëroba, tek një frigorifer i madh apo tek nja dy statuja koka që e shihnin njeriun me një vështrim të vëngërt.

Kur hyri në një dhomë të madhe dhe që iu duk me më pak të papritura se korridori, ndjeu një farë qetësie dhe mundi të shohë me nge rreth e rrotull.

Me sa dukej ishte dhomë ndënieje. Gjysma e mureve qenë mbuluar me pllaka majolike dhe një stufë e madhe buburiste zjarr.

Bujarit nuk iu desh shumë që të kuptonte se në ambientin e kësaj shtëpie kishte diçka që vinte përtej revolucionit të tetorit, diçka që ai nuk po guxonte t'ia thoshte vetes.

Svjetllana po i dukej tashmë se edhe buzëqeshjen e kishte të kalkuluar.

Ajo u end disa çaste nëpër dhomë, solli piroshki e tortë dhe u ndje menjëherë era e mirë e çajit.

Një plakë shtatvogël dhe e kruspullosur hyri për pak çaste dhe kur Bujari i tha se qe shqiptar, ajo picërriti sytë e befasuar duke parë nga vajza.

Svjetllana iu përgjigj se Bujari ishte një shqiptar i mirë.

Plaka tundi kokën me një forcë që dukej e habitshme për atë trup kockan.

Bujari desh të sqaronte diçka rreth asaj "Ky është shqiptar i mirë", por ai mjedis, ku më tepër flitej me pëshpërima dhe duke përplasur lehtë buzët krijonte rreth e rrotull një frymë misteri dhe ai nuk e ndjeu gjuhën të aftë ta prishte atë ritëm të çuditshëm jete.

Ndërkohë që provonte piroshkit, gjyshja e Svjetllanës i tha se kish dëgjuar se shqiptarët nuk e kishin luftuar Stalinin.

Në zërin e saj u ngrit, bashkë me gërvimën e një astme, urrejtja për kryebolshevikun.

Bujari u ndodh ngushtë dhe pa nga Svjetllana. Politika e shtetit të vet ish ashtu siç thoshte plaka.

Vajza i ktheu vetëm një buzëqeshje si t'ia thoshte "më fal, gjyshja ndonjëherë...".

~Kemi hequr llahtar gjatë terrorit të kuq të Stalinit – bërbeliti gjyshja pa forcë zëri, por me një ton të rëndë - Të kuqtë të vrisnin në vend pa gjyq.

Në sytë e saj të zbardhulët shkëlqeu për një moment një flakë.

Svjetllana e pa përsëri Bujarin me atë buzëqeshje-vështtrim që kërkonte sërish falje.

-Ja, ai Stalini - vazhdoi plaka -të pushkatonte në vend pa gjyq. Kemi hequr tmerr deri sa shpëtuam. Tani Stalini e gjeti më në fund nga shokët e tij.

Pastaj ajo foli diçka në gjermanisht dhe Svjetllana iu përgjigj po në atë gjuhë.

Më vonë gjyshja u afrua tek stufa dhe u ktheu shpinën pa u thënë më asnjë fjalë.

Svjetllana e mori për dore Bujarin dhe pasi kaluan atë korridor të ngushtë, të cilin tani u përpoq ta shihte më me vëmendje, hynë në një dhomë të madhe e plot orendi që atij i kujtuan në çast një familje aristokratësh.

Disa portrete njerëzish po e shihnin nga kornizat e drunjta. Ndërkohë Svjetllana qe ulur pranë një pianoje dhe nisi t'i binte një pjese të Glinkës.

Bujari e ndjeu veten ngushtë.

Për herë të parë kishte pranë një njeri që i binte pianos.

Në fshatin e ti me fytyrë nga deti këndohej jo pa piano, por as edhe me një vegël të thjeshtë muzikore.

Kësaj radhe, përpara pianos dhe Svjetllanës, ai ndjeu diçka midis respektit dhe inferioritetit.

Më pas ajo nisi t'i bjerë një pjese të Çajkovskit dhe Bujari e la veten të ëndërronte.

Papritmas ajo ktheu kokën nga ai:

-Të mërzita?

-Jo,jo - shkundi kokën me vrull Bujari, - Letërsia dhe muzika më pëlqejnë.

Svjetllana prishi ekuilibrin e buzëqeshjes së saj dhe ajo u duk tani tepër intime:

-Vetëm letërsia dhe muzika tëë pëlqejnë?

Bujari nuk u gjend gati për të përballuar nëntekstin e fjalëve të porsa thëna. Por Svjetllana qeshi dhe u ngrit nga piano.

-Me Çajkovskin ne po çajmë në Amerikë - tha e diçka deshi të vazhdonte. Veç Bujari tashmë ishte bërë gati të lëshonte përgjigjen e tij.

-Kësaj radhe nuk më duket se e përdorët Çajkovskin për të sfiduar Amerikën.

Ajo qeshi shpenguar dhe bëri drejt tij.

Polemika

Bremeni vazhdoi të fliste edhe pse zilja kishte disa minuta që kishte rënë.

Ky ishte një zakon i tij dhe në radhët e fundit të auditorit me kohë pati nisur zhurma dhe kërcitja e karrigeve për t'i lënë të nënkuptonte se duhej të ikte një orë e më parë.

Leksionet e aeronavigacionit të këtij hebreu qenë shumë të mërzitshme.

Kastrioti i ndiqte se përpiquej që me çdo kusht të përfitonte, por njerëz si Rexhepi në më të shumtën e herës nuk do të gjendeshin aty.

Për shembull sot ai kishte ikur se “i dhembte dhëmballa”.

Këtë truk Rexhepi do ta zgjaste gjer në fund të orës së dytë, kur kishin historinë e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

Në këtë orë Rexhepi nuk rrinte pa bërë ndonjë sherr, kështu që edhe profesori i saj Rikteri e mori zët dhe e ndjente veten më të qetë kur nuk e shihte shqiptarin mes të tjerëve,

Bremeni më në fund iku, ndërkohë që pothuaj të gjithë studentët ushtarakë kishin dalë në korridor nga dera e dytë e auditorit.

Kastriot Leka ndenji në sallë.

Ndjente pak zymti në shpirt.

Sekretari i partisë i kishte kthyer përgjigje pozitive dëshirës së tij për të hyrë në Partinë e Punës. Gjer pak çaste më parë, kur kjo përgjigje ishte enigmë, ai ndjente ankth e pasiguri.

Tashmë që ajo kishte mbërritur krejt e padyshimtë, ndihej pa entuziazëm si të kishte marrë një haber të çfarëdoshëm. Ai shpesh nuk i kuptonte këto sjellje të tij.

Qe njeri shumë kontradiktor e jo rrallë edhe i pavendosur. Që fëmijë kishte lexuar Marksini dhe Engelsin, Ata i kishin lënë një përshtypje të mrekulluar.

I pëlqente edhe Lenini. Ky dukej si një mjeshtër i polemikës Politike.

Për Stalinin nuk kishte ndonjë përshtypje të plotë. Librat e tij nuk i konsideronte tërheqës dhe kish kohë që nuk i lexonte.

Kish vënë re se edhe në bibliotekën e të atit çuditërisht Stalini zinte shumë pak vend.

Këndin e saj më të bukur e zinte Marksi. Sigurisht edhe shumë fjalorë të mëdhenj e botime të perëndimit, libra me aromë e shkronja të kaltra.

Ai me kohë babanë e tij e takonte rrallë, kur vinte në atdhe me ndonjë shërbim urgjent apo pushim të shkurtër. Ato libra të tij ia kishin lehtësuar atë ndarjen e gjatë e jo rrallë të padurueshme.

-Përshtypjetë revolucionare shqiptarëve! - dëgjoji një zë pas Shpine.

Ishte Aleksej.

Kastrioti i tundi dorën i lodhur. Rusi nxori nga xhepi një gur të shndritshëm dhe filloi ta vërtiste nëpër duar.

-Është diamant - këndoi fjalët Aliosha.

Kastrioti pa fytyrën e tij të bukur vajzërore, ende të pa pastruar nga pushi.

Por sytë e rusit ishin më të shkathët. Ata u vërsulën drejt fytyrës së shqiptarit dhe kapën atë vështrimin e tij ironik e dyshues.

-Si është Natasha? - pyeti befas.

U bë nja heshtje e zymtë.

Kastriotit i erdhi një fjalë e rëndë në majë të gjuhës, por u përmbajt.

-Është shumë mirë - u përgjigj, duke iu lënë fjalëve shumë pak hapësirë mes dhëmbëve.

-Pse mu zemërove, të pyeta pa të keq.

-Çfarë do atëherë?

-Në institutin e tyre pati ca turbullira këtë javë.

Aleksej pa qetësisht alarmin që zbriti me aq humbje gjaku në fytyrën e Kastriotit.

-Ishte rebelizëm - vazhdoi rusi me lëkurë të pushtë.

-Po vjen Rikteri - thirri një zë dhe në auditor nisën të hyjnë Studentët. Me sa dukej kishte rënë zilja dhe ata të dy nuk e patën dëgjuar.

Aljoshë gërvishti një nënqeshje ngjyrë balte dhe u bë gati të thoshte edhe diçka tjetër, mbase të sqaronte se çfarë ishte ky rebelizmi apo turbullira e plasur në institutin e lartë të qytetit, por vetëm ngriti supet që të shfajësohej nga ardhja e Rikterit.

Bëri një kthim të shpejtë të trupit dhe u largua për në vendin e tij.

Kastriotit i dukej tashmë sikur i kishin vënë mbi shpatulla një gur të madh e të rëndë.

Me fjalën rebelizëm autoritetet zakonisht përcaktonin gjeste politike në mbrojtje të Stalinit.

-Shokë! - tha Rikteri.

Në auditor ra heshtje dhe ai tundi kokën e mbushur me flokë të mëdhenj e kaçurrel.

Ai ndërkohë kishte hapur fletoren e shënimeve dhe i hodhi një sy pjerrtas.

-Do të flasim për rrugën paqësore të kalimit në socializëm – vazhdoi - Do të marrim si shembull ngjarjet që ndodhën në Çekosllovakia pas Luftës së Dytë Botërore.

Ai bëri një pauzë spektakolare, i sigurt se duhej të rifillonte pasi tek studentët të konsumohej gjer në fund efekti i fjalëve të tij.

Nga fundi i sallës erdhi gjer në krye të saj një zhaurimë fjalësh zë ultë.

Rikteri vuri lehtë buzën në gaz, sepse e kishte marrë tashmë mesazhin e përshtypjeve tunduese që kishte lënë.

-Ju e dini fare mirë, shokë, - pasoi Rikteri - se në kushtet e reja që janë krijuar në botë konsiderohet e vjetruar pikëpamja dogmatike se për të kaluar në shoqërinë socialiste duhet lufta e armatosur ose siç thuhet shkencërisht, kalimi me dhunë për në socializëm.

Ai bëri një pauzë tjetër, të cilën e mbushi sërish me pak spektakël.

Në mes të dyqind studentëve ai nuk mund ta dinte atë çast se njëri prej tyre, shqiptari Kastriot Leka, po mbushej gjer në grykë me një zemërim të tmerrshëm.

Rikteri rinisi oratorinë e vet: Tanimë nuk mund të quhen veç pikëpamje luftënxitëse ato, ku këmbëngulet se në histori revolucionet bëhen me dhunë. Partia jonë dhe shoku Hrushov kanë konkluduar se kësaj i ka ikur koha dhe është mëkat që popujt të derdhin gjak.

Ai fliste e fliste.

Zakonisht me Rikterin studentët kishin polemika dhe jo rrallë atë e shoqëronte edhe vetë Lisenkua.

Kjo ndodhi pas ndërhyrjes së një shqiptari të vitit të dytë, i cili kishte brofur në këmbë e pati ulëritur "ky që bëni ju është revizionizëm".

Qe bërë një skandal i vërtetë.

Autoritetet e shkollës kishin protestuar pranë ambasadës dhe prej andej kishte ardhur urgjentisht atasheu ushtarak. Njeriu i ambasadës i kishte folur rëndë shqiptarit të ri dhe fjalët e tij dukeshin sikur thyheshin nëpër dhëmbë.

Studentët aty kishin ardhur për të mësuar dhe jo bërë politikë.

Diçka pati biseduar me Lisenkon dhe ishte larguar për në Moskë.

U fol se qe takuar edhe me komunistët shqiptarë që ishin në këtë shkollë, por asgjë nuk u morr vesh saktësisht.

Thjesht u tha se ata duhej t'u ruheshin provokacioneve.

Leksioni tani kishte hyrë në një fazë tjetër, në ngjarjet e Çekoslovakisë.

Rikteri po fliste ngadalë dhe i sigurt se pas Luftës së Dytë Botërore çekët me demonstrata paqësore kishin sjellë fitoren e socializmit.

Pastaj çifuti, që jepte historinë e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, tha “A ka pyetje”.

-Ka ndonjë pyetje? – foli sërish Rikteri.

Në këtë çast u dëgjua një trokitje në derë dhe u duk Rexhepi.

Çifuti u vrenjt menjëherë.

-Ku ishit kursanti Rexhep?

Tjetri bëri një lëvizje të dridhur të dorës, duke treguar në mënyrë aktorese një vend të fryrë të gojës.

-Hoqa dhëmballën, shoku profesor.

Dikush qeshi nga salla.

Kastriotit iu duk se ishte e qeshur kinezi.

-Ulu në vendin tënd! - i tha ashpër Rikteri dhe Rexhepi, mbasi endi vështrimin mbi kokat e kursantëve, dalloj grumbullin e shqiptarëve dhe nxitoi për aty.

-Thashë a ka pyetje? – përsëriti për të tretën herë Rikteri.

-Kam unë – u dëgjua një zë.

Ishte çuar çeku Jarosllav Pupak.

Rikteri rregulloi syzet dhe priti: Urdhëro, kursant, fol!

Pupaku heshti një moment, pastaj nisi të flasë rrëmbyeshëm.

-Ato që thatë ju janë plotësisht të drejta. Gjak është derdhur boll edhe nga populli ynë.

Auditorin e përfshiu zhurmërima.

"Po këtu po thuhet se nuk është derdhur gjak" - tha dikush.

Një tjetër: "Pupaku paska fjetur gjumë gjatë leksionit".

"Hajde Pupak, Pupak, na shkrive" – ngacmonte një zë hokatar.

Jarosllavi u përtyp për disa çaste krejt i hutuar.

-Luftë kemi bërë, edhe në mal, edhe në demonstrata – lëshoi me vërtik fjalët - Ne jemi një popull heroik. Unë di që kemi hequr vuajtje të mëdha, bile barbarizma mund t'u thuash, heroizma të pashoqe.

-Po, po - përsëriti ai - Gjatë luftës reparteve tona partizane u ka ndodhur që gjer edhe dy javë rresht të mos kenë të hanë veç bukë e sallam.

Rexhep Mema kërceu sikur ta kishte pickuar ndonjë grerëz.

Rreth tij shokët po përpiqeshin ta ulnin e t'i thoshin "rri se ke edhe dhëmballën të hequr", por personazhi i njohur i replikave me Rikterin nuk përpiquej të ulte as zërin, kur u përgjigj "Çfarë dhëmballe, unë i kam të gjitha shëndoshë si molla".

Ishte e kotë.

Rexhepi qe kthyer nga çeku.

-More ti, Jarosllav! Bukë e sallam the ti se paskan ngrënë partizanët çekë dhe e quake heroizëm? Mund të thuash se u munguan ca vitamina. More vëlla, partizanët tanë në Shqipëri rrinin me javë të tëra duke ngrënë bukë e qepë. Ndodhte që patën ngrënë edhe nga një kalli misri të zierë. Ti thua heroizëm me bukë e sallam?!

-Bukë e qepë?! - hapi sytë Pupaku - Nuk është e mundur.

-Oj, s'është e mundur?! Po unë babanë partizan e kam pasur. Ne si shtëpi sallam kemi ngrënë vetëm pas çlirimit.

-Pse nuk keni pasur sallam para çlirimit ju shqiptarët?!-
Çeku Jarosllav ishte shtangur fare.
Dikush lëshoi një piskamë të qeshuri.
Rikteri nuk dinte ç'të bënte.
Zilja ra me një tingull të ngjirur.
Kastriot Leka ndjeu se zemërimi prej fjalëve të Aljoshës i
ishte fashitur, por thellë gjoksit zemra i klithi “Natalja,
Natalja!”

"Gjithçka në rregull"

Natalja si zakonisht kish ndenjur tek dritarja dhe me të parë Kastriotin të kërcente te pragu i deriçkës, vrapoi për t'i dalë përpara.

Mollëzat e faqeve i digjeshin prush.

-Sa u vonove! - i tha ajo, duke çuar kokën nga supi i tij e duke kërkuar sytë në gjysmë errësirën e korridorit.

Ai e shtrëngoi fort dhe ajo pati një si rënkim të vogël.

Kur hynë në kuzhinë Nina ishte mbledhur pas sobës, kurse Sergeji po gatuante.

Të dy e përqaftuan Kastriotin qetësisht e sipas ritit të zakonshëm dhe ai nuk po kuptonte dot asgjë.

Në Institutin e Lartë kishte pasur gati demonstratë, atje flitej se ishte përzierë edhe Natalja e këtu nuk kishte veç një sjellje indiferente e moskokëçarëse.

Fjalët e Aljoshës në sallën e auditorit donin t'i kumtonin mesazhin se e dashura e tij qe pleksur në një punë jo aq pa pasoja dhe kjo nuk ishte pak për t'u shqetësuar.

Aspak i dëshirë për një skenë të tillë Kastrioti gjeti rastin dhe e pyeti Sergejin se si i venin punët.

-Vsjo vë porjadke (gjithçka në rregull) - mori përgjigjen prej tij, ndërsa kthente në furin e sobës ca mish.

Kështu, mendoi me vete Kastrioti, gjithçka duket në rregull për baba Sergejin, kurse në të vërtetë ngjarjet nuk janë aq në rregull.

Pa nga Natalja.

Në sytë e saj, pas kësaj "Vsjo vë porjadke" të të atit, kishte një trishtim e mërzi bashkë.

-Lexoje! - i tha.

Natalja mbante në dorë një fletore të trashë e të mbështjellë me kujdes.

Kastrioti e pa me një vështrim të tillë, sikur t'i thoshte “ç’do kjo fletore këtu?”, por Natalja nuk foli. Ajo ia la atë në duar dhe u tërhoq në skajin tjetër të kanapesë.

Kastriot Leka zbuloi kapakun dhe nisi të shfletonte ngadalë.

Pastaj e ngriu vështrimin në rreshtat e saj:

“Po i shkruaj këto radhë dhe ende nuk pa e kuptoj përse kam humbur qetësinë e zakonshme, me të cilën jam ulur gjithnjë të mbush faqet e këtij ditari.

Shqetësimi im është i kuptueshëm, sepse unë për herë të parë po shkruaj për “politikë”.

Unë nuk e kam qejf atë dhe jam e lumtur që më ndodh kështu.

Politika mua më tremb, mi prish ëndrrat, ma turbullon qetësinë e shpirtit, më lodh, më merr dashurinë për botën.

Sigurisht nuk nga ata apolitikë që thonë për çdo gjë “Znajet CEKA”, “naçalstvo znajet”, (e di udhëheqja).

Këta njerëz, edhe pse bëjnë indiferencën për të, në të vërtetë këtë gjë e kryejnë në emër të politikës.

Unë besoj se jam nga ato qenie njerëzore që them me zë të lartë “k çjortu politika” (në djall politika).

Por po të rrish e të shkruash për ngjarjet e fundit në Institut, gjëja e parë që provoje ishte se politika më ka dalë përpara dhe më ka prerë rrugën.

Jo rrugën për në Institut, por për në shtëpi, as atë për në teatër apo për patinazh.

Ajo më ka prerë rrugën për tek Kastrioti,

Institutin tonë ka rrezik ta mbyllin për ca kohë. Përfshirë në rebelizëm të studentëve për revoltë, në kryengritje e sabotim kundër shtetit sovjetik.

Nuk po e kuptoj çfarë po ndodh, cili bëri kryengritje dhe ku u bë revolta, kush sabotoi e përse u rebeluan.

Në qoftë se themi se jemi socialistë dhe tek ne ka demokraci, nuk kish pse të vihej kuja e të mendohej se disa studentë ishin ngritur kundër socializmit.

Mua më duket se çdo njeri ka të drejtë të mendojë diçka për atë apo këtë gjë që ka ndodhur edhe pse kjo gjë nuk i pëlqen një personi lart apo një qeverie të tërë.

Si është e mundur që shteti sovjetik gënjen?

Ato që ndodhën në Institutin tonë janë tepër të thjeshta e të rënda njëkohësisht.

Ato kanë lidhje me Shqipërinë.

Po, as më shumë dhe as më pak, por me Shqipërinë.

Kur t'i lexojë këto radhë Kastrioti, ndoshta do të habitet.

Si paskam braktisur dashurinë dhe faqet e këtij ditari intim i kam hapur për politikën.

E ndoshta mërzitet.

Unë kësaj radhe po shkruaj përsëri për dashurinë time, për Kastriotin, sepse edhe shkak për atë që ndodhi në institut midis studentëve ishte pikërisht Shqipëria.

Ç'është e vërteta ka disa kohë që midis studentëve qarkullojnë fjalë se Shqipëria ka tradhtuar kampin socialist për një mbledhje të Bukureshtit, ku një nga udhëheqësit e Shqipërisë, më duket zëvendësi i Enver Hoxhës, ka folur shumë keq kundër Bashkimit Sovjetik.

Këto lajme erdhën si thashetheme, por studentët menjëherë u ndanë në dy grupe.

Disa mendonin se Shqipëria e ka bërë vërtet këtë gjë, kurse një pjesë nuk e besonin.

Këto thashetheme ka mundësi që unë t'i kem dëgjuar e fundit.

Në fakt unë i mora vesh ato vetëm kur në Institut erdhën njerëz nga policia dhe CEKA.

Se çfarë qenka bërë në Bukuresht unë nuk e di. Dhe as dua ta di.

Thonë se është bërë një mbledhje kundër Kinës. Shqipëria qenka bashkuar me kinezët dhe të dy palët qenkan ngritur kundër nesh.

Ndoshta është kështu, sepse politika vetëm sherr sjell dhe nuk di t'i pajtojë njerëzit.

Mua një gjë më duket e çuditshme: përse egërsohen kaq shumë njerëzit e qeverisë e partisë sonë?

Shqipëria është një vend i vogël, ajo nuk mund t'i bëjë gjë Bashkimit Sovjetik.

Tani thonë se edhe unë jam shprehur në favor të këtij vendi fare të vogël. Më thirrën në drejtori dhe më paralajmëruan për largim nga shkolla.

Ndërsa unë nuk kam bërë asgjë.

Thashë vetëm “mos i bini në qafë Shqipërisë”.

Këtë gjë e them edhe tani: “Ju lutem, mos i bini më qafë asaj, mos i ndërprisni ndihmat, mos i bllokoni furnizimin me grurë, i lini fëmijët e tyre të ulen në tavolinë dhe të hanë mëngjesin para se të shkojnë në shkollë!”

Edhe unë lutem: mos e braktisni Shqipërinë, doajeni atë popull! Ata janë njerëz të mirë. Qeveritë le të grinden, por popujt jo, ata nuk duhet t'i bëjnë kërcënime njeri-tjetrit.

Ja kaq thashë, kaq kam thënë, kaq do të them edhe njëmijë herë të tjera.

Kam të drejtë të flas kështu?

Besoj se po.

Shqipëria është atdheu i njeriut më të dashur që kam, prandaj ai është edhe atdheu im.

Do të jetë atdheu im, shtëpia ime do të ngrihet në atë tokë të largët prej viseve ku kam lindur.

Atje do të lindin edhe fëmijët e mi."

Kastrioti ndjeu ngashërim.

Në skaj të kanapesë Natalja e vështronte me sy të lagur.

-Kam dëshirë të përqafoj - shqiptoi me buzë të dridhura.

As vetë nuk e kuptoi përse bëri atë deklaratë që i kuptohej në çdo lëvizje të trupit.

Ajo thirri fjalë loti dhe iu hodh në krahë:

-O Zot,sa të dua!

Sytë e Larisës

Në korridorin e gjerë të katit të parë të uçelishes, atje ku edhe gjithnjë kaloheshin pushimet midis seancave të leksioneve, Larisa po vështronte me sytë e saj të bardhë turmën njerëzore që dallgëzohej në lëvizjen e saj të pambarimtë.

Ja tani, nga kati i dytë, nëpër shkallët e mëdha, duhej të zbrisnin studentët shqiptarë të vitit të tretë.

Ajo uli sytë e lodhur nga ngulmimi.

Pikërisht atë çast e ndjeu ardhjen e tyre.

Ata po zbrisnin si gjithnjë bashkë.

Kohët e fundit atyre sikur iu mungonin ato çapkënlleqet e para e që i bënin, ç'është e vërteta, pa kursim.

Ishin shndërruar në të rinj seriozë, më të heshtur e fjalëpakë.

Ata kishin zbritur në hollin e madh të katit të parë dhe Larisa mund t'i shihte mjaft mirë nga ai vend.

Në fillim ajo kërkoi me sy dhe alarm ta gjente Janaqin. Vetëm ai e dinte se ku rrinte Larisa në pritje të tij këto kohët e fundit, pas dashurisë së tyre aq të shpejtë, ishte pikërisht kjo qoshe, ku ndodhej tani.

Ajo u drodh e tëra.

Janaqi nuk ishte mes turmës së shqiptarëve.

Ai u shfaq shumë vonë tek zbriste ngadalë shkallët.

Ishte i vetëm, shumë i mërzhitur. Tashmë ajo po e ndiqte me ngulm e ankth.

Janaqi gjithnjë prej andej do t'i hidhte vështrimin e do ta përshëndeste lehtë me një lëvizje të dorës. Pastaj gati pa

rënë në sy të shokëve, çante mes turmës njerëzore dhe gjendej përballë saj.

Gjithnjë me sytë që i shkëlqenin nga dashuria, gjithnjë sikur fluturonte.

Dhe ajo gjithmonë do të bënte të njëjtin gjest të menduar ftohtë që më parë: do ta shihte me zjarr në sy, pastaj do të përkëdhelte me vështrim nishanin në faqen e majtë dhe më në fund, me një epsh, që e linte të dukej aq fort sa Janaqin ta paralizonte hutimi.

Pastaj do të ulte sytë e saj të bardhë tek buzët e tij të lëngëta dhe gjithë tul.

Larisa po ndiqte me alarm lëvizjet e studentit shqiptar.

Ai kishte kapërcyer disa shkallë, por megjithatë ende nuk po shihte nga ajo.

"Ah, ajo natë e mallkuar!"

Ajo e kishte ftuar Janaqin me dëshirën që të flinte ma të.

Djalin e vogël e kishte vënë me kohë në gjumë dhe ata të dy hanin nga tavolina e mbushur plot e pinin ngadalë verë.

Kishin kthyer nga ai lëng i kuq e mpirës për një kohë të gjatë dhe më në fund në sytë e shqiptarit kishte rënë perdja mjegullore e dehjes.

Pati kaluar ora, kur duhej të kthehej në fjetinë dhe Larisa tani gjithçka e shihte të sigurt. Por ai krejt befas, fytyrë skuqur dhe me vështrim të tymtë, ja kishte ngulur sytë orës së murit dhe kish brofur me alarm.

Larisa i pati dalë përpara dhe i kish hapur krahët të mos e linte të ikte.

Nuk kish harruar që me kujdes të mbështeste gjoksin e saj në trupin e tij dhe ky më në fund ishte shkrehur i tëri.

Qe ulur sërish në kolltukun e vet, krejt i pafuqi, shumë i turbulluar. Të linte përshtypjen se truri edhe pse tashmë i punonte plogët, ende nuk ishte bllokuar.

Ajo kish hapur menjëherë magnetofonin dhe e kishte lënë për një kohë të gjatë të dëgjonte muzikë. Vetë rrinte dhe e

shihte në heshtje, me shpresë që valset ruse do të vepronin më shpejtë në mpirjen e tij.

Asaj nuk i pëlqenin sytë e Janaqit. Ishin tepër dyshues dhe nuk po i dorëzoheshin tundimit.

Larisa e kuptoi se ai po luftonte me veten.

Ndoshta rrëzohej, mbase i binte në gjoks atë natë dhe gjithçka lehtësohej përfundimisht.

Ky do to ishte edhe sukcesi i saj i parë i asaj fund vjeshte.

Shefat e kishin porositur që ajo të komprometonte sa më shumë studentë shqiptarë të asaj shkolle aviacioni.

Larisa nënqeshi hidhur.

Shefat nuk ia kishin shpjeguar përse duhej të bënte sa më shumë shqiptarë pro politikës së Hrushovit. Ndoshta mendohej të provokoheshin largime masive të tyre nga Shqipëria dhe deklarime publike kundër Enver Hoxhës, Mbase shefat e saj shihnin edhe më larg.

Asaj kjo gjë pak i interesonte. Detyrën e vet e kishte gjer në çastin, kur Janaqi do të pranonte të mbetej në Bashkimin Sovjetik për punë në seksionin shqiptar të Radio-Moskës.

Kaq.

Madje këtë natë kishte qejf të punonte ca edhe për llogari të vet. Donte të bënte qejf.

Fundi dhe kjo ishte hallkë e punës së saj të fshehtë.

Veç ata sytë e Janaqit nuk po visheshin plotësisht, ende pulsonin mendime, akoma kërkonin të kapnin diçka, të kuptonin.

Ajo u tremb.

Shqiptari u duk disa herë se donte sërish të çohet.

U bë gati t'i zinte rrugën e ikjes me gjoksin e saj të nxehtë.

Tashmë ishte çkopsitur aq shumë prej bluzës sa dukej mjaftueshëm për goditjen e fundit dehëse.

Me fytyrë të ndërruar e me një zë që asaj nuk iu duk si i Janaqit, ai e pyeti përse nuk e kishte parë në atë shtëpi fotografinë e të shoqit.

Larisa mungesën e tij e pati shpjeguar se bashkëshortin e kishte inxhinier nafte dhe punonte në Shqipëri.

Nga pyetja e kthjellët e aviatorit ajo ishte rrëqethur gjer në majë të gishtave të këmbës dhe duart ia zbuluan dridhjen e brendshme.

Janaqi nuk kishte pritur përgjigjen e saj, por pati vazhduar t'i fliste me atë zërin e shndërruar krejtësisht.

I kish thënë se edhe në bisedën e gjatë prej më tepër se tre orësh ajo nuk ia kishte zënë në gojë të shoqin. Kurse ai kishte pasur kaq shumë dëshirë t'i fliste për të, në qoftë se ekzistonte.

Po të flisje për të, po thoshte, patjetër do të flisje edhe për atdheun tim.

Larisa vetëtimthi kishte sjellë idenë se ky njeri po i shpëtonte nga duart.

Sipas shefave të saj, ai kishte qenë një nga hallkat më të dobëta të studentëve shqiptarë. Njihej se i pëlqente femrat dhe ato klub netët e jetës modeme.

Larisa ishte treguar e pavëmendshme dhe pati lënë mundësi që atë ta brente dyshimi i parë.

Pastaj Janaqi u çua.

I merreshin këmbët, por rrugën drejt derës e gjeti.

Asaj i vinte t'i bërtiste, ta kapte prej flokësh, ta përplaste në mur, ta vdiste.

Kapotën ai e mori vetë, por ndërsa përpiqej ta hidhte mbi supe, ajo i ra.

Larisa nxitoi t'ia merrte dhe këtu ndodhi mrekullia. Vetëtimthi ajo pa sytë e shqiptarit dhe kuptoi se ata ishin dehur plotësisht.

Asgjë nuk pulsonte më atje. Asgjë nuk kërkohej, asgjë nuk jepte shpresë se përpiqej të kuptonte nga çfarë po ndodhte rreth tij.

Ajo e kapi prej beli dhe koka e Janaqit i ra mbi gjoksin e zbuluar...

Në mëngjes ai nuk mbante mend asgjë.

U zgjua shumë vonë dhe e shihte si fëmijë i bindur.

Ishte larguar pasdite dhe dukej si njeri prej qelqi.

Larisa nuk i hapi fare bisedën e projektuar që më parë me shefat e saj, sepse instinkti i femrës i përcillte këmbëngulshim alarmin se në një qoshe të trurit të Janaqit nuk ishte zhdukur ai dyshimi për të shoqin e saj imagjinar e që ndodhej në Shqipëri.

Gjithçka ishte sajuar për të lehtësuar komprometimin e aviatorit, duke ditur se shqiptarët nuk ishin më pak nacionalistë se vetë rusët.

Por Janaqi sot zbriti shkallët e katit të dytë dhe nuk i hodhi sytë nga ajo.

Çfarë duhej të kishte ndodhur me të?

Po e largonte ai dyshimi i asaj nate apo...

Sytë e Larisës kapën pamjen e Bujar Andonit. Trupi i tij i madh e disi i pa vrullshëm, fytyra naive, ndezën tek ajo flakën përpëlitëse të idesë se ai mund të shndërrohej në viktimën tjetër.

Dy ngjarje

Në ditët e para të nëntorit dy ngjarje tronditën shkollën e aviacionit.

1.

Në një orë të paradites u hodh nga dritarja e katit të tretë të konviktit, ku banonin shqiptarët, busti i Stalinit.

Rexhepi, i cili pati ndodhur në dhomë nga që kishte pasur pak dhimbje koke, me të dëgjuar zhurmën, doli në korridorin e katit.

Busti prej allçie kishte prodhuar një krismë bombe.

Ndoshta për arsyen se brenda ishte krejt bosh.

Megjithatë shqiptari ia kishte dalë operacionit të tij.

Pasi iu vërsul poshtë shkallëve, në katin e parë e pati mbërthyer njeriun që kishte hedhur përdhe bustin.

Ky qe gjeorgjiani Ekvtime.

-Ptul! - e kishte pështyrë - E ke edhe nga vendi yt!

Ekvtimeja pati ngrirë me stërkalat e pështymës në fytyrë.

Ai qe i armatosur me pistoletë dhe kush kalonte aty afër u nemit. Por gjeorgjiani nuk e kishte hedhur dorën mbi armë.

Ky bust që kishte flakur ishte i fundit dhe i vetmi në atë konvikt dhe në të gjithë shkollën.

Ishte i studentëve shqiptarë dhe rrinte në dhomën e tyre të partisë. Deri tani ata nuk kishin lejuar t'ua prekte njeri, por edhe nga të tjerët respektohej ky pëlqim i shqiptarëve.

Tashmë njiheshin si mos kritikues të Stalinit.

Siç duket autoritetet sovjetike të shkollës e kishin konsideruar tashmë të pa tolerueshme qëndrimin e

mëtejshëm të bustit. Ai binte ndesh me kursin e tyre politik.

Ata kishin tentuar fa hiqnin pak muaj më parë, por disa kursantë shqiptarë kishin kërcënuar me grevë urie dhe prandaj qenë tërhequr.

Njëri prej tyre, ndoshta më i guximshmi, u kish thënë se e kuptonte sjelljen e miqve të tyre sovjetikë. Këta e kishin denoncuar Stalinin për krime dhe patën marrë vendimin publik për heqjen e busteve të tij.

Por edhe shqiptarët duhej t'i kuptonin.

Udhëheqësit e tyre mendonin ndryshe dhe studentët shqiptarë në këtë shkollë sovjetike aviacioni nuk duhej të dilnin kundër kursit të tyre. Ne nuk pretendojmë që bustet e Stalinit të mbushin auditorët dhe konviktet, ne duam ta mbajmë vetëm në dhomën tonë të partisë. Madje ne e quajmë atë si edhe ju, "Dhoma e Leninit" e për Vladimir Iliçin, si edhe ju, kemi respekt.

Kështu autoritetet qenë rikthyer pa realizuar vendimin e tyre.

Ndoshta gjer në këtë çast, kur kishin dërguar Ekvtime në. Fundi ishte më mirë që një gjeorgjianës të thyente kokën e një gjeorgjiani.

Ekvtimeja kishte kohë që ishte larguar, kur aty mbërritën shumë kursantë shqiptarë dhe jo pak nga "demokratët tanë".

Në turmën e studentëve plasi një polemikë e madhe.

Më i kudogjenduri ishte Aleksej.

Ai thërriste: -Ku janë gjithë ata oficerë të lavdishëm të vendit tonë? Ku është Tukaçevski, ai hero? Ku janë ata teoricienë të mëdhenj si Kamenievi dhe Zinovievi, që i persekutuan me brutalitet, sepse donin lavdinë e shtetit të madh sovjetik? A mund të rrimë ne leninistët e rinj pa folur për kampet e tmerrshme të përqendrimit, ku u tretën rinia e shpresa e atdheut? Stalini është një kriminel i

zakonshëm, ai është një huligan dhe këtë e di e gjithë bota. Atëherë përse duhet të jemi dogmatikë dhe pse duhet të mbrojmë dogmatizmin?

Kastriot Leka shihte copat e thyera të bustit dhe nuk i hiqte sytë prej andej.

Stalini ishte shndërruar në një gjysmë hundë, diku një pjesë e ballit me një sy, më tej spaleta e djathtë e gjenalisimit bashkë me një xhep të xhaketës ushtarake.

Mustaqet rrinin ndarë më dysh duke marrë pas vetes edhe nga një pjesë buze.

Kastriotit iu kujtua një libër për regjisorin francez Kokto, ku një film i tërë ishte xhiruar me bashkimin deri edhe absurd të pjesëve të ndryshme të një trupi njerëzor. -

-Ky është një provokacion! Provokacion!

Zëri që thërriste ishte i sekretarit të tyre të partisë.

Ai qe krejt i mavijosur prej zemërimit.

Kastrioti më në fund i hodhi sytë nga Stalini i thyer dhe ndjeu se nuk kishte përse të bërtiste e klithte.

Stalini?!

Ai e donte komunizmin, por nuk e ndjente të afërt këtë njeri.

Mbase nuk e donte.

Ndoshta diku thellë qenies së tij rrinte buzagazi i të atit, me atë jakën e këmishës nxjerrë mbi xhaketë.

Ndërkohë sekretari i partisë kishte hyrë mes kursantëve dhe po thoshte diçka. Dëgjohej qartazi vetëm fjala “shokë”. Duhej të shkonte atje.

Më mirë bashkëkombësin e tij se rropamat e zërit të Aleksejit, i cili dukej se bërtiste edhe enkas për të.

Ai po largohej e nuk vuri re se Maria, pastruesja e katit të tyre të konviktit, po mblidhte pjesët e shpërndara të bustit prej allçie dhe po qante heshtur.

2.

Ngjarja e dytë ndodhi ditën tjetër, pothuajse në të njëjtën orë.

Në një nga “Dhomat e Leninit“ të godinës së konviktit ku më të shumtët qenë rusë, u gjet portreti i Hrushovit i goditur mbi tridhjetë herë me një armë sportive.

Pas kësaj ngjarjeje të bujshme orët e mësimit u bënë më të shkurtra, disa leksione pothuaj nuk nisën fare e disa sa vetëm filluan pa shkuar kurrë gjer në fund.

Askush nuk e kishte mendjen në ato që thuhej e shkruhej në dërrasat e zeza.

U hap me shpejtësi fjala se këtë punë e kishin bërë shqiptarët si përgjigje për thyerjen e bustit të Stalinit. Por në këtë kohë që mendohej se fotografia e Hrushovit ishte qëlluar me pushkë sportive, asnjë shqiptar nuk ishte parë aty rreth e rrotull.

Megjithatë thashethemet e hamendjet zienin.

U pyetën me radhë pastrueset, por ato pohuan se nuk kishin parë njeri me armë sportive të dilte nëpër korridor.

Nuk kishin dëgjuar as krisma armësh.

Të dërguarit e drejtorisë sqaronin se armët sportive pothuaj nuk bëjnë zhurmë dhe nuk po u kërkonte njeri të pranonin ekzistencën e krismave.

Atëherë ato tundnin kokat dhe thoshin se sido që të ishte ato nuk kishin parë të huaj të hynte, përveç oficerit të rojës që u ishte hakërryer të mos fusnin njerëz brenda.

U krijua një situatë e ndërlikuar.

Shqiptarët u mblodhën grupe-grupe dhe ndiheshin të shqetësuar.

Dyshimi se këtë gjest mund ta kishte kryer ndonjëri prej tyre ra shpejt.

Fati që këmbëngulën se ai ishte 'një provokacion sovjetik për t'i fajësuar si terroristë.

Moska dhe Tirana kishin hyrë në një luftë tashmë të ashpër dhe aviatorët shqiptarë mund të gjendeshin pretekst për ta ashpërsuar edhe më këtë duel midis Enver Hoxhës dhe Hrushovit.

Ndoshta edhe përgatitej justifikimi i ndonjë mase izoluese dhe represive ndaj Shqipërisë.

Kursantët e asaj shkolle mund të ishin “gozhda” ku mund të varej “xhaketa”.

Pasdite filluan t'i thërritnin një nga një në komandë.

Moskoviti elegant

Ngjarja ishte rrokullisur ashtu siç edhe e kishin hamendësuar: qe shndërruar në një incident mes dy qeverive.

Njëzetë e katër orë pas zhurmës së madhe publike të radios dhe televizionit shtetëror sovjetik, hetimet u ndërprejnë dhe ra një qetësi rutinë.

Kursantët shqiptarë nuk u thirrën më në komandë dhe as në dy zyra të liruara për disa civilë të ardhur nga kryeqyteti.

Kishte reshtur edhe thashethemi se e gjithë ngjarja mund të përfundonte me ndonjë arrestim.

Në këto ditë boshe, kur civilët nga Moska ikën dhe Lisenkua e Smirnovi silleshin nëpër mjediset e shkollës sikur të mos kishte ndodhur gjë, e trazoi ankthin e njerëzve një fjalënjajë se mbi tridhjetë plumbat sportivë tek portreti i Hrushovit ishin hedhur në një konvikt tjetër dhe vetëm sa qenë vendosur në godinën e shqiptarëve.

Autorët e këtij varianti deklarorin se vrimat ishin në letrën e trashë të portretit, por nuk gjendeshin mbi dërrasën e sheshtë, ku zakonisht rrinte ai.

Jo më kot, arsyetonin ata, portreti ishte marrë nga hetuesit bashkë me mbështetësen e tij të drunjtë, çka dukej jo e zakonshme.

U fikën edhe hamendjet se organizatorët e fshehtë të provokacionit kishin pasur për objekt kinezët, por pastaj, për shkak të një gabimi mediokër të tyre, ngjarja ishte adresuar për shqiptarët.

Përhapësit e kësaj teze e quanin me vend t'u kujtonin dëgjuesve se Shqipërinë e vogël asnjë nuk e llogariste në fushëbetejën botërore të politikës, ku ishte pleksur ballafaqimi mes dy grupeve të kampit socialist, kinezëve dhe sovjetikëve.

U shuajt edhe pëshpëritja se kishte pasur një grup të vogël kursantësh shqiptarë, të cilët kishin firmosur një deklaratë kundër politikës së partisë dhe shtetit të tyre e në përkrahje të asaj sovjetike.

Të pyetur veças apo në grup asnjë shqiptar nuk e pranonte hipotezën e fundit.

Në të kundërt, me iniciativën e sekretarit të tyre të partisë, ata firmosën një protestë për drejtuesit e shkollës, të cilët i adresuan akuzat ndaj tyre qëllimisht dhe pa asnjë provë.

Ditën e tretë të heshtjes u kuptua se ngjarja kishte pasur mision propagandistik dhe se tani synohej të harrohej sa më shpejt.

Nuk u bë fjalë më as për gjetjen e autorit.

Në fund të javës Kastriot Leka mori një "propuskë" (lejedalje) dhe u nis për tek Natalja.

As autoritetet e shkollës dhe as ato dy zyrat e hapura rishtas nuk e kishin thirrur.

Në një farë mënyre ai këtë lajm ia kishte përcjellë të dashurës së tij e më në fund ajo ishte qetësuar.

Kishte dalë nga rruga e gjatë dhe e heshtur që lidhte shkollën ushtarake me qytetin dhe iu afrua stacionit më të parë të trolejbusit, kur pa se drejt tij po vinte një veturë "Moskviç", e gjitha e zhytur në ngjyrë blu.

Ai që e drejtonte hapi derën dhe i doli përpara.

-Më quajnë Gromov, Gromov Nikoliajeviç.

Kastrioti nuk u gjend gati t'i kthente një përgjigje kortezie.

Vetëm e shihte në sy dhe kërkonte fjalët.

Por ato e kishin braktisur.

-Jam dashamirës - vazhdoi tjetri.

Ishte i veshur me një pallto me stof të trashë anglez, një shall hedhur qafës si poet dhe një borsalinë që ende e mbante paksa të ngritur mbi një palë flokë të zinj e plot shkëlqim.

Shqiptari më në fund i zgjati dorën.

I porsaardhuri e kish të vetën si të mëndafshtë.

-Më quajnë Kastriot Leka.

-E di, pikërisht se e di edhe dua t'ju takoj.

-Ndihem i gëzuar, por ndoshta gjejmë kohë njëherë tjetër.

Sovjetiku qeshi çiltër dhe e la borsalinën t'i binte mbi kokë.

-Unë do të kisha kënaqësi të madhe që kjo të ndodhte sot – tha- Ju me siguri nuk do të refuzonit.

Kastriotit sërish i munguan fjalët.

-Unë jam nga Moska, - vijoi rusi elegant - jam nga Moska dhe kam ardhur posaçërisht për ju.

Çfarë po ndodh kështu, thirri brenda vetes Kastriot Leka dhe hapi krahët: Unë isha nisur për tek e fejuara ime.

-Atje sigurisht do të shkoni, bisedën nuk do ta lejojmë të kapërcejë një orë. Edhe unë jam i fejuar dhe kur nisem tek Masha ime nuk dua të më dalë përpara asnjë njeri.

Ai sërish qeshi çiltër.

-Urdhëroni! - e tregoi makinën e tij.

Ishin ulur në një tavernë, kishin porositur çaj e biskota, kishin shkëmbyer edhe disa fjalë mirësjelljeje të ndërsjellët, kur njeriu nga Moska me emrin Gromov, zbuloi arsyen e takimit.

-Unë punoj në Komitetin Qendror të Rinisë Komuniste dhe nënën e kam italiane. Sigurisht babanë rus, një rus të bardhë njëqind e njëzetë kile. Ndihem i qetë që jam një bashkim i një evropianeje me një sllav të veriut. Në fund të fundit jam një hrushovian. E them me krenari këtë fjalë..Jam kundër Stalinit dhe përgjithësisht kundër atij komunizmi që nxit luftën e klasave, përçarjen e largimin e njeriut nga njeriu.

Kastrioti i kishte ngulur vështrimin dhe tashmë e ndjente veten më të sigurt në bisedë me moskovitin e lartë.

-Kam dëgjuar për ju...

-Ku keni dëgjuar për mua? - ndërhyri befás Kastrioti.

Gromovi vuri buzën në gaz.

Ai i kishte sytë të kaltër, shumë të kaltër.

-Nuk jam njeri i KGB-së - ktheu përgjigje - Unë di se kohët e fundit KGB-ja ju ka trazuar shumë për rastin e atij incidentit me portretin e Hrushovit.

-Ai ishte një provokacion - ashpëroi tonin Kastrioti.

-Unë vetëm kam dëgjuar për këtë ngjarje, për të shkruan gazetatat dhe u fol në radio. Kaq. Nuk di asgjë tjetër.

Kastriot Leka ia hoqi sytë dhe një çast përmbajti mendimin se ishte më mirë të ngrihej e të ikte nga ajo tavolinë.

-Unë vetëm kam dëgjuar për atë ngjarje dhe nuk gëzohem aspak - rikapi fjalën e tij moskoviti - Nuk gëzohem as për ata kokënxehtë që sulin plumba mbi Nikitën dhe as për ju, që vendoseni në qendër të një lufte politike. Ajo duhet të mbetet mes dy udhëheqjeve kryesore.

Ra heshtje.

Gromovi futi në çaj një biskotë dhe nuk foli për disa çaste.

-Dua të më kuptoni - shqiptoi më në fund - Unë e kam marrë këtë udhë gjer këtu për t'ju thënë se ju nuk jeni si shumë shqiptarë të tjerë.

Kastriotit këto fjalë e gjetën të papërgatitur dhe ai nuk mundi tjetër reagim veç t'i ngulte një vështrim të habitur.

~E përse ndryshokam unë nga të tjerët? - tha.

Gromovi afroi fytyrën dhe i la fjalët e tij të binin të shkoqura:

-Sepse je më modern, më i kultivuar, një njeri i lirë dhe i reformuar, më i etur për një komunizëm të ri, për socializëm me fytyrë njeriu.

Kastrioti u bë i zbehtë:

-Çfarë doni nga unë?

-Asgjë.

Zëri i moskovitit doli i panatyrshëm, i sforcuar.

-Unë e hapa këtë bisedë për t'ju shprehur konsideratën - shqiptoi.

-Ju faleminderit! - ktheu thatë Kastriot Leka - Unë ju kuptoj fare mirë.

Gromovi kishte marrë një të skuqët.

Bëri sikur rrufiti çaj, përtypi pak biskotë e më në fund rrëzoi kokën mbi pëllëmbë.

Ishte shumë i tronditur.

-Më keqkuptuat - belbëzoi më në fund - Unë nuk kam ardhur të ndërtoj një fraksion politik prohrushovian në partinë tuaj, madje as mes kursantëve shqiptarë të shkollës së aviacionit. Nuk më ka dërguar kurrkush nga ata që mendoni ju. Kurrkush.

Kastrioti nuk i ktheu përgjigje. Singëriteti i moskovitit ishte çarmatosës, por dhe nuk donte të jepte përshtypjen e njeriut të rrëmbyer e sherrxhi.

-Unë kam atdheun tim, shoku Gromov. Atdheun tim. I udhëhequr keq apo mirë, unë Shqipërinë e kam atdheun tim. Nuk e mohoj që e dua Partinë e Punës. Babai im ka qenë partizan dhe ka luftuar në mal, pa ditur se një ditë do të bëhej ambasador. Ai luftoi në fillim për partinë e madhe, atë të vendit të vet. Edhe unë e kam atë parti, e besoj dhe i bindem asaj. Sa për të tjerat, ato janë gjëra të dorës së dytë, janë pas Shqipërisë.

Gromovi i preku shqiptarit kurrizin e dorës, sepse vuri re se ajo po i dridhej nga emocioni.

-E di që ju shqetësova me ato që ju thashë pak më parë.

Kisha menduar një bisedë më të qetë. Kërkoj ndjesë!

Moskoviti ende nuk ja kishte hequr pëllëmbën. Ajo ishte e butë, intime.

Kastriot Leka po dëbonte edhe dyshimet e fundit për të.

Papritmas psherëtiu.

-Unë dua një botë më të mirë, shok. Një botë shumë më të mirë, o mik. Një botë më të mirë se kjo doni edhe ju, sigurisht. Mua më pëlqen që këtu tek ju jeta është më e hapët dhe më e lirë se në Shqipëri. Më pëlqen që erdhi mirëkuptimi dhe paqja me kapitalizmin dhe klasën e përmbysur. Ndiem shumë i gëzuar që u liruan shumë të burgosur të ndërgjegjes, që mund të vishesh sipas modës së fundit dhe që jashtë shtetit mund të dalësh disi më lehtë se tek ne.

Në qoftë se do të zgjidhja një model jete midis asaj që aplikohet në vendin tim dhe kësaj tuajës, pa lëkundje do të zgjidhja këtë të dytën.

Por jo Bashkimin Sovjetik.

Do të zgjidhja mënyrën tuaj të socializmit, veç ajo të bëhej në vendin tim.

Gromovi nuk e fshehu dot shkëlqimin e syve të tij të lagur.

-Mbase nxitohem, por unë besoj se ka mjaft rusë që kanë idealizmin tuaj dhe hrushovizmi bëhet rrugë për progres e drejtësi.

Do të desha të ishte kështu, sepse edhe ju keni plehra mjaft. Leninistët e rinj apo siç edhe thirren më shpesh "pushtetarët e rinj", shumë herë janë stalinistë të konvertuar, vjetërsira të veshur sipas modës së re. Reformizmi juaj nuk më duket tjetër veç një shans tjetër që të shpërthejë hipokrizia.

Këta leninistë të rinj, që premtojnë fytyrën njerëzore të komunizmit, janë po aq të këqij sa edhe më parë. Kanë lëvizur fshehtas me dorë akrepat e po asaj orë të ndryshkur dhe na rrëfejnë se gjithçka ka ndryshuar, se ata na sollën një kohë tjetër të përparuar.

Në të vërtetë ata mashtrojnë. Janë po ato duar, është po ajo kokë, po ai shpirt i zi. Ata thjesht kuptuan se duhej ndërruar kostumi. Rëndësi paska që të mos iu largohet

karrigia nga prapanicat, as “Vollga” dhe as “Moskviçi”, as pushimet në Soçi dhe dekoratat e mëdha në gjoks.

Unë dyshoj shumë tek kjo që po ngjan tek ju. Pas makijazhit të parë, një ditë të afërt këta leninistë të rinj do të zbulojnë fytyrat e tyre të vërteta. Të shëmtuara.

Pa e kuptuar as vetë Kastrioti ishte ngritur në këmbë.

U çua edhe Gromovi.

Siç dukej bisedës i qe dhënë fund.

-Na shkoftë mbarë të dyve! - i zgjati dorën Gromovi dhe ja shtrëngoi fort - Ndihem i qetë, më dhatë qetësi.

Kastriot Leka i ktheu shtrëngimin miqësor dhe bëri të largohej.

-Keni përshëndetje edhe nga babai im - tha moskoviti.

Kastrioti ktheu trupin me vrull.

-Ai është shok me babanë tuaj. Janë shumë miq - vazhdoi Gromovi.

~Ato fjalë që më thatë ishin zëri i atit tim?

Fjalët e fundit Kastriot Leka i shqiptoi duke iu dridhur buzët.

Koka e gjarprit

Gjithnjë e më tepër po përhapej një thashethemnajë. Flitej se ishte kapur një bandë e madhe huliganësh, fijet e të cilës shkonin deri në Komitetin Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Këtë bandë e udhëhiqte një grua, e cila quhej “koka e gjarprit”. Ajo e kishte vizatuar gjarprin në të gjithë trupin dhe koka e tatuazhit të tij i dilte mbi sisën e djathtë. Po të hapte pak bluzën dhe të tregonte kokën e gjarprit ajo ishte vetë kapua e bandës. Thoshin se ata kishin bërë vjedhje dhe krime nga më të mëdhatë.

Çfarë thotë radio “Zëri i Amerikës”

Nëntori e kishte kapërcyer tashmë mesin e vet, kur nga komanda e shkollës u dha urdhri i gatishmërisë.

Me sa dukej gatishmëria i qe komunikuar edhe aerodromit ushtarak aty afër, sepse avionët MIG-19 nisën të ngrihen përditë dhe diku mbi një rrafshulët zhvillonin qitje.

Tani gjithnjë e më shpesh kursantët e vitit të fundit po i çonin sa në aerodromin e shkollës, ku fluturonin me “JAK”, aq edhe në aerodromin ushtarak, në të cilin u thoshin se së afërmi do të bënin fluturime me avionë luftarakë.

Në programin mësimor kjo temë dilte shumë më vonë, por autoritetet e shkollës kishin bërë një lëvizje për hir të situatës së gatishmërisë që ishte dhënë.

Pak nga pak u mor vesh se gatishmëria ishte urdhëruar për shkak të zhvillimit të Mbledhjes së Moskës.

Kështu ishte publikuar në shtyp një kuvend i të gjitha partive komuniste të botës.

Ushtarakët e lartë sovjetikë e justifikonin masën e marrë me fjalët se imperializmi ishte aktivizuar shumë këto ditë të punimeve të kësaj mbledhjeje.

Edhe rregulli në shkollë u forcua ndjeshëm.

Tani çdo orë njëmbëdhjetë të natës dhomat kontrolloheshin një nga një prej oficerëve të rojës. Cili prej kursantëve mungonte të nesërmen nisej drejt e tek Smirnovi dhe po të ishte rus pësonte pesëmbëdhjetë ditë burg.

Në rast se qe i huaj për qëndrimin ndaj tij jepeshin rekomandime për masa disiplinore dhe lajmërohej ambasada.

Në këtë kohë u shtua mjaft numri i kursantëve që dëgjonin

fshehurazi radion “Zëri i Amerikës”.

Ajo filloi të informonte për përçarjen që kishte ndodhur mes 81 partive komuniste.

Mbledhja e Moskës u bë ankthi i të gjithëve.

28 Nëntor

Nuk kishte rënë akoma mbrëmja, kur në klubin e shkollës kishin mbërritur të gjithë të ftuarit bashkë me vajzat e tyre. Përgjegjësi i tij, një azerbajxhanas i shkurtër, i qethur ballaboks e me balluke të gjata lëshuar mbi ballin e ngushtë, nuk nxori ndonjë pengesë.

Ai njihej si servil i komisarit Lisenko dhe këtë gjë e dinin të gjithë.

Po të buzëqeshte ky njeri, i cili quhej Zaharov, të kish buzëqeshur Lisenkua.

Ndryshe, po të shihte me bisht të syrit e të përplaste vetëm buzët pa të të përshëndetur, përsëri nuk ishte Zaharovi, por Lisenkua.

Pikërisht ky njeri kapi mënjanë Kastriotin, i ngarkuar me organizimin e mbrëmjes me rastin e pavarësisë dhe çlirimit të Shqipërisë, dhe i tha se në klub ata kishin menduar që të fliste Palush Bardhoshi.

Kastrioti ia kishte prerë shkurt se kjo ishte vetëm punë e tyre.

Tjetri qe fyer shumë e i kish thënë “Ju shqiptarët nuk na respektoni”.

Pastaj shtoi: “Ne, sovjetikët e ndershëm, po ju japim sallën për aktivitet, ndërsa partia dhe qeveria juaj na kanë dalë kundër”.

Kastrioti i ktheu shpinën.

Në derë hyri Fjodori dhe sytë e Zaharovit u kthyen andej, të picërruar.

Mbrëmja u çel nga sekretari i tyre i partisë dhe më pas muzika gjëmoi.

Gati të gjithë vrapuan për të vallëzuar dhe Kastrioti bëri për nga vendi i tij, ku rrinte edhe Natalja.

Papritmas përpara i doli Hu Shia e pasi i rrahu shpatullat, tha se kishte diçka për t'i komunikuar.

-Si është puna? - pyeti shqiptari.

-Shumë keq - ja bëri Hu në shqip dhe pasta} zbrazi një lumë fjalësh në rusisht - Ai shoku-juaj, Rexhepi, nuk vepron mirë. Ai është një rrugaç. Ai vjen tek dera jonë dhe përgjon.

Kastriot Leka u bë i vëmendshëm dhe në moment braktisi një trill të çastit për t'i kthyer shpinën edhe kinezit.

Me këtë Hu Shi-në të pille belaja.

Të gjithë kinezët e tjerë kishin frikë nga ai.

-Më qartë, Hu Shi, më qartë!

-Shumë qartë po e them. Rexhepi, shoku juaj, vjen tek dera jonë dhe përgjon. Sot ne po recitonim vjershën shumë të bukur të shokut Mao "Mao Shiating qyshing" dhe ai prapa derës ja bënte ting-tang-teng.

Kastrioti mendoi t'ia presë shkurt.

-Faleminderit që na informuat, shoku Hu Shi - i tha me pamje të preokupuar - Këtë rast do ta shohim menjëherë.

Kinezi u përkul disa herë dhe u largua.

Kastrioti nxitoi për tek Natalja. Ndërkohë erdhi Fjodori dhe e uroi për festën. Aviatori i talentuar i MIG-ut të prodhimit të fundit siç duket e kishte ndjekur me sy bisedën me kinezin.

Kur Kastrioti i tha se përse bëhej fjalë në protestën e Husë, Fjodori ndërhyri: Në Kinë komandanti i fluturimit nuk të jep leje të ngrihesh në ajër pa recituar një vjershë të Maos.

Natalja vuri pëllëmbën e vockël para gojës dhe kukurisi. Pastaj, ndërsa Fjodori vazhdoi ceremonialin e tij të urimit edhe tek shqiptarët e tjerë, ajo i hodhi duart në supet e Kastriotit dhe kërcyen sa u lodhën.

Si në flu pranë tyre kalonin çifte të tjera.

Kaloi me hapat e tij të mëdha edhe Misha dhe u tha disa kureshtarëve “kodoshë”. Pastaj ja shkrepiti të qeshurit.

Ai atë ditë e kishte mësuar këtë fjalë dhe ende nuk ja dinte mirë kuptimin.

Palushi që ishte mes “kodoshëve”, u nxi nga zemërimi dhe ja ktheu me një “idiot”. Por Misha, i cili edhe pak do të rrinte në mbrëmje se do të merrte shërbimin, nuk ia kishte ngenë të begeniste përgjigjen e asaj fjale që e shijonte shumë në shqip: kodoshë.

Ishte pikërisht ky moment kur Kastriotit i klithi brenda vetes një zë: Po Janaqi ku është?

Mbyllja në vetvete e shokut të tyre të njohur si jetë shpenguar, kishte kohë që i shqetësonte. Ai nuk rrinte më me ta, shmangej, mbyllej në dhomë, ulej vetmitar në ndonjë stol lulishteje, dilte në liridalje fillikat.

Ja edhe sot nuk kishte ardhur në mbrëmje.

Pati kaluar një orë dhe dera e hapur kaq herë nga ardhësit e rinj e të vonuar, nuk kishte shfaqur ende siluetën e tij.

Moldaviana Tamara

Rexhepi kishte njohur Tamarën dhe ajo pati qenë një djallushë e vërtetë.

Qe moldaviane, pak ezmere, buzët e trasha i kishte lyer me shumë të kuq dhe kur kërcente hidhej përpjetë.

Për dhjetë minuta vallëzim e bëri shqiptarin t'i kullonte djersa rrëke.

Pastaj i hipi në kokë ta guduliste nga barku.

Më në fund hoqi këpucët dhe vazhdoi kërcimin me to në duar.

Gjersa u rraskapit edhe vetë.

-Dua të fle - belbëzoi.

-Fli! - ja këputi fjalës Rexhepi.

Ajo mbështeti kokën në supin e tij.

Vallëzuan ashtu për një kohë. Krejt në heshtje.

—E di ti shqiptar se babai do të më nxjerrë zamuzh (të më martojë)? – u përmend Tamara dhe e vështroi duke i pulitur sytë e hirtë.

-Ashtu?!

-Ehë. Ne jemi ngushtë, vetëm me një dhomë dhe ai më tha se po bëhem e tepërt.

Rexhepi ndjeu keqardhje dhe e shtrëngoi lehtë në bel.

-Babai pi shumë dhe unë i dal dhe e pres gjithmonë tek dera e fabrikës për t'i marrë rrogën. Prandaj ai më ka marrë inat.

Rexhepi e shtrëngoi më pranë vetes.

Vetëm një gjysmë ore më parë e kish njohur në këtë sallë. Tamara i qe afruar pa u ndjerë dhe e kish ftuar për një vals.

-A tregojmë barsoleta? - propozoi Rexhepi dhe qeshi kot më kot.

-Tregojmë.

~Po tregoj unë një për Hrushovin.

-Pa hë, shqiptar!

Rexhepi bëri një çast sikur u mendua, rrudhi pak ballin, rrotulloi sytë, i kafshoi cepat e buzëve, ja nguli vështrimin dhe pastaj foli.

-Kur shkoi Hrushovi në Hindi, Nehru i e priti me një drekë me të gjitha gjërat e florinjta.

Gjatë pritjes Hrushovi pa se Bulganini vodhi një lugë të florinjte dhe e futi në xhep. Atëherë i thotë Nehruit: "A e di ti, Nehru, që unë jam prestigjator?"

"Jo" i qe përgjigjur presidenti i Hindisë.

"Po,po" kish këmbëngulur Hrushovi dhe pati marrë nga tavolina një lugë të florinjte.

"Ja, unë këtë lugë po e fut në xhepin tim" dhe fap e futi në xhep.

"Tani lugën e keni në xhepin e Bulganinit", u tha.

Kërkuan në xhepin e Bulganinit dhe e gjetën.

Tamara vuri duart në bel dhe nuk pushonte gazin.

-Tani më trego ti një! - kërkoi Rexhepi.

-Unë di vetëm atë barsoletën, kur aktori që luan Stalinin pas kongresit të njëzetë mbeti pa punë.

Një ditë vishet si Stalini dhe shkon tek Hrushovi....

-Është e vjetër, e dinë të gjithë, vijoi Rexhepi, Hrushovi trembet, se e merr për Stalinin e vërtetë e i thotë "Nuk ta punova unë, por Mikoiani".

Dëgjo tani një barsoletë me Furcevën.

Tamara e puthi në faqe Rexhepin. Ky ishte bërë tundues.

-Po kërcente si puna jonë një herë Hrushovi me Furcevën - nisi Rexhepi - i thotë ky, Nikita juaj, duke i vënë duart në kofshët e trasha të ministres së arsimit dhe kulturës

“Amerikanët do t’i kalojmë në mish”. Ajo i vë dorën në tullë "Po jemi keq me lesh".

Tamara vuri sërish duart në be! dhe lëshoi piskamën e të gajasurit.

~Hrushovi nuk i vë duart tek kofshët e Furcevës, por tek gjinjtë dhe i thotë “Do t’ia kalojmë Amerikës në qumësht”.

Furceva pastaj i vë duart në tullë dhe i thotë atë punën e leshit.

Kishin tërhequr vëmendjen e të gjithëve.

Në fillim, kur konstatoi këtë gjë, moldaviana u nemit, pastaj u shkeli syrin, u nxori gëzueshëm gjuhën dhe mbështeti kokën në supin e Rexhepit.

“Vollga” bishë

Natalja po ecte në buzë të trotuarit.

Bora e kthyer në akull lëshonte një frymë të ftohti të hidhur.

Ajo mbështolli më mirë shallin rreth flokëve dhe befas ndjeu një valë të ngrohtë ndjenjash ta përfshinte të tërën.

Sot priste Kastriotin dhe nxitoi hapat.

Një qeskë një kilëshe me sheqer për ëmbëlsirën tradicionale të të dashurit të saj, e kishte nxjerrë në këtë akullimë dhe tani po e nxiste të vraponte për në shtëpi.

Natalia bëri pak mënjanë për t'u shpëtuar dy të rinjve që kishin hapur krahët për ta përqaftuar. Ndjeu erën e vodkës, breshërinë e fjalëve të ndyra, por mundi t'u kalojë nën krahë.

Nga frika rrahjet e zemrës i ndjeu gjer në majë të gishtave.

Ajo i shpejtoi edhe më hapat.

Ishte ende larg shtëpisë dhe ora kur duhej të vinte Kastrioti nuk po afrohej fare. Lart qielli i duke} i plumbtë.

Kapërceu me nxitim një udhëkryq, pastaj një tjetër. Boritë e automobilave binin si të çmendur.

A do të vinte Kastrioti sot apo ndonjë ngjarje e paparashikuar do ta pengonte?

Koha nuk ishte normale, aq më tepër rreth fatit të shqiptarëve. Edhe Institutin e tyre e kishin mbyllur për disa "meremetime" të brendshme.

Në fillim thanë se kjo do të zgjaste vetëm dymbëdhjetë ditë, tani flitej edhe për një shtesë javore.

Sa ditë të gjata ishin, ditë ku dimri dhe ngrica shkurtonin dritën dhe hidhnin mbi njerëzit një natë të gjatë e të pafund!

Natalja mbështolli sërish fytyrën dhe kokën me shallin e madh të së ëmës. Jam kaq e paduruar, tha me vete, kam një javë që nuk u qetësova njëherë një ditë, një orë. Ç'bëj kështu? Pse veproj si e vogël, si fëmijë? Bëj se e dua, e dua shumë. E dua shumë, shumë. Kastriot! Ka...stri...ot! Kastri...o...o...

Asaj ju bë sikur e thirri një zë.

Vinte që larg apo nga afër? Nuk po e kuptonte. Deshi t'i mbante këmbët, por instinktivisht shpejtoi.

Zëri pati qenë i njohur, por për habi ngjante me një klithje. Kush është vallë, mendoi me vete dhe nisi të sjellë nëpër mend të njohurit e saj.

Përfytyronte me nxitim zërat e tyre, por në asnjë rast nuk ngjasonin,

Zëri u përsëdyt. Ngjante me të vërtetë me një klithmë. Ose më mirë me një rënkim.

Nataljes i kaluan ta ngjethura nëpër trup dhe sërish i shpejtoi hapat.

-Natasha! Natasha!

Zëri tani po vinte nga fare afër.

Asaj i vetëtiti nëpër mend një emër. Vagëllimthi.

E dëboi e tmerruar, por emri sërish iu ngul në tru si një këpushë.

Aleksej, ky është Aleksej.

-Moj Natasha!

Zërin e pasoi një rënie burie. Edhe ajo me klithmë. Natalja nuk shihte nga ikte. Nisi të vraponte duke iu marrë fryma, por pas pak sa nuk u përplas me turirin e një "Vollge" të zezë.

Natalja ishte e lodhur. Mezi ngopej me frymë. Edhe trupi i qe mpirë dhe i dukej se ngrica i kishte hyrë gjer brenda në gjoks dhe po i ngrinte gjithçka, gjer edhe gjymtyrët.

Prej kësaj ngrirjeje asaj iu duk se gjer tani nuk kishte ecur, por pati qëndruar në vend.

-Jashtë bën ftohtë - tha zëri.

Ajo ishte lodhur së rezistuari. Donte apo nuk donte duhej t'i mbante këmbët para këtij njeriu.

Natalja ngrii sytë. Ishte me të vërtetë Aleksej. Qëndronte në veturën e tij dhe buzëqeshte.

Ajo pa pjerrtas fytyrën e tij vajzërore dhe të kuqërremtë nga pushi.

-Eja në veturë! - tha Aleksej.

U dëgjua kërcitja e butë e dorezës së derës dhe Natalja pa kolltukët e ngrohtë e të mëdhenj të sediljes së pasme.

-Të çoj gjer në shtëpi - tha tjetri.

Vetura e ndaluar bënte një zhurmë të lehtë.

Ajo vuri dorën tek dera e hapur. Ndjeu se si makina dridhej e tëra, si të ishte një gjë e gjallë.

Natalja pati përshtypjen se ajo nuk ishte veturë, por bishë. E hoqi dorën.

-Hajde, hajde! - foli përsëri tjetri.

“Vollga” vazhdonte ende të dridhej e tëra.

-Jo!

Zëri i Nataljes kish qenë çuditërisht i lartë, plot trembje.

-S'të kuptoj Natalja.

-Jo, jo!

Ajo nisi të ecte.

Kuturu.

Deshi t'i mbështillte më mirë flokët me atë shall, por ndjeu se ai i kishte rënë me kohë mbi supe.

Duart që i dridheshin, më shumë e çmbështollën.

Mbrapa saj ndjeu gazin e makinës dhe afshin e ngrohtë të motorit që po e ndiqte nga pas.

Turiri i "Vollgës" përsëri i kish dalë përpara dhe ajo pa me ankth rreth e rrotull. Nuk po dallonte asnjë rrugicë ku të vraponte e të fshihej, së paku për disa çaste të vetme.

Aq sa të shkëputej nga ky njeri i hipur në këtë bishë metalike.

-Ç'është kjo frikë nga unë, Natalja? - thirri Aleksej.

Zëri i tij ishte i zbutur dhe dukej sikur kërkonte falje.

Vetëm atë çast Natalja ndjeu një melodi që vinte nga brenda makinës. Iu duk si këngë italiane. Këngëtari klithte herë pas here "amore, amore mio".

Po, po, ishte tamam italisht, vetëm ata klithin kështu për dashurinë, si të çmendur, kaloi furishëm mendimin ajo.

U dëgjua përsëri kërcitja e derës së veturës. Aleksej e kishte hapur.

Përsëri Natalja pa ndenjëset e ngrohta e ndjeu se ato po i provokonin ndjenja të trazuara.

-Jo, Aleksej, unë nuk vij në veturë. S'kam përse.

U duk se më në fund ajo e kishte marrë veten dhe ishte qetuar disi. Veç rrahjet e zemrës i ndjente në të gjithë trupin.

-E pse?! - shqiptoi Aleksej me zë të këputur.

-S'kam arsye - përsëriti ankthshëm Natalja.

-Po unë të çoj gjer në shtëpi, gjer tek dera.

-Shkoj vetë.

Aleksej nuk iu përgjigj menjëherë. Në pauzën që u bë, Natalja pa rreth e rrotull nga mund të ikte e të shpëtonte.

-Si të duash - u dëgjua zëri i lodhur i Aljoshës - unë asgjë nuk kuptoj.

U dëgjua krisma e derës që u mbyll.

Nga brenda veturës melodia u duk sikur u shua.

Aleksej tani po qëndronte para Nataljes.

-Dua të bisedoj me ju- tha me një zë që u fik nga një vrullim i papërmbajtur ndjenjash.

~S'kemi pse bisedojmë.

-Kemi.

Natalja ngriti vështrimin gjer tek sytë e Aleksejit dhe pa ngjyrën e gështenjtë të tyre.

-Jo Aljosh, nuk kemi përse të bisedojmë.

Zëri i saj pati pësuar një ndryshim të vogël. Ish zbutur dhe kjo bëri që vetullat e Aleksejit të tkurreshin nën një mendim të mbrapsht.

-Unë të dua, Natalja! Të dua shumë, ti e di.

Ajo pa dashur kishte vënë duart në gjoks. Diçka po e kafshonte nën brinjë, sikur të qe gjarpër.

-Njeriu nuk mund të flasë kështu, siç flet ti, Aljosh.

-E si mund të flasë ndryshe një njeri i dashuruar?!

-Ti s'je aspak i dashuruar.

-Jam shumë Natalja.

Nga brenda veturës dëgjohej një melodi tjetër.

Kësaj radhe anglisht.

“Aj llov ju” thërriste zëri i ngjirur i këngëtarit.

-Mua nuk më gënjen dot, Aleksej.

Ajo s'tha “Aljosh”.

Vetullat e këtij u tendosën përsëri.

-Vetëm në qoftë se ti gënjen veten - vazhdoi ajo.

Zëri tashmë i qe ftohur e ngrirë. Nuk kishte asnjë nga ato vibrimet e çasteve të para.

Alekseji kishte marrë të kuq në fytyrë.

-Pse më fyen - tha.

-Pse, të fyen e vërteta?

-Më fyeve, më fyeve.

Aleksej nuk kishte më kapardisje.

Vetura gulçonte lehtë.

-Unë të dua me të vërtetë.

Në fytyrën e tij vajzërore kishte ndodhur një shpërfytyrim.

Natalja mendoi me plogëti se ai në të vërtetë mund ta deshte, gjithnjë sipas mënyrës së tij.

-Unë do të shkoj jashtë, në një ambasadë. Eja me mua! Në janar do të iki. Është rregull që duhet të jem i martuar. Kisha dëshirë të shkonim bashkë. Mund të vëmë kurorë para vitit të ri.

Shpërfytyrimi i kishte dhënë pamje tjetër.

Duart i dridheshim lehtë.

Dridhej si edhe “Vollga” me motor të ndezur.

-Unë dua Kastriotin - u përgjigj Natalja.

-E di - tha tjetri me zë të këputur - Por ti je shumë e bukur, ti je yll. Ti s'je për atë vend të varfër e mizerabël, i cili quhet Shqipëri. Ti je sovjetike, ke lindur në një vend të madh e të lavdishëm. Ti nuk e meriton atë fat, atë pafat.

Aleksej kishte folur me rrëmbim dhe gjaku i kishte vërshuar në fytyrë.

Edhe duart kishin lëvizur ose më saktë qenë përpëlitur.

-Unë kam rrugën që do të marrë Kastrioti, edhe sikur ajo të jetë përtej pesë oqeanëve.

-Oh! - rënkoi Aleksej – Ti më dukesh e marrë.

Ishte shndërruar në një të përvuajtur.

Në sytë e tij luanin disa re të vogla trishtimi.

-Unë e dija që do të ndodhte kështu, e dija - tha i pezmatuar. Por ti nuk e di ç'është Shqipëria, nuk e imagjinon çfarë ferri është. Atje ka një Stalin tjetër, i cili jetën e parë që do të nxijë, do të jetë kjo tëndja.

Por Natalja ishte bërë akuII.

Një ndjenjë e thellë zemërimi bëri zë që nga vetëdija e saj.

-Shqipëria është vendi i shqiponjave - tha vendosmërisht një frazë propagande.

-Ptu! Vend i shqiponjave! Është vendi i zvarranikëve – nënqeshi hidhur Aleksej.

Zëri i tij kishte dalë si një fishkëllimë.

Pushi i mollëzave të faqeve të tij u duk sikur u kreshpërua.

-Ti do të përfundosh e pafat - klithi papërmbajtshëm ai.

-Më paske ndaluar për të më kërcënuar - shpërtheu Natalja. Mbi fytyrën e saj zemërimi po shtrinte hapësirat e pushtetit të tij të rëndë.

“Ajo është e bukur, shumë e bukur” - tha me vete Aleksej, - Nuk duhet ta humbas”.

-Ndoshta të ndala në një moment të papërshtatshëm...

-Më lërë të qetë!

-Të lutem, përgjigju dashurisë time!

-Më lër të iki!

-Jo, jo!

Aleksej pati klithur sërish.

Disa kalimtarë kthyen kokat dhe i vështruan të dy për një kohë të gjatë.

Natalja rregulloi me dorë të dridhur shallin, por ai nuk qëndronte mbi flokë.

-Dhembje, o dhembje! - rënkoj Aleksej.

Tiparet vajzërore të fytyrës së tij qenë deformuar përtej çdo shëmtimi

-Koha po më kllapit jetën – rënkoj - Armiku që e ka pickuar zemrën e Nataljes po forcohet e rritet me gjakun që humbas unë.

Ai kishte zgjatur të dy duart drejt saj.

Ato i dridheshin si të një anormali.

Po e shihte Natalinë me sy gati të zgurdulluar.

-Unë dua Kastriotin dhe do të shkoj në Shqipëri. Me ty, po të bjerë në dashuri ndonjë vajzë, nuk ka për të pasur veç fatkeqësi.

-Ashtu'?!

-Kështu dhe s'do të kisha kurrë qejf ta provoja.

-Atëherë shko mbushi trastat me dashuri, sepse vetë je e varfër.

Ai ia kishte ngulur sytë qeskës së sheqerit, që Natalja gjithë kohës e shtrëngonte si gjë të shtrenjtë.

Ajo u kthye me rrëmbim të largohej.

-Ndal! - ulëriti tjetri.

-Largohu sysh!

-Nuk të ndahem aq lehtë, jo. Dymbëdhjetë ditë është mbyllur Instituti, për ty mund të mbyllet përgjithmonë.

Natalja u drodh.

~Ti ke qenë një nga ato rebele që përhapët parulla armiqësore kundër shtetit sovjetik - ulëriti ai, duke marrë frymë me zor.

Shpërfytyrimi i skajshëm po i jepte pamjen e një bishtëze.

-Ti po përfundon spiune e shqiptarëve.

Nataljes iu mblodh një komkë pështyme në fyt. Deshi ta nxjerrë e t'ia hidhte në surrat.

-Mjafton që unë të them një fjalë për ty dhe të pret Siberia.

-Ti mund të bësh gjithçka, por tashmë edhe ata që u internuan në Siberi po rikthehen në shtëpitë e tyre. Hiqesh njeri i kohës së re, por nuk je veç një çinovnik i kohës së Stalinit, je nga raca e pandryshuar e tyre.

-Unë jam komunist i ri.

-Ti je vampir, një nga ata që pi gjak e majmesh. Ti nuk je veç borgjezia e kuqe.

-Mjaft!

Aleksej rrinte tashmë para saj i pagojë e i ngurtësuar.

Buzët i bënë një përpjekje për të thënë diçka, por doli një tingull lëngues si si t'i shtypej gjoksi nga ndonjë spazmë.

-Mjerë ju! - thirri Natalja dhe nxitoi nëpër trotuarin e mbuluar nga akulli e që lëshonte frymën e tij mjegullore.

Mbrapa shpine nuk ndjeu asnjë lëvizje të Aleksejit.

Vonë ju bë sikur dëgjoji përplasjen e derës së veturës së tij.

-“Mjerë ju!” - përsëriti me vete dhe sakaq iu duk e pabesueshme nga i kish buruar gjithë ai zemërim e ai fjalor politik krejt i pa natyrshëm për të.

“Mjerë ju!” - përsëriti dhe truri i lodhur atë jehonë fjalësh e shumëfishoi kumbueshëm.

Gjersa fjala “mjerë” u shuajt ngadalë në humbellën e harresës.

Në të gjithë trupin po depërtonte, si një injeksion çudibërës, qetësia.

Natalja vetëm atëherë ktheu kokën të shihte pas. Gjékundi nuk dukej “Vollga” bishë, që i kish dalë në pritë mes asaj akullime.

Për një fragment të sekondës, si të ishin sulur nga barku i qiellit gri, fjalët e fundit të Aleksejit “spiune e shqiptarëve” erdhën drejt saj në trajtën e një angullime të largët.

“Vollga” kishte qenë një ujkonjë.

Vazhdoi të nxitonte, gjithnjë e më tepër e sigurt se biri i dy herë heroit të Bashkimit Sovjetik nuk po e ndiqte nga pas.

Po i afrohej shtëpisë së vet.

Në reminishencë biseda me Aleksejin ndihej mbyturazi, si në agoni.

Ja edhe shtëpia e saj.

Atje s'dukej asnjë lëvizje. Perdja ishte e mbyllur, e mistershme. Xhamat e dyfishta fshihnin pas vetes vetëm errësirë.

Kastrioti nuk ka ardhur, mendoi ajo vagëllimthi dhe ndjeu një drithërimë të ftohtë në të gjithë trupin. Një “ah” i doli prej zemrës. Çdo gjë t'i ndodhte, por kjo që Kastrioti të mos vinte sot...

Jo,jo, o Zot të mos ndodhë!

Prej barkut të rënduar të atij qielli të akullt u duk sikur përsëri u lëshua drejt saj ajo angullimë “Ti je spiune e shqiptarëve”.

Nataljes iu mpinë gjymtyrët dhe deriçkën e hapi si nëpër një ëndërr të keqe.

Ndjeu sytë t'i lageshin nga lotët dhe thirri fort: Kastriot, Kastriot!

Zëri brenda vetes i kishte gjëmuar, por buzët e saj nuk kishin lëvizur.

Ishte në kllapi.

-Kastriot, Kastriot! - thirri në një përpjekje të dytë, por buzët mezi lëvizën.

I nxiti këmbët të vraponin nëpër oborr, por ato mezi hiqeshin zvarrë.

-Natalja!

Ajo u nguros, pastaj ndjeu gjakun që i rrëmbushi vrullshëm trupin e bëri t'i lëviznin këmbët, t'i ndjente krahët, të dëgjonte zemrën poshtë gjoksit të saj.

-Natalja!

Zëri erdhi nga shumë afër. Ishte si fillim kënge, qe si tingull harmonike, si magji që të sillte në jetë e të ringjallte.

Ajo ndjeu se një dorë po i fshinte me mollëzat e gishtave lotët mbi faqe. Pastaj si po i rregullonte shallin mbi flokë.

-Kastrioti! - thirri dhe kërkoi t'i kapte duart për t'ia puthur.

Ju lejoj uljen!

-Me karburant është mbushur? - e pyeti dhe i ra lehtë barqeve varës të avionit. Të dy ata bënë nga një zhurmë të mbytur.

Qenë plot.

Përvoja e pilotëve thotë se tekniku mund të bëjë gjëmën, mendoi me vete Kastrioti dhe i nguli edhe një herë vështrimin pyetës Mamait.

-Ka për të punuar si sahat - foli qetë ky dhe në fytyrë i ra ngërdheshja e një buzëqeshje.

Kastrioti kërceu mbi shkallë dhe u fut në kabinë.

Andej nga ishin shokët pa duar që valviteshin.

E ndezi me vrull motorin e reaktivit dhe shkulma e tij u ngrit me kujë.

Ai pa gjallimin e shigjetave që lëvizën nëpër aparate.

Para tij tekniku Mamai rrinte me veshin e mprehur për të dëgjuar edhe zhurmat më të vogla të MIG~ut. Ishte tendosur i gjithë dhe Kastrioti i hodhi edhe një herë sytë aparaturave.

Pastaj përsëri pa nga tekniku.

Ky ngriti dorën për t'i thënë se ishte i lejuar të ngrihej.

Në këtë kohë dëgjoji në shlemafon zërin e trashë e nervoz të Smirnovit.

-Çfarë pret akoma 54-15?!

Mbrapa zërit të komandantit të shkollës rendnin edhe disa zhaurima bisedash të rrëmujshe.

-Të dal në brezin e ngritjes? - pyeti Kastrioti dhe pa sërish andej nga duhej të qenë shokët e tij.

-Dil! - iu përgjigj thatë e folura e Smirnovit.

Ai nisi ngadalë avionin drejt brezit të ngritjes. Kur mbërriti atje pista e asfaltuar shkëlqeu vakët nën diellin e ftohtë të atij fillim dimri.

-Më lejoni të ngrihem? – foli dhe priti për disa çaste përgjigjen.

Receptorët e kufjeve i sillnin vetëm atë zhaurimën që bëhej në kullën e drejtimit.

-Më lejoni të ngrihem? - përsëriti edhe një herë fort.

Në receptorë u bë një zhurmë përplasjeje, pasta disa të qeshura dhe më në fund u dëgjua zëri i Smirnovit: 54-15, ju lejoj ngritjen sipas intenerarit të caktuar!

Kastrioti hapi gazin, MIG-u buçiti gm dhe u turr nëpër brezin e gjatë të ngritjes.

Pas disa çastesh ndjeu se po ngrihej nga toka dhe u duk se avioni punonte si sahat. Rafshulta poshtë tij vraponte me një shpejtësi të marrë dhe qiell i kaltër u nder në xhamat e kabinës.

Mori ngadalë kthesën mbi atë rrafsh toke, që iu duk si e përhimët.

- 54-15 në ngritje - përcolli në mikrofon.

-Mirë - u dëgjua Smirnovi - Merr lartësinë katër mijë!

-Po marr lartësinë katër mijë - u përgjigj Kastrioti.

Ai ja mbërtheu sytë radarit, ku me shpejtësi po shfaqej “ptiçka” (zogu) i avioshenjës.

Ajo do të vinte nga një aerodrom që ishte larg prej këtej dhe në më të shumtën e herës ishte Mig-15.

Sovjetikët kishin kohë që po i shkatërronin këta avionë, sepse etjen e kishin në perfeksionimin e shpejtë të tyre.

Tani që ata kishin nxjerrë për ushtrinë Mig-19, me siguri nëpër aerodromet sekrete mbanin Mig-21, të cilët po i kthenin nga avionë fronti në avionë sulmi e me qëndrueshmëri të madhe në ajër.

Ishte e qartë se teknika e tyre e betejës në ajër kishte synim që të mos kryente më veprime luftarake brenda kufijve të Bashkimit Sovjetik, por përtej tyre.

Të gjithë në atë shkollë e dinin se pilotët sovjetikë mësonin të bombardonin në objektiva duke hedhur bombat mbi grumbuj me avionë Il 28.

Qielli ishte i kaltër në mënyrë mjaft monotone.

- 54-15 ki vëmendjen në përmbushjen e detyrës luftarake! - shqiptoi zëri në radio.

-Si urdhëron, të kem vëmendjen në përmbushjen e detyrës luftarake - u përgjigj Kastrioti dhe dalloj emocionin e tij në zë.

l hodhi sytë radarit, por ai qe i zbrazët.

Rrathët e shënjestrës elektronike fërgëllonin lehtë.

Kishte tetë minuta që fluturonte. Befas radari e kapi sinjalin dhe Kastrioti vështroi me alarm nga butonat e lëshimit të raketave.

Tani duhej gjakftohtësi.

Nisi të ndjekë llogaritjen e distancës, e cila po shkurtohej me shpejtësi të madhe.

Kishte ndodhur që pilotët të ishin përplasur me avioshenjën pikërisht nga hutimi i këtyre çasteve vendimtare.

"Ptička" po hynte në rrathët e shënjestrës. Tani Kastrioti mundi ta shihte edhe me sy të zhveshur tek vinte nëpër ajrin e ftohtë e fishkëllyes para kabinës.

Ai bëri manovrimet e fundit dhe e futi në mes të shënjestrës. Shtypi menjëherë butonin dhe ndjeu raketën që vrapoi drejt avioshenjës.

Mig-15 shpërtheu.

E kishte goditur mes për mes turbinës.

-Mollodjec! (të lumtë) - dëgjoji zërin e Smirnovit.

Ishte i ngrohtë: Mollodjec!

Kastriotit i rrihte zemra fort.

-Më lejoni uljen? - tha në radio.

-Ju lejoj uljen - ktheu përgjigje komandanti i shkollës.

Ai ktheu avionin drejt aerodromit. Brezin e uljes e dalloj shpejt.

Në tancoplloshadkë

Sheshi Nahimov ishte në pjesën lindore të qytetit e doemos që nga shkolla e gjer atje kishte mjaft rrugë për të bërë.

Ky shesh ishte i famshëm për zbavitjet që mund të kaloje dhe shumica e kursantëve e bënë me gaz rrugën e gjatë.

Kur mbërritën kish akoma njerëz që vinin dhe makina e vogël me altoparlantë kishte futur turirin në një bërryl rruge e akoma nuk kish nisur të bëhej objekti kryesor i tancoplloshadkës.

Sidoqoftë rreth njëmijë pjesëmarrës qenë grumbulluar dhe organizatorët po i jepnin dorën e fundit rregullimit të projektorëve.

Tregtarët ambulantë po bënë Pazar të frytshëm.

Kështu sheshi Nahimoviç, aq i qetë dhe i harruar çdo ditë tjetër të javës, bëhej të dielën vendi i ngjarjeve më të bujshme dhe qyteti gjithë ditët e ardhshme, gjer të dielën e re, do të merrej me vorbullën e thashethemeve të pafund që kishin lidhje pikërisht me këtë shesh.

Do të kalonte vetëm një gjysmë ore dhe vërshimi i lumit të madh të të rinjve, shumica të njohur midis tyre, do të numëronte tre mijë vetë.

Ky ishte edhe kapaciteti i përhershëm i Nahimovskij Plloshadz".

Dita po thyhej dhe njerëzit akoma bisedonin dhe qeshnin me njeri-tjetrin, vajzat putheshin, huliganët diku shkëmbejnë grushtet e para dhe tregonin thikat, ushtarakët rrinin grumbull dhe shihnin me indiferencë civilët.

“Gaz”-et e vogla të policisë kishin ardhur tashmë me kohë në pritje të zënkave që do të ndodhnin.

Milicët i kishin fytyrat dhe ecejaket kaq mospërfillëse sa të dukej çudi pastaj si turrehin për të rrëmbyer ndonjë trazovaç të rrezikshëm.

Zakonisht tani për tani ishte ende herët. Ata bisedonin grumbuj-grumbuj me njeri-tjetrin ose përtypnin ç’të mundnin.

Palush Bardhoshi pa Larisën që rrëshqiti aty afër dhe Janaqin që po i ndiqte me kërshtëri lëvizjet e dallgëzimeve të turmës.

Pastaj

Rexhepin tek fishkëllente. Më tej Bujar Andonin me të dashurën e tij, Svjetllanën.

Kastriot Lekën nuk po ja zinte syri.

Altoparlantët e makinës së vogël nisën të gërthitnin këngë Italiane, franceze e gjermane, gjër angleze dhe amerikane.

Bile edhe këngë spanjolle e meksikane.

Vallëzuesit preferonin rrokun dhe buki-vuki.

Palushi iu afrua Janaqit dhe i hodhi dorën në qafë.

-Sot ne do të rrimë bashkë - i tha.

Janaq Papa e vështroi si njeri i pajetë.

-Mos u mërzit për atë kurvën, Larisën - vazhdoi Palushi -
Ka vajza të tjera plot, më të bukura dhe më seksi.

Mbrëmja kishte rënë dhe drita e saj e zbehtë që tani po e shpëlante turmën e madhe njerëzore me një ndriçim të mekur.

-Borisi! - shtangu për një çast Janaqi, kur pa huliganin e njohur të qytetit që pinte cigare dhe i futur mes skortës së njerëzve të tij, u hidhte vallëzuesve vështrim pantere.

-Nga e njeh ti atë? - pyeti vëmendshëm Palushi.

-Nga Bujari - preu shkurt e pa dëshirë.

Bukuroshi kaçurrel e nga i cili dridheshin të gjithë, kaloi aty pranë, por nuk u a hodhi sytë.

-A dëshiron të të njoh me Nelin? - dëgjoji Janaqi zërin e shokut të tij.

Nuk ju përgjigj.

-Unë kam Irinën, ti Nelin, kalojmë një natë së bashku.

-Cila është kjo Neli?

-Një femër.

Janaqi përsëri u bë i heshtur.

Palushi ja afroi fytyrën aq sa i ndjeu frymën: Zbavitemi një natë dhe pastaj më thuaj përshtypjet që ke.

Nën tingujt e muzikës që buçiste nga altoparlantët turma njerëzore e sheshit Nahimov po tollovitej si nga një furtunë.

Projektorët qenë ndezur të gjithë me dritat e tyre po luhej mbi vallëzuesit e shumtë.

-A je dakord? - e shkundi nga krahët Palushi.

Janaqi pohoi me kokë.

-Tani më thuaj përse u ndave me Larisën?

Tjetri vetëm e vështroi.

-Nuk jam ndarë - belbëzoi.

-Nuk je ndarë dhe nuk takohesh më me të?!

-Nga e di ti se unë nuk takohem me Larisën?'

Palush Bardhoshi hapi gojën, por nuk foli. Gjeti me vend vetëm t'i binte me dorë miqësisht mbi shpatull.

-Larisa është shumë tërheqëse dhe unë nuk dua të ndahem nga ajo - vazhdoi Janaqi - Por se si më duket ndonjëherë.

-Si?

-Nuk e di.

-Kurvë?

-Nuk më hyn në punë në është e tillë.

-E pabesë, kërkon të të shfrytëzojë?

Janaqi ende nuk e shihte në sy.

Mes turmës vallëzuese sytë i kishin kapur Larisën që po kërcente me Bujar Andonin.

-Nuk e di ç'të them-psherëtiu - Më duket shumë dinake.

-Mos ke përshtypjen se është edhe e dyshimtë?

Janaqi ja nguli sytë shokut të vet.

-Çfarë do me thënë "e dyshimtë"?

Palushi qeshi dhe e shtyu me sup.

-E dyshimtë do të thotë e dyshimtë. Domethënë...

-Domethënë?

Palushi hapi sërish gojën, por nuk lëshoi fjalë.

-Mjaft me këto gjepura! – qeshi - Unë Irinën sot dhe ti Nelin.

“Unë jam shqiptar”

Kur hynë në mensë të hanin drekë panë në korridorin e saj një shpallje të madhe, të shkruar bukur e dukshëm.

Shumica e kursantëve tregoheshin mospërfillës, por megjithatë ajo kish efekt.

Kastrioti ndali këmbët. Ndjeu se edhe shokët e tij po ashtu bënë.

Shpallja fliste për një lektor që do të vinte nga Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Ai do të fliste për deklaratën e 81 partive në Moskë.

Në ato dy vjet e gjysmë që ata ishin në atë shkollë aviacioni, ndodhte për herë të parë që vinte një lektor nga ai forum aq i lartë i vendit.

Nuk ishte çudi që lektori aq i posaçëm të vinte meqë aty ishin edhe shqiptarët.

Kastriot Leka në tabelën e nderit

Të nesërmen në mëngjes Kastriotin e lajmëruan me një ushtar se e kërkonte Smirnovi.

Ai u turbullua pak nga kjo e papritur.

Tërë natën kishte parë në ëndërr Nataljen, por shumë herë u zgjua se e dashura e tij gjithë kohën e ëndrrës i afrohej, por nuk e takonte dot.

Ajo i zgjaste duart, e thërriste, dukej sikur ishte fare afër dhe Kastrioti nderte pëllëmbët e nxehta. Megjithatë, duart e tyre të zgjatura me mall nuk takoheshin.

Para komandës ushtari roje nuk e ndali sapo tha se ishte shqiptari Kastriot Leka.

Kur trokiti dhe i thanë “hyr” ai hapi derën ngadalë dhe e para gjë që pa, ishte Smirnovi.

Komandanti i shkollës rrinte në këmbë para tavolinës së tij në formë “T”-je dhe buzëqeshte.

Barku i rrinte si i rrëzuar mbi syprinën e tavolinës.

Dy telefona qëndronin kokë më kokë me njeri-tjetrin dhe atij, për shkak të ngjyrës tepër të zezë, i lanë përshtypjen e dy maceve gati për kacafytje.

Kastrioti iu paraqit.

Fundet e këpucëve të tij kërcitën në pllakat e dyshemesë së mermertë.

-Qetësohu, qetësohu! - foli Smirnovi që nga vendi i tij.

Kastrioti përkuli fare lehtë këmbën e majtë, siç edhe e kërkonte rregullorja ushtarake.

Smirnovi pa nga harta e madhe e botës, e cila i zinte gati një faqe muri.

Drita e ditës binte në dhomë tepër e dobësuar nga perdet e trasha prej damasku, që mbulonin dritaren.

-Kemi respekt të madh për ju - shqiptoi ai me një zë miqësor - Keni mbiemrin e udhëheqësit tuaj legjendar, Skënderbeut.

Smirnovi më në fund kishte lëvizur nga vendi i tij, ku pozonte. Po vinte drejt Kastriotit. Poshtë gjimnastjorkës së mbushur me medalje, barku lëkundej lehtë sa majtas djathtas në një mënyrë të habitshme.

Shqiptari e shihte për herë të parë këtë gjë dhe e mbajti vështrimin më tepër nga ç'duhej.

Tjetri e vuri re.

-Nuk mund të gëzohet gjithkush që ka bark – tha - Unë, për shembull, jam i sëmurë e prandaj kam bark.

Smirnovi e kapërceu me buzagaz heshtjen e kursantit dhe pëlqeu të hyjë në temë

-Ti habitesh përse të kemi thirrur?!

Ai u ndal përpara hartës së botes dhe hapi këmbët.

Përsëri po pozonte.

-Ne sovjetikët kemi respekt për trimat - vazhdoi pa e parë në sy Kastriotin.

Ky i shihte vetëm shpinën dhe sytë, pa e kuptuar as vetë, qëndruan një moment në vithet e tij të gjera jashtë masës.

I shkoi nëpër mend vetëtimthi mendimi se Smirnovi me mirë e më lehte mund të fliste me prapanicë.

-Komanda ka vendosur të të nxjerrë ne tabelën e nderit - vazhdoi zëri i tij, tashmë i transformuar në tingëllim ceremonial.

Pastaj u kthye nga ai.

-Gjithashtu do të propozojmë që emri juaj të shkruhet në librin e nderit të Ushtrisë Popullore Sovjetike. Ne dëshirojmë që edhe t'ju ndihmojmë për të bërë përpara.

Smirnovi kishte ngritur duart e shëndosha e të buhavitura nga dhjamët.

-Në Bashkimin Sovjetik mund të ngjitësh shumë shkallë - vazhdoi oficeri sovjetik.

Tani ai ishte fare pranë Kastriotit.

-Urime!

Smirnovi megjithatë nuk ja kishte zgjatur dorën, duke u treguar inteligjent. Ai nuk e dinte si do te reagonte kursanti shqiptar dhe nuk deshi të pësonte ndonjë të papritur.

-Unë jam shqiptar - u përgjigj më në fund Kastrioti.

Ishin fjalët e para që kishte shqiptuar në atë zyrë, ku thuhej se ishin të detyruar vetëm të dëgjonin.

Smirnovit i kaloi një hutim nëpër sy.

-Shqiptar trim - i mëshoi ky zërit - por edhe internacionalistë duhet të jemi.

Dhe pas pak shtoi: A pranoni urime?

Kastrioti dha përgjigje një heshtje të gjatë.

Rrinte pa lëvizur, i ngrirë në një "gatitu", në përpjekje për t'i shpëtuar lëvizjes së padëshiruar të zgjatjes së dorës.

Veprimi i komandës së shkollës ishte një lëvizje politike dhe synonte veçimin e tij.

Mbase edhe komprometimin.

Ndoshta edhe deklarimin kundër Partisë së Punës.

-Si të dëshironi - u rrënuar zëri, pak më parë pompoz, i komandantit të shkollës - Emri juaj nesër do të jetë në tabelën e nderit këtu dhe njëkohësisht do të vrapojë edhe për në Moskë.

-Çdo veprimi të sinqertë i jam mirënjohës - shqiptoi thatë Kastrioti - Tani më lejoni të largohem?

-Largohuni - u përgjigj Smirnovi me zërin, ku fjalët tashmë kishin nisur të nxirrnin fishkëllima.

“Fjodor, Fjodor”

-Atij nuk po i hapen rrotat - klithi një zë.

Të gjithë ngrinë me vështrimin nga avioni i Fjodorit, i cili kishte hapur vetëm një rrotë.

Një “ah” kaloi nëpër të gjithë si të ishte rënkimi i një globi të tërë.

-Ai e paska motorin të shuar! - klithi vajtimtar një zë tjetër.

Kastriot Lekës i qenë errur sytë dhe në atë mjegull mezi dallonte Mig-un që po ulej drejt tokës vetëm me një rrotë të hapur.

Shpërthyen një lumë fjalësh tërë alarm.

Shumë thoshin përse nuk e ngrinte edhe atë rrotë e të ulej më mirë me bark.

Dikush tjetër, pa dëgjuar fare çfarë flitej, hamendësonte se si ishte e mundur t’i fikej motori. Po hapjen avari a e kishte provuar.

Kastrioti që mpirë krejt.

Fjodori ishte pilot shumë i mirë dhe dinte çfarë bënte.

Krejt në mënyrë pasive, rastësisht sytë e tij të veshur nga ankthi dalluan teknikun Mamai.

Ky që i zbehtë në fytyrë dhe në ato çaste nuk duke] aspak i pirë.

Avioni po prekte tokën me rrotën e tij të vetme dhe po përpiquej të mbante ekuilibër.

Ndoshta në një fraksion të sekondës ai ja doli, por më pas ishte krejt e kotë. Shumë shpejt atë e përfshinë flakët.

instinktivisht të gjithë vrapuan atje, ku zjarri po përpinte Fjodorin. Dikush thirri për t’i ndaluar, pastaj u dëgjuan breshëri të gjata automatiku.

Më në fund ata kishin mbajtur këmbët.

Flakët njëqind metra më tej bënë një kërcitje të dhimbshme.

Në atë çast ngrirjeje dhe hutimi, nga turma e kursantëve u shkëput Bujar Andoni.

Vrapi i tij drejt avionit në flakë dukej si një pamje që zhvillohej si nëpër kozmos.

Kastriot Leka nuk e kuptoi se si edhe trupi i tij i mpirë nisi të lëvizte drejt flakëve rrapëllitëse...

Por sakaq Bujari kish arritur të hapte kabinën e ta hidhte mbi shpinë Fjodorin.

U dëgjua sirena e një autoambulance dhe bërtitjet e ngjirura të Smirnovit: Largohuni, largohuni që andej!

Zjarrfikësit kishin mbërritur me një shpejtësi të çuditshme dhe po përpiqeshin të mundnin flakët. Siç duket ja dolën, sepse pas pak prej Mig-ut nisi të dalë një tym i zi e i pistë.

Trupin e Fjodorit e kishin shtrirë mbi pistë dhe Bujar Andoni po i mbante kokën.

Po qante.

Pa zhurmë.

Lotët i rrëzoheshin të rëndë si gurë.

-Fjodor, Fjodor - thërritnin të gjithë.

Qenë mbledhur me dhjetëra kursantë, shqiptarë e hungarezë, grekë e kinezë, rumunë e kubanë.

-Fjodor, biri im! - klithi edhe mjeku Zaposhnikov, i gjendur sakaq aty.

Fjodori hapi lehtë sytë. Një curril i trashë gjaku i gurgullonte nën tëmth.

Kastrioti i kapi duart e varura për t'ia puthur.

Piloti buzëqeshi i lodhur dhe si nëpër gjumë. Pastaj i mbylli sytë si të vazhdonte të shihte ëndrrën e lënë përgjysmë.

Kishin sjellë vigun.

Zaposhnikovi i kapi pulsën e dorës dhe ndenji disa çaste i zymtë. Fytyra pak nga pak iu zbeh dhe pasi pa fytyrat e

njerëzve që kishte rrotull, mezi shqiptoi me një zë të rëndë: Fjodori nuk jeton më.

Turma kishte ngrirë.

Dikush klithi vajtueshëm “Fjodor, Fjodor”, por u shua sakaq.

Të gjithë po gëlltitnin lotët.

-Herë tjetër mos e bëni kurrë këtë që bëtë sot - u dëgjua zëri i ngurosur i Smirnovit - Avioni mund të shpërthejë e t’ju vrasë të gjithëve. Ai mund të ishte i mbushur me municion.

Por askush nuk ktheu kokën nga ai, askush nuk i hapi rrugë të shkonte te Fjodori i pajetë.

-Juve ju them - ngriti zërin komandanti i shkollës - Avioni mund të kishte bomba.

Fjodorin e vunë në vig dhe po e çonin drejt autoambulancës. Të gjithë po e shoqëronin nga pas me një ecje të përzishme e të dhimbshme.

Smirnovi rrinte i ngrirë në këmbë.

Puthjet e Leleçkës

Ajo lëvizi krahun e saj të bukur sikur të donte të shpihej, por megjithatë nuk u zgjua. Llëra e saj e mbushur dhe e bardhë u qetua pastaj mbi çarçaf dhe ajo nisi të marrë frymë me një zhurmë të lehtë.

Janaqi e vështroi për një kohë të gjatë fytyrën e saj ngjyrë pjeshke.

Një prushitje e lehtë e gjakut i përskuqte mollëzat dhe i zbriste tek buzët.

Aty çuditërisht kishte një tis të hollë pushi.

Atij iu kujtua fjala venduzë.

Leleçka Besonovna ishte tamam një ventuzë.

Po mbushte gati dyzetë e tetë orë i mbyllur në dhomë me këtë vajzë, që ia kish premtuar me kohë Palush Bardhoshi.

Më të shumtën e atyre orëve e kishte kaluar në shtrat.

Tani atij i merreshin mendtë sa herë që bënte ndonjë lëvizje të vrullshme dhe ndjente gjithnjë e më shpesh kapitje.

Por gjumi nuk e zinte.

Leleçka kishte vënë gjysmën e fytyrës mbi jastëkun e pastër dhe vazhdonte të merrte frymë duke bërë atë zhurmën e saj karakteristike si të një pompe të vogël.

Janaqit i erdhi përsëri në mend fjala venduzë dhe vuri buzën në gaz. Para dy ditësh Palush Bardhoshi e kishte sjellë drejt e në këtë shtëpi.

Ai qe i shoqëruar me një vajzë flokëkuqe, të cilën e thërriste Irina.

Ndenjën vetëm një gjysmë ore bashkë dhe më në fund u larguan.

Palushi i kishte siguruar nga komanda e shkollës një leje dy ditore dhe e pati garantuar të mos shqetësohej. Me shokët do të bisedonte e do t'u shpjegonte se miku i tyre po bënte disa analiza të ngutshme mjekësore, porositur nga komanda.

Një leje dy ditore, veçanërisht në ato situata që kalonin shqiptarët, ishte gjithnjë një privilegj i tepërt dhe i dyshimtë.

“Mund të siguroj edhe një shtesë lejeje prej dy ditësh të tjera” i kish rënë shpatullave Palush Bardhoshi.

Dhe më në fund pati ikur.

Dhe nuk ishte ndjerë i gjallë.

Pastaj dyzetë e tetë orë me Leleçkën.

Jo me këdo, por me Leleçka Besonovnen, dashnoren e Aleksejit.

Janaqi u përpoq ta hidhte vështrimin përtej dritares, ku mugullonte një dritë e hirtë dhe gjumëndjellëse.

Që nga shtrati, pas xhamave, shihte tarracat e disa pallateve. Një copë qielli me dritë të hutuar dhe larg, shumë larg, kurrizin e një mali.

Me sa i kujtohej ato çaste, atje mbi atë shpinë mali kishte qendra pushimi dimëror dhe bëhej ski.

Leleçka rënkoi nëpër gjumë dhe u kthye me fytyrën poshtë. Lëvizja e pakontrolluar e krahëve e kishte larguar nga gjoksi çarçafin dhe asaj iu zbuluan gjinjte e plotë dhe të bardhë.

Janaqin e kafshoi tinëzisht ndjenja e epshit, por qe tepër i lodhur dhe mendimin për ta zgjuar Leleçkën e dëboi me plogështi. Zgjati dorën dhe i ngriti çarçafin gjer në mjekër.

Sisët u ravijëzuan tani nën të, mbi bezen e tij, ngacmuese si më parë.

Atij iu kujtua se atë ditë, kur sapo kishte ikur Palush Bardhoshi, Leleçka Besonovna i qe ulur përballë dhe, pasi

kishte vënë pëllëmbët e duarve mes kofshëve, kishte qeshur shpënguar.

Qeshte dhe shihte Janaqin që u skuq e u bë flakë.

Më pas i kishte shkelur syrin, e kishte gudulisur nën gushë, e pati puthur me një “plluq” tek cepi i buzës dhe kishte vrapuar për t'i përgatitur darkën.

Shumë shpejt i kishte nxjerrë për të ngrënë mish të bollshëm dhe bashkë e patën kapërdirë të gjithë, duke rrufitur edhe verën e bardhë.

Stufa me gaz lëshonte një ngrohtësi dremitëse dhe atë disa herë sa s'e kishte kapulluar gjumi.

Pikërisht në këtë kohë ajo ishte zhveshur ngadalë, si nëpër një përvëlim avull.

Në fillim pati hequr këpucët e saj të bardha, bluzën (dhe tani Janaqit nuk i shqitej nga kujtesa ai çast i parë, kur gjinjtë e saj gati kishin kërcyer jashtë këmishës së puthitur pas trupit) kish hequr pak si me nervozizëm fundin...

Pastaj gjithçka që zhvilluar në kufi me ëndrrën.

Por zjarrmia e parë tashmë kishte rënë dhe në mëngjesin e Parë të shtrirë pranë njeri tjetrit, ajo i kishte folur pak për jetën e saj.

I ati më tepër rrinte në Moskë, sepse e thërrisnin gjithmonë në Kremlin.

Ajo nuk e dinte saktësisht se çfarë pune bënte, por nga njerëz të afërm, thënë duke pëshpëritur, kish marrë vesh se ai herë pas here fshehtas dilte jashtë shtetit.

Kurse e ëma bënte jetë disi të pavarur nga i shoqi dhe e bija.

Kur pati folur për të Leleçka kish treguar me dorë një fotografi që rrinte mbi komodinë në anë të shtratit dhe Janaqi kishte parë një brune të bukur.

Në bisedën e saj gjysmë të errët dhe plot ekuivok Leleçka Besonovna pati lënë të kuptohej se edhe e ëma bënte një jetë si të sajën.

Papritmas u çor zilja e telefonit.

Janaqi menjëherë desh ta kapte atë dorezë të zezë që gërthiste, por u tërhoq.

Zilja vazhdoi të binte gjersa Leleçka hapi sytë dhe u shtriq e paqejf. Pastaj zgjati dorën e zhveshur jashtë çarçafit dhe tërhoqi me forcë dorezën e zezë.

Kuisja e telefonit pushoi menjëherë.

Ajo fërkoi sytë ngadalë dhe u kujdes vonë të mbulonte gjysmën e trupit të saj të zbuluar.

Për Janaqin këto dy ditë e net kishin qenë të mjafta për të kuptuar se Leleçka i kishte marifete pozat me trupin e saj të lakuriqët.

Herë gjysmë, herë vetëm me një këmishë nate shumë të shkurtë, herë me flokë të lëshuar, herë e shtrirë në shtrat dhe e mbështjellë me një këmishë të gjatë e krejt të tejdukshme.

Në kësi rastesh ajo bashkonte dhe i hapte këmbët, i tkurte dhe i zgjaste, krejt si një oktapod.

-Është ai shoku yt - pëshpëriti duke zënë me pëllëmbën e dorës fytin e receptorit.

Janaqi e pa me alarm dhe për pak sa nuk klithi "kush".

Por u përmbajt dhe e kuptoi se për kë bëhej fjalë.

-Palush Bardhoshi?

-Ehë.

Leleçka hoqi dorën nga receptori dhe ja zgjati me një ndjenjë pakënaqësie në fytyrë.

-Ai kërkon që të dalim ndonjë shëtitje jashtë qytetit, diku - bërbeliti duke rrudhur buzët.

Janaqi mori receptorin dhe shkëmbeu disa fjalë etikete.

Kur pati rënë ajo zile telefoni dhe sidomos kur Leleçka i kishte thënë "është ai shoku yt" ai pati ndjerë ca të dridhura në trup.

Ishin të pazakonta për të në këto dy ditë që po kalonte i mbyllur në këtë apartament, por kuptoi se e kish zënë me të vërtetë frika.

Frika!

Janaqi ndjeu përsëri rrëqethjen që i shkaktonte kjo fjalë. Ndoshta nuk kish tamam frikë, por një gjë dihej. Dyzetë e tetë orë nën lëkurë nervat e tij prisnin të tendosura ardhjen e tyre, të shokëve të tij dyshues.

Dhe për herë të parë në trurin e tij të veshur nga një tymtajë e mjegullt orgjie, e kuptoi se nuk kish bërë mirë që kishte ikur nga shokët në ato çaste.

Palushi po fliste pa pushim në telefon dhe zëri i tij po vinte si një zhuzhurimë grerëze.

-Si nuk u mërzitët brenda! Dilni, dilni në një qytet tjetër! Shëtisni! Unë kam siguruar edhe një leje tjetër treditore. Ma dha vetë Smirnovi. Telefonova edhe sekretarin tonë të partisë. Në fillim sikur nuk i erdhi mirë, por pasta] ra dakord.

Mirë, më tha.

Kështu që do të bëjmë qejf edhe tre ditë të tjera.

Kësaj radhe do të vij edhe unë me Irinën.

Qerrata, do t'ja kesh kaluar mirë. Mirë ja ke kaluar apo jo? Qerrata, qerrata! S'kam dorë të keqe unë, di të zgjedh për shokun më të mirë që kam. Ç'ke për të thënë?

Janaqi mori frymë thellë dhe u mendua një hop.

Palush Bardhoshi i kish thënë kaq shumë fjalë sa e hutoi. Provoi edhe mërzi.

Ndjeu duart e Leleçkës që po i vareshin në qafë. E ktheu fytyrën vrik nga ajo.

Besonovna e puthi në faqe dhe i kafshoi lehtë majën e veshit. Janaqi e shtyu nervoz. Leleçka e kafshoi përsëri në buzë të veshit.

-Në çfarë numri telefoni punon shkolla? - i përcolli më në fund një përgjigje zërit matanë receptorit.

-Do të marrësh sekretarin e partisë?

-Kastriotin.

-Aha!

Palushi fishkëlleu.

-E di që ke dobësi për të. Merre! Por do të na prishësh punë kot. Ai po bën analiza mjekësore, e kupton?

U bë një pauzë, gjatë së cilës Janaqi e dalloi mirë shkroftimën e inatosur të Palush Bardhoshit. Ai kishte ulur dorezën e telefonit.

Ky u drodh dhe fjala frikë iu fanit therëse mes mendimeve të turbullta që po e mundonin.

La ngadalë dorezën dhe e shtyu tutje aparatin telefonik. Më tepër se kurrë ai kësaj radhe ndillte tersllëk.

-Fjeta shumë? - u shtriq Leleçka.

-U shqepe.

-Shumë, shumë?

Janaqi nuk i ktheu përgjigje.

E ndjente kokën të rëndë.

-Ah, jam shumë e lodhur - u ankua ajo - Më flihet prapë.

-Ai rrinte si i bërë gur.

Ajo e mbështolli me duart e nxehta, por Janaqi nuk reagoi.

-Ti mërzhitesh kot - iu llastua ajo - Krejt kot. Të gjithë e dredhin, e gjithë bota e dredh. Gënjen. E dreedh!

Ai e pa me ca sy të akullt.

-E dredh, e dredh dhe e përdredh. Ti e ke hallin tek atdheu, mos i kthen shpinën, mos e tradhton. E ke hallin t'i mbetesh besnik idealit, patriotizmit, komunizmit.

Janaqi, megjithatë, vazhdonte vështrimin e tij të vdekur që në bebëza.

-Dy ditë nuk më pyete për Aljoshën, birin e dy herë të heroit të Bashkirnit Sovjetik. Unë e njoh mirë, i njoh mirë të gjithë ata.

Vetëm bëjnë qejf dhe mbajnë fjalime për të gënjyer të tjerët. Të gjithë e dredhin.

Ai zgjati dorën për tek telefoni, por ajo ja ndali.

-Mësohu me këtë kohë! Unë nuk jam ndonjë vajzë e ditur apo që kam lexuar shumë. Shollohovin e kam dashur kaq shumë, sa mund të vdisja për të. Edhe ai bënte be për Stalinin, por kur vdiq ai kam parë një karrocë me libra të Stalinit që e hiqte nga shtëpia për t'i djegur në një nga furrat e qytetit.

Janaqi ia kishte ngulur sytë e ato dukeshin sikur po lageshin e po merrnin jetë.

-Më beso! - iu lut ajo - Edhe Shollohovi që ishte një stalinist i njohur ka bërë vëllimin e tretë të "Tokave të çara". Mbase nuk e ka bërë akoma, por ka folur publikisht për të. A ndoshta e ka shkruar dhe pret çastin për ta botuar. Asgjë nuk merret vesh këtu tek ne. Të gjithë e dredhin. A e di si zhvillohen ngjarjet në librin e tretë të Shollohovit? Nuk e merr dot me mend, por do ta them. Përmbajtjen e vëllimit të trete Shollohovi e ka ndërruar. Nekljudovin, që ishte për diktaturën e proletariatit, ai e vret në përleshje me bandat. Lë të gjallë liberalin, atë që i vinte keq për djemtë e menshevikëve dhe të kulakëve. Bën edhe një marifet në fund. Ja ndërron emrin kolkozit. Heq emrin e parë të tij, ti e di se kolkozi kishte emrin e Stalinit, dhe i vë emrin e Nekljudovit.

Janaqit sytë tashmë i qenë bërë si dy gropa uji nën hënë.

Pastaj me dorë të dridhur ngriti dorezën e telefonit dhe formoi numrin e centralit të qytetit.

-Dua shkollën e aviacionit!

Zëri matanë ishte i hollë, por i tingullt.

-Prit një çast!

Pas pak po ai zë i hollë femre doli përsëri dhe i tha të bisedonte me centralin e shkollës.

Një "alo" klithi pas receptorit dhe me pas fraza "jemi centrali i shkollës së aviacionit".

~Dua oficerin shqiptar Kastriot Leka.

Zëri matanë u këput.

-Dua oficerin shqiptar Kastriot Leka! - përsëriti Janaqi dhe fjalët e tij jehuan bashkë me rrahjet e tëmthave.

Prej përtej zëri erdhi si i përçartur.

-Të gjithë shqiptarët janë në stërvitje.

-Ç'stërvitje moj?!

-Stërvitje, shok.

Janaqit i rrahu zemra fort. Ato ditë nuk kishte asnjë stërvitje, aq më tepër për shqiptarët.

Me sa dukej kishin kufizuar apo prerë kontaktet e jashtme me kursantët e vendit të tij.

-Të lutem! - rënkoi.

-S'paske punë tjetër ti! - u çor zëri piskamë që matanë dhe mbylli dorezën e telefonit.

Janaqi ishte ngurosur.

-Unë po fle - pëshpëriti Leleçka - Fli edhe ti!

Ai nuk iu përgjigj. Formoi përsëri numrin e centralit të qytetit.

Ai i dha sërish centralin e shkollës.

Kësaj radhe një zë mashkullor e i vrazhdë pyeti se kush ishte.

-“Dua të bisedoj qoftë edhe me një student shqiptar”.

-“Kush jeni?” - përsëriti tjetri, - Kush jeni?, Kush jeni?”

Kush jam, belbëzoi me vete Janaq Papa dhe e lëshoi dorezën e telefonit tek gjunjët.

-Flemë bashkë, flemë, se jemi të lodhur që të dy - u dëgjua zëri grishës i Leleçka Besonovnës.

Kush jam unë - i klithi një zë brenda vetes - Kush jam?

Një ekspozitë e papritur

Lajmërimin për ardhjen e lektorit e zëvendësoi një tjetër. Në ato ditë të fund dhjetorit kursantët e shkollës së aviacionit njoftoheshin se në qytet ishte hapur një ekspozitë për sëmundjet nga infektimi radioaktiv.

Ajo vinte prej Leningradit dhe kishte disa ditë që shëtiste nëpër qytetet e mëdhenj të Bashkimit Sovjetik.

Lajmërimi u bë me një bujë dhe zell të tepruar.

U tha në auditor, u përsërit nga pedagogët, nga instruktorët, u fol për të në mensë, në rreshtimin e mëngjesit, në atë të mbrëmjes, gati në të gjitha urdhëresat dhe kujtesat që dilnin.

Lektori nga Komiteti Qendror, i përgatitur për të shpjeguar marrëdhëniet mes partive komuniste të botës, kishte kaluar transit.

Dy orë foli vetë, askush nuk e kishte pyetur.

Nga shqiptarët pjesëmarrja rezultoi e dobët.

Tani bisedat kishin krye temë këtë ekspozitë të papritur.

Më në fund, përkrah afishes doli edhe një grafik vizitash.

I stolisur me vija të kuqe e të verdha, shpjegohej se ndërtesa, ku ekspozita ishte vendosur, nuk i përballonte vizitat e njëhershme të asaj shkolle të madhe ndërkombëtare aviacioni.

Prandaj do të bëhej me një radhë të caktuar.

Për çudi të parët në këtë grafik qenë shqiptarët.

Svjetllana

Atë mbrëmje kur doli grafiku i vizitave, Bujar Andoni po kalonte i vetëm nëpër oborrin e ndriçuar rrallë nga llambat elektrike.

Sapo kishte hyrë në konvikt ai dalloi t'i dilnin përpara gjeorgjiani Ekvtime dhe disa ushtarë rusë.

Ata se si e panë. Por vështrime të tilla shumë sovjetikë kishin nisur t'u hidhnin me kohë shqiptarëve dhe Bujari nuk ju dha rëndësi.

Sapo pati bërë një hap brenda korridorit, kërciti çelësi dhe ra menjëherë errësira.

Në atë çast ai ndjeu një goditje të fortë në toka të rripit.

Nëpër errësirë kishte vezulluar për një çast një teh i bardhë thike.

Bujar Andoni klithi me tërë forcën e mushkërive dhe rrufeshëm zgjati dorën tek çelësi elektrik.

Kur hapi dritën pa para tij Ekvtimenë, që siç duket nuk pati kohë të flakte thikën.

Ky u zbeh i tëri.

Rusët u tërhoqën praptazi. Ata i kishin bërë llogaritë, që me të fikur njëri prej tyre dritën, Ekvtimeja ta godiste shqiptarin shpejt, fort dhe saktë mu në bark.

Pastaj nëpër errësirë të largoheshin.

Por thika kishte goditur në toka të rripit dhe Bujar Andoni i kishte kapur.

Ekvtimeja dridhej i tëri.

Ai pa nga shokët që ishin tërhequr.

Vetëm njeri nga ushtarët rusë, fytyrë shpëlarë në të verdhë, me kokën katërkëndëshe, bëri një hap para që t'i dilte në krah.

Tek dera u dukën disa kursantë polakë.

Bujarit i kishte ardhur ora. Kërceu përpara si i tërbuar dhe trupi i madh iu lakua në ajër si të ishte fajkua.

Grushti i tij kërciti në nofullën e gjeorgjianit.

Ky u rrotullua si fugë dhe ra përmbys.

Sakaq shqiptari i qe hedhur përsipër dhe e kish mbërthyer në fyt.

Një çast u duk sikur do ta mbyste, madje gjeorgjianit rënkimet po i shuheshin e në skaj të buzës i shpërtheu një rrëke shkume.

Por Bujar Andoni rrufeshëm kishte ndërruar mendje.

E kapi nga dy jakat e kapotës ushtarake dhe e ngriti në këmbë.

Ekvtimeja nuk qëndronte dot, veç kjo gjë nuk ishte e nevojshme. Bujari nuk e kishte çuar për ta marrë me të mirë.

Ai i dha një grusht të dytë me sa fuqi që pati.

U duk sikur u thyen të gjitha, edhe nofulla e gjeorgjianit edhe dora e shqiptarit.

Bujar Andoni kishte tendosur trupin edhe për një goditje të tretë, por Ekvtimeja gojën e kishte plot gjak.

Kur pa gjakun Bujar Andoni u shkreh i tëri.

I erdhi keq.

Trupi i bërë hekur pak sekonda më parë, u squll si i një fëmije.

U bë gati që t'i zgjaste dorën të ngrihej, kur dikush e goditi fort mbrapa kokës.

Atij iu errën sytë dhe në ato pak fraksione kohe që i mbetën para se të humbte ndjenjat, e kuptoi se e kishte goditur pabesisht ushtari rus me kokë katërkëndëshe.

Trupin e ndjeu të rëndë sa një shkëmb dhe ra.

Si nëpër ëndërr ai priti me dëshpërim goditjen tjetër, por kjo nuk ndodhi.

Dëgjoi grushte që jepeshin tutje tij.

Si në një pamje të çfokusuar dalloi kubanin Kutinjo që po grushtonte me një shkathtësi të habitshme ushtarin rus.

Kubani e qëllonte me aq lehtësi dhe metodikë sa ai vuri buzën në gaz dhe e la ta rrëmbente humbja e ndjenjës.

Priti, por pikërisht kur u duk se më në fund e mori bota e errësirës, atje, në bebëz të syrit, ku ajo po mblidhej me shpejtësi, ngjau e papritura.

U shfaq e zbehtë drita.

Në fillim një si mjegull, si tymtajë e largët zjarresh që digjeshin dhe më pas hyri një imazh fytyre, më vonë hijet e disa njerëzve.

Më në fund pa qartas grushtin spektakolar të Kutinjos.

Rreth tij kishte shumë kursantë që e nxisnin dhe duartrokitnin.

Një “urra” e mbylli të gjithë shfaqjen.

Kokë katërkëndëshi ishte shtrirë sa gjatë gjerë mbi pllakat e bardha të korridorit.

Gjithçka pati ndodhur si në një ndeshje të rregullt boksi.

Bujar Andoni u ngrit në këmbë.

Si një robot ishte çuar edhe gjeorgjiani Ekvtime.

Me duart e varura, tamam një shimpanze, pasi kishte fshirë me mëngë gjakun, ai duke u lëkundur, po lëvizte drejt tij.

-Bëhemi shokë - nxori fjalë e gjak.

Ekvtime ja kishte zgjatur dorën, por Bujar Andoni po e shihte me dyshim. Nuk provonte asnjë urrejtje ndaj tij, por gjesti i dukej idiot.

-Bëhemi shokë! - belbëzoi tjetri - Bëhemi shokë, dreqi e mori! Unë gabova e ti më fal!

Bujar Andonit ajo që kishte ndodhur iu duk edhe më e largët.

-"Ti doje të më vrisje - iu përgjigj.

-Bëhemi shokë - iu lut tjetri-dhe do të shohësh si e mban fjalën një kokë gjeorgjiani. Dreqi e mori, të një lloji jemi edhe ne, edhe ju.

Bujari nuk ja dha dorën. Për një çast një damar i kishte kërcyer në ballë.

-Shokë bëhemi vetëm kështu - thirri me zë të lartë.

Ai rrëmbeu thikën që rrinte akoma përdhe.

Ekvtime u zbeh.

Bujar Andoni nuk e ndehu atë drejt gjeorgjianit, por e mëshoi në një nga gishtat e tij.

Aty shpërtheu gjaku.

Ekftime e kuptoi menjëherë gjestin e shqiptarit dhe i zgjati dorën e tij.

Ky ja preu një çast mollëzën e gishtit dhe vuri buzët të pinte gjakun gjeorgjianit.

Kështu bëri edhe Ekvtimeja.

-Tani jemi shokë me besë –deklaroi Bujari.

Ekvtime e përqafoi.

Familje cariste

Të nesërmen ishte e shtunë dhe Bujari pasdite mori rrugën e ngushtë dhe plot dredha që të çonte në Bibliotekën e qytetit.

Atij i rrahu zemra sa dalloi nga larg ndërtesën solide e të bardhë të saj.

I ngjiti shkallët nën vështrimin e ngulmët të pastrueseve.

Svjetllana ishte në fond dhe ai e priti pak. Kur ajo erdhi nuk e vuri re sepse ish pas shpinës së dy tre lexuesve, që dëshironin libra.

Bujari e thirri.

Vetëm atëherë ajo e dalloi dhe vuri buzën në gaz.

-Ja, do të vij - i dha përgjigje me zërin e saj gazmor dhe u zgjat tek veshi i koleges për t'i thënë diçka.

Kur doli nga pas sportelit ajo kishte marrë një ngjyrë të purpurt, jo aq e zakonshme në takimet e tyre tepër korrekte. ‘

-Më mori malli - tha ai.

Ajo dalloi fashiturën e bardhë pas kokës.

-Ç'të ka ndodhur?

-Asgjë, rashë praptazi nëpër errësirë.

Svjetllana i dha të kuptojë se bënte sikur i besonte.

-Unë i humba shpresat se do të vije - pëshpëriti ajo.

Për një çast e kishte fiksuar vështrimin e saj mbi buzët e Bujar Andonit.

Megjithatë ngjyra e purpurt po i zbehej dhe në fytyrë po binte muzgu i ftohtësisë.

Çasti fatlumtur kishte zgjatur fare pak. Bujari e pati vënë re shumë shpejt këtë dallim të motit në pamjen e Svjetllanës dhe nuk i vuri rëndësi fjalëve të saj.

-Dalim pak shëtitje - propozoi ajo, duke u përpjekur të mos e bëjë të dukshme një pauzë që u krijua dukshëm.

Hyri në dhomën e punës, u var sërish pranë veshit të koleges së saj dhe më në fund doli e veshur me një pallto ngjyrë rozë.

Shkallët i zbritën në heshtje.

Bujar Andoni po mendonte si ishte e mundur që t'i ndodhte njeriut të vraponte e të vraponte i djegur nga malli drejt njeriut që dashuronte dhe me ta takuar atë, zjarri të fikej sikur të mos kish ekzistuar kurrë.

-Mora vetëm dy orë leje - shqiptoi ai fajshëm.

Svjetllana nuk dukej shumë e habitur. Zakonisht lejet për liridalje të Bujarit kishin qenë njëzetë e katër orëshe.

-Nesër në mëngjes do të shkojmë kolektivisht të vizitojmë një ekspozitë. Kështu duhet të jemi që sot në mbrëmje në shkollë.

Ai fliste dhe ngrinte supet.

-Çfarë ekspozite? - u habit ajo.

-Një ekspozitë për sëmundjet nga infektimi radioaktiv.

Svjetllana rrudhi buzët.

-Si nuk e di?! - u habit Bujar Andoni. I kishte lindur dëshira ta kundërshtonte.

-Ekspozita këtu bëhen plot - ia priti ajo, si të ishte bezdisur nga dyshimi i tij - Por kjo e këtyre sëmundjeve... më mirë të mos ma kishte thënë.

-Më fal!

Ajri i ftohtë pa ju pikte fytyrat. Tani ishin larg zagushisë së kaloriferëve të bibliotekës.

-Ekspozitën e sëmundjeve?! Ç'thua?!

Bujari u skuq. I erdhi inat që u tregua kaq i dobët përballë refuzimit të saj.

Kur kish dashur t'i tërhiqte vëmendjen në bibliotekë më shumë e kish bërë për çapkënllek. Por kur mori vesh se ishte nga ato të "klasës së përmbysur“, i erdhi kaq dhe vendosi ta donte.

Ose të paktën ta merrte për grua.

Bujar Andoni nuk qe nga ai lloj që gëzohej nga fatkeqësia e të tjerëve.

-Të paktën të shkonim bashkë në kinema - foli ultas ai.

-Në kinema?! Është romantikë e prapambetur.

Bujari u skuq më tepër. Ajo qe e bukur. Palltoja rozë i hidhte reflekset e ngjyrës së vet mbi mollëzat e saj të faqeve.

Nuk kishte arritur dot sa ta puthte ndonjëherë.

Ia kish kapur dorën e butë, ja kish lëmuar, njëherë kish dashur të afronte dhe buzët deri atje, por qe tërhequr. Svjetllana pati kakarisur dhe vetëm ishte lajkatuar.

Ndoshta ajo është thjeshtë një femër e ftohtë, mendoi Bujar Andoni me vete.

Thjesht e ftohtë.

Heshtja qëndroi mes bisedës si një gur i rëndë.

-Prindërit këmbëngulin që unë të martohem - tha ajo krejt papritmas.

Svjetllana nuk po e shihte.

Vështrimi i saj qe shpërndarë nëpër ajrin e ftohtë të asaj rruge krejt të zbrazët.

Bujarit ju duk se në fytyrë ruses së bardhë i ishte gdhendur edhe një ngërdheshje tallëse.

-Më kërkon një njeri me post të lartë - vazhdoi Svjetllana dhe ndoqi me kënaqësi të veçantë tronditjen që ai pati nga ky lajm i beftë.

Por Bujari akoma nuk po i shihte dot sytë.

-Ai është një anëtar i Komitetit Qendror të republikës - shtoi ajo qetësisht.

Bujar Andonit tashmë i ishte mpirë i gjithë trupi.

Vendi i plagës pas koke i theri aq sa iu errën sytë.

-Ti ç'thua? - foli sërish Svjetllana dhe atij ju krijua përshtypja se ajo donte që ai të vdiste aty, mes ngricës së trotuarit, i goditur nga hemorragjia cerebrale.

Në përgjigje mobilizoi të gjithë trupin e vet, por vetëm belbëzoi.

-Unë nuk kam vendosur akoma - tha ajo pas një heshtje rrënuese - Unë nuk e di si mendon ti.

Bujari bëri dhe një sforcim të dytë dhe më në fund fjalët i dolën shkoqur.

-Mua pse më pyet?

Svjetllana e pa pjerrtas.

-Ne jemi miq - vazhdoi ajo ftohtësisht - dhe miqtë duhet të këshillohen me njëri-tjetrin, kur hedhin hapa të rëndësishme në jetë.

Ajo kishte folur dhe më në fund pati vënë buzën në gaz.

Ndoshta tani ai po e kuptonte se buzëqeshja e saj e shpeshtë ishte një maskë.

Një valë urrejtjeje për të iu ngjit si zamkë në fyt dhe ai qe gati ta nxirrte bashkë me gllomkat e pështymës për t'ia lëshuar në të gjithë fytyrën e për të parë si do të nxihej nga zemërimi ajo buzëqeshje e ngrirë sallonesh.

Por e gëlltiti.

Ai nuk dinte të urrente njeri.

As këtë vajzë të bukur ruse, tre breza të përndjekur e persekutuar nga komunistët e vendit të vet.

Ajo nuk mund si të kish ndjenja as për të, as për atë tjetrin, anëtarin e Komitetit Qendror.

Svjetllana donte të gjente një strehë të sigurt, politikisht të garantuar.

E çfarë do t'i jepte asaj një martesë me një shqiptar, madje me një fshatar nga një vend i largët.

-Mua më vajti vonë për ekspozitën - ngriu zërin ai.

Fjalët fishkëllyen nëpër ajrin e akullt dhe ranë si brymë.

Svjetllana u drodh.

Vështrimi i saj u turbullua.

-Mirë u pafshim! - shkrofëtini Bujar Andoni dhe shpejtoi hapat të largoj sa më parë nga ajo.

~Nuk po më përcjell deri në bibliotekë? - foli Svjetllana ankueshëm.

Ai donte të thoshte “jo”, por u kthye.

-Po të përcjell.

Gjer tek shkallët e mëdha e të bardha të bibliotekës ata të dy heshtën. Ajo u përpoq disa herë të thoshte diçka, ndoshta faleminderit, mbase ndonjë formulë pendimi, por Bujar Andoni i ktheu kurrizin dhe iku.

Nën rrethin e bustinës ushtarake fasha e bardhë e plagës dukej prej së largu.

Ekspozita e sëmundjeve nga infektimet radioaktive

Një orë para se të niseshin për në ekspozitë mbërriti urdhri që bashkë me shqiptarët të shkonin dhe kursantët kinezë. Autoritetet e shkollës nuk dhanë asnjë sqarim përse kishte ndërruar plani i parë i tyre, por shumëkush e lidhi ngjarjen me përplasjet e fundit politike në kampin socialist.

Para ekspozitës rreshti i gjatë i kursantëve kinezë dhe shqiptarë ndenji një kohë të mirë sa të futeshin brenda. Nëpër korridore ata dëgjuan që ekspozitën ta thërrisnin muze.

Në ballë të godinës me germa të mëdha që shkruar se ajo nuk ishte një ekspozitë për sëmundjet nga infektimi radioaktiv, por për kurimin nga to.

Studentët i lexuan dhe i rilexuan fjalët qetësuese në hyrje, duke kërkuar të kuptonin misterin e të gjithë asaj thashethemnaje të përhapur në shkollë, ku ekspozita paraqitej si vend i tmerrit.

Dera vazhdimisht rrinte e hapur dhe prej andej dilnin herë pas here njerëz. Kursantët u a qepnin menjëherë sytë për të deshifruar frikë apo paqe në vështrimet e tyre.

Disa çifte policësh i shihnin shqiptarët me bishtin e syrit dhe flisnin zë ulët me njëri-tjetrin.

Më në fund shoqëruesi i kolonës, çifuti Bremen, doli nga ndërtesa e muzeut. Me të ishte edhe një njeri shumë i shëndoshë e që dukej tamam si fuçi birre.

Pas pak rreshti i kursantëve futi kokën në ndërtesën masive dhe të gjithë shtangën.

Disa makete njerëzish të djegur nga rrezatimi bërthamor ishin duke dhënë shpirt në pozicione nga më të ndryshmet.

Qe një tkurrje e një kruspullosje trupash nga një dhimbje e llahtarshme.

Rreshti i njerëzve provoi ndjenjën se kishte hyrë në gojën e një ndërtese lubi.

Pastaj lëvizi ngadalë si në një ngërç.

Po hynin në një korridor të gjatë dhe gjysmë të errët.

Maketet e njerëzve gjysmë kufoma nuk kishin të mbaruar.

Në të vërtetë qenë manekinë, por të punuara kaq mjeshtërisht sa truri i gjithsecilit binte në grackën e përngjasimit me njeriun e vërtetë dhe kjo shkaktonte terror psikologjik.

Nga kokat dhe gjokset e manekinëve derdhej vazhdimisht gjak, lëkura digjej, eshtrat shtrembëroheshin me një shpejtësi të tmerrshme, drita të mëdha ndizeshin e fikeshin si në makth për të imituar rrezatimin bërthamor.

Rexhep Mema ishte bërë dyllë i verdhë.

Tek hyrja e një salle të madhe ai i mbajti këmbët dhe kërkoi ujë. Në të vërtetë ujë po kërkonin edhe disa kursantë të tjerë.

-Na ka zënë sëmundja e gjakut - tha dikush.

Një tjetër mezi po mbante të vjellët.

Si të kishte mbirë nga dheu, një nëpunës shërbimi u vërsul tek njeriu që po gulçonte dhe, pasi e kapi fort nga të dy bërrylat, ja uli kokën mbi një enë të rrumbullakët të vendosur në qoshe. '

Tek kinezët kishte plasur paniku.

Një pjesë e tyre kishin dalë duke lëshuar disa thirrje në gjuhën e tyre si të kishin provokuar kataklizmin e përshkruar nga ungjilli.

Me ta pati dalë edhe Palush Bardhoshi.

Atij i kishte rënë të fikët dhe dy policë e kishin lënë jashtë në dëborë deri sa kishte ardhur në vete.

Janaqi më kot thoshte “mos çani kokat, këto janë gënjeshtër”.

Kastriot Leka mbahej, sidoqoftë. Kjo shkaktoi ngacmimin “ai nuk ka dalë kot në tabelën e nderit”.

Po hynin në sallën qendrore.

Atje ishte imituar shpërthimi bërthamor.

Në çdo faqe muri kishte nga një shpërthim të tillë.

Të dukej vetja se ishe në një vend të zhveshur e të pambrojtur nën mëshirën e shpërthimeve të pafund të bombave atomike.

-Bomba! - thirri me një zë të ngjirur Rexhepi.

Ai po tregonte një sferë të madhe që rrinte në mes të sallës.

E rrethuar nga parmakë elegantë të mbajtur nga zinxhirë të hollë e që shkëlqenin nën ndriçimin e katër shpërthimeve të mëdha që rrethonin vizitorin.

Shumica iu afruan me kujdes armës bërthamore. Ishte një maket i bombës atomike të hedhur në Hiroshima.

Disa zgjatnin duart dhe i mbështetnin mbi sferë.

-Janaq, na bëj një fotografi! - tha me zë disi të holluar Bujar Andoni.

Janaq Papa në fillim nuk kuptoi asgjë.

-Vërtet, na bëj një fotografi - përsëritën disa zëra.

Kursantët u gjallëruan dhe nisën të shihnin njeri tjetrin në sy. Rexhep Mema ia shkrepiti të qeshurit.

Vështrimet kërcyen edhe mbi të, pastaj u larguan sepse e kuptuan se shoku i tyre po përdorte të qeshurin për të zbuar edhe gjurmën e fundit të llahtarit nga bomba.

-Më qafsh, Janaq, një pozë! - thirri Palush Bardhoshi.

U krijua sa hap e mbyll sytë një pështjellim gazmor dhe Janaqi hoqi aparatën nga supi. Të gjithë u turrën rreth Bujar Andonit, trupi i madh i të cilit shërbeu si direk për t’u mbështetur të tjerët.

Bomba e madhe mbeti pas shpinës së tyre.

-A ja vutë mirë bythët, djem? - thirri Bujari.

-I vumë, i vumë - u përgjigjën të gjithë mes të qeshurave.

- Jepi tani Janaq!

Ky tashmë kishte zënë këndin e përshtatshëm që të fuste pamjen sfiduese antiatomike të shqiptarëve, vuri aparatit në sy dhe tha në mënyrë ceremoniale:

-Shikoni këtu, tek xhaxhi!

Dhe e shkrepiti.

Borë Krishtlindjesh

Nëpër vitrina qenë shkruar urimet e para për vitin e ri që po vinte.

Por ato ishin të pakta.

Tek-tuk nëpër skaje vështrimi të kapte lodrat e para dhe ishin shpeshuar bredhat e zbukuruar, të cilët kishin nisur të vezullonin dridhshëm pas qelqeve të magazinave popullore.

Veç njerëzit nxitonin secili ne hallin e vet.

Qe një lëvizje shumë paqësore dhe mjaft nga ata nuk dinin asgjë se çfarë po ndodhte në botë.

Ose të paktën dinin aq pak sa nuk e kuptonin dot gjendjen e vërtetë ndërkombëtare.

Ata dinin parullat “garë paqësore” dhe “paqe”.

Imperializmi, term kaq i përdorur në kohën e Stalinit, ishte çvlerësuar dhe bërë fjalë gati pa jetë, megjithëse e gjendur në të tëra fjalimet e radios, të shtypit e të televizionit. “Pravda” dhe jo shumë mbrapa konkurrentja e saj e vjetër “Izvestija”, njëra gazetë e partisë dhe tjetra e shtetit, i kishin mësuar njerëzit të konsumonin eterin politik të ngjarjeve me hundët e bllokuara nga “gripi” i fjalëve të përgjithshme.

Shume pak e dinin se ky ishte pragu i vitit 1961, vitit më të vështirë të lëvizjes komuniste botërore, e cila do të përçahej më dysh rreth dy super poleve, Moskës dhe Pekinit.

Ndërsa më parë kishte krijuar një qendër çarjeje Beogradi dhe afro dy dekada më pas edhe komunistët italianë.

“Imperializmi” po e merrte kalanë rivale pak e nga pak.

Bora në majën e kodrave të buta rreth qytetit ishte çdo dimër vendi i preferuar i amatorëve të skive.

Dy teleferikë të mëdhenj ngjiteshin e zbrisnin pa pushim nga stacioni i tyre i zhurmshëm në qytet e deri në oborrin e madh të hotelit me disa kate të turizmit, i cili qe lakmia e shumë njerëzve.

Sovjetikët, më parë se të ndërtonin një hotel komod poshtë në qytet, këtë gjë e kishin bërë lart, në kurrizin e kodrës më të madhe e që i ngjante një shpine deveje.

Kastriot Leka bashkë me Nataljen kishin hedhur skitë mbi supe dhe shtrëngonin fort duart e njeri tjetrit.

Bardhësia e borës rreth e rrotull qe e bukur dhe turmat shumëngjyrëshe të skiatorëve gëlonin nëpër hapësirën e saj të pafund.

Një babushkë (plakë, gjyshe) sikur të mbinte nga dheu, u doli përpara.

-Mollodoj çellovjek (djalë i ri) - tha ajo duke vështruar Kastriotin me ca sy të shndritshëm e të qetë - Mbaheni kapelën në kokë se do të ftoheni.

Kastrioti vuri buzën në gaz dhe me dorën e çliruar nga shtrëngimi i Nataljes fërkoi flokët e zbuluar.

-faleminderit, nënë! - i foli plakës dhe menjëherë e ngjeshi kapelën në kokë.

Natalja qeshi lehtë dhe duke vënë dorën para gojës.

Kastrioti e kishte vënë shtrembër atë dhe ashtu dukej si aktor cirku.

Duke kukurisur ajo zgjati dorën e mbuluar me dorashkën ngjyrë kremi dhe ja rregulloi.

-Mjaft se u shkrive! - i tha Kastrioti.

Ajo qeshi më tepër.

Nisi të gajaste edhe babushka. Kjo kishte një të qeshur me zë fare të ulët, sikur donte të mos prishte qetësinë e kurrkujt mbi atë rrafsh të bardhë bore.

Pastaj duke tundur lehtë kokën, u largua nëpër gjurmët e këmbëve të skiatorëve.

Prej andej dukej pista e lëshimit dhe atje njerëzit bënë zallahi të madhe.

Natalja ia zgjati dorën përsëri Kastriotit.

Ky e shtrëngoi fort.

-Ikim tutje nga janë pishat - tha ai.

Ajo mënjanoi pak kokën me një gjest çapkënlleku.

-Jo.

Kastrioti u skuq.

-Më keqkuptove - foli me dëshpërim.

Ajo iu var në qafë dhe e puthi gjatë.

-Shkojmë - u përgjigj, ndërsa faqet i qenë përskuqur nga një ndjenjë e hovtë lumturie.

-Fëshfëritja e pishave do të na zëvendësojë orkestrën.

Ata vrapuan një kohë nëpër borë, duke dihatur e qeshur penguar. Diku u dëgjua një melodi me kitarë dhe Natalja i mbajti këmbët.

Pastaj nisën sërish të ecnin.

E kishin lënë shumë pas pistën e lëshimit të skiatorëve.

-Eja me mua në male, atje afër qiellit unë e kam shtëpinë ~ perifrazoi Kastriot Leka vargun e një kënge popullore shqiptare.

Natalja kukurisi sërish.

Gërsheti i vetëm mbi gjoks iu përhodh.

-Varg shumë mahnitës - thirri ajo me entuziazëm - Ju shqiptarët keni këngë të bukura.

-Ne shqiptarët?!

-Ne?!

Natalja iu hodh në gjoks dhe bëri një “ah” sikur të ishte kujtuar papritmas për një gjë të këndshme.

-Në verën e këtij viti unë do të jem shqiptare. Ky do të jetë edhe viti im më i bukur.

Ajo klithi me gëzim dhe u rëndua mbi trupin e tij.

Kastrioti u gjend i papërgatitur dhe nën peshën e trupit të saj nën pelush për pak u rrëzua.

Nataçia qeshi edhe më tepër.

-Më fal, kur më hipën në kokë qesh tërë ditën si budallaçkë

- tha ajo, pasi vështroi pamjen a habitur të Kastriotit

-Ja një tropinkë (shteg) – thirri pas pak dhe tregoi me dorën e nderur përpara një anë të pyllit me pisha, ku vërtet dallohej një shteg i ngushtë kalimtarësh.

Hynë në pishnajë dhe ndoqën tropinkën.

Herë pas herë mbi kokat e tyre degët shkundnin borë.

Ata ngazëllenin dhe harronin t'i shkundnin menjëherë copërat e bardha e të ftohta të saj.

Nataljes i qe ndezur edhe më ajo ngjyra e purpurt në fytyrë dhe vështrimi iu zbut nga disa pikëlime të vogla lotësh.

Ajo ishte varur kaq shumë pas tij, sa në një çast Kastrioti nuk po kuptonte asgjë.

Donte të çohet, por Natalja tashmë ishte bërë një me të dhe i duhej të ngrinte dy njerëz.

E pamundur. Dukej se bora po e zhyste brenda saj dhe nuk pati aq kohë të mendonte se ç'po ndodhte.

Në këtë çast Natalja e puthi dhe ato buzët e saj fshin aq të nxehta sa mund të shkrinin borën e gjithë atij mali.

Madje u duk se gjithçka rreth tij shkrihej, tretej, ujërat gurgullonin e largoheshin tej, bari mbinte e rritej me shpejtësi, degët e pishave mbusheshin me zogj dhe një diell i madh nxirrte kokën e i këqyrte hokatar.

Ajo i kishte zbërthyer xhupin dhe i kishte futur kokën në gjoks.

Me një zë të tronditur plot mall e blatim, krejtësisht e dorëzuar para ndjenjës së saj femërore, NataIja i pëshpëriste pa pushim “të dua, të dua më tepër se gjithçka tjetër në botë”.

Atëherë ai e kuptoi fjalinë e saj “Këtë verë ne do të martohemi”.

Kjo i ngrohu trupin dhe Kastrioti e ndjeu veten mashkull. Kërkoj me duar nën pelushin e saj, pasta| nën xhaketë, nën pulovër, nën këmishën e mëndafshtë pjesët e lakuriqta të Nataljes.

Ishte hera e parë që po shkonte kaq larg, që ishte njëkohësisht edhe kaq afër.

“Eja me mua në male, atje afër qiellit unë e kam shtëpinë”. Kush po këndonte këtë varg dashuror të vendit të tij?

As nuk e dinte, as po e kuptonte, as mundte ta gjente. Trupat e tyre tashmë ishin tretur në një dhe atij ju duk se shtrati i tyre bashkëshortor qe ngritur tamam në atë shtëpinë përrallore pranë qiellit.

Babushka

I kish marrë uria.

Pyetën njeri-tjetrin dhe u siguruan se kjo pati ndodhur me të dy.

Hodhën skitë në krah dhe u drejtuan në një kioskë portative. Aty kishte birrë me shumë alkool, kishte edhe petulla me reçel, me marmelatë dhe me mish.

Por Natalja preferoi një kafe. Ajo bëhej me pak qumësht dhe që të dy vendosën të pinin nga një filxhan.

Pasi e rrufitën atë ngadalë, ashtu në këmbë, ndërsa njerëzit vinin dhe largoheshin tërë zhurmë, e panë se urinë nuk e kishin shuar aspak.

Morën edhe nga një petull me reçel e më pas Kastrioti mori edhe një tjetër me mish e piu edhe një gotë birrë.

Shpejt të dy e ndjenë veten të rigjeneruar.

Pas asaj që ndodhi në shtegun e pyllit me pisha, dëshira për të bërë ski e kishte humbur të gjithë ekzotiken e saj.

Ranë dakord të ktheheshin në qytet.

Aq më tepër që edhe Sergejit dhe Ninës Kastrioti u kishte premtuar të kthehej për drekë.

Natalja pati marrë një dritë të veçantë në fytyrë.

Nuk kukuriste më, as ia lëshonte veten të qeshurit dhe fjalëve të shumta.

Kishte rënë në një heshtje, ku si fjalë përdorte herë buzëqeshjen e përmbajtur, herë vështrimin e shpejtë e që më pas tërhiqej nën qerpikët e syve, herë shtrëngimin e trupit të saj pas tij, herë një frymëmarrje të turbulluar si në atë shtegun e pyllit, ndërsa bënin dashuri.

U nisën drejt teleferikut. I qenë afruar stacionit kur dikush

rrëshqiti me ski bri tyre dha sa nuk u përplas me ta.

Më në fund mes shkulmit së borës të ngritur nga vrapi i skive, ai qëndroi disa metra larg tyre.

Njeriu kishte një kokore me xhufkë dhe mbante një pulovër të madhe me një kokë tigri që i rrinte në pjesën e gjoksit.

Skiatori po afrohej dhe më në fund poshtë kokores së madhe dhe syzeve të errësuar në blu, u shfaqën sytë e Aleksejit.

Nataljes i ra një ngjyrë e bardhë në fytyrë.

Rusi po vinte këmbëngulshim drejt tyre, duke hedhur ngadalë këmbët e lidhura pas skive.

-Ju përshëndes! - thirri, duke ngritur lart njërën dorë të mbështjelle me një dorashkë gjithë push.

Kastrioti vetëm tundi kokën, por në krah të tij Natalja ishte bërë gur.

-Mirë u pafshim! - bërbëlit tjetri, i zënë ngushtë nga heshtja e dy njerëzve përballë.

Pastaj u kthye rrëmbimthi e rrëshqiti poshtë të tatëpjetës.

Lëvizjet i bënte me forcë dhe pas pak kohe u shndërrua tej në horizont vetëm në një pikë të zezë.

-Mollodoj çjellovjek! - dëgjuan ata pas shpine.

Hutimi i Kastriotit dhe i Nataljes ishte i vogël dhe i shkurtër.

U kthyen andej nga dëgjonin zërin.

Përpara tyre qëndronte një babushkë.

Kastriotit iu duk se ishte pikërisht ajo që u doli në fillim.

Edhe zëti i butë që dëgjuan, u ngjasoi me të.

Ai instinktivisht vuri dorën në kokë dhe pa se kapelën e kishte në vend.

-Jeni zbërthyer në gjoks - tha plaka dhe zgjati dy duart e saj të buta dhe tepër të vogla për t'i mbërthyer Kastriotit lëkurkan me push, marrë hua prej Sergejit.

-Faleminderit! - u përgjigj me të shpejtë ky dhe mbërtheu me nxitim kopsat.

Babushka tundi kokën me miratim dhe u largua qetësisht.

-Ajo ishte? - pyeti Kastrioti Nataljen.

-Është tjetër.

Kastrioti ngriti supet me habi. U përpoq të sillte ndërmend babushkën e parë, por gjithçka iu ngatërrua me portretin e asaj që sapo ishte larguar.

-Ndoshta kjo ndodh sepse janë Krishtlindjet – ngriti supet Natalja - Gjyshet dalin nëpër borë dhe kujdesen për të rinjtë.

Kastrioti vazhdonte të ishte i heshtur.

-Domethënë sot paska qenë ditë e mirë? - pyeti ai.

Natalja në fillim nuk e kuptoi dhe u bë gati që t'i jepte një përgjigje me fjalën "ndoshta", por pastaj klithi nga gëzimi dhe iu hodh në qafë.

I kishte vërshuar në fytyrë e përskuqura e bukur tek rrinin në atë "shtëpinë pranë qiellit" në shtegun e pishnajës.

Po flokonte borë.

-Edhe kjo është borë Krishtlindjesh - ngazëlleu Kastriot Leka.

Kishte ardhur teleferiku dhe që të dy nxituan drejt tij.

Vallëzim me të gjithë të dashurat e tyre

Mbrëmja e madhe e vitit të ri u bë në palestrën qendrore të shkollës ndërkombëtare të aviacionit.

Zaharov balukja ishte kujdesur që gjithçka të vinte si në një mbrëmje moderne. Kishte sjellë edhe orkestrën më të mirë të qytetit si dhe dy projektorë të ngjyrosur.

Kursantët kishin marrë të gjithë të dashurat e tyre. Mungoi" vetëm Tamara e Rexhep Memës, e cila e kishte justifikuar mosardhjen me dëshirën që vitin e ri ta festonte me vëllezërit e vegjël në shtëpinë e saj sa një kuti.

Studenti shqiptar doemos ishte i mërzitur, sepse ky do të ishte takimi i tij i dytë me moldavianen e gëzueshme të tancoplloshadkës Nahimov.

Në orën dymbëdhjetë, siç e desh zakoni, vallëzuesit e shumtë dhe të gjithë amatorët e bisedave dhe të pijeve, të ngulur nëpër tryeza, u përqaftuan dhe i uruan njëri-tjetrit një vit të mbarë.

Kishte nisur viti 1961 dhe më të shumtëve në atë sallë ai po u dukej si një vit i ëmbël, në të cilën do të binte muzikë gjithë kohën dhe do të kishte plot për të ngrënë e bërë dashuri.

Çimçakiz

Ndoshta shumë njerëz flinin pas natës së pagjumë të vitit të ri, kur u hapën shumë fjalë se në Moskë, midis vitrinave me bredha e me lodra fëmijësh, në një fasadë ndërtese, ishte gjetur një portret i madh i Hrushovit me një kalli misri në gojë.

Njeriu që e përfliste më me pasion këtë thashethemnajë ishte Alekseji.

Ai fliste dhe përtypte diçka nëpër dhëmbë.

-Po ti ç'e ke këtë gjë? - e pyeti dikush.

Alekseji e nxori nga goja dhe ja zgjati tjetrit.

Ky e preku me kujdes. . .

-Çfarë është kjo që të ngjitka kështu?

I biri i dy herë heroit u gajas:

-Është çim ça kizzz.

Ngricë

Kishin ardhur pushimet dimërore, të cilat rusët i quanin zimnije kanikulli.

Studentët bullgarë, rumunë, hungarezë, çekë, polakë dhe gjermanë u kthyen në shtëpitë e tyre. Si zakonisht shumica me rublat e hequra mënjanë bleu sende që në Bashkimin Sovjetik ishin lirë, kurse në vendet e tjera mezi i gjeje.

Më shumë nga të gjithë me këtë tregti brenda “kampit socialist” merreshin çekët dhe bullgarët.

Vetëm njëri prej tyre u kthye në Sofje me dhjetë aparate fotografikë.

Mëngjesin e ditës së parë të pushimeve dimërore mbërriti në shkollën e aviacionit gruaja e oficerit polak Tadeush.

Ky Tadeushi kishte një kostum e kapotë gri, me disa gjerdanë të varur tej e përtej gjoksit, si të ishte një oficer mbretëror.

Të gjithë i kishin ngjitur një nofkë: "Gjenerali".

Pikërisht ky “gjeneral” atë ditë pati shkuar në qytet tek një dashnore e tij dhe e shoqja, pasi e priti gati gjithë ditën, i hipi trenit e iku.

Të nesërmen ikën dhe laosianët.

Këta pilotë të mbretit me kohë kishin bërë presion pranë ambasadës që të iknin sa më parë nga kjo shkollë aviacioni, ku disiplina për ta ishte e padurueshme.

Me uniformat e tyre të çrregullta e me huqet që mbase i kishin marrë sa tek oborri mbretëror dha sa tek partia, ku kishin qenë më parë, për të mësuar drejtimin e avionëve ishin bërë vazhdimisht objekt humorit, sidomos me atë historinë që u përhap menjëherë në shkollë e që lidhej me

kërkesën e tyre pranë komandës se në cilën ditë të javës ishte dita e bordellos.

Tani këta laosianë po iknin dhe rendën fjalë se në vend të tyre do të vinin pilotë nga mbretëria e Sudanit.

“U nas zabota takaja”

Bora kishte një ditë të tërë që binte pa pushim.

Kishte filluar prej natës së kaluar-dhe tani me kohë errësira shtrihej gjithkund.

Qytetin e pushtoi nata, por ajo nuk po pushonte.

Në oborrin e shkollës ndërkombëtare të aviacionit jashtë kishin nxjerrë një togë ushtarësh dhe i kishin dënuar për të pastruar borën.

Ata lëviznin lopatat të mardhur dhe pas pak, nën rënien e pafund të floknajës së bardhë, u kthyen në njerëz prej bore.

Kishte rrezik të ngrinin.

Roja profesionist Sherifjevi i vështronte nga mbrapa xhamave të dyfishta të ndërtesës së postërojës dhe herë pas here qeshte bashkë me disa oficerë të shtritur nëpër karrige.

Llambat elektrike mezi lëshonin një njollë dritë mbi këtë skenë të pazakontë.

Kastrioti që mbështetur tek parvazi dhe mes borës flokë madhe që po vishte xhamat, përpiquej të shihte atë që po ndodhte në oborrin e shkollës.

Pas shpatullave ndjente shokët e tjerë që vepronin si ai e rrinin gojëkyçur.

-Të shkojmë e t'u flasim oficerëve që t'i fusin brenda.

Ndryshe ata do të ngrijnë - tha i revoltuar.

-Ç'na duhet - u përgjigj Janaqi.

-Unë do të iki - tha Kastrioti dhe pasi hodhi supeve kapotën e ngjeshi në kokë kokoren, doli nga dhoma e ngrohtë.

Të tjerët mbetën të pagojë.

-Shkojmë dhe ne - ndërhyri Rexhepi.

-Na vjen keq, por këto janë punët e tyre – reagoi mbyturazi Bujar Andoni - Ta marrin keq këta djaj oficerë, aq më tepër me ne.

Kishte rënë heshtja sërish.

Të gjithë iu afruan xhamave dhe prej frymëve të tyre ato visheshin në çast nga mjegullimi.

Kastriot Leka që afruar tek dritarja e dhomës, ku po rrinin oficerët dhe nisi t'u binte me majat e gishtave xhamave të mbushur me dëborë të ngrirë.

Prej një copëze vendi të pastruar prej ngricës shiheshin uniformat sovjetike që vazhdonin të bisedonin dhe herë pas here të qeshnin me zë të lartë.

Siç duket ai iu kishte thënë atë për të cilën edhe kishte zbritur aq i revoltuar.

Siluetat e oficerëve kthyen nga një gllënjë të madhe pijeje dhe pas pak Sherifievi doli jashtë.

Kastrioti i tha diçka, por tjetri e dëgjonte pa e parë.

Pastaj lëvizi një rënë dorë dhe diçka po i thoshte shqiptarit.

Ky nuk lëvizi nga vendi, thua ishte ngrirë.

Sherifievi menjëherë nxitoi për tek grumbulli i ushtarëve.

Edhe ata dukeshin si të murosur në mes të asaj bore flokë rëndë.

Më në fund oficeri sovjetik u bërtiti ushtarëve dhe ata u rreshtuan me ankth e mundim.

-Ja doli mbanë, më duket - pëshpëriti Rexhepi.

Në shesh ushtarët nisën të ecnin me hap rreshtor.

Si prej një bote tjetër, krejt e transfiguruar, mbërritën zvargur edhe disa tinguj të këngës “U nas zabota takaja” (Preokupimi ynë është i madh).

Po këndonin të detyruar.

Ata fundoseshin në borë, dikush binte e një tjetër mezi ngrihej.

Shqiptarëve në dritare iu mpi trupi.
Tutje në errësirë Sherifjevi po futej përsëri në dhomën e ngrohtë, ku gajaseshin oficerët.
Ai kaloi para Kastriotit pa ia hedhur vështrimin.
Shokët e tij pas xhamave shanë nëpër dhembë.
Kënga rreshtore nëpër borë vazhdoi, zgjati apo u zvarg edhe për ndonjë orë tjetër.
Ishte makth.
Ajo nuk qe më këngë, por klithmë e rënkime.
Kishte kaluar ora njëzetë e dy dhe sipas rregullores të gjithë ishin shtrirë nëpër shtretër.
Dhimbje-kënga ngrihej nëpër natë dhe kursantët nuk e kuptonin dot se ishte realitet apo zhgjëndërr që po iu avitej bashkë me gjumin e prishur të asaj nate.
Pastaj gjithçka u shua.
Kastriot Leka gjersa rënkim-kënga u fik, ndenji mes borës.
Si shtatore.
I egërsuar e kokëfortë.
Kështu ai mbeti një nga dëshmitarët e rrallë të asaj ngjarjeje të ndodhur më pas.
Tek porta e hekurt ishte hequr zvarrë e me zorrët jashtë Aleksej Leonidoviçi.
Kastrioti e njohu menjëherë, megjithëse ende rrokullisej shumë borë e dendur nga qielli dhe flokë zbuluar ai ishte fytyrë nxirë më tej se nata.
Disa ushtarë dolën me të shpejtë nga postëroja dhe pasi e morën në krahë, e hodhën në makinën e gatishmërisë, e cila me uturimë u nis drejt spitalit ushtarak.
Të nesërmen u mor vesh se çfarë pati ndodhur.
Aleksejin e kishin goditur me thika huliganët.
U hapën fjalë se ishte ngatërruar me ta për një shumë të madhe rublash.

U saktësua se goditjet me thikë i kishin ardhur prej miqsh dhe se në fund të fundit e gjithë historia qe një larje hesapesh.

Në spitalin ushtarak Aleksejin e kishte shpëtuar një operacion i gjatë dhe i vështirë.

Ljubov maja (dashuria ime)

-Më pyesni për letërsinë- tha ajo pas pak - Unë kam mbaruar dy vite të fakultetit. -

Rexhep Mema nuk u përgjigj.

Tamara e shihte me një vështrim, ku lutja ishte tunduese. Ishte takimi i tretë i tyre dhe moldaviana nuk kishte treguar më barsoleta. As i kishte fjetur në sup. As ecte çapraze me ato këmbët e saj plot lëvizje të shkujdesura.

Tamara qe tashmë shumë serioze, ajo dëshironte vetëm të largonte nga përfytyrimi i mikut të saj atë mbrëmje të fund nëntorit.

-Më pyet, më pyet, pra, për letërsinë - këmbëngulte ajo.

Po lutej e po buzëqeshte.

Rexhepi u gjend i pambrojtur para këmbënguljes së saj.

-Unë letërsinë e njoh pak - shkundi supet ai.

-Ja, më pyet për Eseninin dhe unë do të përgjigjem me gjithë qejf!

Ç'i kishte ato sy kjo Tamara!

Shpirti i saj ishte thellë, thellë atij deti të vogël, ku tashmë Rexhep Mema po hallavitej në mëdyshje.

-Atëherë më thuaj se çfarë ka thënë Majakovski për Eseninin!

Një i purpurt i shpejtë u duk sikur buroi nga gropëzat e mollëzave të moldavianes.

-Rusisë i ka humbur çiraku nopran me zë tingëllues - u përgjigj ajo gjithë gaz.

-Po tjetër?

-Tjetër?!

Ajo kishte ngritur supet. Buzagazi i saj në fikje, ende kishte lënë gjurmët në skajet e dridhura të buzëve.

-Pse ç'ka thënë? - pyeti pas pak.

Rexhepi i kapi të dyja duart, duke dashur ta tërheqë pranë vetes.

Ajo klithi në pritje të puthjes, por ai vetëm sa i aviti gojën tek veshi:

-Ka thënë “i mjeri, shkoi atje, ku nuk do të ketë më shishe vere bosh dhe brekë grash”.

Tamara turbulloi detin e vogël të syve të saj.

Pastaj iu var në vesh.

Ai dëgjoji pëshpërimën e fjalëve:

-Unë nuk desha të përgjigjesha, sepse druhesha. Ka qenë vetë Esenini, i cili ka thënë “kur të vdes, po qe se nuk do të ngjallem, dua të kem rreth e rrotull nëpër kodra vetëm shishe pije të boshatisura dhe brekë grash”.

Ajo tashmë i ishte varur në sup.

I qarkoi dorën në bel dhe bënë për të dalë nga bulevardi plot njerëz. Andej ku do të ishin vetëm të dy.

Duke ecur Rexhepi ndjeu se Tamara nuk ishte aq e lehtë në lëvizje sa edhe të jepte përshtypjen në vallëzim.

Madje sikur nuk i ekuilibronte dot këmbët.

Sërish për Svjetllanën

Bujar Andoni pati përshtypjen se dikush goditi në xhamin e kabinës telefonike.

Pastaj trokitjet u shpeshuan dhe u bënë më të forta.

Dukej se xhami bashkë me borën e ngrirë do të thyhej.

Ktheu kokën dhe dalloi siluetën e një gruaje.

Kishte dhjetë minuta që priste në telefon të dilte Svjetllana, por ajo ende nuk po vinte.

Kur i pati rënë numrit të saj, në telefon kishte dalë e gjyshja.

Zëri i plakës i erdhi i çjerrë dhe si i ndërprerë nga disa frymëmarrje të zorshme.

Bujari mendoi me habi se astma e saj kuptohej fare lehtë në telefon dhe bile kur e dëgjoje pas receptorit të krijohej përshtypja se grahmat e përtejme vinin nga një botë tjetër, për ku ajo, duke dhënë shpirt, po nisej.

Plaka kur mori vesh se cili ishte për matanë telefonit, sikur e shtoi astmën dhe zëri iu bë më nervoz.

Edhe Svjetllanën, kur e thirri, u duk sikur klithi.

Bujarit iu bë se do të ishte më mirë për të ta mbyllte atë telefon dhe të ikte. Të ikte sa më parë. Kurrë mos të kuturiste të pendohej si sot dhe të rikthehej tek Svjetllana.

Kjo lidhje kishte vdekur, madje ajo as nuk pati marrë jetë ndonjëherë.

Në xhamin e rëndë të kabinës trokitja e duarve të siluetës ishte shndërruar në përplasje grushtesh.

Bujar Andoni thirri edhe një herë më kot emrin Svjetllana në receptor, por pas tij nuk u ndje frymë njeriu.

Vendosi ta mbyllte përfundimisht atë telefon.

Përfundimisht.

Ajo i kishte thënë se do të martohej me një njeri me pozitë, bile me një anëtar të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Republikës.

Ajo i kishte kumtuar kështu ndarjen.

Bujari e pati marrë në telefon me një shpresë ende të pavdekur se Svjetllana mund të kthehej tek ai.

Besonte se në ato çastet e fillimit të njohjes së tyre ajo e dashuronte, ndërsa ai jo, se më pas ishte ai që po e donte marrëzisht dhe jo ajo.

Besonte se tani që radha e saj të ngrohte kujtimin e atij rasti, kur i binte pianos dhe ai i puthte duart.

Zëri u dëgjua tamam në çastin, kur Bujar Andoni po e largonte receptorin në uljen fatale drejt aparatit.

-Bujar, ti je?

Atij iu drodh dora dhe e rrahura e zemrës u përpëlit.

E donte, sigurisht e donte.

Nuk mund të ikte aq lehtë, me një "mund të martohej me një anëtar të...".

E gjithë ajo që e kishte turbulluar shpirtin e tij ishte një "mund".

-Bujar, Bujar!

-Svjetllana, jam unë.

Fjalët e tij kishin tingëlluar si një "Svjetllana, eja tek unë!"

-Bujar...

Ajo heshti dhe nëpër humbëtirën e saj ai ndjeu një ngashërim të largët, tepër të largët.

-Bujar...!

Ngashërimi po afrohej si uturima e një shtrëngate.

-Bujar, unë nuk të thashë të vërtetën.

Fjalët tashmë po binin të lagura nga lotët.

Mes kapitull

Brenda shkollës po bëheshin disa riparime që tërhoqën vëmendjen e kursantëve kuriozë.

Ato nuk kishin të bënin shumë me ndreqje dritaresh apo risuvatim tavanesh e muresh.

Jo.

Në të gjithë shkollën po ndërroheshin llambat e vjetra dhe kudo po montoheshin disa globe të rrumbullakët e modernë.

Abazhurët u ndërruan edhe nëpër auditorë, gjer edhe në sheshe.

Në salla u vunë tablo dhe disa piktura të blera nëpër ekspozitat personale të mjaft autorëve në qytet.

Shumica e këtyre krijimeve tregonin tmerret e luftës.

Bashkë me to erdhi edhe një pikturë e madhe, e cila tregonte momentin e mbërritjes së letrës nga fronti për vdekjen e djalit.

Më pas shumica e dyerve të zakonshme me kanata u zëvendësuan me ato rrotulluese. Për këto dyer nëpër shkollë nisi të përhapet edhe një shaka.

Duke parë se ambienti po modernizohej, por rregulli i brendshëm i shkollës po ashpërsohej edhe më, studentët nisën të thoshin se në këtë shkollë hyn lehtë, por e ke vështirë të dalësh.

Po vij!

Svjetllana kishte thënë “po vij, më prit” dhe pastaj “Ku je!” Bujar Andoni i kishte kthyer pa marrë frymë përgjigjen “po të pres para teatrit”.

Sa hapi derën e kabinës telefonike për të dalë, u ndesh me fytyrën të një gruaje që skërmiti diçka nëpër dhëmbë.

Mes rrudhosjes së tyre ai dalloi vetëm fjalën “ushtarakët”, të shqiptuar me përbuzje.

Donte t’i kërkonte falje, por gruaja e përplasi derën e kabinës dhe ai tashmë ndodhej nën qiellin e hapët.

Sa zgjati rendja e tij gjer tek godina e teatrit nuk e kuptoi dot.

Sa zgjati pritja deri sa erdhi Svjetllana, as edhe këtë nuk e mati dot.

Ishte një sekondë, një minutë apo një orë.

Ajo po vinte me pallton e saj rozë, me kokoren e bardhë me push të madh dhe çizmet ngjyrë vjollcë.

Tek ecte drejt tij, një avull i çuditshëm që ngrihej nga shtresa e trashë e dëborës, e ravijëzonte siluetën e saj si në flu.

Bujari ndjeu se kishte djersë në lëkurën e tendosur të gjoksit.

Vetullat e saj të holla u lakuan për të shprehur gëzim.

Svjetllana kishte lyer lehtë buzët me të kuq.

Ato u çelën ndoshta për të shqiptuar emrin e tij.

Bujar Andoni dëshiroi t’i thoshte diçka, të paktën fjalët “je bërë shumë e bukur”, por tjetra i futi menjëherë krahun dhe u mbështet tek ai.

Ecën ashtu për pak kohë.

Bujari kishte një drithërimë lumturie dhe për herë të parë në jetë kuptoi atë figurën letrare të shkrimtarëve se i duke] vetja sikur fluturonte.

-Ah, sa bukur! – thirri Svjetllana dhe tregoi me dorë një fëmijë të vogël, të cilin një grua shumë e bukur po e tërhiqte në slitë.

Kaq butësisht sa duke] si hyjni e porsa zbritur nga qielli. Ajo i tundi dorën dhe fëmija i qeshi.

Pastaj ngriti doçkën e tij të vogël të mbështjellë me dorashkë.

Ai kish një pako të madhe në gjunjë, të cilën e shtrëngonte fort me dorën tjetër.

Gruaja si hyjni vuri buzën në gaz dhe i përshëndeti me një ulje të përmbajtur të kokës.

Slita po ikte dhe sytë e fëmijës ende qeshnin dhe shihnin nga ta.

-Më fal!-tha Svjetllana pa pritur - Më fal! Mua nuk më kërkon për t'u martuar ndonjë nga Komiteti Qendror.

Po kalonin pranë një tabele emulacioni ku rreshti i gjatë i fotografive u ndje i tepërt dhe bezdisës.

-Unë rrjedh prej një familjeje cariste dhe është shumë e vështirë të lidh jetën me një komunist me pozitë të lartë.

Bujari nuk i dha përgjigje.

Edhe rrëfimi i saj tashmë i dukej i panevojshëm.

Svjetllana kishte folur me atë vrapim gjer tek ai.

-A je komunist? - foli pas pak.

Ai e pa në sy, i befasuar nga kjo temë e re e bisedës.

-Jo.

-A do të bëhesh?

Ai nuk po i shihte më sytë e saj.

-Jo - tha pas pak.

Svjetllana harkoi vetullat. Krahu i saj u shtrëngua më fort pas dorës së tij.

-Ti gëzohesh që unë nuk do të bëhem komunist? - e pyeti

qetësisht.

-Sigurisht.

-Por unë nuk thashë se nuk dua të bëhem, por nuk do të bëhem.

Svjetllana i mëshoi në krah dhe ngadalësoi hapat. Gati i kishte dalë përpara dhe po i kërkonte sytë.

-Unë nuk shoh ndonjë ndryshim mes tyre.

-Ndërsa unë shoh.

Bujar Andoni ndali dhe i vuri duart e tij mbi dy supet e imta të Svjetllanës.

-Kjo do të thotë se nuk dua të bëhem anëtar partie, por jo se e urrej komunizmin. '

Svjetllanës iu sulën mbi fytyrën delikate retë e turbullimit.

-Kurse unë e neverit komunizmin tënd - gati klithi ajo - E neverit, e neverit!

Kishte ndryshuar krejt, ishte bërë gur, qe shndërruar në akull.

-Unë nuk mund të dua atë që më bën të vuaj. Nuk mundem.

-Dhe kështu nuk më do edhe mua, që e dua komunizmin?

Svjetllana u bë gati disa herë të nxirrte fjalët sqaruese, por ia dha të qarit.

Dëneste.

Ai e kapi pas shpatullave të brishta dhe e afroi tek kraharori i tij.

Ajo nuk kundërshtoi. Dënesat iu kthyen në gulçe.

-Svjetllana, e dashur! - e thirri ai butë, duke dashur që ajo t'i ngrinte sytë deri tek fytyra e tij.

-Svjetllana, e dashur - përsëriti me ton shumë të butë.

Ajo u drodh lehtë dhe ngriti kokën.

Lotët i rrokulliseshin të nxehtë.

-Unë nuk e dua komunizmin. Nuk e dua - tha vendosmërisht Bujari.

Fytyra e Svjetllanës i ngurosi të gjitha tiparet e saj të bukura e të imta gjer në përmasat e një kukulle.

-Nuk e dua - pëshpëriti ai dhe i uli buzët e tij të dridhura në ballin e saj, pastaj nëpër faqet e ngrohura e të lagura.

-Nuk e dua! – përsëriti - Ky është sekreti im i madh, të cilin po ta besoj vetëm ty.

Svjetllana u duk sikur u tkurr, por në të vërtetë ky ishte gjesti i saj i para kërcimit. Kur iu hodh për ta puthur në buzë arriti vetëm të thërriste emrin e tij, a gjysmë emrin, apo vetëm rrokjen a shkronjën e parë.

Apo asgjë dhe ajo ishte vetëm një thirrmë e brendshme gëzimi.

Veç zemra e saj kishte thënë brenda kraharorit fjalët “Bujar, i dashuri im!”

Mësuesi im, ku je?

Zarfi ishte rëndomësisht shqiptar.

Me ngjyrën kafe të letrave të zakonshme të ambalazhit.

Sipër ishte shkruar shkujdesur emri i Kastriot Lekës dhe tek “dërguesi” shkarravitej gjithashtu një emër.

Shok i gjimnazit, madje në maturë edhe shok klase. Në miqësinë e tyre kishte pasur vetëm pak muaj "mjalt" dhe pastaj ai qe larguar drejt një grupi tjetër shokësh.

I shkurtër, vrapues i jashtëzakonshëm dhe shtytës gjyle, kopjues i famshëm dhe amator kokë shkrepur i peshkimit, ish-maturanti i pati sjellë një letër.

Pa i shkruar asnjë gjatë tre vjetëve që njëri rrinte në kryeqytetin shqiptar edhe tjetri jo shumë larg atij sovjetik.

Në hapësirën e dy mijë kilometrave ky ishte zarfi i parë që fluturonte për t'i sjellë disa radhë me gjuhën amtare.

E hapi.

Nuk dyshonte se letra apo kartolina duhej të kishte lidhje me vitin e ri.

Urim, patjetër një urim i zakonshëm.

Kishte hyrë me kohë gjysma e dytë e janarit, vërtet, por vonesa të tilla ishin të zakonshme në shërbimin postar mes dy vendeve dhe brenda shtetit sovjetik.

Për vitin e ri atë që një postier i zakonshëm e mbante në një çantë të lëkurtë supi, tani duhej ta ngarkonte një makinë me tonazh të plotë.

Si edhe zarfi, edhe letra e shkruar ishte fare e rëndomtë.

Diku edhe e zhubravitur.

Shkrimi i shokut të tij nuk kishte ndryshuar fare.

Kishte mbetur çapraz.

Fillonte me “I dashur Kastriot” dhe “në radhë të parë të uroj gëzuar vitin e ri 1961”.

Pastaj tregonte se vetë ishte mirë dhe se uronte që edhe ai, Kastrioti, të qe mirë.

Më vonë përshkruante se si do ta festonin 31 dhjetorin në kryeqytet, përmendte një bredh shumë të bukur të vendosur afër sheshit “Skënderbeu”, veturat private që ishin shtuar, një grup muzikor të cilin e kishte krijuar me shokët e vet dhe se vazhdonte Universitetin e Tiranës.

Këtë vit kishte mundur të siguronte një të drejtë studimi.

"Jam shumë mirë, mjaft mirë" shkruante duke mbyllur dy fletë të plota me shkrimin e tij tekanjor.

Kastriot Leka provonte ngadalë një lloj ndjenjë gëzimi që nuk po e kuptonte nga i vinte.

Nga kjo letër mbase, i erdhi mendimi i parë.

E zhubravitur apo plot rrëmujë fjalësh, sidoqoftë ajo i ngacmonte mallin për vendin e tij, për gjimnazin, për shokët, për bulevardin e madh të kryeqytetit, për vitin e ri e të gëzueshëm që kishin kaluar atje.

Letra kishte edhe tre radhë, por ai mendoi se tashmë qe i dehur prej saj. Një dorë nga larg i ishte zgjatur për t’i hequr mërzinë dhe shqetësimin që po kalonin.

Në Tiranë kishte paqe, kurse këtu tensioni ishte i ngritur deri në prag të kacafytjes.

Sidoqoftë i hodhi një sy shkarazi tre radhëve që mbyllnin shkujdesur atë letër nga larg.

Dhe ngriu.

Rreshti i parë thoshte se qe arrestuar mësuesi i tyre i letërsisë.

Vetëm kaq.

Emri nuk përmendej fare.

Ata në gjimnaz kishin pasur tre të tillë, por cili prej tyre ishte burgosur?

Katër fjalë të tjera sqaronin se a e mbante mend “ngopu Nano!”

“Ngopu Nano” ishte një batutë nga “Evgjeni Grande” e Balzakut.

Ah, klithi.

I qe arrestuar mësues Moisiu. Ai seç kishte pasur diçka në biografi.

Kështu flitej nëpër shkollë, por nxënësit nuk u vinin veshin shumë këtyre nëpërgojimeve. Ata e donin atë dhe kjo mjaftonte.

Më në fund shoku i tij i maturës, në një radhë e gjysmë bënte përpjekjen e fundit për të ndriçuar prangimin e profesorit të tyre.

Shkruhej me të shpejtë se ai kishte kërkuar që edhe në Shqipëri të bëhej një kongres i njëzetë, siç disa vjet më parë qe zhvilluar nga vendi i madh sovjetik.

Kaq.

Pati thënë se do të ishte mirë të bëhej një ndryshim i tillë. Dhe e kishin arrestuar.

E gjithë Tirana me bredhin e madh në sheshin qendror, tërë grupi muzikor dhe bora që valëvitej mbi malin e Dajtit, veturat private që shtoheshin dhe paqja shqiptare, iu tretën si të përpirë nga një gjeratore e krijuar mbi kokën e tij, në qiellin ngjyrë plumbi të atij piku dimri.

Ku je mësuesi im? Ku je?

Kastriot Leka ishte mpirë i tërë dhe kërkoi me sy një pikë, ku mund të mbahej.

Por gjithçka para tij ishte bosh, vakum.

E ndjeu trupin pa peshë tek po e përpinte një vorbull marramendëse ajri.

Për të ai mësues kishte qenë si një Krisht.

Delikat dhe i butë në shpirt, me duar që i nderte sa herë që donte të shprehte atë që e mundonte. Ai kërkonte letërsinë ngushëllim, personazhet artistikë qenë shokët e tij që i

gjendeshin aq afër sa mund t'i mirë përdorte për t'u ngarkuar mesazhet. Personazhet e Bajronit apo Dikensit, Hygoit apo Balzakut ishin si pëllumba të bardhë postarë.

Ai u vendoste në këmbë letrën e vogël të mesazhit dhe ata fluturonin aq larg.

Një pëllumb i tillë i bardhë kishte mbërritur gjer në Moskë me aspiratën për të hequr përfundimisht logjikën komuniste të ndëshkimit të njerëzve për shkak të së kaluarës politike dhe bindjeve të tjera.

Ku je mësuesi im?

Në cilin burg, në cilën qeli?

Përse?

Ti nuk rrezikoje kërënd, asnjë person, ca më tepër një shtet.

Ti ishe paqësor gjer në vetëmohim.

Përse t'i vunë prangat?

Ato duar të dobëta vetëm pesha e prangave mund t'i thyente.

"Ngopu Nano!" kishte deklamuar ai një herë një batutë të koprracit francez Grande, drejtuar shërbëtores së tij të përvuajtur.

Të gjithë kishin qeshur në pamundësi të duartrokisnin prej entuziazmit.

Ai adhuronte njerëzit e pafat, ata që vuanin, që nuk kishin shpresë.

Nuk donte t'i shihte ashtu, të sunduar e të fyer nga varfëria.

Boshllëku që e kish përrpirë nëpër vrundujt e ajrit, i kishte hyrë Kastriot Lekës nën gjoks.

Moskë, Çikago, Los Anxhelos u bashkuan në një kolkoz

Njeriu që këndonte atë mesnatë me sa dukej ishte ndonjë Student i huaj, sepse ruishten e fliste rëndë.

Në mëngjes herët Rexhep Mema ndjeu dikë që po fërkonte më disa lëvizje të shpejta derën e dhomës.

Ishte si gërvishtje.

Dëgjoi për një çast i tendosur dhe pa marrë frymë. Pastaj kërceu nga shtrati dhe hodhi me të shpejtë kapotën në supe.

Uli dorezën.

Mbajti për një hop frymëmarrjen dhe befasisht tërhoqi fort derën.

Para tij rrinte e ngurosur Maria.

Rexhepi u skuq dhe u bë flakë.

Deshi t'i kërkonte falje, por nuk i pëlqeu turbullimi në sytë e pastrueses.

Ajo diçka belbëzoi me sytë që përpiqeshin t'i shmangeshin vështrimit të tij.

Rexhepi u kthye me rrëmbim nga dera.

Atje ishte fshirë diçka e shkruar me bojë këpucësh, por që tashmë nuk kuptohej.

-Kush e ka bërë? - thirri shqiptari me alarm.

Turbullimi i madh i pastrueses i shkaktoi një parandjenjë akoma më të keqe.

Maria vazhdoi të fshijë me leckë derën dhe kur e pastroi mirë i tha:

~S'ka gjë, bir. Ishte shkruar një fjalë turpi.

Një kryq hitlerian

Të nesërmen e kësaj ngjarjeje Maria nuk arriti ta fshinte dot të gjithë atë që ishte shkruar në shpinën e derës së dhomës së shqiptarëve.

Ata nuk kishin bërë gjumë pothuaj gjithë natën, kur ndjenë ndaj të gdhirë hapat e pastrueses që po fërkonte sërish me nxitim.

E hapën menjëherë dhe panë se aty ishte vizatuar një kryq hitlerian.

-Dimitriu - belbëzoi plaka e urtë.

Studenti rumun Kosta

Kryqi hitlerian, i shkruar mbi shpinën e derës së kursantëve shqiptarë, i ndau në dy grupe studentët e vendeve të demokracive popullore.

Po kështu edhe rumunët.

Dimitriu nuk e pranoi se e kishte bërë, por kjo gjë që e sigurt përderisa e pati thënë pastruesja Marie.

Kjo që ndodhi, i acaroi grindjet midis dy grupeve në shkollën e aviacionit. Një pjesë thoshin se presioni ndaj aviatorëve shqiptarë për shkak të qëndrimeve të partisë dhe shtetit të tyre nuk ishte aspak i hijshëm.

Në fund të fundit divergjencat mes partive komuniste nuk qenë të vogla edhe në pjesë të tjera të kontinentit dhe globit.

Ç'ka ishte punë partish e qeverish le të që e tyre, ajo që i përkiste studentëve ishte tjetër gjë.

Aq më tepër që shqiptarët nuk provokonin politikisht dhe vetëm përpiqeshin të përvetësonin programin mësimor.

Të tjerët hidheshin me forcë dhe ngulmonin se që të gjithë kursantët e këtij vendi të vogël nuk ishin gjë tjetër veç tradhtarë të kampit socialist.

Nuk mund të rrihej duarkryq e të mos denoncoheshin.

Për ta ishte demokratike që t'i tregonin opinionit se Partia Komuniste Shqiptare dhe ithtarët e saj ishin stalinistë, zbatues të krimeve klasore, nuk qenë për bashkëjetesën paqësore midis kampit socialist dhe atij kapitalist.

Sigurisht edhe rumunët, nismëtarët e qëndrimeve të ashpra ndaj kursantëve shqiptarë, u ndanë më dysh. Ra në sy për polemikat e rrepta në favor të vendit të vogël

ballkanas një student rumun, i cili deri dje nuk kishte tërhequr vëmendje.

Ai quhej Kosta.

Ishte një djalë gazmor dhe i shkathët.

Më vonë u mor vesh se ai kishte filluar të mësonte edhe shqipen.

Por në uçelishe ndodhi edhe një ngjarje tjetër jo e zakonshme.

Në aerodromin ushtarak pranë shkollës së tyre qe bazuar një skuadrilje avionësh modernë Mig-21.

Ishte prodhimi i fundit i uzinave sovjetike dhe deri pak çaste më parë këta avionë rrinin vetëm në tre repartet e zgjedhura të gardës ushtarake të Moskës.

Pilotët e tyre flinin në shkollën ndërkombëtare të aviacionit dhe që në fillim të linin përshtypjen se mbaheshin me të madh.

Veçanërisht me përbuzje e duke qeshur me shpoti ata lëshonin fjalë kur pranë tyre kalonin kursantë shqiptarë.

Kjo gjë për pak shkaktoi një rrahje mes një grupi të tyre dhe dyshes Bujar dhe Ekvtime, të cilët kohët e fundit ishin bërë shokë tepër të afërt dhe shumicën e kohës së lirë i shihje së bashku.

Sigurisht miqësia e papritur dhe e pajustificuar e këtij çifti nxiste shumë fjalë. Pak ishin ata që e besonin se, pasi një njer tenton të të vrasë me thikë, mund pas dy-tre minutash ta zësh shok në besë.

Atasheu ushtarak i ambasadës shqiptare në Moskë

Mbërriti menjëherë pas ngjarjeve të ndodhura rishtas.
Mbledhjen e tij të parë ai e bëri me studentët, pastaj me komunistët.

Ai kishte folur me zjarr clhe e dinte se gjuha i bënte mrekulli.

Si gjithnjë natë pa yje

Në sallën e teatrit të qytetit po jepej një koncert dhe Kastrioti me Nataljen tashmë kishin parë gjysmën e tij.

Në afishet e vendosura nëpër rrugë ishte njoftuar si një koncert me këngë nacionale. Edhe spikerja pa kështu e paraqiti spektaklin.

Qenë tetë vajza që vallëzonin e këndonin vazhdimisht.

Kastrioti pyeti një rus që e kishte pranë vetes, se çfarë këngësh ishin ato. Fqinji çuditërisht i mbështjellë me peliçe, megjithëse në sallë bënte ngrohtë, u përgjigj se qenë këngë popullore.

-Po të kujt populli? - nguli këmbë Kastrioti.

-Popullore - u përgjigj njeriu me peliçe, duke e parë me shpërfillje të stisur.

Kastriot Leka deshi t'i thoshte se Bashkimi Sovjetik ishte bashkim shumëkombësh, por nuk po i pëlqente fytyra e tij.

Kur dolën nga salla e teatrit ai ngriti jakën e kapotës së tij ushtarake. Nataljes nuk i shpëtoi ky detaj dhe e pa me habi.

Kastrioti nuk e deformonte kurrë pamjen e jashtme të uniformës.

-Paske ftohtë?

Ajo kishte vënë buzën në gaz dhe marrë një pamje shpotitëse. Por Kastrioti nuk iu përgjigj.

Në të vërtetë ai kishte shumë ftohtë.

Edhe në sallën e ngrohur nga kaloriferët herë pas here i kalonin mornica në trup.

I hodhi krahun në sup Nataljes dhe ajo gati iu zhyt nën sqetull.

Bora qe e freskët e siç dukej pati rënë për disa çaste, ndërsa kishin qenë në koncert.

Ajo kërciti butë dhe nuk mbarte ftohtësi.

Veç Kastrioti frymën e të ftohtit e kishte brenda vetes. Kishte gjithë atë pasdite që ndodhej në mëdyshje t'i hapte Nataljes një bisedë.

Atasheu ushtarak, i ardhur nga Moska në mbledhje me organizatën e partisë së kursantëve, kishte propozuar se përgjigja më e mirë ndaj provokacioneve të autoriteteve sovjetike për t'i përçarë studentët shqiptarë ishte të hynin në Partinë e Punës.

Kështu ishin rreshtuar disa emra të mundshëm dhe i pari mes tyre kishte qenë ai i Kastriot Lekës.

Këtij ia kishin thënë këtë gjë me të mbaruar mbledhja dhe kishte qenë vetë atasheu ushtarak i ambasadës. Ai njihej me të atin dhe në një farë mënyre bisedën e filloi edhe si një dëshirë të tij. Kastrioti e priti me qetësi propozimin dhe vonë e kuptoi se në fytyrën e tij ushtaraku i zgjuar, i ardhur nga Moska, pati dalluar diçka më tepër se hutimi. Kështu ai kishte nxituar dhe belbëzuar se do të mendohej.

Përfaqësuesi i shtetit u step.

Nuk e kishte nxjerrë akoma radhën elegante të fjalëve të tij, kur Kastriot Leka nxitoi të korrigjonte qëndrimin e tij mëdyshës.

Tha se thjesht do të konsultohej, por e shihte tepër të mundshme hyrjen në parti.

Madje kjo kishte qenë edhe një dëshirë e vjetër e tij, që në bankat e gjimnazit.

Atasheu vuri buzën në gaz.

Lodhshëm.

Tek bashkë me Nataljen ecte bora kërciste intimisht nën këmbët e tyre dhe Kastrioti hodhi vështrimin në qiell.

Qe i errët, pa asnjë yll.

Gjithë këtë javë kështu kishte qenë, i zymtë.

Çdo natë, gjer në këtë të shtunë, Kastriot Leka e kishte ndjekur me ankth pamjen e këtij qielli.

I dukej se përgjigjen e brengës së tij do ta merrte nga ai. Nga retë e ngrira në gri të fortë apo nga pikimi i yjeve.

-Natalja! - thirri me zë të mbytur - A e di se më kanë propozuar të hyj në parti?

Ndoshta ajo bëri një "oh" apo diçka tjetër, sepse qe prishur në fytyrë.

-Më saktë kanë vendosur që unë të hyj në parti.

-Që të bëhesh komunist?!

Kastrioti tundi kokën.

Para tij u shfaq silueta e largët e ardhësit nga Moska, njeriut të rinisë komuniste. Ai imazh e kishte ndjekur gjatë gjithë ditëve të javës.

Në të vërtetë Kastriotit i venin pas dy hije, që të dyja nga Moska.

Kë duhej të zgjidhte, kë duhej të pranonte dhe cilës t'i bënte refuzimin.

Njëra sillte mesazhin e një partie liberale e në bashkekzistencë me Perëndimin, tjetra atë të luftës përjetë a vdekje me të.

Kë?

-Si? - pyeti Nata!ja.

Një "si" shqiptoi edhe vetë Kastrioti.

Ajo i tha se kishte folur diçka nëpër dhëmbë. Ai e kuptoi se atë "kë" pa dashje e pati thënë zëshëm.

-Si do të më këshilloje?

Natalja ngriti supet. Ishte krejt e pavendosur për të përcjellë një përgjigje.

-Të luftosh për drejtësi është gjë e mahnitshme - shqiptoi më në fund-Ndoshta duke hyrë në parti të shtohen mundësitë për këtë aspiratë.

Kastrioti psherëtiu.

-Domethënë më këshillon të pranoj? – pyeti - Kështu?

-Oh, jo, jo!

Zëri i Nataljes papritmas ishte alarmuar.

-Unë vetë nuk do të hyja kurrë në një parti. Kurrë. Politika për mua është zanat i një planeti tjetër.

Ra heshtja.

Më saktë ajo u rrokullis si një ortek që donte ta prishte atë bisedë disi absurde, pa kokë e këmbë, më tepër qenie ankthi.

-Unë nuk mund të vendos vetë - tha Kastrioti - Ne do të jetojmë bashkë dhe kjo çështje është e përbashkët për të dy.

-Nëse jeta tënde lartohet shpirtërisht me hyrjen në parti, atëherë unë do të ndihem e lumtur. Mua nuk më pëlqen asnjë lloj politike. Bijë e një stalinisti të hekurt e gardisti të kuq si edhe e një nëne anarkiste e trockiste si unë do të ishte vetëm kështu siç jam.

Ai e shtrëngoi fort pas trupit dhe pati përshtypjen se rrobat e dimrit nuk penguan ngrohtësinë e saj t'i depërtonte deri në zemër.

-Atëherë unë do të hyj në parti - foli si në ëndërr - Nëse partia është më e dëlirë se unë, atëherë kam fat të marr mirësi prej saj. Në rast se ajo është më e keqe se unë, atëherë le të tretim duke i dhënë sadopak mirësi asaj.

Kastriot Leka po shihte qiellin.

Ishte natë dhe ai vazhdonte të mos kishte yje.

Por as dritat e tokës nuk mbërrinin dot tek ai.

“Pravda” njofton

Njoftimi në gazetën “Pravda” për kongresin e katërt të Partisë së Punës së Shqipërisë ishte shumë i vogël.

Atje nuk ziheshin në gojë as dy raportet e mbajtura, as diskutimet e delegatëve.

Botohej vetëm një pjesë e përshëndetjes së kryetarit të delegacionit sovjetik, Pospjellov.

BBC (Projenij Vozdushnij Sill-Forcat Ushtarake Ajrore)

Kryekuzhinieri rrinte ne tavolinat e tyre dhe përpiqej t'u shpjegohej me mimikë se kjo që kishte ndodhur nuk qe për faj të tij.

Fytyra e madhe dhe e shëndoshë i rrinte si e ngjitur me zamkë dhe nga çasti ne çast i dukej se do të këputej e do të binte përdhe.

Gjestet që bënte ishin të ngatërruara dhe do të qenë shumë komike, sikur studentët shqiptarë të mos ishin aq të zemëruar.

Ishte dita e dytë e kongresit të katërt të partisë dhe për dreke u kishin nxjerrë peshk të gjallë të kripur.

Ai ishte i nxirë dhe binte erë të keqe.

I pari volli Janaqi.

U bë trazirë e madhe dhe për pak nxorën zorrët jashtë edhe të tjerë.

Edhe Bujar Andonin e nxorën të verdhë dyllë në korridor.

Tani pas protestës së tyre kishte ardhur vetë kryekuzhinieri.

Nga këndi i tij i preferuan disa rreshta tavolinash tutje, i vëzhgonte shqiptarët komisari Lisenko.

Shumë hungarezë po qeshnin nën zë dhe u hidhnin vështrime të pjerrëta.

Ata kishin kësaj dreke një ushqim të ri suplementar: çokollata.

-Mund t'ju thotë ndonjë gjë komisari - belbëzoi me ton të fajshëm kryekuzhinieri dhe përsëri bëri atë rrëmujën e grimasave, duke lëvizur sy dhe vetull.

-Ta thërresim qenin! - thirri Rexhep Mema - Hrushoviani i fëlliqur!

Klithmën e tij e përsëritën edhe mjafi nga studentët e vitit të dytë.

Ata i kishin përmbysur pjatat me peshk që të mund pakësonin kështu disi erën e keqe.

-Ta thërresim - tha edhe Kastrioti dhe u çua nga tavolina.

Të gjithë ndoqën me sy ecjen e tij drejt Lisenkos.

Ky e dalloj menjëherë shqiptarin që u drejtua për nga ai.

Koloneli nxitoi të dilte nga mensa, por Kastriot Leka ja kish prerë rrugën.

Replikat që shkëmbyen ishin të shpejta, por që nga tavolinat e tyre kursantët shqiptarë nuk i dëgjonin dot.

Lisenkua tundte supet, sikur pikërisht atje t'i formonte fjalët.

Me në fund erdhi pas Kastriotit.

Ky vazhdonte të ishte i zemëruar dhe gjersa erdhën tek tavolinat e tyre nuk e ktheu asnjëherë fytyrën nga ai.

Lisenkua dukej sheshit që ishte i fyer e megjithatë po bindej.

-Hë? - foli nëpër dhëmbë koloneli me të mbërritur në tavolinat e shqiptarëve.

-Sytë që të pëlcastin, nuk e sheh? - shkrofëtiti Rexhepi.

Ai kishte ngritur pjatën me peshk dhe ia kishte futur Lisenkos mu në hundë.

Ky e shtyu me përbuzje dhe pjata ra përdhe.

-Përjashta nga kampi socialist! - thirri që nga vendi i tij dikush nga hungarezët.

Sytë e tij qenë të vegjël e dukeshin si bizele.

-Përjashta! - u dëgjuan disa zëra të tjerë.

Pastaj nisën t'i binin me lugë pjatave. U duk sikur bashkë me ta do të bashkohej e gjithë mensa me të njëmijë studentët.

-Fricër! - iu përgjigjën zallamahisë së pjatave mjaft studentë të tjerë të huaj dhe drejt hungarezëve fluturuan lugë e pirunë.

Këta një çast u nemitën.

Njeriu me sytë si bizele futi qafën e tij nën shpatulla.

-Gjakftohtësi! - foli Janaqi.

Dikush nga shqiptarët kishte rrëmbyer një pjatë dhe që bërë gati tua vërviste mbi kokë sharësve.

Lisenkua përpiqej të tregojë i qetë.

-Këtë peshk të qelbur na e keni sjellë qëllimisht dhe me Keqdashje - shqiptoi fjalërendë Kastrioti - Keni bërë diferencim në ushqim. Ne do të protestojmë.

Koloneli u ngërdhesh.

-Keni thyer disiplinën dhe keni bërë provokacion kundër forcave të armatosura ushtarako-ajrore sovjetike - tha tërë pompë.

Ndihej i inkurajuar nga mbështetja e një pjese të sallës dhe tërheqja e atyre studentëve, të cilët pak çaste më parë kishin sulur lugë e pirunë kundër përkrahësve të tij.

-Xhunga! - bërtiti njëri nga kursantët shqiptarë të vitit të parë.

Lisenkua ktheu kokën me vrull andej, por ishte e kotë ta dallonte njeriun që kishte sharë rusisht.

Fytyra gjatoshë me hundën e madhe e me kurriz. u mbush me rrudha si të ishte mbushur me miza.

Ai kapi një nga pjatat e përmbysura dhe ja zgjati në fytyrë Kastriotit.

-Lexo këtu! - ulëriti.

Kastriot Leka e pa qetësisht në sy, por vështrimin nuk e hodhi aty ku tregonte koloneli me gishtin e tij të trashë e të mbushur me qime.

-Këtu ka tre shkronja që duan të thonë Vojenij Vozdushnij Sill dhe kjo pjatë përfaqëson dinjitetin e forcave ajrore sovjetike - hungëriti.

Gishti i tij i trashë dridhej mbi inicialet BBC.

Atje ku ishin kubanët u dëgjua një fishkëllimë.

Pastaj një zë: Jashtë Lisenkua!

Kastrioti njohu zërin e Kutinjos dhe pa andej ku duhej të ishte ai. Kubani i tundi dorën e mbledhur grusht. Në thilenë e kapotës kishte vënë një distinktiv të madh me portretin e Fidel Kastros.

-Kjo që thatë ju është një budallallëk - iu përgjigj Kastrioti -

- Kjo që bëtë është antisocialiste.

Lisenkua flaku pjatën mbi tavolinë.

-Ngrihuni kundër Bashkimit Sovjetik dhe do ta shihni! - shkrofëtimi.

-Ky është provokacion - u përgjigj sërish Kastrioti.

Kësaj radhe shtrëngonte dhëmbët. Tjetri e pa vëngër.

-Peshku i gjallë të bën mirë për sytë, apo jo?

Koloneli kishte parë nga kryekuzhinieri. Këtij i ngriu qafa si ta kish zënë përdheci.

Të bën mirë apo nuk të bën?

-Si urdhëron, shef! - shkundi fort kokën kryenjeriu i kuzhinës sikur të desh ta shkulte nga supet.

Koloneli hapi krahët: A s'ju thashë shoku përgjegjës i shqiptarëve?

-Mjaft me këtë komedi! - ia preu shkurt Kastriot Leka dhe i ktheu kurrizin - Dalim shokë!

Kursantët dolën në këmbë dhe brofën pas Kastriotit.

Rumuni Dimitriu po pastronte thonjtë me pirua dhe po ndiqte me vështrim të shtrembër largimin e shqiptarëve.

Ajri përjashta ishte tepër i ftohtë dhe dukej gjithçka kishte ngrirë në transparencën e tij.

Sytë e shumicës automatikisht mbetën pezull mbi statujën e një vajze të bukur që mblidhte lule e ishte vendosur kohët e fundit në shatërvanin para mensës.

Kastriotit i theri diçka në kraharor.

“Natasha”, thirri ai brenda vetes dhe zemra i brofi si të donte të dilte jashtë gjoksit.

-Shqiptarët të mblidhen në sallën numër trembëdhjetë – u dëgjua një zë gërvishtës nga altoparlanti.

Ata nisën të kërkonin sytë e njeri~tjetrit për të kuptuar ç’po ndodhte.

Ishte një dialog i heshtur dhe i rrufeshëm.

-Përsëri ndonjë provokacion - tha Kastrioti.

Ai tundi kokën vendosmërisht: Të shkojmë me hap dhe këngë rreshtore.

Kursantët sikur u gjallëruan pas atij hutimi të parë. Ata u vunë në rresht dhe pas pak çastesh buçiti kënga “Shqipja jonë mori malet”.

Mjaft studentë të huaj po i shihnin me kërshëri.

Rumuni Kosta i ndiqte me sy të trishtë.

Shqipja jonë mori malet,

Theu zinxhirët përsëri,

Fluturoi e s'do të ndalet

Gjersa të ketë liri...

Kënga nuk kishte mbaruar kur të gjithë altoparlantët nisën të transmetojnë këngën rreshtore sovjetike “Nasha pjehota, nasha rota”.

Volumi ishte ngritur në maksimum dhe nga vibracionet altoparlantët u dukën sikur do të binin.

Për një moment kënga ruse, e shpërfytyruar nga kuisja e super volumit, u duk sikur brenda saj të qenë futur një tufë qensh. '

Zampoliti Lisenko bën diversion

Më 20 shkurt mbaroi punimet kongresi i katërt i Partisë së Punës.

Me këtë rast studentët shqiptarë u gatitën të bënë një mbrëmje vallëzimi. Ata përgatitën ftesat dhe fjalën e rastit si zakonisht e mori përsipër sekretari i partisë.

Veprimtaria u la për një ditë më pas, më njëzetë e një.

Por pikërisht në paraditen e kësaj date Lisenkua thirri sekretarin e partisë në zyrën e tij. Në auditor ai kishte dërguar një major shtatlartë, oficer i batalionit sovjetik të rojës së shkollës.

Sekretari u ngrit e doli pa fjalë, midis heshtjes së ngrirë të auditorit.

Kishte qenë orë mësimi me Bremenin dhe ky e shoqëroi daljen e oficerit shqiptar me një vështrim djallëzor.

Majori që shkelte rëndë dhe me hap gjëmimtar, e çoi deri tek dera e zampolitit (komisarit politik), por vetë nuk hyri. Sekretari trokiti fort dhe prapa derës u dëgjua “hyr”.

Lisenkua u ngrit menjëherë në këmbë sa pa oficerin shqiptar.

Dukej i befasuar.

Pastaj u vetëpërmbyt nga sugjestionimi i pamjes së papritur që i bëri ardhja kryelartë e tjetrit dhe u lëshua sërish mbi kolltukun e tij të zi.

-A e dini përse ju kam thirrur? - pyeti pa ja hedhur sytë më.

Vështrimi i tij vërtitej si i kapur në kurth nëpër letrat që kishte mbi tavolinë. Nga dritarja e madhe dhe e mbuluar

me një perde të re të hollë binte një dritë e zbërdhulët e që ja errësonte më tepër fytyrën me preka.

-S'kam si ta di - u përgjigj sekretari.

Zampoliti në fillim u përtyp dhe pastaj pastroi fytin.

Donte të tregohej i qetë.

-Ju doni të bëni një mbrëmje për kongresin e partisë suaj?

-Po.

—Shumë mirë.

Lisenkua u çua në këmbë. Sytë i mbajti vetëm për një moment shumë të shkurtër mbi fytyrën e sekretarit të partisë. Pastaj i hoqi menjëherë që andej sikur ta kishte kapur nga ai kontakt një rrymë e fuqishme elektrike.

Sytë e oficerit shqiptar kishin një kaltërim të përndezur.

-Kam një propozim dhe jam i sigurt se do ta vlerësoni. Bëni një mbrëmje të përbashkët me ne sovjetikët. Ju keni gëzimin e kongresit tuaj, ne të përvjetorit të ushtrisë sonë. Dakord?

Koloneli kishte vënë buzën në gaz dhe në atë humor bëri disa hapa drejt sekretarit. Me një shpejtësi të rrufeshme i hodhi dorën mbi sup dhe i rrahu shpatullat.

Buzagazi i qe shndërruar në një lojë ngërdheshjesh.

-Dakord je patjetër - e hovi zërin me një gëzim artificial zampoliti i shkollës ndërkombëtare të aviacionit.

-Jo.

Lisenkos i rrëshqiti dora nga supi i shqiptarit.

Qe një rrëzim i saj.

-U mendove mirë?

-Shumë mirë.

-Kujtova se do të kuptoheshim, sido që e dija që me shqiptarët askush nuk merret dot vesh.

Toni i Lisenkos ishte i hidhur.

Ai tashmë i kishte kthyer shpinën përgjysmë sekretarit të partisë.

-Më paskeni thirrur në zyrën tuaj për të më kërcënuar dhe për të fyer dinjitetin e popullit tim.

Zampoliti u kthye vrulltas.

Fytyra i ishte shtrembëruar dhe zbardhur.

-Unë kam mbaruar punë me ju. Dilni!

Oficeri shqiptar nuk lëvizi. Kish kafshuar buzët dhe i pati bërë gjak.

-Kongresi i Partisë së Punës së Shqipërisë nuk është festë e një ushtrie - replikoi sërish - Ju në qoftë se dëshironi mund të bëni së bashku festën e partisë suaj me të ushtrisë dhe të gruas.

-Përrjashta!

-Natyrisht që do të largohem. Edhe unë kam mbaruar punë me ju.

Lisenkos iu drodhën buzët dhe dora i bëri një gjest për të rrëmbyer ndonjë send nga tavolina e tij e punës.

Oficeri shqiptar e pa skërmitës atë dorë dhe kaltërimi i syve të tij u bë ndjellakeqe.

Dora e zampolitit u tërhoq si në ngërç.

Shqiptari i ktheu shpinën dhe doli.

Pa hyrë në auditor iu shfaq përpara Zaharovi dhe i tha se nuk do ta lejonte atë mbrëmje vallëzimi në qoftë se nuk i jepnin atij të gjitha ftesat e përgatitura që t'i ndante vetë, si edhe donte të lexonte njëherë që më parë fjalën e përshëndetjes.

-As njërën dhe as tjetrën - iu përgjigj.

Shumëfishohen rojet

Kur studentët dolën nga mensa vunë re se të gjitha rojet e shkollës ishin dyfishuar. Kurse tek porta e hekurt u katërfishuan.

Zaharovi nuk u lejoi sallën e madhe të aktiviteteve dhe shqiptarët vendosën të bëjnë mbrëmjen në “dhomën e Leninit”, në konviktin e tyre.

Aty nuk kishte fuqi komandanti i zëmëruar sovjetik.

Përvjetori i Ushtrisë së Kuqe

Ishte më 23 shkurt.

Ai u festua me pompë të madhe. Pasdite u rreshtua e gjithë shkolla dhe gjatë fjalimit të tij, midis të tjerash, Smirnovi tha “Forcat e Armatosura të Bashkimit Sovjetik janë forca zhdukëse”.

Pas ceremonisë u dha një film për armën bërthamore sovjetike.

Shqiptarët nuk vajtën.

Të rregullt në rreshtim për shfaqjen ata dhanë justifikimin ‘Filmat janë punë qejfi’.

“Mos më shaj Enver Hoxhën!”

Pak ditë para fillimit të punimeve të kongresit të katërt të PPSH, nga ambasada kishin ardhur broshurat mbi gjyqin e Teme Sejkos.

Shumica ishin shqip, por midis tyre kishte edhe në gjuhën ruse.

Këto qenë vendosur në “dhomën e Leninit”, por pak çaste para nisjes së mbrëmjes erdhi një oficer sovjetik me dy ushtarë të armatosur dhe i hoqi.

Rexhepi, i cili ishte gjendur ato momente aty, këmbënguli që ata të mos i merrnin me vete, sepse nuk do t'i hapnin më aty.

Tre sovjetikët ikën, por Rexhep Mema kaq donte. I hapi përsëri, madje bashkë me broshurat e fjalimeve të Hrushovit.

Por tre të armatosurit erdhën pas një ore dhe oficeri i flaku përdhe shumë i inatosur.

“Pse i hiqni?” kish kundërshtuar kësaj radhe studenti shqiptar.

Qe përkulur dhe i kishte mbledhur: “Kjo është një dhomë partie dhe çdo material i partive motra këtu është vendosur dhe do vendoset. Ja, shiheni këtë!

Dhe ai pati ngritur para duarve një revistë polake, e cila kishte ditë që rrinte aty.

“Kjo revistë tregon se në Varshavë është hapur një klub nate, e megjithatë kjo rri këtu dhe ju nuk e flakni”.

Rexhep Mema ndërkohë kishte ngritur vështrimin deri tek portreti i Gomulkës, që rrinte mbi mur.

Ai lexoi me zë çfarë ish shkruar poshtë sekretarit të parë të Partisë së Bashkuar Punëtore Polake: “Guri themeltar i miqësisë sovjeto-polake është sigurimi i kufijve tanë perëndimorë”.

Pastaj kishte fryrë zërin dhe i pati thënë oficerit sovjetik “ja kush është miqësia e polakëve!”

“Gjyqi kundër admiralit tuaj është një gjyq politik dhe i bërë enkas për të sajuar një grup armiqësor sovjetik në Shqipëri”, foli qetë e ftohtë sovjetiku.

“Ju e morët më qafë gjeneralin tuaj të detit dhe e sakrifikuat për karrigen e Enver Hoxhës”, vazhdoi.

“Këto broshura përmbajnë gënjeshtër dhe nuk është në dinjitetin tuaj t’i përhapni si materiale të vyera”.

“Kështu flet “Zëri i Amerikës”, shkumëzoi Rexhepi.

“Flet zëri im”, u përgjigj vendosmërisht tjetri.

“Flet “Radio-Moska”, ulëriti shqiptari.

“Flas vetëm unë” përsëriti sovjetiku.

Me gjithë tonin e acaruar të bisedës ai kishte vështrim të butë.

“Mos më shaj Enver Hoxhën” - shqiptoi i çarmatosur prej atij vështrimi Rexhep Mema - “Mos ma shaj, as unë nuk ta shava Hrushovin. As Gomulkën nuk po ta shaj, as kampin socialist, miqësinë mes tyre, as partitë motra”.

“Jo, shok, ju morët më qafë një gjeneral të shquar. Jo, jo kështu”.

Në këtë kohë tek dera ishte futur Maria.

Ajo shtangu kur pa seç po ndodhte.

Oficeri sovjetik po ikte.

Fjalët e tij të fundit ishin: “Po i pashë përsëri këto broshura do t’i gris ose do t’i djeg”.

U largua me rrëmbim, duke kaluar para syve të shtangur të pastrueses.

Albina

Në prag të mbrëmjes e para vajzë që erdhi tek postbloku ishte ajo, të cilën Bujar Andoni e thirri Albina.

Kur e panë këtë të re, fytyra e të cilës ishte fare e panjohur për të gjithë, studentët shqiptarë u habitën.

Një pjesë e tyre kishin dalë me kohë jashtë dhe të tjerët prisnin pas xhamave të dyfishtë të dritareve.

Prisnin vajzat e tyre.

Qe Bujari ai që u drejtua tek e vetmuara. Disa tipare të saj ngjanin shumë me të Tamarës.

-Lëreni se ka ardhur për mbrëmjen tonë - u tha ai ushtarëve të katërfishuar dhe nervozë.

Këta e shtynë larg portës dhe ai sa nuk ra mbi borë.

“Albina!” klithi, duke u kapur fort pas hekurave.

Dy ushtarë sovjetikë kërcyen prej murit rrethues të shkollës dhe i dolën nga pas.

Ajo i pa vetëm kur e kapën prej krahësh dhe gati e tërhoqën shumë metra matanë portës.

Atje, e ngulur në mes të borës, me lot të ngrirë në sy dhe e mekur, vajza qëndroi me vështirësi tek Bujar Andoni.

Rreth këtij ndërkohë qenë mbledhur pothuaj të gjithë studentët shqiptarë.

Ai e kishte takuar Albinën në qytet fare rastësisht.

Ajo e kishte thirrur “o luftëtar” dhe Bujari pati ndjerë diçka jo të zakonshme.

Një sovjetike e thërriste shqip “luftëtar” dhe kjo i dukej fjala më e qëlluar.

Ai ndali hapat dhe priti ngarendjen e saj.

Kur rusja u afrua ai vuri re se ajo kishte një trup të imët e këmbët të shtrembra. Porse kokën të bukur, të vogël e të bukur.

Në një rast tjetër, megjithatë, ai nuk do t'ia kishte varur një vajze të tillë.

Sot po ndodhte ndryshe.

Ajo e kish kapur nga të dyja duart dhe i pati thënë se “nuk e di kush je dhe nga je, por di që je shqiptar”.

Bujari i befasuar kish dashur t'i thoshte se nga e dinte këtë gjë.

“E parandiej”, foli ajo, “e parandjeva sa të pashë”.

Vajza kishte hequr duart e saj nga pëllëmbët e tij të mëdha dhe ja pati vënë në sup: “Në librin e gjeografisë tonë në gjimnaz për Shqipërinë thuhet se nga ora 10 deri më 15 nuk del dot se ka shumë diell”.

Pastaj pati qeshur shpenguar: “por unë e di që libri i gjeografisë ja këput kot, sepse babai im ka qenë disa vjet në Shqipëri”.

Pas kësaj ai vendosi të shëtiste me të dhe kjo ndodhi për një orë.

Kaq do të mjaftonin për të kuptuar rusen dhe dashurinë e saj për shqiptarët.

1 ati kishte qenë në Shqipëri e pati shërbyer deri edhe në Vermosh.

Ishte kolonel.

Quhej Petrov.

Gjyshja qe komuniste e vitit 1917.

Petrovi kishte qenë shumë kohë atashe ushtarak në Shqipëri.

Në vitin 1957 e thirrën në Moskë dhe e emëruan në kufi me Turqinë. Një ditë në orar të punës u gjet i vdekur nga një plumb në qafë.

U konsiderua vetëvrasje dhe pas kësaj familja qe larguar vetë nga kryeqyteti rus.

Emrin Albina ia kish vënë i ati, sepse ajo kish lindur kur ai Ndodhej me shërbimin e parë në Shqipëri, katërmbëdhjetë vjet më parë.

Tani rusja e vogël rrinte e ngulur mbi dëborë dhe shihte dhembshurisht studentët shqiptarë.

Kjo po i vinte në siklet të gjithë.

-Jam komandanti i kompanisë së shqiptarëve që studiojnë këtu - u paraqit Rexhep Mema.

Po gënjente, por kjo gjë aq i bënte.

-Kërkoj që kjo vajzë dhe të tjerat, që do të vijnë, të lejohen të hyjnë për të marrë pjesë në mbrëmjen tonë me rastin e kongresit të katërt.

Oficeri i rojës e pa ftohtë.

-Kam urdhër të mos lejoj asnjë njeri.

Ndërsa shqiptonte këto fjalë fytyra po i turbullohej nga një mori ngjyrash që i vinin dhe i iknin.

-Prania e vajzave në aktivitetet kulturore është rregull në shkollën tonë, përse bëni dallim për ne?

-Thashë që kam urdhër.

-Urdhër të mos i lini, por edhe t'i godisni dhe t'i shtyni?!

Oficeri i rojës u kapërdi dhe u rrudh në fytyrë si të kishte një dhembje në gjoks.

-Për mua... - pëshpëriti tjetri me zë të ulët dhe të kuptimtë- Por do të vijë vetë Smirnovi. Zëre se ka ardhur tani.

Në këtë çast mbërriti para portës një "Moskviç", pastaj një "Zim" i zi.

Vajzat po vinin.

Prej njërës nga këto makina zbriti edhe Tamara. Ajo në çast e mori vesh se çfarë po ndodhte dhe bëri drejt portës së hekurt.

Dy ushtarë sovjetikë i brofën përpara.

-Stoj! (Ndal!).

Tamara u zbeh.

Pa nga ushtarët dhe megjithatë lëvizi para.

Ata i vunë automatikët në gjoks.

-Jam e ftuar - tha e tronditur moldaviana dhe nxori nga çanta e vogël ftesën që i kishin dhënë shqiptarët.

Por ushtarët hungërinë dhe e shtynë.

Tamara ngriti dorën dhe qëlloi fort me shuplakë njerin.

Tjetri ngriu.

Në këtë kohë uturiu “Zim”-i i Smirnovit.

Ai doli vrullshëm dhe qe i zbehtë në fytyrë.

Studentët shqiptarë, që i kishin hapur rrugë, tashmë patën krijuar një rreth që po mbyllej rreth tij.

-Mos i pengoni! - bërbëlit ai.

Fillim marsi

Hyrja e marsit ishte ndjerë me një ngritje të lehtë të temperaturës.

Thëllimi nuk qe më aq i egër dhe qielli i plumbtë i borës sikur po fironte pak e nga pak i tretur në thellësi të atmosferës.

Avionët Mig-21 kishin intensifikuar fluturimet dhe sërish kishte nisur programi stërvitor i fluturimeve me Mig-17.

Më tre mars kursantët shqiptarë festuan përvjetorin e armës së tyre të aviacionit dhe dëgjuan sekretarin e tyre të partisë, i cili ishte një pilot i vjetër, një nga ata që kishte fluturuar mbi Tiranë me avionët e parë me helikë.

Nëpër bisedar e studentëve shumëkombësh qe rindezur edhe kurioziteti për Aleksej Leonidoviçin.

Thuhej se ai më në fund kishte dalë nga spitali, pati mbaruar edhe një periudhë normale pushimi, por në shkollë nuk ishte parë më.

Disa thoshin se i ati i tij ja kishte arritur ta niste me punë në një ambasadë të huaj, të tjerë siguronin se biri i dy herë heroit ishte krejt i papunë dhe i pashpresë, dhënë pas alkoolit dhe femrave.

Një palë e tretë këmbëngulte se ishte rishtruar në spital i goditur përsëri me thikë.

Ditari i Nataljes

Natalja kishte mbetur me vështrimin e mbërthyer mbi fletën e bardhë të ditarit të saj.

Kishte menduar me kohë që të hidhte në të për çka i pati ndodhur pasditen e një marsit, por sa herë që ishte përpjekur ta shkruante, stilografi vetëm sa i kishte bërë një pikë të kaltër në fletën e boshatisur enkas për atë ditë.

Sot ishte tre mars, ditë e aviacionit shqiptar, dhe ajo do t'ia kushtonte Kastriotit.

Por pikërisht sa kish dashur të shkruante për këtë datë, i qe kujtuar ajo ditë dhe sërish pati shfletuar praptazi fletët e mbushura me shkrimin e saj të madh e të ngadaltë.

I ati atë një mars kishte ardhur nga puna i dehur si asnjëherë tjetër, ish ulur në tavolinë dhe pati kërkuar përsëri vodkë.

Natalja sapo ishte veshur për të shkuar në një mbrëmje në Institut dhe ai e kishte parë me një vështrim të përhumbur. Kish thirrur fort “dua vodkë”, sepse i qe dukur se Nina nuk e pati dëgjuar.

Dhe kish përplasur fort grushtin në tavolinë.

Nina i kishte sjellë me të shpejtë një gotë me vodkë, por ai sapo e kishte parë, pati ulëritur “një shishe!”

E shoqja kishte belbëzuar me vete jo pa inat, por nuk kish lëvizur nga vendi.

“Sillmë një shishe, dy, tre...sa të dua! - kish ulëritur Sergej dhe ja pati rrëmbyer gotën nga dora. Pastaj ja kish hedhur në fytyrë.

Nina ish bërë dyllë e verdhë dhe i kish thënë “turp të kesh!”

Ai pati kërcyer si ta kish pickuar gjarpri dhe e kish qëlluar më pëllëmbë.

Natalja kish klithur dhe pati hyrë në mes të tyre.

Në këtë çast Sergej e kishte qëlluar edhe atë.

Ajo pati nisur të qante me dënësë dhe kish mbështetur kokën në gjoksin e së ëmës.

Ai e kishte parë këtë skenë me sy të ngrirë dhe papritmas kish marrë pallton e dalë jashtë nëpër acar.

Pati ardhur vetëm pak çaste para mesnatës.

Nuk i kish thënë asnjë fjalë kurrkujt për një kohë të gjatë.

Vetëm në fund të asaj heshtjeje torturuese pati belbëzuar “më kanë përjashtuar nga partia”.

Natalja u drodh sërish tek përfytyroi atë natë.

Uli stilografin mbi fletën e bardhë dhe ai bëri përsëri një pikë të kaltër.

Afër mesnatës

Kastriot Leka gjithë mbrëmjen e vonë të 23 marsit e ndjente veten shumë të lodhur.

Tani ora e kishte kapërcyer njëmbëdhjetën dhe shokët patën rënë të flinin.

Bujar Andonin e kishte zënë gjumi dhe mbi fytyrën e tij të madhe kishte rënë si dritë hëne një buzëqeshje feminare.

Janaqi si zakonisht ishte shtrirë përmbys dhe po gërhiste lehtë.

Rexhep Mema ishte mbuluar kokë e këmbë dhe nën përgun e batanijeve nuk dallohej në merrte frymë apo jo.

Palush Bardhoshi rrinte shtrirë e i pa lëvizur dhe nuk e merrje vesh kurrë në e kish zënë gjumi apo jo.

Kastrioti pa instinktivisht fushën e orës, pak sa të ndriçuar nga fosfori.

Ajo iu duk si një botë e vogël që pulsonte e pulsonte në atë tik-takun e pandërprerë të jetës së saj.

Akrepat si krahë të diçkaje misterioze po i afroreshin dymbëdhjetës sikur të donin ta përqaфонin në ndarje të një dite që po ikte.

Mbas xhamave të veshur nga akulli fekste oborri i përgjumur dhe i heshtur i shkollës.

Herë pas here shkretinë e tij e prishte ndonjë kalimtar i rrallë, duke lënë pas gjurmët e tij në tragat e mëdha të krijuara nga shkelja e mijëra e mijëra këmbëve.

Bazamenti i një statuje aviatori rrinte vetmitar dhe ashtu siç qe, i ngjante më tepër një ish-statuje, ku silueta njerëzore mbi të ishte bërë e gjallë e kish vrapuar të ikte në arratisje nga kjo shurdhëri e kësaj mesnate të ftohtë.

Kastriot Lekës i shkoi vagëllimthi nëpër mend se pas disa ditësh kursi i tij kishte fluturim.

Gjatë gjithë javës avionët që prej Mig-15 e deri tek “Njëzetë e njëshi”, kishin fluturuar pa ndërprerje në aerodromin ushtarak dhe ai e dinte se në qytet flitej vazhdimisht për këto stërvitje intensive.

Në ato rrethina me kohë ishte prishur qetësia dhe qytetarët sovjetikë qenë mësuar me bisedat për aerodromin e madh ushtarak e pastaj me barsoletat që qarkullonin pambarimisht.

Poshtë në oborr u dëgjuan disa klithma.

Kastrioti u mundua të shquajë diçka në atë gjysmë terr, por në fillim nuk e pati të lehtë.

Klithmat fshin dëgjuar tek porta e hekurt.

Pas pak ai e pa të gjithë skenën që ndodhi.

Dy oficerë sovjetikë kishin vënë në mes gjeorgjianin Ekvtime të dehur dhe e godisnin me shkelma nëpër kërcinjte e këmbëve, gjersa mes klithmave të dhimbjes ai u shemb mbi akull.

Aty të dy oficerët iu sulën më të zemëruar dhe shkelmat nisën t’ia jepnin nëpër brinjë.

“Qen gjeorgjian!”, kuisnin ata dhe e qëllonin vazhdimisht.

Kastriotit iu errën sytë dhe pastaj në to erdhi një dritë e ylbhtë.

Ai ndjeu lot t’i njomnin sytë.

Poshtë të dy oficerët po e tërhiqnin zvarrë Ekvtime në drejt ndërtesës së vogël të burgut të shkollës

“Dua të ble...”

-Dua të ble edhe një biçikletë “Zis” - tha Palush Bardhoshi, duke rregulluar në dollap radion e re “Rekord” që kishte blerë atë ditë.

Ai e fshehu në fund të ca ndërresave të tij dhe pastaj e mbuloi me to.

-Fshihe mirë! - shpotiti Rexhep Mema.

-Nuk besoj të ma vjedhë njeri – u përgjigj tjetri.

Palushi tashmë kishte zbuluar se një cep i radios dukej dhe po i hidhte edhe një piring tjetër ndërresash ushtarake.

Pastaj nisi të murmuronte një melodi.

-“Berberi i Seviljes” është? - e pyeti Bujar Andoni.

-Është një opera tjetër - u përgjigj gjithë indiferencë Palush Bardhoshi.

Këtë gjë e kishte shprehur duke lëvizur dorën në mënyrë pozante.

Ndërkohë vazhdoi të murmurinte melodinë akoma të pakuptueshme.

-Çfarë do të blesh tjetër? - pyeti Rexhepi.

-Kam ca plane.

-Çfarë?

-Dua të ble edhe një çifte.

-Bli edhe ndonjë frigorifer!

Rexhep Mema kishte folur këtë herë, por në fytyrë e pati lënë të lexohej haptas talljen.

Ndërkohë Palushi i ktheu vetëm një vështrim të vrenjtur, fryu gushën dhe melodinë me zë e shndërroi në fishkëllimë..

Larisa me veturën “Zim”

Natalja sapo kishte hedhur këmbën në trotuar, kur një veturë “Zim” i rrëshqiti aq afër sa ajo u tremb.

-Shoqja Natalja! - thirri butë Larisa Medvjedovna, e cila kishte zgjatur kokën nga xhami i derës së parë të makinës. Vetura frenoi menjëherë dhe për disa çaste vazhdoi të lëkundej.

Natalja pa fytyrën e bukur të Larisë dhe iu kujtua menjëherë se e kishte parë mes studentëve të shkollës ndërkombëtare të aviacionit.

-Ju kujtohem?

-Po - vuri buzën në gaz Natalja.

Larisa hapi derën e veturës dhe u çua nga ndenjëset e buta.

-Më ra rruga këtej dhe ju pashë. Mund t'ju çoj gjer në shtëpi?

-Faleminderit!

Larisa buzëqeshi, por pas xhamave të syzeve sytë e saj të errët nuk morën dritë.

Ajo hapi me të shpejtë derën e prapme të “Zim”-it dhe e la Nataljen të hynte e para.

Shoferi ishte një njeri me shpatulla të mëdha, mjekër të gështenjtë e trup sportiv.

-Unë do të rri bashkë me Tashën – i tha Larisa këtij të fundit dhe u ul pranë Nataljes.

Derën e mbylli fort.

“Zim”-i uturiu lehtë dhe nisi të ecte nëpër asfaltin e pastruar nga bora. Natalja deshi të përshëndeste disa nga

shoqet e saj të Institutit, me të cilat sapo ishte rindarë, por ndërroi mëndje.

Se si iu duk.

-Si e keni nënën? Po babanë, mirë është?

Zëri i Larisës kësaj radhe u duk femënor.

Ajo kishte lëpirë lehtë edhe cepat e buzëve të lyera me të kuq.

-Faleminderit!

-Ajo që i ndodhi babait tuaj të dashur Sergej ishte një fatkeqësi - tha Larisa dhe u mundua ta shihte në sy bashkëbiseduesen - Kryesorja është ta mbani pranë e të mos dëshpërohet. Kishte nisur të pinte shumë e të thyente disiplinën në punë. Një komunist i tillë jo gjithnjë është shembull dhe detyrohesh të marrësh masa.

-Ju kuptoj.

-Fjalët se ai është përjashtuar si konservator dhe mbrojtës i të kaluarës së Stalinit, me sa kam pyetur, janë vetëm fjalë.

-Edhe këtë gjë ju a kuptoj.

Uturima e "Zim"-it tashmë vinte prej shumë së largu.

Natalja ndjeu se në tëmthat e saj enët e gjakut po pulsonin me një ritëm të nxituar dhe kjo po i shkaktonte një zhurmë lodhëse.

-Sergej doli nga partia, por atje mund të hyni ju.

-Unë?!

Larisa u tund. Sytë e errët iu kapsallitën pas xhamave të syzeve.

Ajo kishte mbështetur njëren pëllëmbë mbi duart e bashkuara të Nataljes.

-Ju, ju, Tasha. Që nesër mund të hyni. Ju ndihmoj unë. Dhe të jesh anëtare partie nuk është gjë e thjeshtë. Të hapen të gjitha rrugët. Të mbyllet dhimbja edhe për atë që i ndodhi baba Sergejit. Por edhe ai qetësohet, shpëton nga dëshpërimi dhe pesimizmi që e ka mbërthyer.

Natalja qe mpirë.

Kjo grua e kishte ftuar vetëm për ta shoqëruar gjer në shtëpi dhe që në minutën e parë i kishte propozuar një mendim të bluar me kohë në kokën e saj dhe kush e di ku tjetër.

Nga i dinte kjo kaq shumë hollësi për jetën e saj?

Për mirësi dhe edukatë nuk donte t'i thoshte një çast "jo".

-Unë Kastriotit nuk i kam dhënë mësim – vijoi Larisa - por ta dini që pedagogët e tjerë flasin shumë mirë për të. Keni fat, Tasha.

Natalja tha "faleminderit".

Vështrimi i saj rrëshqiti tek gjunjët e Larisës. Ato rrinin të shkujdesura.

Pauzën që bëri biseda, e mbushi uturima e makinës dhe ajo zhurmërimi në tëmthat e saj.

-Këtë verë do të martoheni?

-Po.

-Sa mirë!

Flisnin e që të dyja shihnin jashtë xhamave.

Turma njerëzore po rrëshqiste anash veturës së tyre.

-Atëherë, me sa duket, Kastrioti do të rrijë këtu patjetër.

Natalja e ktheu kokën vrulltas nga Larisa Mjedvjedovna.

Ajo iu duk e qetë.

-Jo, do të shkojmë bashkë në Shqipëri.

Larisa vuri buzën në gaz dhe sërish i vendosi dorën në prehër.

-Më ardhka keq.

Në sytë e kësaj të fundit pejsazhi përtej xhamave të "Zim"-it u err.

-E pse ju vjen keq?

-Unë e njoh mirë Shqipërinë - buzëqeshi Larisa dhe zëri i saj u spërdrodh për herë të parë - Sapo është kthyer që andej burri im. Ishte në bazën ushtarake të Vlorës. Më tregon tmerre.

Natalja u kthye me të gjithë fytyrën nga ajo.

Prej zemërimit të përmbajtur zorshëm ajo e kuptoi se nuk po i dallonte më objektet qartë.

Priti disa sekonda sa pamja përftoi pak kthjelltësi dhe gjëja e parë që pa ishin buzët e Larisë, të cilat u lëpinë ngadalë skajeve.

Ajo dukej sikur një zjarr i madh e digjte përbrenda dhe i shtonte etjen.

-Çfarë tmerresh?

-Burgje për kundërshtarët politikë, gulagë (kampe përqendrimi) si të Stalinit, sjellje e ashpër kundër imperializmit, gjendje e varfëruar ekonomike.

-?!

-Kanë filluar t'i shohin shtrembër edhe sovjetiket e martuara me shqiptarë e të vendosura atje.

-!?

-Do të ndahen përfundimisht nga kampi i madh socialist dhe do të mbeten në gojën e ujkut. Fillikat. Mund t'i mbysin me një bombë atomike.

Nataljes iu duk sikur zemra i ishte ndarë në qindra copë dhe ato, të shpërndara në të gjithë trupin, po pulsonin kudo.

Pamja e objekteve në fillim iu bë konkave, pastaj nisën vrapin e largimit duke u zvogëluar e zvogëluar pambarimisht.

-Kastrioti më thotë fjalë të tjera për Shqipërinë.

-Eh, Kastrioti!

Larisa kishte psherëtirë hovshëm. Dora e saj ende nuk ishte hequr nga prehri i Nataljes. Por tashmë, pasi kjo kishte larguar me kujdes duart, pëllëmba rrinte si e zënë ngushtë mbi gjurin e tjetrës.

-Kastriotit ashtu i takon të flasë, ndryshe si do të të marrë me vete.

Ajo heshti sa një e marrë fryme dhe sërish foli vrulltas.

-Habitem përse dashka edhe Kastrioti të kthehet në Shqipëri, kur shumë shokë të tij do të rrinë këtu.

Tani Natalja kishte shmangur edhe gjurin nga ngërthimi i pëllëmbës së Larisës.

-Kastrioti të do si i marrë dhe ti, po të duash, ja ndërron mendjen.

Natalja tashmë i priste më e qetë batutat ritmike dhe këmbëngulëse të Medvjedovnës.

Ajo zhurma brejtëse në tëmtha, e cila i prodhonte dhimbjen e kokës, po zvogëlohej e mpakej.

-Rrini të dy këtu, asgjë nuk humbisni, përveç se fitoni. Ti do të hysh në parti dhe pastaj të presin shumë shkallë për t'u ngjitur. Sepse je edhe vajzë e mençur.

Larisa heshti përsëri, kësaj radhe në pritje të përgjigjes.

Por ajo nuk erdhi.

-Ah, Shqipëria! Burri që u kthye para dy-tre javësh më thotë se atje ka papunësi të madhe, ka ekonomi të çoroditur, bujqësia prodhon vetëm ullinj dhe presh, kurse industri nuk kanë fare. Atje njerëzit vdesin për të ngrënë dhe lypin rrugëve.

Natalja kësaj radhe e ndjeu zemërimin të tillë që nuk mund ta përmbante më me etiketën e mirësjelljes.

-Shqipëria për mua është ndryshe- tha shkoqur, por fjalët iu drodhën si para një membrane.

-Ndryshe?! - u habit Larisa dhe hoqi syzet.

Vështrimin e kishte të shpërqendruar, me gjithë sytë e bukur të tretur në ngjyrën e blertë.

-Si ndryshe?

-Ndryshe. Domethënë ndryshe nga fjalët tuaja dhe njëlloj si ne.

Natalja qeshi.

Ishte sforcuar për të shfaqur atë moskokëçarje.

-Shqipëria vetëm me Bashkimin Sovjetik nuk mund të krahasohet. As nga trupi dhe as nga trutë. Më vjen keq

Natalja që rrezikon të shkosh në atë vend sakrifikimi. Unë të kuptoj, ti nuk e do Shqipërinë, ti do Kastriotin. Dhe meqë Kastrioti e do vendin e vet, atë e do edhe ti. Më vjen keq me të vërtetë.

Natalja për herë të para ishte bërë e vëmendshme për praninë e shoferit.

Në çastet e fundit të replikave të saj me Larisën kishte kuptuar se sytë e tij vëzhgonin nga pasqyra e brendshme.

Tepër vëmendshëm.

-Më vjen keq edhe për një fakt tjetër - vazhdoi Medvjedovna.

Ajo sapo kishte rivënë syzet dhe tiparet e fytyrës sikur i ngrinë.

-Ju duhet ta dini që Shqipëria është shitur tek Amerika.

-Ju lutem mbajeni makinën! - thirri Natalja dhe uli dorezën e derës - Shtëpinë e kam shumë afër.

-E marrtë djalli, e marrtë! - thirri me zë të panatyrshëm shoferi- As më thatë se ku duhet ta fus makinën që ta çonim shoqen Natalja deri tek porta e saj!

Larisa nuk ishte më lozonjarja e fillimit të bisedës. Toni i qe ashpëruar dhe zëri i dilte i grindosur.

-Sidoqoftë gjer në verë ka mjaft kohë për t'u menduar. Të presim Tasha!

Larisa nuk harroi të lëpijë skajet e buzëve.

-Unë kam vendosur - iu përgjigj Natalja - Unë do të shkoj pas Kastriotit dhe në ferr ta ketë ai shtëpinë.

Ajo shtyu derën për ta mbyllur sapo e pa veten se ishte e lirë nga gracka e asaj veture.

Në ast u kujtua se duhej ta mbyllte butë dhe se po ta përplaste do të bënte një gjest pa edukate.

Veç ishte vonë.

Zemërimi e kish pushtuar të tërën dhe dora nuk iu bind.

Dera u përplas me forcë gati mu në fytyrë të Larisa Medvjedovnës.

Në largim të shpejtë nga njëra-tjetra Natalja mendonte se çfarë donin të thoshin fjalët “shumë shokë të Kastriotit do të rrinë këtu”, kurse Larisa kafshonte lehtas buzët dhe shfrynte “Ajo është e çmendur pas një shqiptari”.

Dekoratë e refuzuar

Në këndin e lajmërimeve më të rëndësishme të shkollës ishte vendosur një shpallje, ku shkruhej se nën kujdesin e drejtë për drejtë të shtetit sovjetik qenë rehabilituar varrezat e carëve të Rosisë.

Të mirëmbajtura ato tashmë mund të prisnin vizita nga i gjithë Bashkimi Sovjetik.

Flitej se mjaft studentë të huaj kishin shprehur dëshirën par të shkuar gjer atje.

Shqiptarët patën heshtur, heshtje e cila u kuptua si refuzim.

Në njërin prej këtyre ditëve të përfolura me varrezat e meremetuara ta carëve, Kastriot Lekën e thirrën në komandë. Madje urgjentisht.

Ja përse tani ai po ecte, duke shkelur në mëdyshje atë borë të verbër dhe po përpiquej të arsyetonte se çfarë pritej t'i thoshin eprorët e lartë.

Ndërtesa e komandës ato ditë ishte lyer me bojë të kaltër e kjo atij i ra në sy menjëherë.

Mendoi vetëtimthi se edhe në shtëpinë e Nataljes qe folur që, me t'u ngrohur pak koha, edhe ata do ta lyenin shtëpinë.

Ndoshta këtë dëshirë të tyre e kishte shtyrë përkohshëm temperatura e lartë që i hipi papritmas Nataljes. Ajo u ngujua disa ditë në shtëpi dhe vetëm kur u bë më mirë, nisi të shkojë rregullisht në Institut.

Tani Kastrioti po kalonte para tabelës së emulacionit.

Aty duhej të ishte edhe fotografia e tij. Si student i dalluar.

Ishte shqiptari i parë i atij viti akademik që dilte në këtë kënd të elitës së shkollës.

Asnjëherë, tek kalonte aty, nuk i kishte mbajtur këmbët.

Kësaj radhe u kthye nga foto e tij.

Ajo ishte dritëzbehtë, bërë kur që në vitin e parë. E rëndomtë dhe e marrë nga dokumentet e tij personale.

Kastrioti e dinte se ajo fotografi ishte me kohë karemi me të cilin komanda donte ta kapte.

Kur mbërriti tek komanda, roja e lejoi menjëherë sa përmendi emrin e tij.

Kur hyri, Smirnovi e Lisenkua ishin që të dy në këmbë dhe dukej që e pritnin.

Buzëqeshën në të njëjtën kohë, sikur të ishin dy enë komunikuese.

Kastrioti i nderoi ushtarakisht dhe qëndroi para tyre si i ngrirë në “gatitu”.

-Shoku Kastriot, ju thirrëm që t'iu komunikojmë vendimin e komandës supreme se jeni dekoruar për shërbime të shquara ushtarake. Urime!

Kishte folur Lisenkua.

Në fytyrën e Smirnovit buzëqeshja rrinte si e qepur me korfillon. Cepat e buzëve i dridheshin lehtë nga sforcimi.

-Urime! - thirri me zë të lartë edhe Lisenkua, duke ecur me të shpejtë drejt tij.

I rrëmbeu dorën dhe ja shtrëngoi me të dyja pëllëmbët.

Këtë ceremoni e kreu edhe Smirnovi.

-Uluni, ju lutem! - tha pas pak Lisenkua.

Pauza ishte bërë e gjatë dhe atij i që dukur se ajo e kishte gëlltitur efektin më të madh të ceremonialit.

-S'ka gjë - u përgjigj Kastrioti.

Lisenkua rrudhi sytë për të mos lënë buzagazin t'i rrëzohej nga fytyra prej nervozizmit.

Smirnovi u bë flakë në të dy sytë.

-Si të dëshironi. Kursantët në zyrat tona kanë qenë gjithnjë të mirëpritur e të respektuar.

Komandanti i shkollës fjalët i kishte thënë pothuaj me cepin e buzës.

-Prej jush do të marrin shembull të gjithë. Si aviator dhe si njeri. Edhe si shqiptar.

-Kjo dekoratë është edhe një gjest simbolik miqësie me popullin shqiptar - ndërhyri zampoliti.

Heshtja u ngjit si zamkë dhe bllokoi për një kohë të gjatë vazhdimin e bisedës.

Dy eprorët pritnin që studenti shqiptar të shqiptonte ndonjë “faleminderit” ose ndonjë formulë tjetër të përshtatshme për kësi rastesh, por Kastriot Leka kishte ngrirë në “gatitu”, me sa duket edhe fjalët.

-Ne dekoratën mund tua dorëzojmë që tani – e prishi heshtjen Smirnovi - por mendojmë se ajo do ta kishte efektin e saj po ta merrnit para gjithë shkollës.

-E vlen një ceremoni - shtoi Lisenkua - Shembullin tuaj duhet ta mësojnë e ta ndjekin të gjithë. Dekorata e thekson posaçërisht se jeni njeri shumë i ditur, ushtarak tepër i disiplinuar, pilot mjaft i përgatitur, mik i madh i popullit tonë, tamam një njeri i ri sovjetik.

Kastriot Leka lëshoi fjalët e para prej shtatores së tij të ngujuar në drejtpëndrim: Unë jam shqiptar, jam mik i popullit sovjetik, por një shqiptar.

-Sigurisht, sigurisht - kapi Lisenkua nëpër ajër replikën e Kastriotit - Një shqiptar i vërtetë. Formulimi “njeri sovjetik” në vlerësimin e kësaj dekoratë është bërë në kuptimin e njeriut socialist. Bashkimi Sovjetik është një shtet i madh, ku mbështetet i gjithë revolucioni botëror.

-Në rast se nuk thuhet që unë jam një shqiptar e jo “një njeri i ri sovjetik”, më lejoni t’ju them se e refuzoj.

Lisenkua dhe Smirnovi morën frymë thellë, si për të përmbajtur fjalët inatçore që u erdhën njëherësh në majë të gjuhës.

Intriga me avionin stërvitor Mig-17

Kastrioti eci me hap të ngadaltë drejt avionit Mig-17 që rrëzëllente akoma nën diellin e dobët të asaj dite marsi.

Ishte një shkëlqim disi i vrerët dhe ai puliti sytë.

Tekniku Mamai e përshëndeti duke tundur dorën.

Kastrioti i shkoi pranë dhe e pa me kujdes.

Ai kishte dy rrathë të mëdhenj nën sy, por veprimet i kish të ekuilibruara.

As erë vodkë nuk binte.

Tregohej i qetë dhe në pak fjalë i raportoi për gjendjen e avionit.

Kastrioti goditi lehtë rezervuarët dhe ata kthyen tingullin karakteristik të shurdhët. Qenë të mbushur.

Pastaj i hodhi një sy motorit dhe u ngjit nëpër shkallë.

Hapi fanarin dhe hodhi vështrimin andej nga ishin shokët e tij.

Ata çuan duart lart.

Prej largësisë pamja u duk pa zë.

Mamai thirri me zë të lartë. Ndoshta i thoshte të hynte në kabinë, mbase edhe ndonjë gjë tjetër, por ai nuk e dëgjoi.

Kush e di përse nisën t'i gumëzhinin veshët.

Kastriot Leka bëri një përpjekje për të larguar atë zhaurimë dhe në çast ja doli.

Kjo ishte edhe përpjekja e tij për të ardhur në vete e për të mposhtur një ndjenjë malli që i mbiu krejt papritmas në gjoks.

Po i dukej sikur, duke ikur nga toka, në të vërtetë po largohej nga jeta.

Futjen në kabinë e bëri me një kërcim të shpejtë.

Dikush i hoqi me të shpejtë shkallët dhe për një moment vështrimi i Mamait iu duk i vëngërt.

Kastrioti mbylli fanarin, u mbështet mirë në shpinoren e ndenjës dhe u lidh me rripat e sigurimit.

Megjithëse rutinë këto veprime nuk zbuajn dot një imazh njeriu, i cili gati i zbriti gjer në kabinë.

Fytyra u fanit me shkëlqimin e zbehtë të dritës që hynte nga xhami i fanarit.

Ai po i buzëqeshte.

"Fjodori" i thirri atij që poshtë brinjëve dhe iu duk sikur ai emër jehoi mes humbellës së kraharorit.

Tani trupi i Fjodorit rrinte nën cipën e ngrirë të tokës së pamasë ruse.

Mamai po tundte dorën e ngritur lart. Shuplaka e tij e hapur Kastriotit iu duk e përgjakur.

Ai mbylli sytë dhe i shtrëngoi aq fort, sa kur i hapi, drita i erdhi mes një dallgimi të madh njollash të zeza.

Pastaj gjithçka iu kthjellua.

Mamai vazhdonte të tundte dorën për ta lejuar të ndizte motorin.

Dhe ai shkeli pedalin.

Reaktori gjëmoi.

Në atë pështjellim të madh të avujve të nxehtë të karburantit Kastrioti ndjeu zhurmën ritmike të motorit.

E dëgjoi për një kohë të gjatë dhe pastaj e nguli vështrimin tek Mamai.

Ky po i bënte shenjë që të nisej se gjithçka ishte në rregull.

I ngriti pak dorën për t'i dhënë të kuptonte se e kishte marrë vesh e do të nisej menjëherë.

Mamai u hoq mënjanë dhe i hapi rrugë.

-Të dal në brezin e ngritjes? - foli në mikrofon Kastrioti.

Në shlemafon dëgjoi një zhurmë të lehtë si gërvimë.

-Dil!

Zëri i Smirnovit iu duk i ngjirur, por megjithatë i butë dhe i vetë kontrolluar.

Ai ish përgjigjur menjëherë pas lejes së kërkuar prej Kastriotit, gjë që e bënte rrallë.

Ai e nisi avionin drejt brezit të ngritjes.

Përmes xhamit të fanarit u mundua të shohë atje ku ishin shokët e tij, por tashmë nuk i dalloj dot.

Pas pak çastesh brezi i ngritjes u shfaq para tij si një shirit i hirtë që tretej drejt qiellit.

-Kërkoj leje të ngrihem! - tha në mikrofon.

Përsëri në shlemafon zëri i Smirnovit i erdhi me atë gërvimën e parë.

-Ke leje.

Kastriot Leka shkeli pedalin dhe avioni uturiu shurdhët.

Pista e hirtë nisi të vrapojë anash gjithnjë e më me shpejtësi.

Trupi i Mig-ut kishte një dridhje të lehtë.

Po i afrohej me shpejtësi çastit të shkëputjes nga toka.

-Më i vëmendshëm! - u dëgjua Smirnovi në kufje.

Kastrioti nuk i dha përgjigje. Se si i tingëlloi ajo “ji i vëmendshëm”.

Ai ndjeu trupin e avionit që u shkëput nga toka.

Mig-u nuk u epua dhe as u duk më i lehtë se zakonisht.

Ishte e qartë që të tre rezervuarët qenë mbushur plot.

Poshtë tij toka e akulluar po largohej e mpakej gjithnjë e më tepër.

-58-62 në ngritje - raportoi.

Përgjigja e Smirnovit erdhi pas një heshtjeje të gjatë.

-Merr lartësinë pesëmijë dhe ec në intenerarin e caktuar!

Kastrioti pa aparatin e lartësisë. Ai tregonte ende kilometrin e parë të ngritjes.

E ngjiti avionin lart dhe dielli iu duk sikur u ul në majë të fanarit.

Nëpër të tre pikat e rrotullimit të marshrutit ai kaloi qetësisht.

Asnjë fjalë nuk i tha Smirnovi, veç një “bravo”.

Mbi çdo pikë rrotullimi ai i raportoi me gjakftohtësi dhe pati përshtypjen se komandanti i shkollës e ndiqte me vëmendje të pazakontë.

-Si është koha? - u dëgjua pas pak çastesh zëri si gërvimë i Smirnovit.

-Disi. Ka ca re.

-Janë larg?

-Shumë.

Kastriot Leka ktheu Mig-un drejt aerodromit.

Pikën e tretë të rrotullimit e kishte kapërcyer.

-Po kthehem në bazë.

-Ndiq kursin 280 gradë për kontroll meteorologjik!

Ai deshi t'i thoshte se kishte kaluar gjysma e orës dhe tani duhej të kthehej për në aerodrom.

-Ke karburant? - pyeti Smirnovi.

Kastrioti i hodhi një vështrim të shpejtë llambës që tregonte për fillimin e konsumit të treqind litrave të fundit.

Ajo ishte e pa ndezur.

-Kam - u përgjigj.

-Atëherë ndiq kursin që të thashë.

Kastrioti e ktheu avionin në kursin dyqind e tetëdhjetë gradë.

Fluturoi ashtu për disa minuta.

Në shlemafon kishte rënë heshtja.

Komandanti nuk po ndihej. Për një çast u dëgjua vetëm një si gërvimë.

-Jam 58-62. Më jepni detyrën!

Në shlemafon u bë zhurmë. Kësaj radhe zëri i Smirnovit erdhi i panatyrshëm dhe me një mekje nëpër të.

-E moore kursin e caktuar?

-E mora.

-Mirë.

Qe një mirë e pakuptimtë.

Me një shpejtësi vetëtimë Kastrioti e kuptoi se Smirnovi po përpiquej ta vononte.

E ktheu menjëherë avionin drejt kursit për në aerodromin ushtarak.

Dhe as do t'i kërkonte leje.

Ai pa menjëherë llambën sinjal të rezervës së fundit, por ajo vazhdonte të rrinte e shuar.

Një alarm e kapi në të gjithë trupin.

Ajo llambë mund të ishte e djegur apo e liruar dhe avioni i tij tani mund të ishte në djegien e litrave të fundit.

E ngriti Mig-un lart dhe pa treguesin e lartësisë.

Po arrinte gjashtë mijë metrat.

-58-62, ç'po bën? - pyeti Smirnovi me rrëmbim.

-Po kthehem për në aerodrom.

-Pseee?!

Kastriot Leka nuk i dha përgjigje. Motori vazhdonte të punonte qetësisht dhe ai i thirri fort vetes të ishte gjakftohtë.

Kishte edhe shumë minuta fluturim gjer në bazë.

Pikërisht atë çast ndjeu se motori u fik.

Ndjenja e alarmit ia mpiu për një çast të gjithë trupin.

"Gjakftohtësi" i thirri vetes dhe ndjeu një djersitje të ftohtë mbi ballë. Vetëm gjakftohtësia mund ta shpëtonte.

Si edhe kjo lartësi që kishte marrë.

Mund t'ia delte të ulej me motor të fikur.

Mblodhi forcat dhe pa qetësisht humbellën e madhe të rrafshinave që shtriheshin poshtë tij.

Aerodromi qe ende larg.

Kastrioti dalloi qytetin dhe zemra i brofi. Atje ishte Natalja e tij dhe ajo mbase po ndiqte krejt rastësisht fluturimin e pa zë të këtij avioni.

Por kjo nuk kish mundësi. Ai qe akoma larg nga qyteti dhe në ato dhjetëra fluturime që ishin bërë sot, Natalja nuk mund ta gjente dot avionin me të cilin do të fluturonte ai.

Kastrioti kaloi brinjas qytetit dhe ia nguli sytë pistës së hirtë.

Asnjë fjalë deri tani nuk i kishte thënë Smirnovi.

Asnjë nuk i kishte thënë edhe ai.

Tani për tani i duhej të zbriste me doemos dhe fjalët t'i linin për në tokë.

Ai provoi të hapte rrotat avari, por asnjëra prej tyre nuk funksionoi.

-Të poshtër! - thirri fort me një zemërim të papërmbajtur.

Në shlemafon zhurma erdhi e mbytur.

Një si hungërimë.

Anës pistës po vraponin një grumbull njerëzish. Duhej të ishin shokët e tij.

Kastriot Lekës iu lagën sytë dhe provoi edhe njëherë të hapte rrotat.

Qe e kotë.

E ktheu menjëherë avionin e heshtur e që fishkëllente hidhët, drejt gruntit.

Do të ulej pa rrota në brezin e rezervës, atje ku nuk kishte asfalt, por një brez të ngjeshur dheu.

Kur avioni preku tokën ai ndjeu një tronditje të madhe dhe koka iu përplas në një vend të fortë. Iu errësua gjithçka, por në ato çaste që humbte ndërgjegjen, u mundua të ruante drejtpeshimin e avionit.

Pastaj nuk ndjeu asgjë.

Dielli i largët

Dhe akoma i ftohtë po rrëzohej në perëndim të rrafshulëtës së pamat e që ende dergjej nën dëborë. Mbi aerodromin ushtarak po vërtitej një helikopter, i cili dukej si një shpend i egër që hetonte vendin ku do të ulej. U dëgjua edhe uturima e shurdhët e një reaktivi, diçka e ngjashme më tepër me një përçartje. Po binte ngadalë mbrëmja dhe bashkë me të edhe një heshtje e thellë.

Dy buzë të nxehta

Kastrioti sapo kish dalë nga kabina telefonike e parë që kish ndeshur pas daljes nga shkolla. E kishte lajmëruar Nataljen se po vinte.

Kishin dy javë pa u takuar.

Gjashtë ditë në spitalin ushtarak të uçelishes, ditët e tjera një pushim i detyruar në dhomë.

Bisedat telefonike me jashtë territorin e shkollës ishin ndërprerë për të gjithë.

U fol se po bëheshin riparime të plota të linjave.

Për shqiptarët qenë ishin kufizuar edhe liridaljet.

Mbas ngjarjes që i kishte ndodhur, komanda iu zotua t'i jepte një pushim të shkurtër vetëm pas një kurimi të dobishëm.

Aksidenti me avionin kishte shkaktuar pështjellim vetëm atë ditë, kurse më pas gjithçka kishte marrë një rrjedhë të çuditshme.

Tekniku Mamai ishte zhveshur dhe nxjerrë në lirim.

Komanda krijoi kushtet dukshëm shumë të mira për shërimin e shpejtë të aviatorit shqiptar. Një grup hetimi ushtarak mbërriti menjëherë nga shtabi i ushtrisë dhe u formulua një deklaratë përshëndetje për trimërinë dhe kurajën e Kastriot Lekës.

Këto veprime u kryen me një shpejtësi marramendëse dhe ai u gjend i çarmatosur për të lëshuar politikisht akuzën e tij se kishin dashur ta vrisnin.

Aksidenti pati lënë një shije të hidhur tek të gjithë studentët e huaj, madje edhe hungarezët ndiheshin më të afruar me shqiptarët.

Tani, pas dy javësh, ëndrra e keqe e atij fluturimi i qe tretur nga malli për Nataljen. Smirnovi ja dha lejen vetë, ç'ka ishte shumë sugjestionuese.

Edhe kur e thirri për t'i manifestuar këtë gjest, ndihej i përzemërt, i hutuar.

Kastriot Leka kuptoi se nuk e urrente më.

E parandiente se në incident, në ishte përzierë, më pas duhej të qe penduar.

Megjithatë ai kishte marrë një leje gjashtëmbëdhjetë orëshe. Nga pasditja e së shtunës gjer të dielën në mëngjes. Do të dashuronte pak më tepër se një gjysmë dite ose të paktën do ta harronte për pak kohë atmosferën e rëndë të shkollës.

Ai tashmë vraponte drejt shtëpisë së Nataljes.

Një trolejbus i rrëshqiti pranë e pak metra më tutje qëndroi, por Kastrioti nuk donte të hipte. Për të dashurën e tij ai kishte kaq shumë mall sa nuk arrinte të besonte se trolejbusi do t'i shkurtonte kohën për të vajtur gjer tek ajo.

Kur autobusi elektrik kishte gërvishtur sërish shinat e humbur pas një kthese, atij i doli përpara imazhi i Nataljes, lu duk se ishte në një ëndërr.

-Kastriot!

Ai u rrëqeth deri në fund të këmbëve.

Mornicat nuk i kishte ndjerë kurrë në jetën e tij kaq të ëmbla dhe lumturi ndjellëse.

-Kastriot!

Ai bërbëlitë "Natalja" dhe puliti qepallat për të dëbuar atë imazh të pabesuar të saj që i lëkundej në sy.

"Natalja" thirri ai brenda vetes.

-Kastriot!

Zëri ishte fare pranë tij dhe thirri thekshëm.

Silueta e saj në sy i hapi krahët dhe Kastrioti ndjeu ta përqafojë.

Dy buzë të nxehta po e puthnin tek sytë dhe ai ndjeu aromën e trupit të Nataljes.

E thirri disa herë emrin e saj dhe e la veten nën përqaqim.

-Të kam kërkuar, të kam kërkuar - belbëzonte ajo dhe i kaloi dorën rreth belit. Kishte mbështetur kokën mbi supin e tij dhe pas një të qeshure të beftë nisi të qajë.

-Oh - rënkoi tjetri - Çfarë ke?

Ajo nisi ta përqafojë e ta puthë me më shumë zjarr.

-Kam parë një ëndërr të ligë, kam qarë gjithë këto ditë duke të pritur.

Gishtat e saj i ishin futur në qafë dhe dridheshin nën gjimnastjorkën e ngrohtë të tij.

-Sikur hiqe në një avion dhe pastaj, ah, pastaj...një zog i madh t'u sul e të rrëmbeu.

Kastrioti i kërkoi me buzë ballin.

-Po ja ku jam - i tha.

-Sa ëndërr e keqe! Llahtar!

-U beson ëndrrave?

-Ato dalin.

Ai e puthi sërish në ballë.

-Puthmë në buzë! – bërbëli Natalja.

Kastrioti qeshi shpenguar dhe ajo iu spërdrodh përsëri rreth trupit. Pastaj i hoqi kokoren dhe i përkëdheli flokët.

Ai e puthi nxehtë dhe ajo u tkurr e tëra. Iu ngjit përsëri në trup si atëherë në shtegun e malit me pistën për ski.

Atëherë ai i kishte folur për një shtëpi që ata do ta ngrinin afër qiellit.

-Dua një fëmijë! - belbëzoi ajo e skuqur flakë - Një fëmijë!

Natalja e puthte dhe ai nuk ia linte buzët të shkëputeshin për të thënë përgjigjen e pritur e vetëm me një rrokje.

-Më jep një fëmijë!

Kastrioti ishte si i dehur dhe ajo fjala “fëmijë” po e ngrinte peshë drejt qiellit.

Ajo fjalëz kishte ardhur si një engjëll me krahë.

-Një fëmijë, një fëmijë! - belbëzonte Natalja dhe e puthte e puthte.

Pak metra më tutje një plakë e shëndoshë kishte ndalur hapat dhe po i shihte me buzën në gaz.

-Ah, fëmijë të dashur! - foli ajo me një zë që atyre iu duk i njohur.

U hutuan për një çast dhe u ndanë nga njeri tjetri.

-Vini kokoren, mollodoj çjellovjek - tha babushka, tashmë duke nënqeshur me çapkëllëk.

Natalja bëri një “ah, ajo!” dhe i rregulloi me të shpejtë kokoren Kastriotit.

-Tamam ajo! - belbëzoi ky dhe ja dhanë gazit.

Provim në historinë e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik

Njoftimi kishte dalë në urdhrin e ditës.

Këtë provim të parashikuar në programin shkollor vetëm në fund të vitit mësimor, komanda e justifikonte si një zbatim të një urdhërese të veçantë të ardhur nga qendra.

Në të do të përfshiheshin të gjithë, rusë e të huaj.

Në urdhrin e ditës shpjegohej se kryerja para kohe e tij ishte shkaktuar nga ndryshimet që kishin ndodhur këto katër vite të hrushovizmit në tekstet e historisë, tashmë duke thënë të vërtetën.

Komanda shënonte se studentët e parë që do të kalonin në këtë provim do të qenë shqiptarët.

Kjo ishte edhe radha e alfabetit.

Në urdhër bëhej i njohur edhe komisioni: Smirnovi, Rikteri, Larisa dhe i deleguari nga aparati i Komitetit Qendror të Republikës.

Ky erdhi të nesërmen.

Ishte futur në një pallto të madhe me stof anglez, me ngjyrë të zezë.

Në vend të kokores mbante një borsalinë të leshtë, po kështu edhe ajo e zezë. I zi qe edhe kostumi.

Që në çastet e para studentët shqiptarë, të mbledhur para derës së sallës, ku do të ushtrohej provimi, thanë se i porsaardhuri i ngjante më shumë një prifti.

Por "prifti" u takua përzemërsisht me ata që ndeshi në korridor.

Prezantoi edhe emrin e tij. Tha se quhej Zheleznjak.

I shoqëruar nga Smirnovi dhe Rikteri, i deleguari i Moskës hyri në sallë.

Ajo që erdhi e fundit ishte Larisa Medvjedovna. Takat e saj trokitën me nervozizëm.

Studentët shqiptarë i hapën ngathët rrugën, por ajo që kaq e ngutshme sa anëtarja e komisionit kaloi si buzë një humnere.

Dera u hap vetëm pas një gjysmë ore pritjeje jo pa ankth.

Doli Rikteri dhe ai, në të njëjtën kohë, shkoi dorën nëpër flokët e tij kaçurrela dhe vuri buzën në gaz.

Pozoi lodhje.

-Katër të parët do të jenë...

Ai vuri dorën në njërin xhep të xhaketës, duke gërmuar dukshëm me gishta.

Pastaj filloi të kruajë në xhepin tjetër.

Pak më vonë iu sul sërish xhepit të mëparshëm dhe shumë shpejt edhe tjetrit.

Kjo ndodhi disa herë dhe lëvizja e gishtave mori një pamje epileptike.

E gjithë skena komike u mbyll me rënien e ballit me pëllëmbë.

U kthye përsëri në sallë dhe doli që andej me një fletë letre.

Tani rregulloi i qetë syzet dhe lexoi katër emrat. Ishin sekretari i partisë, Kastrioti, Palushi dhe Rexhepi.

Sakaq që të katër u gjendën para tavolinës së madhe, ku rrinte komisioni.

Fletët e bardha të tezave shtriheshin në një varg të gjatë e të mistershëm. Larisa Mjedvjedovna, si për të shtuar enigmën që rrinte pas tyre, kalonte me të shpejtë vështrimin në të gjithë radhën e gjatë të copë fletëve.

-Merrni nga një! Teza nuk ndërrohet - foli pa i parë në sy Rikteri.

I pari mori sekretari i partisë. Pastaj tre të tjerët.

-Paskam një pyetje për Stalinin - tha me zë të ulët sekretari.

-Për Stalinin e kam edhe unë - u përgjigj Kastrioti.

-Edhe mua... - belbëzoi Palushi.

-Të gjithëve na paska rënë pyetje për Stalinin - lëshoi zërin e gëzuar Rexhepi.

Në tavolinën e komisionit kërcitën karriget.

-Pushoni! - thirri Rikteri - Po folët më do tua quaj kopjim.

Ata të katërt kthyen kokat dhe panë qetësisht nga ai. Rikteri lëvizi duart në vend të fjalëve:

-Janë rregulla - mërmëriti.

Më në fund u ulën.

Sekretari i partisë lexoi edhe një herë tezën.

Të dyja pyetjet ishin formuluar në një mënyrë të tillë, që në njërin duhej patjetër të përmendje Hrushovin dhe në tjetrën Stalinin.

Por në asnjërën pyetje këta emra nuk qenë përmendur.

Pa nga komisioni.

Ata të katërt po bisedonin shpenguar.

Pa nga shokët.

Ata kishin ulur kokat mbi fletët e bardha dhe po shkruanin me nxit.

Kishin kaluar jo më tepër se dhjetë minuta, kur Rikteri tha se duhej t'i jepnin fund përgatitjes.

“Çohuni!” thirri Smirnovi si të komandonte.

-Po vij unë - tha sekretari.

-Hajde po nuk duam shumë llafe - foli zëvendës komandanti i shkollës.

Ai u çua ngadalë dhe u ul në tavolinën para komisionit. Ata të katër po e shihnin me kureshtje.

Zheleznjaku shuajti bishtin e cigares.

Atë çast shqiptari me funksionin politik të sekretarit pa se në xhaketën e tij të zezë rrinin stemat e dy akademive.

-Fol! - përtypi fjalën i deleguari.

Sekretari i partisë u përgjigj qetë. Ata e dëgjuan me vëmendje.

-Shumë mirë - tha Zheleznjaku.

-Ky është përgjegjësi i shqiptarëve-shqiptoi Smirnovi.

-Ashtu?! - bëri i deleguari dhe tundi kokën i menduar.

-Po s'u përgjigj mirë ky kush do të përgjigjet - foli Rikteri dhe u hodhi sytë pjerrtas disa fletëve të shkruara - Po do të të bëj një pyetje.

-Bëj! - kishte folur i ngrysur Smirnovi.

Kurse Zheleznjaku e pa me vëmendje Rikterin.

-Shoku shqiptar u përgjigj mirë, nuk kam asnjë kundërshtim. Por për t'i lidhur me kushtet konkrete unë kam dëshirë t'i bëj një pyetje. Ngadalë-ngadalë ai le të na përgjigjet. Shkruaje pyetjen!

-Po e dëgjoj një herë - u përgjigj sekretari.

-Shkruaje, shkruaje më mirë se... është më mirë!

Rikteri priti një çast të kotë që shqiptari të ulte kokën dhe stilon mbi fletë, pastaj nxitoi të vazhdonte: E kam fjalën këtu. Pikëpamjet politike të të dy palëve, tonat dhe të shqiptarëve, tashmë dihen, kështu që do t'i heqim dorashkat.

-Po hë! - shfryu Smirnovi.

-Si urdhëron, shoku komandant! Po pyetja është ca politike.

-Në orë të politikës jemi - buzëqeshi Zheleznjaku.

Ai kish një zë si të gërvishtur, por kjo gjë nuk ta vriste veshin.

Rikteri mori frymë thellë dhe u mundua t'i qëndronte vështrimin të sekretarit të partisë.

-Unë, më duket, kam mendimin se miqësinë midis popullit tonë dhe atij shqiptar e pengon një njeri në udhëheqjen e shqiptarëve. Vetëm një njeri.

Ai kishte ngritur njërin gisht të trashë të tij dhe po e spërdridhte në ajër.

-Nuk është Enver Hoxha, në asnjë mënyrë. Ai është i arsyeshëm, i logjikshëm.

Sekretari që zbehur pak dhe dukej sikur nuk po merrte frymë.

Anëbuzët ishin bërë të verdha, sytë si të ngrirë.

-Nuk e di në më kupton - bërbeliti Rikteri.

-Ju kuptoj shumë mirë.

-Atëherë na thuaj ca fjalë!

-Do t'i them disa, por ju sikur nuk keni mbaruar akoma.

Nuk keni përmendur atë njeriun.

Rikteri tashmë po zbehej dhe fytyra e shqiptarit po mbushej me rremba gjaku.

Mes tyre heshtja kërceu si panterë.

-Në të gjitha pikat e acarimit me shqiptarët - kapi fillin e fjalëve më në fund Rikteri - emri i tij del i pari. Pse bëni sikur nuk e dini që është Mehmet Shehu. Ai është njeriu i amerikanëve. Ai e nxiti konfliktin me ne për hir të kalimit të Shqipërisë me SHBA.

Katër palë sytë e komisionit tashmë ishin kapur si ganxha pas lëvizjes më të vogël që do të bënin tiparet e përgjegjësit politik të studentëve shqiptarë.

Por ky ishte bërë i ftohtë akull.

Zheleznjaku

Pas pesë minutash, ndërsa të gjithë studentët shqiptarë kishin përfunduar provimin, komisioni dha notat.

Të gjithë kishin marrë dysha, kurse Palush Bardhoshi kishte marrë njësh, nota më e mirë që jepej.

Më në fund edhe Zheleznjaku kishte veshur pallton e tij të zezë dhe në dalje të korridorit arriti sekretarin e partisë.

Mundi t'i thoshte vetëm pak fjalë: “Nuk duhet shumë shkollë për të përballuar drejtësinë. Ja, unë kam mbaruar dy akademi, por nuk po e zbuloj dot të vërtetën”.

Pastaj nxitoi e iku.

“I dyzetë e njëjti”

Kastriot Leka më në fund kishte në dorë formularët me të cilët do të parashtronte kërkesën e tij për të hyrë në radhët e Partisë së Punës.

Ishin disa fije letre, të cilat nuk i dukeshin të zakonshme. Sekretari i partisë ia dha me gjest ceremonialiteti të vërtetë dhe ai gjatë disa ditëve u duk sikur ishte ngarkuar me emocionin që iu shkaktua ato çaste.

Plotësimi i tyre i solli një ndjenjë gëzimi që ia bënte dorën të lehtë dhe e solli në humor.

Formulari i madh përmbante shumë pyetje për biografinë e tij dhe të familjes. Veçanërisht a ishte dënuar ndonjëherë, a kishte bërë pjesë i ati apo pjesëtarë të tjerë të familjes në formacionet e Ballit Kombëtar, Legalitetit apo patën bashkëpunuar me pushtuesit.

Dokumenti tjetër ishte kërkesë-biografi, në të cilën parashtronte hollësisht jetën e tij që nga lindja, shkollat e kryera, pjesëmarrjen në rininë komuniste, dekorata të ndryshme, edhe një herë imtësisht për prindërit, për të afërmit më kryesorë, vëllezërit apo motrat.

Më në fund do të formulonte arsyen përse dëshironte të hynte në Partinë e Punës.

Ai dhe rrethi i tij familjar kishin pasur një jetë të pastër. Gjyshi kishte qenë fanolist, më pas i dënuar në mungesë nga mbreti, pas çlirimit avokat deri sa kishte dalë në pension.

I ati ishte bashkuar që 15 vjeç me lëvizjen antifashiste, më 1943 kishte aderuar në grupet e rinisë komuniste dhe shumë shpejt edhe në parti.

Dalë në verë të këtij viti partizan, ai kishte shkuar gjer në tokat jashtë kufirit shtetëror për çlirimin e popullit shqiptar të Kosovës.

Viti pesëdhjetë e kishte gjetur në Tiranë në Ministrinë e Jashtme, prej ku nisi një kurs disamujor në Bashkimin Sovjetik dhe përfundoi diplomat në disa vende të Perëndimit.

E ëma ishte mësuese, bijë edhe ajo e një familjeje të lidhur me luftën kundër fashistëve italianë dhe gjermanë.

Para se të shkruante dhe frazën e fundit të kërkesës autobiografike Kastrioti rilexoi edhe një herë jetën e tij dhe të familjes së vet.

Ndihej si i dehur.

Një ndjenjë krenarie apo diçka më e afërt më superioritetin e një “race të pastër“ e bëri të hidhte edhe fjalët e fundit: “Për Partinë e Punës unë jam gati të jap edhe jetën”.

Ai nuk ia kishte dorëzuar ende sekretarit të partisë paketën me dokumente, kur në këndin e lajmërimeve të shkollës u vu shpallja “për filmin e ri sovjetik “I dyzetë e njëjti”.

Seancat e tij shfaqeshin paralelisht në qytetin civil dhe në atë ushtarak.

Në vojenij gorodok (qytetin ushtarak) ai qe caktuar në sallën e kulturës së shkollës së aviacionit. Studentët e shpjeguan këtë privilegj të tyre vetëm me qëllimet politike të udhëheqjes sovjetike për të përçuar idetë e kongresit të njëzetë dhe përgjithësisht të kursit të ri që po i jepte Nikita Hrushovi lëvizjes komuniste botërore.

Po atë ditë, kur nisi edhe seanca e parë e shfaqjes së filmit, një orë më përpara, në mënyrë shumë ceremoniale, u arrestua një ushtar sovjetik i batalionit të rojës, sepse kishte thënë “më mirë të na udhëheqë një kurvë gjeorgjiane se Hrushovi”.

Pasi e kishin marrë me vete të arrestuarin dhe studentët e rreshtuar enkas ishin shpërndarë, u mor vesh se dy instruktorë të rinj dhe dy pilotë të Mig-21 ishin përplasur me veturat e tyre, tek vinin nga qyteti ushtarak për të parë filmin në shkollë.

Ata kishin qenë që të katër të dehur dhe të dyja makinat ishin shndërruar në gërmadha.

Megjithatë asnjëri prej tyre nuk vdiq.

Veç kishin marrë plagë të rënda dhe i çuan me urgjencë në spital.

Pas këtyre ngjarjeve seanca e filmit “I dyzetë e njëjti” u ndoq me një interesim të përmbajtur dhe mes një zhurme

që dallohej herë pas here në sallën e madhe e të mbushur plot.

Si zakonisht kishin ardhur edhe Smirnovi me Lisenkon, por kësaj here ata kishin marrë me vete edhe gratë e tyre.

Mbyllja e filmit ishte duartrokitur nga disa pjesëmarrës dhe herë pas here nëpër grumbuj që linin sallën, përmendeshin fjalët "është një sukses i madh i kinematografisë sovjetike".

Studentët shqiptarë pas asaj seance, hëngrën darkë më shumë në heshtje dhe u ngjitën në dhomat e tyre. Të nesërmen një pjesë e pilotëve do të kishin fluturim, kurse teknikët dhe shturmanët gjithashtu praktikë në aerodromin ushtarak.

Kastrioti kishte qenë i tronditur nga filmi.

Në fillim kishte hyrë në sallë si për të qenë dëshmitar i një akti të thjeshtë propagande, por dalëngadalë e kishte dorëzuar të gjithë qenien e tij në mëshirë të ngjarjeve të ndodhura në ekran.

Gjer në mesnatë pati bërë mjaft përpjekje për t'i harruar skenat e atij filmi, por gjithnjë ndihej shumë i lodhur dhe i pafuqishëm për t'i larguar.

Ai ishull peshkatarësh, ku gardistja e kuqe dhe mjaft e bukur ishte ngarkuar me detyrë të ruante një oficer carist të kapur rob, iu bë si makth.

Filmi e kishte trazuar dhe turbulluar me idenë e tij.

Regjisori ishte kujdesur që edhe caristi të ishte një djalë për të cilin të lije kokën.

Një lëkurë e hollë dhe ca kaçurrela të bukura i vizatonin një portret shumë tërheqës.

Gardistja e kuqe këtë djalosh simpatik ishte ngarkuar ta ruante fillikat, pa njeri tjetër, në një ishull të vetmuar e të rrethuar nga uji.

Pikërisht edhe në një kasolle shumë të këndshme.

E gjithë kjo ishte e sajuar dhe pa një logjikë reale, por shikuesi dukej sikur e kapërdinte.

Aq më tepër që gardistes i kishin dhënë një pushkë me bajonetë të gjatë.

Kështu edhe kishin nisur flirtet me kundërshtarin politik, gardistin e bardhë.

Një ditë ajo kishte varur pushkën në gozhdë dhe që zhveshur lakuriq.

Para syve të oficerit rob.

Ky kishte bërë fytyrën mënjanë, por gardistja e kuqe i kish thënë “edhe Adami me Evën prej këtij mishi ishin”.

Kështu u bë flirti i parë, pastaj pasuan shëtitje e puthje të gjata nëpër ishull, me pushkën e varur e të harruar në gozhdën e kasolles.

Veç një ditë ëmbëlsinë e këtyre ditëve e prishën disa krisma armësh që binin përtej ujërave. Pas pak një barkë e mbushur plot me bjellogardistë nisi të lundrojë drejt ishullit.

Kërkonin të fshiheshin atje.

Oficeri i zënë rob i pa dhe vrapoi duke thirrur “Nashi, nashi!” (Tanët, tanët).

Ajo rrëmbeu pushkën e varur prej shumë kohësh në gozhdë dhe rendi pas tij.

I bërtiti “stoj” (qëndro).

Ky ndaloi pak, duket sikur reflekton një çast, por përsëri vrapon drejt barkës që po afrohej.

Gardistja e kuqe e dashuruar i thërriti sërish “stoj”, ai i ndali pak hapat, sepse dëgjoji në shpinë lëvizjen e shulit të pushkës.

Tash ai kishte hyrë në ujë dhe ecën e ecën.

Ajo e thërriti me dhimbje “stoj, stoj, stoj” dhe më në fund, krejt e pashpresë që ai do të ndalte apo kthehej, e qëlloi.

Ai ra mbi ujë.

Barka me bjellogardistët u kthye dhe iku.

Gardistja e kuqe me pikëllim në fytyrë rendi drejt të dashurit të saj që sapo e kishte vrarë me një plumb në mes

të shpatullës dhe e përqafoi për një kohë të gjatë me dënësë e duke thirrur “millij moj, millij moj” (i dashuri im, i dashuri im).

Akrepat e prej fosfori e kishin kapërcyer mesnatën dhe Kastriot Leka nuk po dilte dot nga makthi.

Herë e përmbyste zemërimi për sajesën artificiale të asaj ngjarjeje realisht të pamundshme, herë dhimbja që fatet e njerëzve kaq shpesh i prishte politika.

Nuk i largohej nga mendja skena, kur vajza bolshevike e nguli pushkën në rërë dhe vrapoi drejt të vrarit për ta puthur.

Ajo për hir të një kauze politike kishte vrarë dashurinë e saj.

Për kauzën e tij e kishte dhënë jetën edhe oficeri carist.

Edhe Kastrioti kishte shkruar në fund të një lutjeje të gjatë për hyrje në parti, se për të do të jepte edhe jetën.

Kokën e ndjeu sikur po i shkëputej nga trupi.

Statuja e Paqes dhe skulptori Cigarjev

Në mes të oborrit të shkollës ishte pastruar bora dhe një grup ushtarësh vietnamezë e sovjetikë po hapnin themelet e bazamentit për statujën e paqes, që do të ngrihej.

Afati nga komanda ishte shumë i shkurtër: tre ditë.

Aty rrotull, duke shkelur borën me nxitim e si i dalë mendsh, vërtitej skulptori Cigarjev.

Kokorja i rrinte e madhe dhe kjo ja tregonte edhe ca më thatime fytyrën.

Ai bënte me duar disa lëvizje të vrullshme e qartas të pa ekuilibruara. Disa herë u bërtiti dy ushtarëve.

Pranë kësaj pamjeje do të ndalnin këmbët mjaft studentë kureshtarë.

Më shumë aty ndenji Larisa.

U hapën fjalë se ajo kish pasur dëshirë për t'i ndenjtur si model, por Cigarjevi e pati refuzuar këtë gjë me shumë përbuzje. Larisa ishte fyer dhe një ditë e kishte pyetur enkas se cili ishte modeli.

Skulptori nuk i ishte përgjigjur për një kohë të gjatë dhe ajo ishte shndërruar gati në një bishë.

Cigarjevi që moskovit dhe me influencë në qarqet e larta të partisë komuniste sovjetike si dhe bënte pjesë në artistët që mbështetnin frymën e re të Hrushovit.

Më në fund një moment, kur edhe ai dukej i qetë, Larisa e kishte shkëputur sekretin: Model ishte një vajzë shumë e bukur nga qyteti aty pranë.

Skulptori kishte pulitur disa herë sytë dhe shtuar me gjysmë zëri: Megjithatë ajo akoma nuk ka ardhur në

studion time. Deri tani kam modeluar me hamendje. Ajo më duhet e shumta dy ditë ose të paktën dy pasdite. Cigarjevi fliste gati si përçart.

Dy ikje të dyshimta

Mungesën e Palush Bardhoshit dhe të Janaq Papës ata e vunë re në kohën që po hanin drekë. Veçanërisht Palushi liridaljet i shfrytëzonte vetëm pasdite dhe pothuaj nuk kishte ndodhur kurrë që ta linte pa ngrënë drekën.

Bile mund të vinte në shkollë që nga qyteti sa për të ngrënë dhe pastaj të shkonte prapë.

Kurse tani nuk ndodhej bashkë me Janaqin.

Kështu shqiptarët u gëlltitën pa qejf.

Pati që edhe e lanë gjellën. Për një kohë ata u munduan që të gjejnë shkaqet e dy ikjeve të papritura.

Dhe pas një çasti mbuluan me pyetje Rexhep Memën, sepse në mëngjes ai kishte shkëmbyer fjalë të rënda me Palushin.

-Nuk u zumë - u hodh ky me nxitim dhe mezi kapërdui një kafshatë bukë që kishte në gojë - Ne vetëm shkëmbyem fjalë. Ai më tha se ju të gjithë u treguat burracakë dhe u servilosët para komisionit të provimeve, duke iu përgjigjur si qengja pyetjeve, kurse në të vërtetë duheshin refuzuar me heshtje. Unë ia ktheva se ne bëmë shumë mirë që u përgjigjëm edhe pse ky provim dhe pyetjet i kishte provokuese. Palushi e ngriti zërin i pari dhe më bërtiti "Ju jeni servilë të Bashkimit Sovjetik dhe të Hrushovit. Më takonte edhe mua ta çoja zërin dhe iu përgjigja "Ti shiko më mirë veten tënde, pastaj ne të tjerët. Bardhoshi u nxi dhe ulëriti "pse, çfarë kam unë për të parë". "Atë e di ti" i postova reston. "Unë nuk e tradhtoj kurrë vendin tim" u jargavit. "Asnjëri nuk të akuzon për këtë gjë. Përse e shtije

ndër mend?” Pas kësaj ai nuk foli më ose, ç’është e drejta, më fliste me vështrime shumë të inatosura.

-Mos vajti më tepër?” - ndërhyri Kastrioti.

Ai kishte dalluar njëren kopsë të gjimnastjorkës së Rexhepit të këputur.

Ky e kishte kapur vështrimin e tij dhe pati vënë dorën menjëherë tek vendi ku ajo mungonte.

-Qëparë e pashë që më është këputur. Ju betohem që, me aq sa ju thashë, u mbyll biseda. Unë, meqë e donte një përgjigje, edhe në fund fare i thashë “kur flet ti, mua më vjen si të përzier. Vetëm kaq”.

Rexhep Mema kishte ulur vështrimin mbi pjatë dhe pas pak e la atë përgjysmë.

Të tjerët heshtnin të menduar.

Hungarezët tek tavolinat e tyre po qëllonin me toptha brumi buke njëri-tjetrin.

Nga mensa dolën grumbull.

Në oborrin para konvikteve u shkëmbyen me Ekvtimeënë. Ai i përshëndeti si i tronditur dhe i ndoqi me një vështrim të çuditshëm.

Bujar Andonit iu duk sikur ai diçka desh t’u thoshte, por pas një burgimi dhjetë ditor që i kish bërë komanda për arsye se ishte “dehur”, gjeorgjiani dukej më i rezervuar në shoqërinë me të.

Sapo ishin larguar nga njëri-tjetri, kur Bujari dëgjoji zërin e Ekvtimesë që e thirri në emër.

U kthye drejt tij dhe i zgjati dorën. Kish kohë pa e bërë këtë gjest.

Gjeorgjiani e kishte pëllëmbën të nxehtë dhe sytë e tij të lëvizshëm kësaj radhe u fiksuan butë në ato të mikut të vet.

-Po sikur t’ju thonë të rrini këtu?

Zëri i Ekvtimesë kishte pak ngashërim, ç’ka u duk veçanërisht në skajet e fjalisë që mezi shqiptoi.

Bujar Andoni e pa me ngulm dhe alarm.

-Kurrë!

Gjeorgjiani ja përkëdheli kurrizin e dorës, si të ishte në mundimin e gjetjes së fjalëve të tjera.

-Mollodjec, orlli (ju lumtë shqiponja) - tha dhe fytyra sikur iu mbush me dritë – Mirë u pafshim!

Po ikte me nxitim, rrëmujshtëm, disi i përkulur përpara dhe me duart që i kishte vënë në fytyrë. Diku u pengua.

Nëpër ajër kishte lënë ato tonet e mbytura të një ngashërimi gati në shpërthim.

Atë natë studentët shqiptarë pothuaj nuk fjetën fare.
As Palush Bardhoshi dhe as Janaq Papa nuk erdhën.
As telefonuan apo dërguan lajm se ku ndodheshin.
Në mëngjes herët nga një aparat telefonik i shkollës, ata kërkuan ambasadën e tyre.
Pritën dy orë që centrali tua plotësonte kërkesën, por kjo nuk ndodhi.
Shkolla ishte gdhirë e rrethuar me roje të dyfishta dhe të tjerë po vinin me këngë e hap rreshtor.
Askush nuk mund të dilte dot.
Rexhep Mema tha se po e survejonin në çdo hap.
Sa dilte nga konvikti një ushtar i shkurtër dhe i trashë sa një kërcu, i qepej nga pas tepër bujshëm.
Kur erdhi koha e ngrënies së mëngjesit ata lanë dezhur në telefon Bujar Andonin dhe hynë në mensë.
Kësaj radhe shumica e studentëve të huaj i ndoqën me sy gjersa u ulën nëpër tavolinat e tyre.
Kishin përpara nga një gotë çaj dhe nga një copë djathë që binte erë të rëndë.
Të gjithë i morën erë djathit dhe e lanë nëpër tryeza.
U dëgjuan disa të qeshura nëpër sallë. Më pas edhe disa fishkëllima.
Kur u duk se kjo zhurmë ra, një zë ulëriti “Përjashta nga kampi!”
Zërat u shumuan me shpejtësi: “Kush ndahet nga kampi kështu e pëson”, “Rebela!”
Pastaj rinisën fishkëllimat.
Dhe klithmat: "Dilni jashtë nga kampi! Jashtë nga mensa!"

Shqiptarët e kuptuan se tashmë ishin para një provokacioni të organizuar. Njerëzit që ulërinin, ishin vetëm disa dhe njiheshin si të përkëdhelur nga komanda.

Të tjerët rrinin të heshtur dhe i shihnin me keqardhje.

Në këtë çast nga tavolina e tij u shkëput Ferenc Fozha.

Ai po tundte në ajër një çokollatë të madhe të zhveshur dhe nisi ta përtypë, duke vënë në lëvizje me qejf nofullat.

-Gjakftohtësi! - thirri Kastriot Leka - Ju lutem, gjakftohtësi!

Fozha u kishte pozuar tashmë fare pranë, sa një kërcim.

Mensa e kishte mbajtur frymën pezull.

Nuk pipëtinte asgjë.

-Avash se do mbytesh! - shpotiti Rexhep Mema.

Ferenci fshiu me kurrizin e dorës buzët plot gjurmë të dukshme të çokollatës së tretur dhe zgjati në drejtim të shqiptarëve gishtin tregues.

-Ju, shqiptarët, dini të rroni edhe me rrënjë pemësh Bile ju edhe bar hani. Por ne jemi ushtri e rregullt. Edhe kur luftonim njëzetë vjet më parë, nuk hidheshim në sulm pa ngrënë çokollata. Ja, kështu!

Ferenc Fozha nguli dhëmbët tek çokollata që mbante në dorë dhe ja shkrepiti të qeshurit. Pastaj befas u skërmit dhe bërtiti: Dilni jashtë nga kampi socialist!

Hunda e tij si sqep u duk sikur kulloi.

Në këtë kohë një lugë, që nuk u mor vesh nga erdhi, e goditi mu në ballë.

Ai klithi dhe rrëzoi kokën gjer në bel.

Kur hoqi duart dhe stërmundimshëm drejtoi trupin, një xhungë e zezë po fryhej me shpejtësi mbi syrin e tij të djathtë.

-Ikim! - foli dikush nga studentët shqiptarë dhe në mënyrë automatike të gjithë u ngritën dhe filluan të largoheshin.

Ikja e tyre u ndoq në heshtje.

-Kush ndeshet me komunizmin kështu e pëson - thirri me zë të mekur dikush nga tavolinat e kursantëve sovjetikë. Pastaj ra sërish një heshtje e thellë.

Jashtë dielli u vrau sytë.

Ai rrinte mes një cope qielli të kaltër, ndërsa rreth e rrotull tisi i reve të shpupuritura spërdridhej ta mbulonte.

Bujar Andonin e gjetën gati përmbys mbi telefon.

Sytë i ishin bërë të kuq nga zemërimi.

-Tani sapo më thanë se linja me Moskën nuk punon.

Zëri i tij, i ndërprerë nga gulçet e frymëmarrjes, tashmë e tregonte më mirë dallgën e inatit.

Kastrioti u mendua një hop.

Më pas tha zyrtë se ambasadën e tyre duhej ta njoftonin me do kusht. Ikja e Palush Bardhoshit me Janaqin, djathi i prishur në mensë dhe Ferenc Fozha i përgatitur për provokacion, të gjitha brenda fare pak orësh, nuk të linin dyshim se po zbatohet një skenar.

Ekvtimeja kishte thënë me nënkuptim “po sikur t'ju thonë të rrini këtu” e kjo donte të thoshte se mbase po projektohet një tentativë për t'i detyruar të dilnin kundër vendit të tyre.

-Të provojmë të dalim nga kaldaja - tha Rexhepi me një zë, në fillim të të cilit kishte lodhje e dyshim, kurse në fund tingëlloi me një timbër gëzimi.

-Po si?!

-I japim një kapotë kaldajistit.

Në përfytyrimin e të gjithëve u shfaq me shpejtësi fytyra e ligur dhe me mjekër qimerrallë e kaldajistit Jegor.

-Ma lini mua këtë punë! - shtoi Rexhepi - Tani u ngroh koha dhe kapotat nuk duhen më.

Kastrioti pa vështrimin e zjarrtë të Rexhepit dhe e pushtoi dëshira t'i hidhej në qafë e ta përqafohte: Atëherë ti nëpër kaldajë, kurse ne do të shkojmë te Smirnovi dhe do të protestojmë për të gjitha.

Rexhep Mema uli strehën e kapelës dhe sakaq fluturoi nëpër korridor. Ata të gjithë zbritën me nxitim shkallët dhe ashtu grumbull u nisën për në godinën e komandës.

-Të vihemi në rresht! - propozoi Bujar Andoni - Sikur nuk vete kështu. Do ta quajnë demonstratë.

Kastrioti mbajti këmbët dhe pa nga shoku i tij. Bujari kishte thënë me zë të lartë atë që po mendonte ai në ato momente.

-Të rreshtohemi dhe t'ia marrim këngës! - tha.

-Këngën e brigadës së parë - foli një zë.

-Asaj t'ia marrim - thanë njëherësh disa kursantë.

Atëherë Kastriot Leka dha komandën dhe tre togat e shqiptarëve u tendosën në rresht.

-Me këngë e hap rreshtor para marrsh!

Rreshtat u epuan një çast nga krahu i djathtë dhe hapat kërcitën bashkë me këngën.

Në sulm, në sulm, brigadë e parë,

Përpara, shokë, me trimëri

Dhe liri në zjarr, në zjarr

Të gjithë bashkë me guxim!

Nga dritaret e godinës së administratës u hapën me krismë kanatat dhe disa koka njerëzish u varën jashtë tyre.

Sulmon armikun me tërbim

Dhe kurdoherë fiton...

-Bravo, bravo! - thirri një zë dhe duartrokiti.

Papritmas një turmë e madhe ushtarësh sovjetikë dolën nga fjetina e tyre.

Komandat me zë të alarmuar mbushën tejmbanë ajrin.

Disa dritare u mbyllën me tërsëllimë.

Pengesat kalon me guxim...

Vazhdonte kënga ndërsa kursantët ndjenin mornica nëpër trup.

Godina e komandës, e lyer me ngjyrën blu, iu duk si një shtëpi prej letre. Rreth saj tashmë ishte formuar një gardh me automatikë e uniforma.

Kastrioti dha komandën “ndal” dhe kënga kishte pushuar sakaq. Gjithkund kishte rënë heshtja.

Ai dhe Bujar Andoni kishin vazhduar mugën dhe hapat e tyre kërcitën me një tingull të veçantë në brezin e betontë të para godinës.

-Stojtje!

Zëri kishte qenë i ngjirur dhe ngjasoi me klithmë.

Dy oficerë sovjetikë hapën zinxhirin e ushtarëve dhe u dolën përpara, duke tundur me kërcënim duart.

-Duam të bisedojmë me komandantin - tha qetësisht Kastrioti.

-Largohuni sa më parë! Prapakthehu! - ulëriti njëri prej tyre.

-Duam të bisedojmë.

-Shporruni!

-Jemi ushtarakë të Traktatit të Varshavës - ngriti fort zërin Kastriot Leka dhe bëri një hap përpara.

Ata u hutuan për disa çaste.

-Na lini të kalojmë! - tha Bujari.

Trupi tij i madh u duk edhe më gjigand.

-Komandanti nuk është këtu - shqiptoi ultas njëri prej oficerëve.

-Takojmë zampolitin - ndërhyri Kastrioti.

-As ai nuk është.

-Shefin e shtabit.

-Prapakthehu! - thirri po ai oficer, i cili në fillim u kishte bërtitur “shporruni”.

Në këtë kohë u dëgjuan hapat e rënda të Smirnovit dhe të Lisenkos. Ata kishin dalë të dy nga zyrat dhe po qëndronin prapa murit të ushtarëve sovjetikë.

Zampoliti ishte më përpara dhe shtrëngonte nofullat dukshëm, kurse komandanti qëndronte pas tij, i heshtur.

Qe hera e parë që ata shihnin një rreshtim të tillë.

Me sa dukej partia e kishte marrë në dorën e saj situatën.

-Shoku komandant! - thirri Kastrioti dhe bëri të kalonte përmes dy oficerëve.

Lisenkua u ngërdhesh dhe vetëm zgjati dhe përdrodi buzët, por pa nxjerrë asnjë fjalë.

-Shoku komandanti - përsëriti Kastrioti në përpjekje për ta bërë Smirnovin të prishte heshtjen e tij të shumë kuptimtë.

-Kjo është demonstratë - fishkëlleu zampoliti.

—Duam të bisedojmë - thirri studenti shqiptar.

-Nuk pranojmë - rifishkëlleu Lisenkua.

-Shoku komandant! – grishi edhe një herë Kastriot Leka Smirnovin.

Ky u duk sikur doli nga heshtja dhe turfulloi nën të dridhura.

-Me ju nuk bisedojmë - tha.

Shqiptari ndjeu zemërimin t'i çohet si furtunë e ta godiste buçimshëm në gjoks.

Brinjët i sëmbuan.

-Na nxirrni djathë të prishur e thërrisni “nuk duam të bisedojmë”, bllokoni bisedat tona me ambasadën dhe klithni “nuk pranojmë të bisedojmë”. Le të mos bisedojmë. Në bisedat me ju ne kemi humbur çdo besim. Por do të pranoni sfidën me ne.

Smirnovi tundi faqet e tulta dhe fikthi i lëvizi disa herë për të kapërdirë pështymën.

-Do të bisedojmë shumë shpejt - përplasi fjalët Kastriot Leka.

-Do të bisedojmë. Do të ulemi të bisedojmë.

Lisenkua kishte shtrembëruar fytyrën për të vënë buzën në gaz.

Ardhja e mareshalit

Rexhep Mema ja kishte dalë të ikte nga rrethimi ushtarak i shkollës dhe të njoftonte ambasadën.

Ai kishte arritur edhe të takonte Tamarën e t'i linte porosi të lajmëronte të gjitha vajzat që kishin miqësi me studentët shqiptarë. Tamara kishte marrë vesh edhe për ikjen e Palush Bardhoshit e të Janaq Papës.

Kështu ndërsa Rexhepi natën vonë nëpërmjet kaldajës rihyri në shkollë, shumë nga vajzat ruse e kishin lënë që paradite të shkonin në aty për demonstrim.

Edhe nata e dytë kaloi shumë e shqetësuar nëpër dhomat e studentëve shqiptarë.

Të nesërmen në mëngjes ata në mensë gjetën përsëri gotën e çajit dhe djathin e prishur. Nuk i prekën me dorë.

Shkuan në klubin ushtarak, por ai qe mbyllur.

Në orën nëntë para portës së hekurt të postbllokut mbërritën vajzat e para dhe pas një momenti fare të shkurtër ato u bënë një turmë që thërriste.

Kësaj radhe ushtarët e batalionit të rojës i mbajtën tepër larg.

Në orën njëmbëdhjetë në shkollë hyri një “Zim” i zi e që shkëlqente nga rrezet e diellit. Në fund të tij rrinte i zhytur në ndenjësë një oficer me gradat e mareshalit.

Kur kaloi portën e hekurt ai çoi vetëm pak dorën tek streha për të përshëndetur njerëzit rrotull që ngrinë në gatitu.

Ky ishte ushtaraku më i lartë që kishte ardhur në këtë shkollë vitet e fundit.

Pasi përshëndeti rojet ai më nuk e ktheu kokën as majtas as djathtas.

Në orën njëmbëdhjetë e gjysmë kursantët shqiptarë u ngritën në këmbë, kur mareshali hyri në sallë i rrethuar me Smirnovin dhe Lisenkon të emocionuar si asnjëherë.

Tani dukej qartësisht shtatlartë dhe kur hoqi kapelën një tufë flokësh të thinjura i ranë mbi ballë.

U mundua të mos shihte asnjërin në sy.

Smirnovi u çua duke u përpjekur t'u buzëqeshë shqiptarëve.

Edhe vështrimi i tij shihte gjetkë, mbi kokat e njerëzve. Barku si thumb iu mbështet në tavolinë dhe atje u duk sikur iu fry edhe më shumë.

-Shoku Arhopov ka ardhur t'ju mbajë një temë për Luftën e madhe patriotike. Është nder për ne që do të dëgjojmë një mareshal të lavdishëm të ushtrisë sovjetike.

Mareshali nuk foli për një kohë të gjatë edhe pasi Smirnovi u ul e mori pozën e njeriut që kërkon të dëgjojë me shumë vëmendje.

Pastaj ai nisi të fliste ngadalë, por sërish pa vështruar askënd në sy.

Shumicën e kohës foli për të quajturat dhjetë goditjet staliniane, por emrin e Stalinit nuk e përmendi fare.

Vetëm kur mbaroi, e uli vështrimin deri në radhët e fundit të kursantëve.

-Ndoshta ka pyetje - foli zë ulët.

Lisenkua kërceu sikur ta kishte pickuar një grerëz: Nuk ka. Mareshali e kaloi vështrimin gjer tek duart e tij.

Ndenji kështu pa thënë asnjë fjalë.

-Kam unë - tha mes heshtjes Kastriot Leka.

Në rreshtat e shokëve të tij u ngrit një pëshpëritje e shurdhët.

Karrigia e Lisenkos kërciti me nervozizëm.

-Pyetni! - foli me zë të fortë mareshali.

Kastrioti i hodhi një vështrim rrufe trupit të majmur të Smirnovit, i cili edhe ai po përpëlitej.

-Shoku mareshal, a është komuniste t'u japësh të tjerëve bërçolla dhe çokollata dhe ne shqiptarëve vetëm një gotë çaj e djathë të keq?

Të gjithë muskujt në fytyrën e Arhopovit u tendosën dhe i dhanë asaj një pamje krejt tjetër.

-Jo - u përgjigj.

Sytë e tij me një të kaltër të butë feksën nga një dritë në bebëza.

-A është komuniste mos të lënë të takohesh me të njohurit?

-Jo.

-Po të të mbyllin mes mureve të shkollës e të të bllokojnë telefonin?

-Nuk është komuniste.

-Po të të zhduken papritur dy shokë dhe komanda të heshtë, a është komuniste? _

-Nuk është - thirri thekshëm mareshali.

Në sytë e tij kishte rënë një zjarr që uturinte flakë.

Kastrioti mori frymë thellë dhe ndjeu se dridhej i tëri.

-Shoku mareshal, ju keni qenë në betejën e Moskës dhe atje patjetër jeni takuar me Stalinin.

Gjoksi i Arhopovit u hodh sikur një grusht ta kishte goditur me forcë të llahtarshme që brenda brinjëve.

Ai lëshoi një klithmë të mbytur.

-Me emrin e Stalinit vdisnin miliona njerëz në botë – vazhdoi Kastriot Leka i ndezur prush në fytyrë - A ishit në eskortën e mareshalëve kur u thyen statujat e tij?

Arhopovi qe zbehur.

Të dyja duart para tij u mundua t'i shtrëngonte me njëra tjetrën, që të ndalte sa të mundte dridhjen e tyre.

-Ky është provokacion! Ky është antisovjetizëm! – klithi Lisenkua. Flegelat e hundës së tij sa nuk u shqyen nga gjithë ajo gulçimë fryme që i nxorën mushkëritë.

Por mareshali përplasi grushtin mbi tavolinë dhe u çua në këmbë.

-Ata kanë të drejtë.

Lisenkua u nguros dhe pastaj u mpak e u bë sa një grusht. Smirnovi u mek dhe duart e tij në fillim u tendosën drejt kokës dhe më pas ranë pa fuqi drejt barkut si thumb.

Arhopovi vuri kapelën në kokë dhe doli nga salla me rrëmbim e pa vështruar as nga kursantët dhe as nga drejtuesit e shkollës.

Pas pak "Zim"-i i tij uturiu para portës së hekurt dhe ndërsa mori bërrylin e rrugës, shkëlqeu nën diell me një dritë të mugët.

Kastrioti tashmë ishte ulur dhe nuk po kuptonte më as veten e tij.

Si ishte e mundur që i ishte ringjallur brenda vetes komunisti nostalgjik pas Stalinit.

Ai kishte menduar se me kohë e pati hequr qafe admirimin për shefin e tmerrshëm të bolshevizmit.

Kishte kujtuar se leximi i ngulmët i veprave filozofike të Marksit e kishte mbajtur larg nga figurat e ashpra të socializmit.

Mirëpo vetëm kishte kujtuar.

Stalini i vogël ende flinte mes pasioneve të tij dhe gjeti rastin dhe shpërtheu.

Ose ndoshta Marksit dhe Stalini, diku më pak a diku më shumë, ishin e njëjta gjë.

Ishte një prill

Re të davaritura vareshin nëpër qiell për të mbytur kaltërsinë.

E megjithatë gjithçka që të kujtonte dimrin, po zhdukej ngadalë e natyra po ndërronte pamje.

Dëbora po shkrinte me të shpejtë dhe ujërat e saj gurgullonin anë rrugëve.

Atë ditë fluturime pati shumë, sidomos me Mig-21 dhe me helikopterë.

Këta vërtiteshin mbi aeroportin ushtarak dhe herë pas here gumëzhinin gjer mbi shkollë. Kursantët shqiptarë i ndiqnin me sy.

Ata tashmë qenë përjashtuar nga fluturimet e kjo ndodhi që të nesërmen e ikjes së mareshalit.

Në ditën e tretë nuk u duk në shkollë as Palush Bardhoshi dhe as Janaq Papa.

Të nesërmen në mëngjes mbërritën në qytet komunistët shqiptarë që bënë pjesë në organizatën bazë që mbulonte edhe Shkollën Ndërkombëtare të Aviacionit.

Mbledhja u bë në një lulishte të madhe dhe të tre komunistët e uçelishes arritën të dilnin prej saj fshehurazi.

Të njëmbëdhjetë, bashkë me Kastriot Lekën të ftuar, nuk u ulën në asnjë vend për shkak se dyshonin se i ndiqnin.

Mbledhjen ata e bënë duke ecur.

Sekretari i lodhi ca me këmbët e shpejta. Ai tha se kishte mundësi që qeveria sovjetike t'i dëbonte kursantët shqiptarë që studionin në të gjitha shkollat e Bashkimit Sovjetik.

Bile mund t'u ndodhte që edhe të mos u siguronin kthimin, sepse për këtë punë dhe biletat e udhëtimit kishin kërkuar flori.

Ishte një situatë e jashtëzakonshme dhe lidhjet me ambasadën që nga ky moment do të mbaheshin dy herë në ditë.

Për shkak të rrethanave jo normale edhe në shkolla të tjera, ku studionin shqiptarë, atasheu ushtarak nga Moska do të vinte pas disa ditësh.

Sekretari u tha se prej ambasadës do të vinte edhe një valixhe plot me fjalime të Enver Hoxhës në kongresin e katërt të PPSH-së.

Pastaj thirrën Kastriotin, që e kishin lënë pak më pas, në një farë mënyre në roje të tyre.

“Do të pranojmë kandidat partie” i kishte buzëqeshur sekretari.

"Keni ndonjë pyetje“ u hodh e ju foli të tjerëve.

Dikush tha se duhet ta provojmë me ndonjë pyetje teorike. Të tjerë kundërshtuan. Sekretari i partisë tregoi se ç'i kishte ndodhur me Mig-17.

Pastaj ai nisi të tregonte edhe...por dhjetë të tjerët ngritën duart si me një komandë.

Cili ishte modeli i femrës së statujës së paqes

Po mbusheshin dy javë dhe asnjë shqiptar nuk u takua dot me të dashurën e tij.

Nuk mundi as Kastrioti të rrinte pranë Nataljes.

Prej saj erdhi një pusulle, ku i thoshte se e përqafonte fort dhe se priste me ankth sa të liroheshin ndopak kushtet e shtrëngimit për ta.

Kaq.

Këtë letër-telegram, ardhur nëpërmjet studentëve të tjerë të huaj, ai e lexoi disa herë. Dhe ashtu siç ndodh nga malli dhe nga pamundësia për t'u sqaruar për gjithçka që të mundon, gëzimi iu kthye në trishtim, merak, dyshim.

Përse i shkruante aq pak?

Ndërkohë bazamenti ende bosh i statujës së paqes në sheshin e madh të parakalimeve të shkollës herë pas here provokonte thashetheme rreth skulptorit moskovit Cigarje. Njeriu me kokën e mbushur me flokë ishte dukur vetëm dy herë dhe pasi i kishte hedhur vështrime të menduara bazamentit, pati thënë ndonjë fjalë të rëndomtë e kishte ikur.

Askush nuk e merrte dot vesh se çfarë po bënte: po krijonte apo priste modelin, e kishte veprën në përfundim apo në fillim.

Por një ditë u hap fjala se skulptura kishte përfunduar dhe do të vendosej.

Modeli kishte qenë ajo, për të cilën Cigarjevi pati ngulur këmbë: vajza më e bukur e qytetit.

Njeriu me borsalinë

-Ka ardhur një njeri dhe kërkon të takojë ndonjë shqiptar – u dëgjua si nëpër mjegull një zë.

Të gjithë kishin ngritur kokat dhe po shikonin atë që kishte shqiptuar këto fjalë.

Ishte gjeorgjiani Ekvtime.

-Kush është?

-Një burrë i moshuar, me një borsalinë. Nuk ma dha emrin.

-Çfarë kërkon?

-Kërkon të takojë një shqiptar, kështu më tha.

Ata të gjithë ende nuk e kishin hequr vështrimin e ngulmët e të shtangur nga fytyra e Ekvtimesë dhe dukej sikur qenë vënë në gjueti të ethshme të fjalëve që ai nxirrte me hapjen e gojës.

-Po shkoj unë - tha Bujari.

Pastaj, si të ishte kujtuar për diçka, u kthye sërish.

-Eja edhe ti Rexhep!

Që të dy veshën në heshtje kapotat dhe kasketat e dolën në korridor. Gjeorgjiani i ndoqi nga pas.

Tek porta e hekurt ishte një njeri me trup të lartë që bënte ec e jake pa pushim.

-Nuk e njohim - tha Bujari.

-Kthehemi - foli Rexhepi.

Ekvtimeja u doli përpara.

Ai mu lut shumë që t'i sillja një shqiptar. Unë mezi rregullova edhe takimin.

Njeriu pas portës së hekurt po buzëqeshte me sytë nga ata.

-Ç'na polli! - thirri Rexhep Mema.

Ata, megjithatë, ecën drejt tij me hapa të ngadaltë e të ndrojtur.

Në anë të borsalinës ardhësit i zbuloheshin thinjat e flokëve.

-Janë shqiptarë - i foli Ekvtimeja, duke treguar Bujarin dhe Rexhepin.

Tjetri u gëzua dhe bëri një lëvizje të supeve sikur donte të hapte krahët.

-Kam qenë në Shqipëri. Jam inxhinier nafte e kam punuar në Qytetin Stalin, në Patos dhe në Ballsh. Sapo jam kthyer. Bujari i zgjati dorën me një shpejtësi që edhe vetë u habit. Të njëjtën gjë bëri me padurim edhe shoku i tij.

Ardhësi i mbajti në pëllëmbët e tij të dyja duart e zgjatura dhe lagu sytë prej lotëve.

Më thanë që në këtë shkollë ka studentë shqiptarë dhe nga malli erdha t'ju _takoj. Banoj në qytet.

Përmatanë portës së hekurt, në skaj të rrugës, si të ishte njeri tjetër, me xhamat e pastra e që lëbyrnin diellin, shihte një veturë “Moskviç”.

-Është makina ime - tha i porsaardhuri, i cili e kapi lehtas vështrimin e dy shqiptarëve - E kam blerë këtu këto ditë me kursimet që bëra në vendin tuaj. Është dita e dytë që po e ngas. Ai ngriti supet, buzëqeshi me ndrojtje, kërkoi fjalët dhe pastaj vijoi - Akoma nuk di ta drejtoj mirë, por me ta mësuar do të vij këtu e t'ju shëtis nga të doni.

Fjalët e thëna për t'u gëzuar, në të kundërt shkaktuan heshtje.

Ardhësi u gjet në pozitë të vështirë, u lëshoi duart, ngriti disa herë supet, ngulmoi për të gjetur fjalët e reja, por nuk tha asgjë.

-Ju faleminderit! - mbushi heshtjen Bujar Andoni - Ju faleminderit për dashurinë që keni ndaj vendit tonë!

Tjetri akoma vuante mundimin e gjetjes së fjalëve të tij. Më në fund bërbëlit: Vij e ju marr vetë, kur të keni kohë të lirë. Ja edhe numri im i telefonit!

Ai i Ia Bujarit në dorë një pusullë të vogël.

Pastaj bëri të ikte.

-Mirë u pafshim!

Dhe po ikte vërtet.

Si me pezmatim, si në mëdyshje.

Ndoshta kishte bërë një duzinë hapash, kur befas ktheu trupin dhe tundi dorën: Do të jem pranë jush, gjithë kohën.

I di të gjitha, i dimë të gjitha.

Pastaj nxitoi drejt “Moskviç”-it të vet.

Më jep një fëmijë!

Natalja iu afrua për herë të parë pasqyrës pas tre ditëve që kishte zënë shtratin.

Ishte krejt e zbehtë.

E kishte pritur Kastriotin, ish lutur, pati qarë, kishte klithur, por ai nuk mundte dot të vinte.

Javën e fundit shpresat herë i gjalloheshin dhe herë i fundoseshin. Herë palponin nga jeta dhe herë bëheshin si kufoma.

Nataljes i dukej se edhe vetë, e gjithë qenia e saj, ishte një pemë që pa thahej dhe po rrëzonte fletët, që po shteronte lëngun nëpër degë, që po vdiste.

Në të vërtetë ajo vuante njëherësh disa dhimbje.

Pa mundur të bisedonte me Kastriotin kishte pranuar tre seanca pune me skulptorin Cigarjev.

Tashmë fytyra e saj duhej të ishte tretur në bronc e mbase statuja e paqes kishte dalë nga uzina e derdhjes dhe po nxitonte drejt sheshit qendror të Shkollës Ndërkombëtare të Aviacionit.

Po vuante mos takimin me të, ankthin se si ishte në çdo çast, në çdo ditë që gdhihej dhe në çdo natë që binte.

Ëndrrat e mundonin e jo më pak fjalët e përhapura në qytet se shumë studentë shqiptarë qenë arratisur, të tjerë futur në burg, disa ishin sëmure, mjaft ndodheshin në grevë urie e jo pak pa vënë gjë në gojë.

Natalja, megjithatë një dhimbje e kishte më të madhen.

Nuk po e provonte dot se kishte mbetur shtatzënë.

Nuk kishte as në stomak të përziëra, as vështirësi për të ngrënë ndonjë ushqim.

Gjithçka shkonte si më parë, përveç faktit se menstruacionet e saj kishin kapërcyer muajin dhe nuk po vinin më.

Por çrregullime të tilla i kishin ndodhur edhe më parë.

O Zot,më jep një fëmijë!

Kjo ishte lutja e saj në çdo orë të ditës dhe në kllapitë e natës.

Më jep një fëmijë!

Karantinë

Të shtunën e tretë të mezi pritur për të siguruar liridalje u tha se lejimi i kursantëve për të dalë jashtë shkollës do të bëhej të dielën.

Porse kur gdhiu kjo ditë, u përhap lajmi se të gjithë do t'i nënshtroheshin karantinës.

U tha se kishte pasur grip dhe realisht ngjarje të infektimit prej tij gripi nuk kishte pasur pak. Në rastet e ndodhura ai pati shkaktuar edhe ndërlikimet e nuk mungonin edhe shtrimet urgjente në spitalin ushtarak.

Në orën nëntë filloi karantinimi i studentëve vietnamezë, më pas i bullgarëve dhe i kinezëve.

Karantinimi i shqiptarëve nisi në orën njëmbëdhjetë.

Me këtë operacion të madh merrej një kompani ushtarësh sovjetikë me automatikë dhe gjoksoret e mbushura me kompletin luftarak.

Ata zunë të gjitha hyrjet e fjetinave si edhe çdo dalje në oborrin mes tyre.

Një kolonel që drejtonte kompaninë, u kujdes që jo vetëm konvikti nga konvikti, kati nga kati, por edhe një pjesë e katit nga tjetra të izolohej.

Kështu kinezët u urdhëruan të mos kapërcenin gjysmën tjetër të korridorit, ku po qëndronin në karantinë shqiptarët.

Tashmë ushtarët e armatosur rrinin në të gjashtë bërrylat e shkallëve të fjetoreve trekatëshe.

Në orën njëmbëdhjetë e gjysmë gjithçka kishte përfunduar.

Kursantët shqiptarë u mbyllën në gjysmë korridorin e tyre.

Me fytyrë të zbehtë roje kati ishte Misha.

Rexhep Mema iu afrua me ndrojtje dhe shikimi i ra për një çast tek automatiku. Pastaj i ngriti sytë për të gjetur vështrimin.

-Edhe ti, Misha?!

Tjetrit iu duk sikur iu ënjt fytyra, goja iu shtrembërua dhe fjalët që donte të thoshte, më tepër qenë një zmadhim i pazakonshëm sysh.

Pastruesja e konviktit Maria Listova

Në dhomën e tyre erdhën edhe kursantë të tjerë e dikush edhe me kitarë.

“T’ia marrim këngës” thanë shumë dhe u dëgjuan tingujt e parë të krijuar nga vrundulli i gishtave të rëna njëherësh mbi të.

-Marrim këngën për Tiranën - shtoi një zë.

Kastrioti dëgjonte si i përhumbur, i shtrirë përgjysmë në shtratin e tij.

Ishte i lodhur, ndihej i pafuqishëm për të kënduar.

Sigurisht kjo gjë nuk i kishte hije një komunisti, por aq i bënte. Qe i lodhur edhe nga rregullat e ngurta e edukata për të qeshur, kur duhej qarë.

Ai kishte mall për Nataljen, po çmendej për të. Këngët vazhdonin dhe për çudi, tek shihte nga dritarja, vuri re se në oborrin e madh mes fjetoreve patrullat e ushtarëve ishin larguar dhe midis tyre kishte filluar lëvizja e lirë e njerëzve. Kjo gjë shkaktoi hutim mes shqiptarëve. Disa dolën në korridor, por as Misha dhe as rojet e tjera nuk qenë hequr. Siç dukej karantina për gripin kishte qenë një pretekst për t’i izoluar ata.

Kështu e ndërprejnë edhe këngën.

Nuk kishte më kufij mes zemërimit, mërziës, dëshpërimit, urrejtjes, pështjellimit.

Sa do të vuanin kështu?

Përse dy partitë e shtetet i shkarkonin helmet e luftës së tyre kështu?

Si qe e mundur që një vend i fuqishëm e që hahej me Amerikën, maste forcat edhe me ta, një popull i vogël?

Ishte kthyer lufta brenda vetes më ashpërsisht se midis dy kampeve. Lufta e Ftohtë që shndërruar në akullimë që nuk frynte mes SHBA dhe BRSS, por mes këtij të fundit dhe Kinës.

E për pasojë edhe kundër Shqipërisë.

Por çuditërisht në Shkollën Ndërkombëtare të Aviacionit beteja kishte gjeografi tjetër.

Ajo i pati lënë disi mënjane kinezët dhe që shndërruar në furtunë vetëm kundër shqiptarëve.

-Ka ardhur nënë Maria dhe ushtari sovjetik nuk e lë - u dëgjua një zë që hapi vrullshëm derën dhe zgjati gjysmën e trupit.

Të gjithë vërshuan në korridor. Atje nuk ishte më roje Misha, por ai ushtari rrondokop, i cili kohët e fundit ndiqte nga pas Rexhep Memën.

Maria Listova ishte ulur këmbëkryq mbi rruginën e gomuar të buzë shkallëve dhe flokët e bardhë i qenë shpupuritur.

-Nënë! - thirri Bujar Andoni dhe vrapoi drejt saj.

Maria për një çast nuk arriti dot të orientohej dhe e pa si e përhumbar, pastaj rrudhat e anë syve iu shtrinë butësisht nën gëzimin e buzagazit.

-Bijtë e mi! - tha me një zë të ngjirur dhe u çua me një vrull të pazakonshëm për moshën e saj.

Trupi i rëndë iu epua për disa momente, në kërkim të ekuilibrit.

-Stojtje! - klithi ushtari sovjetik dhe i vuri bajonetën në gjoks.

Bujar Andoni tendosi kraharorin dhe e shtyu përpara. Bajoneta u duk sikur rrëshqiti mbi trup dhe shqeu xhepin e gjimnastjorkës.

Maria iu vërsul ushtarit sovjetik dhe nisi ta godiste në kraharor me grushte gjersa u lodh.

Rondokopi që hutuar dhe po e shihte atë me sy të tej hapur.

-Krap! - u dëgjua një e kërcitur.

Disa metra larg pastrueses rrinte Hu Shia me një aparat në dorë. Ai po e mbushte përsëri barkun e diafragmës me shirit celuloze.

E vuri menjëherë në sy dhe e shkrepiti.

Pastaj u shkeli sytë shqiptarëve dhe sa të hapësh e të mbyllësh sytë kishte firuar në një nga dhomat e gjysmë katit.

Maria Listova nuk e kishte parë skenën me kinezin. Ajo tashmë po i përgjerohej rojës sovjetike ta hiqte bajonetën nga gjoksi i Bujar Andonit.

Ajo belbëzoi si në përçartje “po komunizmi ku është?”

Rrondokopi më në fund e tërhoqi armën, por tehu sërish shihte trupin e shqiptarit.

Me duart të dridhura pastruesja hapi futën e saj të madhe dhe nxori që andej dy panine me djathë.

Por nuk arriti dot t’ju a jepte kursantëve shqiptarë. Roja klithi si i çmendur dhe pastaj thirri disa emra.

Që poshtë shkallëve u dëgjuan hapa që vraponin dhe katër ushtarë sovjetikë me automatikë në duar ngjitën tre katet.

Rrondokopi kërceu tek Maria Listova dhe me një lëvizje inatçore të bajonetës ia hoqi asaj copat e bukës nga duart.

Dy paninet tul bardha u rrokullisën nëpër shkallë dhe katër ushtarët që po ngjiteshin, i shkelën.

-Mallkuar qofshi! - klithi Maria Listova.

Tek hekurat e portës rrinte Natalja

Kish ëndërruar gjithë kohën për Nataljen dhe tani qe gati të betohej se ajo që po i shihnin sytë, ishte ende trallisja nga malli për të.

Pas xhamit të veshur nga fryma e gjindes njerëzore të ndodhur vazhdimisht në dhomën e tyre, tek porta e hekurt e postblokut ai shqoi një siluetë të ngjashme me të.

Ishte hutuar dhe në çast u kujtua të fshinte mirë me pëllëmbën e dorës avullin mbi qelq.

Pamja u kthjellua menjëherë.

Me të dyja duart të kapura tek hekurat e portës rrinte Natalja.

Kastriot Lekës i shpëtoi një rënkim dhe u qep pas xhamit për të thirrur. Gishtat gërvishtën qelqin dhe gjuha iu përpëlit në gojë: Natalja!

Pastaj iu sul derës dhe korridori për të u shndërrua në një pistë vrapimi.

Kishte humbur vetëkontrollin dhe nuk e llogariti rojën sovjetike.

As “stoj”-in e tij nuk e dëgjo.

As kërcitjen e shulit të automatikut.

Ndjeu vetëm një goditje të fortë në nofull dhe ju morën mendtë. Tepër vonë kuptoi se e kishin qëlluar me kondakun e armës.

Studentët shqiptarë që dolën vrulltas nga dhomat dhe pastaj ardhja e shpejtë e disa ushtarëve sovjetikë për pak çaste sa nuk shkaktoi përleshje.

Do të ishte vetë Kastrioti ai që do të hynte në mes dhe hoqi dorë nga largimi prej godinës.

U kthye në dhomën e vet ashtu i tronditur dhe i trishtë.
Tek porta e hekurt dy ushtarë po përpiqeshin të largonin
qetësisht Nataljen dhe në fillim ajo nuk u bind.
Pastaj dolën një trumbë oficerësh, madje edhe një veturë.
Gjithçka Kastriot Leka e ndoqi pas xhamave.
Koka i dhembte dhe jo më pak nofulla e goditur.
Atje, larg, pas portës së postblokut, Natalja i hipi makinës
dhe iku.
Pas pak erdhi një çift oficerësh dhe i komunikoi kursantit
shqiptar se e fejuara ishte shumë mirë, por vetëm kishte
merak për shëndetin e tij.
Ata e kishin siguruar se karantina nuk mendohej të zgjaste
më shumë se tre-katër ditë dhe se në fund të saj komanda
e shkollës kishte planifikuar leje njëzetë e katër orëshe për
të gjithë.
Kur ata u larguan, vështrime shkaras hidheshin drejt
Kastriotit si drejt një çudie tepër të rrallë.
Ishin të mbyllur në një karantinë politike e kjo nuk qe më
pak se një luftë.
Ndërsa njeriu që kohët e fundit ishte pranuar si kandidat i
partisë së gjendur në mes të një beteje, e kishte mendjen
tek e dashura e tij.
Madje gati sa nuk dha edhe jetën për të.
“Duhet si të çmendur” sqaroi me pëshpërima Rexhep
Mema.

Spiuni

Pasdite mjaft studentë të huaj u përpoqën të ngjiteshin gjer në katin e tretë me bukë të futur në gjoks nëpër tuta sportive dhe në çorape.

Kubani Kutinjo hodhi që poshtë një bukë të tërë të mbështjellë me gazetë, por në ajër gazeta u hap dhe ajo u duk. Nga dritaret e konvikteve përballë studentët ngrinin dy duart të bashkuara fort.

Shqiptarët ua kthenin përshëndetjen me dorën e shtrënguar grusht. Pas pak orësh kjo u bë një nga përshëndetjet më të përhapura mes studentëve të huaj. Deri edhe rumuni Dimitriu përshëndeti një herë me grusht. Kur ra nata ata e ndjenë veten shumë të lodhur e të uritur. Më të shumtit u shtrinë nëpër shtretër, rojën e kishte marrë përsëri.

Misha dhe ai solli një telegram nga ambasada, ku kërkohet që sekretari i partisë të vinte urgjentisht në Moskë.

Vonë, shumë vonë, një student i kursit të parë pati marrë një pusullë nga e dashura e tij dhe rusja i thoshte se në qytet ato kishin ngritur grupe të kërkimit të Palush Bardhoshit.

Konfirmohet që ai ndodhej në qytet, madje e kishin parë një çast edhe në lokalin “Boçka”, por u kishte shpëtuar shpejt nga sytë.

E dashura e tij shkruante se shqiptari i ikur që veshur me një kostum të ri ushtarak sovjetik.

-Aha - tha në moment Rexhep Mema - Kostumin e mëparshëm ai e ka shitur. Pres kokën po që se ai spiun nuk e ka shitur.

"Spiun".
Kjo fjalë i ngjethi të tërë.

Shqiptari nga Saporizha e Ukrainës

Janaqi lëvizi ngadalë që të mos zgjonte Leleçkën.

Sa vonë e kishte zënë gjumi atë!

Ai i hodhi edhe një herë sytë orës, tiktakun e së cilës kësaj nate e kishte numëruar gati me zemër të ngrirë.

Leleçka nuk kishte dashur të flinte, por Janaq Papa nuk donte më të bënte dashuri.

Kishte një dëshirë gllabëruese që të ikte një orë e më parë prej andej.

Ajo i kishte belbëzuar fjalë intime. Pastaj kishte nisur të mërmëriste ngadalë disa këngë dashurie, të cilat ai për herë të parë i dëgjonte.

Për një çast kishte pasur përshtypjen se ajo ishte një nga ato sirenat që me zërin e tyre të bukur ndillnin drejt shkëmbinjve vdekjeprurës udhëtarët e lodhur të detit.

Jam si Odiseu, tha me vete dhe ndjeu se gjymtyrët nuk i kishte më të vetat.

Më hipnotizoi, mendoi përgjumshëm dhe ndjeu zemrën t'i përpëlitej e lodhur. Por kishte shtrënguar tëmthat me pëllëmbët e duarve derisa kishte ndjerë dhimbje dhe përgjumja qe larguar.

Pas pak e ndjeu veten në çdo ind të trupit dhe e kuptoi se i kishte shpëtuar hipnozës.

Palush Bardhoshi i kishte marrë edhe një herë në telefon buzë mbrëmjes.

Me Janaqin ai kishte shkëmbyer disa fjalë rutinë e si të sajuara me zor. Më vonë, pas një heshtjeje të vështirë, i kishte kërkuar që t'ia linte telefonin Leleçkës.

Me të Palushi foli gjatë.

Ajo më shumë heshti se iu përgjigj.

Sytë e zinj pak nga pak iu pikëlluan dhe ajo i vari kokën pa fuqi mbi sup.

Zëri i përtej telefonit e gërvishte në vesh dhe më në fund, pas ca “po”-ve të rralla e ku “o”-ja më tepër ishte një rënkim, e lëshoi dorezën e aparatit.

Atë çast nuk foli, por më vonë, tek hanin darkë të heshtur, ajo i tha se të nesërmen ishte mirë të dilnin një shëtitje jashtë qytetit.

Qenë ndrydhur këtu brenda, dashuria kërkon liri, do hapësira.

Pikërisht kështu i pati thënë, por pa asnjë dridhje zëri, pa asnjë emocion. Fjalët e shprehura bukur ajo i kishte thënë ftohtë, në mënyrë të pashpirt.

Dhe ai e pati kuptuar se ajo nuk kishte aspak qejf të shëtiste jashtë qytetit, siç edhe mori vesh se ish Palush Bardhoshi ai që këmbëngulte të iknin sa më parë.

Diçka duhet të ketë ndodhur, i vetëtiu atij mendimi.

Qe si një shkrepje e llahtarshme drite mbi shkretinë e trurit të tij.

Pati përshtypjen se ajo shkrepimë verbuese kishte qenë fati i tij ashtu siç edhe mbi një tokë të përvëlur nga një thatësi e gjatë një gjësim resh sjell shi.

Po çmпиhej rrafshina e tij e lodhur e si e dehur e trurit.

Ishte një çmпиrje e ngadaltë dhe torturuese.

“Duhet të iki” qe mendimi i parë që i erdhi në trurin që po kthjellohej.

“Duhet të iki patjetër”, përsëriti dhe e kuptoi se që nga ai çast ai e kishte marrë vendimin.

Janaqi rrëshqiti me kujdes nga shtrati dhe pa Leleçkën.

Ajo nuk e ndjeu.

Po flinte me fytyrën përmbys dhe mbi jastëkun e bardhë supet e lakuriqtë dukej sikur dremnitin në paqe.

Atij i erdhi keq për të dhe për një kohë të gjatë e pa me pikëllim.

Flaka e gazit në stufë buiste ngadalë dhe atij iu duk se do të shuhej.

E hapi edhe pak rubinetin dhe ndjeu se dhoma u ngroh më tepër.

Tek pasqyra e madhe, e varur në mur, ai ndali këmbët i habitur.

Përmes errësirës së dhomës dritat e rrugëve kishin hedhur disa grimca përndritjeje edhe në pasqyrë.

Kështu ajo i ngjante një ekrani televizori në prag të ndezjes.

Në atë ndriçim të zbehtë të pasqyrës ai befasisht kishte parë fytyrën e tij të tretur.

Shkoi pëllëmbët e duarve mbi të dhe u mundua të prekë rrathët e mëdhenj e të zinj të poshtë syve.

“Ç’jam bërë kështu!” i klithi vetes dhe zuri sytë.

Ndjeu turp.

Leleçka foli përçart dhe atij i ngriu zemra nga mendimi se mos zgjohej. Por ajo po flinte thellë.

Ai nxitoi të hapte derën e dhomës dhe në korridorin e vogël shtriu me të shpejtë dorën atje ku me hamendje, nëpër errësirë, i binte të ishin çizmet e tij ushtarake.

Pak më lartë preku me duar pallton dhe gjimnastjorkën e filloi të vishej.

Pasi mbërtheu shpejt e shpejt kopsat, futi këmbën në njërën çizme, por ajo iu duk e ngushtë.

Shau me vete dhe e provoi edhe një herë tjetër.

Përsëri nuk e nxinte.

Vetëtimthi provoi këmbën tjetër dhe ajo i hyri menjëherë.

“Paskam dashur të fus këmbën e djathtë në çizmen e majtë” iu qesh me vete dhe rrëmbeu kapotën.

Pastaj hapi ngadalë derën e dhomës.

Leleçka po flinte me shpatullat e zbuluara.

Ai iu afrua me kujdes, por çizmet i bënin aq zhurmë sa në çdo hap që bënte, priste që ajo të zgjohej.

Kur më në fund iu afrua, i tërhoqi gjer mbi qafë çarçafin dhe batanijen e hollë dhe dora për pak sa nuk preku në mishin e saj të bardhë e të plotë.

Pati dëshirë ta puthte.

“Po puthjet zgjojnë”, mendoi i tronditur dhe u tërhoq.

Kishte dalë jashtë, mes shkallëve, kur u kujtua se pati harruar kapelën.

U kthye ngadalë dhe i inatosur.

Atë e gjeti shpejt në gardërobë dhe e ngjeshi fort në kokë.

Jashtë frynte një erë e akullt dhe ai për ca kohë që aq i ngrohtë sa të mos e ndjente ftohmen e saj.

Por kur doli nga qyteti dhe hyri në rrugën drejt shkollës së aviacionit, ndjeu të mardhura në trup.

I nxitoi edhe më hapat dhe si nëpër mjegullinë iu kujtua se ajo ishte një nga rrugët më me zë të atij qyteti për të papriturat e huliganëve.

Ai u drodh i tëri dhe e kuptoi menjëherë se në dridhmat e para që kishte ndjerë sapo kishte hyrë në këtë rrugë, kishte edhe ftohtë, por edhe frikë.

Eci me vrap një kohë që atij iu duk e pafund.

-Xhaxhi! - u dëgjua anash tij një zë i hollë fëmije, i cili më tepër i ngjau me klithmë kukuvajke të trembur.

Janaqi u mpi.

-Xhaxhi, të lutem sa është ora? - thirri përvajshëm ai zë fëmijëror dhe më në fund Janaqi dalloj në brinjë të tij një vogëlush të futur në një xhaketë të madhe, si në një thes.

Ai u mundua të mbledhë veten e të rregullojë frymëmarrjen për të formuar qoftë edhe një fjalë.

Zgjati në errësirë dorën gjer tek fytyra në një mënyrë të tillë që të mund të dallonte sa ishte ora. Por në atë çast dy tehe thikash iu ngjeshën në ije.

-Hiqe orën, xhaxhi! - foli zëri i fëmijës, tashmë i transformuar.

Janaqi pa në të dy anët e tij dy djelmosha trupmëdhenj e që skërmiteshin.

Ai e hoqi ngadalë orën. Gishtat iu ngatërruan për një kohë tek rripi i saj.

-Edhe kapotën! - përsëriti fëmija.

Janaqi ngulmoi për një moment, por të dyja thikat në ije iu shtrënguan më fort.

U çkopsit dhe e hoqi me të shpejtë edhe kapotën.

-Edhe gjimnastjorkën! - foli sërish fëmija me një zë të qetë.

-Jo! - klithi më në fund Janaqi dhe ndjeu ta pushtojë zemërimi - Unë jam ushtarak dhe nuk mund t'iu lë uniformën.

Thikat në ije iu shtrënguan gjer në mish. Thirri me dhimbje.

-Kapo! - u çirr njeri nga ata të dy që kishte anash - Ky miku nuk do të zbatojë urdhrat. E mban veten edhe për ushtarak.

Nëpër errësirë qeshi një zë i trashë.

Disa hapa të rënda lëvizën midis territ dhe pas pak Janaqi shqoi para vetes një fytyrë me tipare tërheqëse dhe me flokë kaçurrela.

-Ç'je? - pyeti.

Janaq Papa u drodh i tëri. Zëni që vinte nga ajo pamje simpatike të jepte përshtypjen e kundërt.

-Jam ushtarak - u përgjigj, duke sforcuar disi veten.

Tjetri qeshi fort.

-Këtë e shoh. Rus je?

-Jam shqiptar.

-Shqiptar?!

Zëri i tjetrit ishte këputur në mes.

-Po unë jam Borisi, miku i shqiptarëve.

Ai i hodhi krahët mbi shpatulla.

Borisin e njuh i gjithë qyteti. Edhe ti duhet të më njohësh.

-Po, po - bërbeliti tjetri, ndërkohë akoma nuk po e sillte në hatër.

Borisi e shtrëngonte ende në supe.

-Po ti ku shkon kështu, ku paske qenë?!

-Shkoooj tek shokët në shkollë.

-Pooo.... - Borisi kishte hequr duart nga supet e tij.

Rreth tyre ishin mbledhur edhe disa huliganë të tjerë.

-Ti s'je në karantinë?

-Në karantinë?!

Tashmë të gjithë ardhësit nisën të flisnin njëherësh.

Janaqi ndjeu djersë të ftohta t'i binin në të gjithë trupin dhe të rrahurat e zemrës e pickuan gjer në majë të gishtave të këmbës.

Shokët e tij i kishin futur në karantinë, kurse ai bridhte me një vajzë.

-Më lini të iki tek shokët! - klithi dhe u përpoq të çante mes morisë së tyre.

-Prit! - ia bëri Borisi dhe e kapi me të shpejtë nga bërryli – Jepini një herë orën e dorës dhe kapotën!

Sa të hapje e të mbyllje sytë huliganët i vunë orën në dorë dhe i veshën kapotën.

Ai e ndjente veten tmerrësisht të kapitur.

U bërbeliti diçka si faleminderit dhe i tërhoqi këmbët zvarrë nëpër natë gjer sa iu afrua portës së hekurt të postërojës.

Sytë vetvetiu iu ngritën gjer në dritaret e largëta të katit të tretë të fjetores së tyre.

Ato ishin të ndezura.

Iu duk sikur dëgjoji mërmërimë zërash, por në të vërtetë zhurmonte era.

Ndjeu trishtim të madh në shpirt dhe ndoqi me vështrim ec e jakët e dy rojeve të armatosura në postblok.

Qe i bindur se në shkollë nuk mund të hynte dot nga ajo derë.

Pëllëmbët e duarve i përcollën akullimën e tokës.

U tërhoq praptazi dhe nisi sërish të ecte nëpër terr.

Po kërkonte murin e rrëzuar.

Ecte vrulltas dhe pa vështruar ç'kishte përpara.

Kur iu afrua murit të rrëzuar pa edhe atje një patrullë ushtarësh sovjetikë. Iu duk sikur ndërtesat e mëdha të shkollës dhe fjetoret u shtrembëruan dhe ranë me rrapëllimë.

Pati rënë barkas pa e ditur as vetë pse.

Era fishkëllente nëpër atë rrafsh të zhveshur dhe ai u ngjesh edhe më shumë pas saj. Priti më kot që çifti i rojeve të largohej, por ata rrinin atje, me jakat e kapotave të ngritura dhe me shpinat kthyer erës.

Për një kohë të gjatë u përpoq të mendohej se si mund të hynte në shkollë.

Iu kujtuan shkallët e ullukut të shiut, por ato qenë shumë të rrezikshme për pa shkathtësinë e tij.

Idea se mund të kalonte nga kaldaja i shkoi vetëtimthi nëpër mend, kur dalloi njollën e madhe të dritës që përhapnin flakët e saj.

Siç dukej kishin lënë hapur derën e jashtme dhe ajo tashmë i dukej si porta e parajsës.

Janaqi u bë skrupull nga të ftohtit. Pastaj nisi të tërhiqej praptazi, gjersa më në fund u duk se patrulla e rojeve sovjetike nuk e shihte dot.

Dhe ja dha vrapit.

U rrëzua e sërish u ngrit.

Tani derën e kaldajës të mbushur plot me dallgëzimet e shkëlqimit të flakëve ai e shihte përballë.

U përpoq të dallonte ndonjë nga punëtorët e saj, por nuk dukej asnjë.

Atëherë nisi t'i avitej mureve rrethues të shkollës në drejtim të portës së rrëmbushur me dritë.

Ndenji për një çast rrafsh me tokën.

Njolla e dritës mund të nxirrte nga terri siluetën e tij dhe këtë mund ta pikaste patrulla e lëvizshme.

Vuri kokën mes pëllëmbëve dhe u mundua të qetonte frymëmarrjen.

Papritmas iu bë se dëgjoji disa hapa.

Çoi kokën me vrull dhe sytë, tashmë të mësuara me errësirën, dalluan tek muri Jegorin. Ai po kollitej mbytur, i kishte kthyer shpinën dhe bënte ujët e hollë.

Pastaj përsëri u kollit dhe u kthye të çapiste drejt derës së kaldajës.

-Xha Jegoor! - thirri mbyturazi.

Plaku ktheu kokën andej nga dëgjoji zërin dhe ia qepi sytë territ. Drita e flakëve që lëshonte kaldaja, i zhbiroi nëpër qimet e rralla e të gjata të mjekrës së tij.

Xha Jegor! – e thirri sërish Janaqi.

Plaku nisi të ecte drejt kursantit shqiptar, por edhe ky drejt tij. Xha Jegori më në fund rrinte dy hapa larg dhe po e shihte me sy të hakërryer.

-Kush je, ç'bën këtu, i paudhë?!

Janaqit iu morr goja.

-Dua të hyj në shkollë.

Jegori belbëzoi diçka nëpër dhëmbë, pastaj foli.

-Hajde i paudhë! Kërkon të hysh në shkollë nëpër vrimë. Kërkon të hysh nëpër vrimën e xha Jegorit ti?! Të gjithë kur e kanë keq dhe janë bërë tapë me vodkë, vijnë e përplasen këtu tek unë. Xha Jegori nuk ua prish, e ka zemrën të bardhë. Hajde edhe ti, hyr edhe ti si të tjerët, por një hyrje nga kaldaja është baras me një kapotë.

Janaqi thirri mbytur: Aman, ta jap, vetëm futëm!

-Xha Jegori e ka zemrën të pastër. Hajde, hajde! Hiqe kapotën!

Ai e hoqi me të shpejtë dhe ja lëshoi në dorë. Ky e mbuloi me trup ne drejtimin e mundshëm të shfaqjes së patrullës gjersa shkuan tek dera e prapme e kaldajës.

-Çfarë je? - e pyeti befas Jegori.

Janaqi u hutua.

-Shqiptar jam - u përgjigj.

-Shqiptar?!

Plaku Jegor kishte çakërdisur sytë.

Në çast Janaq Papa e kuptoi se kishte gabuar. Duhej t'i thoshte se qe nga një komb tjetër, por tashmë ishte vonë.

-Pooo.... - foli përçart plaku dhe i vuri pëllëmbën e dorës përpara.

- Nuk të fus, është me bela.

Shqiptari kishte ngrirë i tëri.

-Të lutem!

-Hiç mos mu lut - Jam plak unë, e njoh mirë jetën. Po të futa humbas edhe kokën.

Janaqi deshi t'i lutej më, por Jegori bëri disa hapa brenda kaldajës dhe duke vënë pëllëmbën e dorës së lirë përpara belbëzoi disa herë dhe mbylli derën.

Gjëja e fundit që i rrëshqiti nga vështrimi Janaqit, ndërkohë që plaku mbylli derën, ishte kapota.

Jegori ja kishte marrë atë.

E kapi një inati papërmbajtur dhe desh t'i vërsulej me grushte asaj dere të veshur me llamarinë, por e kuptoi se ishte e kotë.

Iku nëpër errësirë për një kohë të gjatë.

Ishte tërë mllef dhe ndjente në gojë shijen e hidhur të zemërimit.

E kishin kapur të dridhurat nga të ftohtët dhe pafuqia po ja mpinte gjymtyrët.

Tani nuk kishte më asnjë rrugë tjetër. Do të provonte shkallët e rrezikshme të ullukëve të shiut.

Duhej të kalonte sërish përballë portës së madhe të hekurt në hyrje të shkollës.

U vërtit për një kohë të gjatë nëpër errësirë, gjersa u gjend përballë saj, por larg.

Dukej vetëm një roje dhe ec e jakët e tij.

Do të ikte, kur shtangu. Ushtari roje ishte Ekvtimeja. Siç duket ishte bërë ndërrimi i shërbimit.

-Ekvtime! - thirri mbyturazi me një zë pothuaj të shurdhët

- Ekvtimee-ee! Ekvlimeeee!

Por e kuptoi se më shumë se zë lëshonte rënkim.

-Ekvtime, vëlla!

Gjeorgjiani ngriu kur pa njeriun e mbushur me baltë e stërkala bore.

Pa njëherë rreth e rrotull dhe bëri disa hapa gjer tek porta e hekurt.

Pas kangjellave të saj fytyra e tij e zeshkët e me mustaqe i ngjante me një maskë bufoni.

-Dua të hyj, të hyyyj! - u lut Janaqi.

Tjetri sikur u përmend nga një makth. U drodh i gjithi.

-Jooo! - klithi dhe i bëri shenjë me duar për t'i shpjeguar sado pak se kishte njerëz në ndërtesën e postërojës. Janaqin sa nuk e mbyti dënësia.

Nuk kishte më fuqi.

Për një çast iu duk se diçka lëvizte përtej portës së hekurt dhe e ngriti kokën vrulltas tek dera e godinës së postërojës. Një fashë drite ra në rrugë.

Nga dera e hapur dolën tre njerëz. Dy ishin me pallto civile "gub" nga ato që mbanin shpesh njerëzit e Sigurimit sovjetik KGB, kurse njeriu që kishin vënë në mes, ishte mbështjellë vetëm me një xhaketë.

Ata të dy e shtynë njeriun me xhaketë gjer tek porta e hekurt dhe i bërtitën që të mos dukej më aty.

Njeriu i veshur hollë nisi të dridhej shpejt nga të ftohtit dhe eci kuturu nëpër errësirë gjer pothuaj tek trupi i shtrirë i Janaq Papës.

Ky ishte bërë memec dhe nuk lëshonte dot asnjë zë. Tjetri më në fund e kishte dalluar dhe thirri me frikë.

-Shshsht! - ia bëri Janaqi, por ardhësi u tremb më shumë.

-Shshsht! - përsëriti më me forcë dhe i kapi këmbën. Iu bë sikur tjetri do t'ia jepte vrapit e do të lajmëronte civilët me palltot "gub".

-Jemi tanët – belbëzoi - Mos bërtit se na dëgjojnë! Hajde, ulu!

Ardhësi po rrinte si i ngrirë.

-Jemi tanët, hajde ulu - përsëriste automatikisht Janaqi dhe u çua përgjysmë, duke hapur miqësisht krahët.

Tjetri u qetësua, megjithatë, vonë.

-Ç'je? - e pyeti me zë të dridhur jo vetëm nga të ftohtit.

-Kolkozian - u përgjigj tjetri.

Kishte një kokë të gjatë dhe një ballë të madh e të bardhë, që dukej sikur i bënte dritë në atë fytyrë të mavijosur.

-Unë dua të hyj në shkollë.

-Hyr!

-Dua, po si të hyj?! Ka roje.

-Aha.

-Po ti përse ke ardhur këtu?

-Desha të takoj shqiptarët.

-Shqiptarët?!

Janaqi i kishte mbërthyer fort duart e ardhësit dhe ja shtrëngonte tërë gulç.

-Jam me origjinë shqiptare, jam nga Zaporozhja - tha tjetri. Janaqi tashmë nuk ishte në vete. Nuk ia shqiste sytë e i kishte hapur ato frikshëm.

-Shqiptar ti?! Ju?! - belbëzoi.

-Jemi pesë fshatra shqiptarësh të ikur që në kohë të Skënderbeut.

-Po edhe unë jam shqiptar - thirri Janaq Papa në shqip dhe tani ishte radha e tjetrit të shtangte.

-Shkip, shkip! - belbëzoi ky.

-Shqiptar e kaluar shqiptarit - thirri me gëzim Janaqi.

-Mëmë, mëmë - rënkoi tjetri dhe iu hodh në krahë.

Ndenjën ashtu të përqaftuar për një kohë të gjatë. Pastaj ai i rrëfeu përse kishte ardhur në atë shkollë.

Pati dëgjuar se atje mësonin shqiptarët.

Donte t'i takonte, kishte mall. Shqipërinë e kishte dëgjuar në radio këto kohët e fundit. Flitej vazhdimisht për të. Më parë kishte përshtypjen se qe bërë sovjetik e kur ndonjëherë binte fjala për atdheun e largët, nuk e ndjente kombëtarinë e tij.

Porse kohët e fundit, tek dëgjonte për lufatën mes Moskës dhe Tiranës, për tradhti të shqiptarëve ndaj kampit socialist, për bashkim me kapitalizmin, i kishte riardhur në damarë gjaku i vjetër i shqiptarit.

Dhe pati vendosur t'i takonte në vendin më të afërt, ku mësonin.

Kishte udhëtuar dy ditë të tëra me tren. Por kur mbërriti këtu në perëndim të ditës e kishte kërkuar të takohej me bashkëkombësit, e patën kapur prej krahësh dhe e kishin futur në një dhomë.

E kishin mbajtur gjer tani.

E patën pyetur nga ishte e plot gjëra të tjera.

Kish firmosur edhe dhjetë fije letër për ato që kishte thënë.

Pastaj e nxorën jashtë portës.

Janaqi e dëgjoi i nemitur.

Pastaj i shpjegoi për karantinën.

Zaporozhasi shqiptar shau.

-Ikni sa më parë nga Bashkimi Sovjetik! Ikni nga kampi me nder socialist! Bashkohuni me Amerikën! Ikni sa më parë! Këtu nuk jetohej më.

Janaqi e kapërceu hutimin e parë të shkaktuar nga fjalët e porsa shqiptuara, por nuk mund të merrej me këtë bisedë.

-Dua të hyj në shkollë, tek shokët!

-Hyr!

-Po nga?! - u ankua ai dhe menjëherë e kapi përdore – Hajde me mua, mbase më ndihmon.

Ata vrapuan të dy gjysmë të kërrusur gjer tek një vend nga ku shiheshin shkallët e ullukut të shiut.

-Më ndihmo të kap ato shkallë dhe të ngjitem!

Arbëreshi ishte i shkathët si një ketër. Vrapoi i pari nëpër rrafshinën e asaj toke ende të akulluar dhe u mbështet pas murit.

Janaqi iu afrua gjysmë i kërrusur dhe kur mbërriti afër tij, ky u ul. Ai vuri njërën këmbë mbi shpatullën e tij, pastaj tjetrën.

Zaporozhasi shqiptar i dha trupit forcë dhe u ringrit.

Janaqi zgjati duart që të kapte buzët e fundit të shkallës së prerë. Po të hipte në to arrinte të hynte brenda murit rrethues.

Më në fund pasi arbëreshi u sforcua disa herë, ia doli ta kapë hekurin e ftohtë të fund shkallës.

-Mirë u pafshim! - i thirri zaporozhasit me një ndjenjë të papritur përmallimi.

Po ndaheshin kaq befasisht pasi qenë njohur pak minuta më parë.

-Mirë u pafshim! - u përgjigj tjetri dhe zëri i doli dridhshëm.

Ndenjën për pak çaste duke i tundur dorën njeri-tjetrit.

Pastaj Janaqi u hodh brenda territorit të shkollës.

Kur iu afrua fjetores së shqiptarëve dëgjoji këngë.

Po na vjen, po na vjen,

Bota zien, bota zien,

Shokët tanë

Kjo luftë po na i rrëmben.

Vjen statuja

Gjithë mëngjesin e ditës së dytë, me një urdhër të veçantë, dritaret e konvikteve që shihnin nga shqiptarët e mbyllur në gjysmë katin e tyre, u mbuluan me perde të zeza.

Megjithatë studentët e huaj i hapnin pak atë dhe përshëndetnin që prej thellësive të dhomave.

Për kubanin Kutinjo, i cili hodhi bukën e mbështjellë me gazetë, u bë një mbledhje e veçantë dhe u paralajmërua për t'u përjashtuar nga shkolla.

Nuk duhej të kishte shkuar ora dhjetë kur dy ushtarë sovjetikë të armatosur dhe një oficer lëshuan mes gjysmë katit një kazan të mbushur me supë.

Nga dhomat dolën mjaft kursantë shqiptarë dhe u thanë të porsa ardhurve se ata nuk qenë të internuar që t'u vinte ushqimi ashtu.

Protestuan kundër karantinës dhe thanë se për të gjitha këto do të vinin në dijeni ambasadën e tyre.

Oficeri sovjetik që ishte një djalë shumë i ri e me ca sy të vegjël, qeshte dhe i binte ritmikiisht me majën e çizmes kazanit të gjellës.

Atëherë iu propozua që të lejohej një shoku i tyre, i shoqëruar me ushtarë sovjetikë, të blinte disa gjëra për të ngrënë në klubin e shkollës.

-As me ushtarë të armatosur nuk ju lëmë - u ngërdhesh oficeri.

Dhe vazhdonte t'i binte ritmikiisht kazanit të supës me majën e çizmes së tij që shkëlqente nga lustra.

Më vonë iu tha se kishin një telegram nga ambasada shqiptare në Moskë dhe se një shoku i tyre duhej patjetër të nisej për atje.

I shpjeguan se një kopje e atij telegrami, sipas rregullit, duhej ta kishte edhe komanda e shkollës.

Oficeri sovjetik tregoi njërin nga aparatet telefonikë në dritare “merreni vetë në telefon shokun Lisenko”.

–“Telefonat janë të shkëputur nga linja, ju këtë e dini - iu përgjigjën oficerit.

Ky përsëri u ngërdhesh dhe maja e çizmes nuk pushonte së godituri fundin e kazanit të gjellës.

Ai iu drejtua sekretarit të partisë: “Vetë shoku Lisenko do t’ju lejonte me gjithë qejf të shkonit në Moskë, por pasaporta juaj ka nevojë për një plotësim të vogël dhe është nisur ajo përpara jush për në Moskë”.

Pa mbaruar këto breshëri fjalësh ai lëshoi tjetrën: "Ju nuk paskeni uri për të ngrënë, urinë e paskeni për llafe" dhe urdhëroi dy ushtarët që të ngrinin kazanin për t'u larguar.

“Trak”.

Këtë skenë e kishte fotografuar kinezi Hu.

Oficeri sovjetik e përshëndeti Hu Shinë me fjalët “edhe një pozë tjetër!”

Kinezi ja bëri sërish “trak" dhe përkuli kokën tërë mirësjellje.

Paraditja pati edhe një ngjarje tjetër.

Një makinë “Zill” solli në karrocerinë e saj statujën e bërë nga skulptori Cigarjev.

Megjithëse e mbuluar dhe pasta] e magazinuar, ata që e kishin parë thanë se ishte një vajzë e bukur me një pëllumb paqeje në dorë.

Skulptori do të vinte të nesërmen dhe menjëherë statuja do të vendosej në bazamentin e bërë gati prej kohësh.

Karantina u ndërpre pas dyzetë e tetë orësh.
U tha që rastet e “gripit” ishin veçuar dhe nuk përbënin rrezik për shëndetin e kursantëve.
Altoparlantët filluan gjithë ditën të jepnin muzikë ushtarake sovjetike si edhe këngë popullore të vjetra.
U bë pastrimi i përgjithshëm i fjetinave, i të gjitha ndërtesave të tjera dhe i territorit.

Li-ri-da-lje

Kastriot Leka po e shihte i nemitur.

Smirnovi po e vështronte me sy që i shkëlqenin dhe përsëriti për të dytën herë:

-Ju jap liridalje, shkoni tek Natalja!

Mirëpo shqiptari ishte ende i mpirë dhe nuk reagoi.

-Keni liridalje të gjithë! - thirri komandanti i shkollës dhe për çudi i ktheu shpinën.

Fytyra e Kastriotit tashmë ishte lumturuar.

-Li-ri-da-lie ju jap! - klithi Smirnovi me dëshirën e marrë për ta sjellë në vete studentin shqiptar - E bëj pavarësisht nga bindjet e mia politike. Dhe nga tuajat. Nuk dua që ato të influencojnë në marrëdhëniet midis nesh.

Ushtaraku sovjetik sërish e kish kthyer fytyrën nga Kastriot Leka.

-Jeni i lirë, më kuptoni? 1 lirë të shkoni në shtëpinë e Nataljes, të bisedoni me të.

Shqiptari më në fund kish formuluar përgjigjen.

-Bukur! Po na jepni liridalje kur nuk kemi para as për të hipur në tramvaj.

Smirnovi mbyti një të klithur, që iu përpëlit në kraharor.

-Dilni, liridalje! Dilni! Qyteti për herë të fundit do të ndjejë lodhjen tuaj.

Këto fjalë komandanti i shkollës i kishte shqiptuar duke tundur dorën në ajër.

Kastriotin e goditën si breshëri gurësh fjalët "për herë të fundit qyteti do të ndjejë lodhjen tuaj".

Vendosi të mos i përgjigjej e të largohej sa më parë nga ajo zyrë, ku i zoti nuk po kuptohej dot në gëzohej apo i vinte keq për fatin e tyre.

Dhe u nis drejt derës.

-Nuk po më lë një relik? - foli mbrapa shpinës Smirnovi.

Ai iu kthye përballë.

-Po. Pasi e kthyet vaporin tuaj me grurë që populli im të mos kishte bukë, pasi na e bëtë jetën të rëndë në këtë shkollë dhe, me sa duket, edhe po na dëboni, po ju lë kujtim, shoku komandant, këtë thënie të Hrushovit: “Shqipëria do të bëhet një kopësht i lulëzuar”.

Dhe hapi derën e doli.

Jurij Gagarini fluturon rreth tokës

Ata hanin në heshtje.

Sapo kishin shkëmbyer disa fjalë dhe duke i rënë me pëllëmbë supeve të Kastriotit, Sergei e kishte pyetur “përse nuk ke ardhur këto dy javë?”.

Natalja kishte çuar e ulur sytë menjëherë.

Kishte një vështrim të trishtë dhe kjo për të atin ishte një vuajtje.

“Na mbyllën në karantinë”.

“Karantinë?, pati përsëritur me vete Sergei dhe ajo fjalë iu duk sikur kërciti, duke u thyer në gojë.

Që prej atij çasti kishte rënë heshtja dhe të gjitha lëvizjet e të katërve rreth asaj tavoline përpiqeshin që atë ta bënë më të thellë, me të rëndë e më të dhimbshme.

-Me shqiptarët bëjnë poshtërsi të tilla, kurse populli sovjetik nuk di asgjë - belbëzoi nëpër dhëmbë plaku dhe çoi sytë drejt pjatës, ku lugën e kishte lënë me kohë buzë saj.

Nina trazonte më kot fundin e pjatës së vet të vogël e të paprekur.

-Po ta dinte, ah! – thirri serish ai dhe papritmas e goditi me grusht tavolinën.

Nina u zbeh.

-Nuk është hera e parë dhe as e vetmja gjë që popullit qeveria e sovjetike i fsheh të vërtetën - u përgjigj Kastrioti.

Sergei e pa me vështrim të ngrirë e të tej humbur.

-Kemi pasur vetëm pak ditë bukë dhe një vapor sovjetik me grurë të nisur për në Shqipëri ata kanë urdhëruar dhe kthyer rrugës.

Plaku mbështeti bërrylat mbi tavolinë dhe e rrëzoi kokën e mbushur me thinja.

Kraharori i merrte frymë me zor.

-Po pse, pse? - klithi thekshëm.

-Baba! – thirri Natalja me zë të trazuar dhe kërkoi t'i kapte duart.

Ai e pa dhe dhembshuria për të ia paqëtoi tiparet e fytyrës.

-Bijë!

Natalja u ngrit nga vendi i saj dhe shkoi e përqafoi Sergein.

Ai i kapi të dyja duart e saj të varura në qafën e tij dhe i puthi për një kohë të gjatë.

-Jeta është një luftë e ashpër bijë dhe unë kam shumë merak për ty: A do ta nderosh babanë tënd atje në Shqipëri?

Natalja buzëqeshi si në ëndërr.

-Të jap fjalën, baba!

Sergei vari kokën dhe nisi t'i puthte përsëri duart.

-Kurse babai tënd dhe nëna do të rrinë këtu të vetmuar gjer në fund të jetës së tyre - tha dhe vështrimi i shkoi tek soba, atje ku kish ndenjur gjer në vdekje nëna e tij e sëmurë nga skleroza.

Natalja i mbështeti kokën mbi sup dhe sytë iu rrëmbushën.

-Ne pa bijën tonë - belbëzoi ai.

-Po hap televizorin - tha Nina dhe kërcëu nga karrigia e saj. Pas pak ekrani i errët u mbush me dritë të verbër.

Ata të katërt kishin rënë pavetëdijshtë nën joshjen e asaj drite dhe pritën me sytë e ngulur atje.

-Levitani - thirri Nina, kur më në fund drita e verbër u tërhoq në thellësi të ekranit dhe një njollë e zezë mes tij befasisht u kthye e mori pamjen e spikerit të vjetër të Radio-Moskës.

-Levitani! - ngriu në fytyrë Sergei.

Ishte bërë dyllë i verdhë.

Spikeri i vjetër i Radio Moskës ishte mplakur shumë, por zëri i trashë dhe i rëndë nuk i kishte ndryshuar aspak.

-Vnimanie, vnimanie! (Vëmendje, vëmendje!)

Kastrioti pa se si në fytyrat e Ninës dhe të Sergeit pati rënë si një re e zezë zymtia.

Natalja më tepër dukej e habitur. Goja e saj kishte ngrirë në fillim të thënies së një fjale.

-Pjervij sovjetskij cellovjek (Njeriu i parë sovjetik)...

Mes zërit të tij të trashë më në fund u zhvesh lajmi që donte të thoshte: kozmonauti Jurij Gagarin kishte shkuar drejt Hënës.

Kraharori i Sergeit e nxori me zhurmë ajrin që ishte tkurrur në mushkri.

Nina bëri një "uf" dhe u lëshua në nim.

Natalja përplasi me gëzim shuplakat: Sa bukur!

-Thamë plasi lufta! – shqiptoi Sergei dhe mbushi mushkëritë përsëri me ajër. Pastaj nisi të tundte kokën si një njeri, të cilit akoma nuk i kishte ikur habia.

Por më tepër nga të gjithë aty ishte çuditur Kastriot. Ai që befusuar nga e gjithë ajo frikë që shpërtheu tek Sergei e Nina sa panë Levitanin, spikerin e çasteve të shënuara e dramatike të Bashkimit Sovjetik.

Ishte ai që pati lajmëruar sulmin gjerman mbi tokat e vendit të vet, vdekjen e Stalinit, pastaj kongresin e njëzetë.

Psikologjia e frikës nga lufta këtu është bërë psikologji kombëtare, mendoi ai dhe pa pjerrtas nga Natalja.

Vetëm ajo nuk ishte trembur.

-Hajde hamë! - thirri gëzueshëm Sergei dhe fërkoj duart – Një gotë e dua, e kam hak. Kemi gëzim. Nuk ka luftë, por njeriu i parë sovjetik, Jurij Gagarin, shkoi drejt Hënës.

Nina vuri buzën në gaz dhe pas pak çastesh një gotë para të zotit të shtëpisë u mbush gjer në fyt me vodkë.

-Gëzuar! – thirri ai dhe pasi e rroku gotën me pëllëmbën e dorës, e ktheu atë njëherësh.

Fikthi i brodhi si i çmendur nëpër gurmaz.

Kur e hoqi nga goja qelqin e zbrazët, lëshoi edhe një “oh” kënaqësie.

Natalja po e shihte e skuqur flakë.

Gati nuk folën gjersa Sergei tha “u ngopa” dhe u ngrit nga tavolina.

Televizori vazhdonte të jepte disa lajme të shurdhëta nga republikat balltikase.

~Rri nga ne sonte! - foli plaku, duke u shtritur mbi një jastëk.

Kastrioti u çua ngadalë nga tavolina dhe nuk i dha përgjigje menjëherë.

-Nesër ka mundësi që të ikim për në Shqipëri - i tha pastaj me një zë që edhe pse donte ta thoshte me qetësi, ishte mjaft i tronditur.

-Si?!

Ishte një klithmë që doli nga kraharori i të treve.

-Po, baba Sergej. Nesër mund të ikim.

-Të ikni?!

-Pa mbaruar shkollën. Na dëbojnë.

Natalja i qe hedhur në krahë dhe ndjeu se koka e saj po i hynte thellë në gjoks.

-E mora me mend, e parandjeva - rënkoj ajo - Ta lexova në fytyrë.

Sergei kishte ndërruar krejt pamje.

Flokët e thinjur i qenë prishur dhe në fytyrë çdo tipar po i transformohej me shpejtësi.

-Ishte kaq e papritur! - belbëzoi Nina si e ngurosur dhe nuk e vështroi Kastriot Lekën në sy.

-Po ikën pa dasmë, bijë! – mërmëriti Sergei dhe nisi të fshinte me pëllëmbët e duarve lotët që po i rridhnin çurg - Po ikën pa një gëzim!

Një heshtje e rëndë dhe e mbushur me ngashërimet e të zotit të shtëpisë i la pa fjalë për një kohë të gjatë që të gjithë.

-Kur do të ikni, bir? - pyeti më në fund me zë të mekur Nina.

-Ndoshta nga dreka. Në atë orë ka një tren për në Moskë.

-Oh!

-Po na ikën, bijë, po na ikën! - belbëzoi sërish Sergei dhe ja nguli vështrimin xhamit të dritares, përtej të cilës kishte vetëm errësirë.

Natalja po fshinte lotët e nxehtë.

-Si do të mësohet babai tënd me largimin!

Nina diçka desh të thoshte dhe pa me përgjërime nga Kastriot Leka.

Heshtja e saj kishte diçka të mundimshme.

-Vajza duhet të bëhet gati, moj grua - u përpoq të fliste me zë më të qetuar Sergei - Duhet bërë gati valixhet.

Nina kishte ngrirë fare, bërë gur. Në fillim iu ngurosën sytë, pastaj flegrat e hundës dhe mollëzat e zbehura dhe më në fund lëvizën si në ngërç buzët.

-Po sikur, bir, sikur... e kemi vajzë të vetme...

-Mjaft Nina! - thirri Sergeji.

-Po e kemi vajzë të vetme - klithi ajo - t'i lutemi Kastriotit të rrijë këtu. Ja, shtëpinë tonë e ka. Edhe ne na gëzon, se e kemi si djalë.

Sergeit nisën t'i dridhen duart dhe u çua me një rënkim që u duk sikur i therën të gjitha eshtrat.

-Natalja e ka vendin në Shqipëri, grua. Bëji gati valixhet! Nesër ajo duhet të iki.

-Po sikur; sikur... - thirri ajo mes lotëve që i gurgullonin nëpër faqet e saj. Sytë e zinj i ishin bërë aq pikëllimtarë sa Kastriotit zemra iu mblodh sëmbueshëm.

I vinte keq për gjithçka që po ndodhte aty, por dhënien e atij kumti të dhimbshëm se nesër do të iknin, nuk mund ta

Inte për më vonë. Në orën njëmbëdhjetë të natës duhet të ishte në shkollë dhe gjer atëherë kishin mbetur vetëm dy orë.

-Kastriot, biri im! Natalja vendin e ka atje, në Shqipëri - foli Sergei dhe i vuri pëllëmbën e madhe të dorës në sup.

Ai dukej më i qetësuar dhe goditja e parë tashmë qe tretur mes gjithë atyre lotëve dhe rënkimeve.

-Në Shqipëri e ka vendin. Le të jetojë Natasha në një vend ku nderohet Stalini dhe luftohet për revolucionin. Aty do të bëhet qytetare e mirë e Shqipërisë dhe një grua besnike për ty. Ne do të ishim krenarë me bijën tonë, po qe se do të dojë atdheun tënd si vendin e vet.

Ai hapi krahët dhe e përqafoi Kastriotin: Të trashëgoheni! Sergei mbështeti kokën e tij të thinjur mbi supin e shqiptarit dhe ndenji ashtu për një kohë të gjatë.

Gjoksi i madh i kumbonte nga të rrahurat e zemrës.

Kur më në fund e ngriti kokën, e puthi Kastriotin në ballë.

-Hajde, bijë, të trashëgohesh! - dhe i hapi sërish krahët e tij të mëdhenj.

Natalja gati u rrëzua në ato duar.

Sergei e puthi në ballë dhe e mbajti kokën e saj për një kohë të gjatë.

-Hajde dhe ti, grua, uroji!

Kësaj here zërii tij u duk i tronditur.

Nina sikur u zgjua nga një gjumë i keq. Ajo çapiti drejt së bijës, duke u lëkundur.

-Të trashëgohesh, bijë!

Zëri i saj ishte fjalë e drithërimë. Pastaj e tërë pamja iu shpërfytyrua.

Menjëherë iu shkreh në lot.

-Oooo! Mjaft me lot, kjo është dita e dasmës. Duhet gëzim, gëzim! – tha Sergei me zë të panatyrshëm dhe i rrëmbeu dorën të shoqes.

-A e di ç'kam menduar? Të shkojmë një vizitë tek nëna tënde dhe këta të dy do t'i gjejmë shpejt këtu. Të ftojme edhe njerëz të tjerë, dasmë ta bëjmë!

Atij i kishte rënë një gëzim i madh në fytyrë dhe po e gjestikulonte mimikën si një fëmijë.

Nina sikur ngurroi një çast, por ai e tërhoqi fort. Pas dhjetë minutash dolën.

-Tani e kam radhën unë të qaj - u shkreh fjalë e lot Natalja. Kastrioti e futi kokën e saj në kraharor dhe e la të dëneste.

Unë e ti, e dashur, kemi dy atdhe

-Kjo është nata e dasmës sonë fatkeqe - pëshpëriti ajo e tretur e gjitha në trupin e tij.

-Pse? - pëshpëriti edhe ai.

-Po a ngjan kjo me një dasmë?!

Gërsheti i saj i madh i rrëshqiti supeve.

Kastrioti pati dëshirë t'ia çplekste.

-Do të jetoj në një vend tjetër, larg atdheut tim. Ndërsa ngjarjet po rrokullisen hidhur. Ndoshta një ditë nuk do të kem mundësi të vij tek prindërit e mi dhe ata tek unë.

-Përse mendon kështu?

-Kam një parandjenjë.

Ai ia mori në duar gërshetin dhe ja puthi.

-Atdheun tënd duhet ta duash gjer në fund të jetës. Bashkimi Sovjetik është një atdhe për t'u dashur. Ai është i madh e i bukur, me njerëz zemërmëdhenj e që i duan librat, vend ku këndohet kaq ëmbël dhe ku çdo shtëpi ka shumë ngrohtësi njerëzore.

Kastriot Leka fliste, por skajet e buzëve i dridheshin lehtë.

-Edhe unë e dua shumë vendin tuaj dhe nuk do ta harroj kurrë.

Natalja nisi t'i puthte gjimnastjorkën e çkopsitur pa ditur si t'i shprehte mirënjohjen.

-Unë e ti, e dashur, kemi dy atdhe.

Ndenjën ashtu të përqaftuar për një kohë të gjatë.

-Unë e ndjej zemrën tënde si rreh - pëshpëriti Natalja.

-Edhe unë e ndjej tënden - u përgjigj Kastrioti.

Ajo e shtrëngoi edhe më fort.

E kishte futur kokën mes gjoksit të tij dhe ashtu, gati mbytur, tha: Shumë shpejt ne do të ndjejmë edhe zemrën e një njeriu të tretë.

Tjetri u drodh dhe i kapi mes duarve kokën.

-Natalja!

Ajo vuri buzën në gaz me çapkënllek: Duhet të jem shtatzënë.

-Vetëm duhet?!

-Duhet - lëvizi buzët e ngrohta e të skuqura ajo - Nuk jam vizituar tek mjeku, por duhet, më kupton, jam shumë e sigurt që duhet të kem edhe një zemër tjetër të vockël që do të më rrahë në trup.

Ai tani po i puthte duart.

-Emrin do t'ia vendosim rus. Emrin do ta ketë rus dhe mbiemrin shqiptar.

Kastrioti ishte përfshirë krejt nga ëndërrimet.

-Po të jetë edhe djalë...

-Po të jetë djalë unë kam menduar t'ia vëmë emrin Ljev. Në kujtim të Tolstoit të madh dhe dëshirës sime për letërsi.

Kastriot Leka përsëriti: Ljev! Ljev Leka.

Ata u përqaftuan sërish për një kohë të gjatë. Ajo tashmë ishte e lumtur, përfundimisht e lumtur.

Në një çast, ashtu e dehur siç ishte, i tha nëse e dinte që në oborr kishte nisur të çelte vishnja.

Ata tashmë nuk ndjenin asgjë tjetër veç zemrave të tyre që trokitnin në gjoksin e secilit gati për të dalë që andej e për t'u përqaftuar edhe ato para syve të tyre.

Në ekranin e ndezur të televizorit e të harruar me kohë, rrinte portreti i Leninit, i shtrirë në një kanape, me kufje në vesh.

Komentuesi fliste e fliste për një gjë, të cilën e quante revolucion botëror.

Pastaj ca fjalë që dukeshin krejt si të një bote tjetër: proletariat, socializëm, luftë klase, komunizëm, përmbysje, paqe.

Ptu!

Hë për hë ideja ishte e Rexhepit dhe e Bujar Andonit. Në “operacion” do të merrnin pjesë edhe dy kursantë të vitit të parë.

Kushti i numër një: Të gjendej ku ishte fshehur Palush Bardhoshi. Kushti numër dy: Askush nuk duhej të merrte vesh asgjë. Baza materiale: një veturë “Moskviç” i “një mikut të tyre instruktor në shkollë dhe një pelush.

Ky do t’i dhurohej Leleçka Besonovnës, e cila duhej të hapte gojën e të tregonte se ku ndodhej ikësi.

Konsulent teknik: Janaq Papa.

Koha e veprimit: brenda së dielës, ditë që përflitej se ishte e fundit e qëndrimit të tyre në qytet.

Shënim: menjëherë pas kryerjes së “operacionit” do të shkonin tek vajzat e tyre.

Leleçkën e gjetën në shtëpi. I ranë ziles elektrike për një kohë të gjatë dhe nuk pritën pak deri sa pas derës dëgjuan dikë që tërhiqte zvarrë një palë lëpitka.

Kur u gjendën përballë me Leleçkën ata vunë re se ajo ishte shumë e trembur. Me fytyrën e bërë dyllë të verdhë ajo i shoqëroi gjer në dhomën e saj, ku stufa ishte fikur dhe bënte shumë ftohtë.

-Kemi një bisedë me ju - foli me zë të rëndë Re-xhepi.

Leleçka e shikonte e murosur dhe përpiquej të tregohej e bindur.

-Ndodhi si ndodhi ajo puna e mashtrimit të Janaqit ne atë po bëjmë sikur e harrojmë. Por duam një shërbim, të na thuash se ku ndodhet Palush Bardhoshi.

Leleçka u bë pothuaj si limua. Jo vetëm fytyra, por edhe duart.

-Si mendon?

-?!

Ajo kishte belbëzuar diçka pa kuptim.

-Të japim një peshqesh – bërbëlitë Rexhepi - Një pelush, material çek.

Leleçka hapi sytë dhe gjaku dalëngadalë po i mbushte fytyrën.

-Vërtet?!

-Vërtet.

Ajo nuk ia hiqte sytë dhe dukej sheshit që nuk besonte.

-Po të jetë kështu unë diçka mund të bëj për ju. Unë kam respekt për shqiptarët. Ja, shihni çfarë mbaj!

Ajo hapi me vrull një sirtar dhe nxori që andej një album fotografish personale.

-Ja! - tha dhe tregoi një foto të vogël të Enver Hoxhës - Udhëheqës i pashëm! S'kam parë më të bukur. Udhëheqësit e tjerë sikur i zgjedhin mes të shëmtuarve. Pa le Hrushovi ynë!

Leleçka ia plasi gazit.

Po qeshte si e dalë mendsh.

Ata e lanë gjersa shfryu.

-A e di Palush Bardhoshi se Janaqi është kthyer tek shokët?

-Jo, nuk e di. Di vetëm që ka ikur prej meje.

-Atëherë bjeri telefonit dhe lajmëroje që të vijë sot tek Universagu në qendër të qytetit, në ora pesë. Thuaji se ke një punë me rëndësi me të.

Leleçka u zbeh.

-Si t'i them?!

-Thuaji se Janaqi dëshiron të kthehet përsëri. Është larguar nga shkolla dhe nuk do të kthehet në Shqipëri.

-Po... – belbëzoi, veç ndeshi me këmbënguljen e dy të tjerëve dhe përtueshëm ngriti dorezën e telefonit.

Palush Bardhoshi doli menjëherë dhe ata e dëgjuan zërin e tij në receptor.

Leleçka ishte e stërvitur dhe gjatë bisedës nuk la asnjë dyshim për kurthin që i ngrihej.

Pas pak ajo e uli dorezën dhe tha “do të vijë”.

Në orën katër e gjysmë “Moskviç”-i me Rexhepin dhe Bujarin brenda dihashte një fjollë të hollë tymi në bërrylin e një rrugice që dilte përballë rrugës qendrore, ku ishte Universagu katërkatësh.

Turma njerëzore zhurmonte nëpër shkallët dhe hyrje-daljet e tij, që prej katit të parë, ku ishin sallonet e automobilave e gjer në katin e katërt, në të cilin shiteshin gjërat më të lehta në peshë, prej trikotazheve e gjer tek gjilpërat.

Në orën pesë pa dhjetë minuta Leleçka u duk bashkë me një shoqe të vet dhe shumë shpejt u nda nga ajo.

Pas pesë minutash drejt saj nxitoi Palush Bardhoshi. Ishte veshur civil. Pallton e re “gub” e kishte lënë zbërthyer.

Pas pak ata hynë në godinën katërkatëshe të biznesit.

Nga Universagu dolën shpejt dhe Palushi u gjend i mbërthyer në duart e hekurta të Bujar Andonit.

Rexhepi kishte shtrënguar Leleçkën.

-Qen tradhtar! - shkrofëtiu Bujari dhe ja përdrodhi fort dorën.

Ky klithi.

Disa njerëz kthyen kokën nga ata.

-Ç’keni me mua?! - thirri me llahtar ikësi - Nuk ju njoh.

-Nuk na njeh?! - iu skërmit Rexhep Mema dhe i futi duart në fyt.

Në këtë kohë Leleçka ia dha vrapit dhe u zhduk nga sytë.

-Më mbyti - thirri Palushi.

Bujari e kapi prej jake dhe e shkundi aq shumë sa koka e vogël e tjetrit u trullos dhe u zvogëlua edhe më.

-Nuk të vrasim - i tha - As do të marrim me vete në Shqipëri, sepse gjithsecili është i lirë ta ndërtojë jetën e vet si të dojë.

Palush Bardhoshit i kishte ardhur çehreja në vend.

-Po ç'doni atëherë?!

Ata të dy e panë ngultas dhe e pështynë në të njëjtën kohë.

-Ptu!

Palushi u zbardh dhe pastaj u nxi.

-Ptu!- e pështynë përsëri.

-Unë nuk mund të kthehem në një vend të pazhvilluar edhe pse do ta dua gjithnjë, thjesht sepse është vendi im - belbëzoi ai.

-Ptu!

Ata e pështynë për herë të tretë.

Palush Bardhoshi u zbraps, trupi duk sikur iu bë skrupull dhe toka u hap për ta futur brenda humnerës së saj.

-Ti nuk ke atdhe - i tha Bujar Andoni - Je pa atdhe. Nuk e ke hallin as tek zhvillimi apo varfëria, as tek komunizmi i Enverit apo i Hrushovit. Ti nuk ke as bindje politike, prandaj edhe për ty nuk ka luftë për ndonjë ideal.

Ikësi po tkurrej edhe më e tashmë në largim po shndërrohej në një njollë.

U zhduk shpejt nga sytë.

Ata u nisën drejt "Moskviç"-it dhe shfaqja brenda tij e Leleçkës në fillim i hutoi.

Pastaj u kujtuan për të dhe Rexhepi i zgjati pelushin.

-Ah, sa i bukur! - ja bëri ajo.

Ata i kthyen kurrizin dhe hipën në makinë.

Dita tjetër

Dita tjetër gdhiu e përhimët me po ato re hutaqe e të përumbura.

Në sheshin para fjetoreve po bëheshin përgatitjet për inaugurimin e statujës së paqes.

Një vinç stërmadh po vendoste në bazament skulpturën e Cigarjevit. Rreth saj kishte kureshtarë të shumtë.

Studentët shqiptarë i çuan në rresht për të ngrënë mëngjes dhe nuk kishin mbaruar ende atë bukë të përzishme, kur i lajmëruan se duhej të mblidheshin në “dhomën e Leninit”.

Ndërsa ktheheshin për në konviktin e tyre, tek sheshi i madh ata mbajtën këmbët për të parë statujën.

Kastrioti shtangu.

Pa nga shokët e vet dhe sërish nuk po u besonte syve.

Koka e vajzës së skulpturës ngjante krejt me Nataljen.

Nuk po mbushej dot me frymë dhe zemra dukej se do t'i pushonte.

Bëri të largohej, por ishte kaq e vështirë.

E pa edhe një herë atë kokë të bukur, ku një gërshet i madh kthehej si ujëvarë dhe i binte mbi gjoks.

“Natalja ime!” i klithi një zë brenda vetes dhe vendosi të ikte.

Magjia e statujës e kishte ngurosur si në legendat shqiptare të Mujit dhe Halilit.

Ajo ngjante me një zanë.

-Sheh nga perëndimi - dëgjoji të thoshte dikush pranë tij.

-Kush? - u hutua një zë.

-Statuja.

-Aha, vërtet sheh nga perëndimi. Drejt tij po i dërgon edhe pëllumbat e paqes.

Gjer tek “dhoma e Leninit” eci automatikisht.

Atje i priste Bremeni dhe një kapiten nga administrata e komandës.

Ishte një oficer, të cilit zakonisht i kishin vënë nofkën “xhunga”.

Kur studentët shqiptarë u ulën dhe një pjesë ndenjën në këmbë, “xhunga” u kollit thatë.

-Kam vetëm një njoftim të komandës për ju - ndau fjalët një nga një kapiteni - në orën njëmbëdhjetë të jeni gati për të ikur.

Bremeni pa orën.

-Keni katër orë kohë - tha duke u munduar të vërë buzën në gaz - Ju mjafton të dorëzoni materialet, bile të blini edhe ndonjë suvenir.

Në mes të studentëve u bë zhurmë.

Më në fund u çua Rexhepi, i cili zëvendësonte sekretarin e partisë, të nisur një ditë më parë drejt Moskës.

-Nuk pranojmë të largohemi me urdhrin e komandës. Duam urdhrin e qeverisë sonë.

“Xhunga” u zbeh në fytyrë dhe në kërkim të përmbajtjes së zemërimit u ënjt.

-Mos thyeni urdhrat! - u skërmit - Ne i kemi marrë të gjitha masat që gjithçka të bëhet shpejt dhe pa ju penguar kohën e lirë për t'u çmallur me miqtë.

-Në katër orë?!

-Katër orë nuk na mjaftojnë as të bëjmë shurrën - u dëgjua një zë mes kursantëve të vitit të parë.

Kapiteni u nxi.

-Jeni ushtarakë!? Zbatoni urdhrat! Në orën njëmbëdhjetë të jeni gati!

Pastaj kapiteni kapi prej krahu Bremenin dhe të dy dolën nga dhoma.

Ata u çuan dhe u shpërndanë. Kur zbritën poshtë panë se si dy vetura “Zim” kishin futur turirin në sheshin e madh të shkollës dhe disa civilë vërtiteshin pranë tyre.

Që prej njërës nga veturat kishte dalë edhe Larisa Medvjedovna.

-Skotina (Kafshë)! - u dëgjua të shante dikush.

Nuk e patën mbërritur qendrën e sheshit, kur një vrundull shiu shpërtheu mbi kokat e njerëzve.

Të gjithë vrapuan nëpër strehë.

Civilët rrëmbyen duke qeshur Larisën dhe u futën brenda veturave.

Shqiptarët ndenjën në shesh, mes shiut.

Ata nuk kishin kohë më të rrinin nëpër strehë e të sodisnin rënien apo mbarimin e këtij uji qiellor.

Në shi po rreshtonin edhe kubanët.

U kishin thënë se do t'i çonin në aerodrom.

Ata pyetnin njeri-tjetrin të habitur “Po ne nuk kemi fluturim sot! Aq më tepër po bie edhe shi?!”

Ndarja e dhimbshme, Natalja, Tamara, Irina, Albina, Svjetllana, Ljuba...

Në orën njëmbëdhjetë erdhën dy autobusë "Zim". Që të dy të vjetër e që lëshonin fjolla të hidhura tymi të zi.

Autobusi i parë njihej në të gjithë qytetin se e kishte emrin "mbeturina".

Studentët e huaj patën dalë pothuaj të gjithë. Shumë shqiptarë ata i ngritën në krahë, madje ndonjë që prej katit të tretë e gjer në autobus.

Disa gra të administratës kishin sjellë një tufë me lule dhe e vunë në krye të autobusit të parë.

Maria u rregullonte çantat e valixhet që ato të zinin sa më pak vend.

Disa gra të mensës sollën stola të vegjël dhe i vendosën mes ndenjësive të pakta të autobusëve për t'u siguruar udhëtim ulur të gjithë shqiptarëve.

Rexhep Mema vuri në krye të të dy makinave, në xhamat e parë, stemën e republikës dhe portretin e Enver Hoxhës.

Dy autobusët nisën të zhurmonin motorët dhe rrapëllima e tyre e mbushi sheshin me tym.

Jashtë ende kishin mbetur shumë valixhe.

"Xhunga" urdhëroi që të gjithë plaçkat e studentëve shqiptarë të viheshin në një makinë të tretë.

U bë rrëmujë.

Një makinë e mbuluar me tendë erdhi menjëherë dhe shumica e plaçkave u sistemuan atje.

Kapiteni urdhëroi të nxitonin. Pastaj u ul në autobusin e parë dhe bëri shenjë të niseshin.

Më në fund me të vërtetë po iknin.

Pas xhamave të autobusëve rrëshqiti e u trondit si prej një tërmeti fjetorja e tyre, pastaj tjetra.

Jashtë tundeshin duar e ngriheshin grushte, gratë e administratës tundnin shami të bardha.

Po i afroheshin sheshit qendror të shkollës, kur autobusi i parë frenoi.

Që andej zbriti Ekvtimeja. Ai kishte qenë ulur pranë Bujar Andonit dhe i fshehur pati dashur të shkonte për t'i përcjellë gjer sa të hipnin në tren.

“Xhunga” i bërtiti dhe e shau.

U rinisën, por ende ishin në ulje drejt sheshit, kur kësaj radhe frenoi autobusi i dytë.

Që andej zbriti Maria Listova, ende duke u përqaftuar edhe tek dera. Pastaj ajo nisi të rrokte duart e studentëve, që ata i nxorën të gjithë nga dritaret.

Veç kjo gjë pothuaj u bë e pamundshme sepse autobusët tashmë po nxitonin si të marrë.

Nënë Maria mbeti pas tyre, me krahët që i tundte në ajër.

-Shihni çpo bëhet! - thirri një zë nga brenda makinës së parë.

Ai tregoi andej nga në ballë të sheshit qendror ishin sekretarët e parë të partive të vendeve të kampit socialist.

Të gjithë i kthyen kokat me vrull nga po tregonte ngulshëm shoku i tyre.

Portreti i Enver Hoxhës nuk ishte më.

Në vend të tij ishte vënë një portret i Titos.

Tashmë po kalonin pranë statujës së paqes.

Ajo ishte mbuluar me një pëlhurë të madhe të zezë. Dukej sikur po e çonin për ta pushkatuar apo prerë kokën në gijotinë.

Kastriot Lekës iu veshën sytë dhe nuk mundi ta përmbante dot thirrjen e brendshme, që nuk ishte veç një emër: Natalja.

Ai nuk vuri re që dy ushtarë po rregullonin dukshëm një shirit të kuq e që duhej të ishte ai i përrurimit të shpejtë të statujës.

Ndoshta pasdite, mbase sa të iknin shqiptarët.

-Albina! - thirri një zë.

Ishte një nga kursantët e vitit të parë. Dukej krejt i zbehtë.

Albina, me kokën e mbështjellë me një shami shumë të bukur, po rrinte tek kangjellat e portës së hekurt dhe dy ushtarë përpiqeshin ta largonin me kujdes.

Ushtarë të tjerë sovjetikë po hapnin me nxitim portën.

“Zis”-at u përpoqën të kalonin me vrull postblokun, por Albina arriti të shtrëngonte duart e zgjatura dridhshëm nga studenti i vitit të parë.

Pastaj ajo thirri “Rroftë Shqipëria!”

Autobusi i dytë iu avit aq pranë ruses sa shumë studentë thirrën nga ankthi se mos ai e futi nën rrota.

Shoferi. një sy vëngër, nënqeshi tek pasqyra që kishte përballë.

Albina vrapoi pas autobusëve për një kohë të gjatë.

Më në fund u lodh dhe pasi çapiti edhe disa hapa, qëndroi në mes të rrugës.

-Tani jemi në tokën sovjetike - tha kapiten “Xhunga” – stemën dhe këtë portretin e Enver Hoxhës do ta heqim.

-Por edhe kursantë që studiojnë në një shkollë të Bashkimit Sovjetik nuk jemi më - u përgjigj një zë - Zëreni se jemi turistë dhe është në të drejtat tona t'i mbajmë të dyja.

“Xhunga” rrudhi buzët me zemërim dhe hoqi portretin e Enver Hoxhës.

Dikush ia mori dhe e vuri përsëri.

Kapiteni, sa tjetri u kthye të ulej në vendin e tij, e hoqi përsëri.

Dikush tjetër nga kursantët u ngrit nga vendi i vet dhe e rivuri mbi xham.

“Xhunga” i vuri dorën stemës së republikës.

-Ulni kokat! - thirri Rexhep Mema, i cili ishte gati në fund të autobusit.

Menjëherë të gjithë kursantët që ishin para tij, ulën kokat dhe ai rrëshqiti mbi ta si në ski. Ra drejt e tek kapiteni sovjetik dhe ja vuri duart në fyt.

Gati e mbyti sikur të mos kishin ndërhyrë të tjerët. “Xhunga” rrinte si pulë.

Tashmë po i afroreshin qytetit.

Ndërtesat e tij dukeshin të zymta nën atë qiell të errët e të ngarkuar me shi.

Pas pak të dy autobusët hynë në periferi dhe së shpejti u duhej të kalonin mes përmes tij.

Këtu ishte edhe shpresa e Kastriot Lekës.

Nataljen do ta hipte në autobus me ta parë në trotuar. Të bëhej çtë bëhej.

Kalimtarët kthyen kokat nga autobusët. Dikush përshëndeti me dorë.

“Jam Borisi” thirri një zë në buzë të trotuarit.

Shumë duar u nxorën jashtë xhamave dhe ai iu sul rrokjes së tyre. Sa u kapte majat e gishtave.

Këtë gjë filluan ta bënë edhe disa kalimtarë.

-Ktheje! - i shkrofëtini kapiteni shoferit, që dukej i hutuar.

Ky i dha një të rrotulluar të shpejtë timonit dhe turiri i “Zis”-it u fut në një rrugicë.

Pas autobusit të parë hyri edhe i dyti.

Makina me tendë nuk dukej më.

Pas një çerek ore mbërritën në stacionin e trenit. Kangjellat e hekurta të tij qenë mbyllur dhe dy kordonë me policë mbanin një turmë të madhe njerëzish që të mos hynte në sheshin e stacionit.

Makinat frenuan rëndë.

-Treni do edhe një gjysmë ore të niset – shqiptoi zymtë “Xhunga” - Mund të takoheni me të njohurit tuaj.

Ata vërshuan jashtë autobusit.

Turma e njerëzve në pritje u tollovit të shpërthente, por policët ishin të shumtë dhe të pajisur me shkopinj gome.

Për herë të parë ata e shihnin policinë sovjetike të pajisur me mjete të tilla, parë vetëm në filmat perëndimorë.

-Kastriot! Kastriot!

Thirrja vinte nga radhët e para të grumbullit njerëzor në hyrje të stacionit.

Kastriot Leka njohu zërin e Nataljes dhe pasi shtyu me krahë shokët e tij, zbriti nga autobusi dhe vrapoi drejt turmës.

-Nataaaalja!

-Kastrioooot!

Ajo po tundte duart në ajër.

Një vello e vogël nusërie i rrinte mbi flokë bashkë me një kurorë lule vishnje.

Ai ndjeu kraharorin t'i digjej.

Një lëmsh iu mblodh në fyt dhe për një çast para tij gjithçka u megjullua.

Natalja tundte duart dhe kjo ia shtonte ndjesinë se gjithçka ishte një ëndërr makthi.

Dikush e shtyu fort dhe ai u përmend.

Mes turmës Natalja kishte klithur.

-Largohu! - i ulëriti në vesh një polic.

Kastrioti u zbraps vetëm një hap.

-Bir! - thirri një zë i njohur dhe ai kuptoi se në mes të asaj turme njerëzore që dallgëzohej nën shtrëngimin e kordonëve të policisë sovjetike, ishte edhe Sergei.

-Baba! - thirri Kastrioti dhe vrapoi drejt kangjellave.

Një goditje e rëndë në sup u duk sikur e tërhoqi drejt tokës.

Silueta e një shkopi gome i lëvizi ankthshëm para syve.

-Kastrioooot! - u dëgjua zëri i Nataljes - Nuk më lënë të të vij!

“Të vij” i oshtiu zëri i saj në kraharor dhe vetëm atëherë u ndërgjegjësua se tmerri kishte ndodhur. Gjëma tashmë kishte ngjarë. Krimi ishte kryer.

Nataljen nuk do ta linin të vinte në Shqipëri.

Mushkëritë iu përvëluan nga një i nxehtë i madh.

Pas një tisi mjegulle ai mezi dallonte se si e dashura e tij përpiquej të çante me krahë kordonin e policisë dhe si ata e shtynin me duart-kthetra.

Kastriot Lekës iu bë sikur asaj në fillim i ra kurora me lule vishnje dhe pastaj velloja e nusërisë.

Ato ranë mes çizmeve të rënda të policëve.

Rreth tij dëgjonte thirrje e klithma “Tamara, shpirt!”, “Rexhep!”, “Jam Svjetllana, të puth nga larg”, ”Bujar!”, “Aha, edhe Leleçka qenka”, “Paskan ardhur të gjitha, të gjitha”.

Pastaj një emër “Ljuba”, u dëgjua “Vera”, “Irina”...

Nuk po duket makina me plaçkat tona, ia behu një zë me alarm.

Lokomotiva fishkëlleu gjatë. Turma mes kordonëve të policisë u tendos të shpërthente.

Pastaj u dëgjua “i ka rënë të fikët, të fikët”.

Grumbulli njerëzor u hap dhe disa ngritën në krahë trupin e lëshuar të një vajze.

“Është Svjetllana” tha dikush.

Një klithmë që dukej sikur dilte nga qielli.

Kishte vrapuar drejt gjindjes njerëzore Bujar Andoni dhe e kish rrëmbyer në krahë Svjetllanën.

Policët e mbuluan me trup, por nuk ndërhyjnë ta goditnin.

Kishte njerëz që kishin nisur të ngashërenin.

Treni fishkëlleu përsëri, por shumë nga shqiptarët nuk po hipnin në të. Me uturimë dhe i ndotur nga balta në stacion kishte hyrë edhe kamioni me plaçkat personale.

Më në fund po hipnin nëpër vagonë.

Edhe turma në stacion dukej disi më e përmbajtur, më e bindur se nuk do t'i linin kurrë të çmалleshin me të dëbuarit nga qeveria e tyre.

Një moment, vetëm një moment sa një vetëtimë, vështrimi i një kursanti shqiptar kishte kapur siluetën e Aljosa Leonidoviçit.

Shumë pyetën "ku, ku" dhe ai përpiqej t'u shpjegonte se e pati parë vetëm një sekondë në rreshtat e parë të turmës.

Ishte i zbehtë, shumë i dobësuar dhe i prishur në fytyrë, ngulmonte sqarimin tjetri. Ju betohem, vazhdoi, sapo e pashë dhe mu duk sikur na ngriti dorën.

Lokomotiva fishkëlleu ose më saktë klithi e klithi.

Dhe u lëkundën vagonët.

Bujar Andoni ishte kthyer tek shokët e vet dhe po u shpërndante pusullat e dhuratat që vajzat i kishin lëshuar nëpër duar për të dashurit e tyre.

Kur erdhi tek Kastrioti e tregoi atë që nga larg. Ishin dy tulipanë.

Treni, pak çaste më parë në mëdyshje për të ikur, më në fund rrotulloi pakthyeshem rrotat e tij të mëdha e të hekurta.

Shamitë që tundeshin mbi turmë, u bënë si një re e bardhë.

Kastrioti dalloi sërish Nataljen e përlotur dhe tre valixhe të vogla tek këmbët e saj.

Lokomotiva kuisi me dhimbje. Tashmë ajo po largohej e ikte si e çakërdisur. Në peronin e zbratur vraponte e vraponte vetëm një vajzë.

Ishte Tamara.

Moldavia ishte e lehtë si një flutur, por nuk mund të mbërrinte dot turravrapin e trenit.

Më në fund u ndal pa arritur dot të shtrëngonte duart e Rexhep Memës që mbetën të nderura jashtë dritares për një kohë të gjatë.

Ajo kishte rendur me aq shumë forcë sa nuk kish mundur të fshihte një defekt të lindur të saj, çalimin lehtë. Në ato pak takime të kursyera me Rexhepin ajo ishte kujdesur që të mos binte në sy.

Por tani, tani nuk i duhej më ajo përkujdesje e kotë.

I dashuri i saj shqiptar e kishte parë tek çalonte lehtas, por nuk i kishte larguar duart nga ajo zgjatje drejt saj, si në kërkim të një përqafimi.

Në Moskë

Pas dy orësh treni ndali në një stacion dhe u zbraz nga shumica e udhëtarëve.

U nis pas pak, por ngadalë e si të shkelte në një rrugë të minuar.

-Është rrugë e vjetër, ndoshta nga ato të paraluftës, duket e përdorur rrallë - shpjegoi një zë.

Buzë mbrëmjes qëndruan në një stacion pothuaj të boshatisur.

Në altoparlantë u dha lajmërimi se treni do të qëndronte aty një gjysmë ore. Ishte një stacion me dy porta e një shesh të rrethuar me kangjella.

Disa studentë dolën për të pirë ujë a për të ngrënë diçka.

Nuk kaluan vetëm disa minuta, kur lokomotiva e vjetër me qymyr ulëriti dhe treni u nis. Ata që kishin dalë, vrapuan drejt tij, por menjëherë u mbyllën të dy portat.

Atëherë kërcyen nëpër kangjella.

Në të njëjtën kohë nëpër vagonë shqiptarët ulën dorezat e frenave të avarisë.

Treni më në fund u ndal.

Pasi hipën të gjithë, u bë apeli. Nuk mungonte asnjë njeri.

Në Moskë mbërritën në orën gjashtë të mëngjesit.

Atje kishte dalë atasheu ushtarak dhe disa punonjës të ambasadës. Qe edhe sekretari i partisë.

U përshëndetën dhe u nisën për në aeroport.

Do të udhëtonin me një avion TU-104.

Ja Shqipëria

Kur dolën në pistën e aeroportit Rexhepit iu afrua një njeri dhe i tha “të jap një orë dore, më jep një shishe konjak shqiptar”.

“Ik, more kungull!” - i bërtiti ai.

Tjetri u zhduk menjëherë.

TU-104 rrinte i rëndë dhe i zyrtë mes pistës. Nëpër shkallë po ngjiteshin një grumbull hungarezësh.

Ishin studentë të një instituti letrar të Moskës dhe ktheheshin për një pushim të shkurtër në shtëpitë e tyre.

Atasheu ushtarak nisi t'i përqafonte të gjithë. Faqet e rreshkura i kishte të nxehta dhe kapelën e pati hequr nga koka.

Era i lëkundte flokët e thinjur.

Tek ngjitej nëpër shkallë, dikush i ra me bërryl dhe Kastrioti ktheu kokën.

Po i tregonin me dorë në drejtimin e një njeriu, që po rrinte pranë një “Moskviçi” të kaltër.

Ai njohu Gromov Nikollajeviçin.

Ky i tundi dorën.

Gjatë.

Dukej i trishtuar.

Ose sikur diçka donte t'i thoshte.

Më në fund dera e avionit u mbyll me një krismë të rëndë dhe trupi i tij u drodh. Po nisnin udhëtimin drejt Shqipërisë.

Rrafshi i tokës ruse po mbetej prapa dhe ata të gjithë ishin të pushtuar nga malli e pikëllimi.

Ulja e avionit në Kiev ishte e beftë dhe e dyshimtë.

TU-104 asnjëherë, kur ndiqte këtë linjë, nuk ulej në Kiev. Dikujt i erdhi në mend fjala “bombë”, por tha vetëm qetësisht se kohët e fundit ishin shtuar shumë aksidentet ajrore në flotën civile sovjetike.

Megjithatë askush nuk u tremb. Vazhduan të bisedonin qetësisht.

Pas një ore aeroplani u ngrit drejt qiellit.

Kishte dalë një diell shndritës dhe poshtë pejsazhi po bëhej gjithnjë e më i gjelbër.

-Ja Shqipëria! - thirri me gëzim Rexhep Mema dhe u tkurr pas dritares së avionit.

Të gjithë panë vezullimin e argjendtë të Adriatikut.

-Alpet! - thirri dikush.

-Tirana, ja Tirana! – u dëgjua një zë i lumturuar.

Papritmas Rexhep Mema teshtiu.

Shumë kthyen kokën nga ai.

Ky vuri buzën në gaz.

-Alergjia – tha - Është pranverë në Shqipëri.

Ata qeshën.

-Ju kërkoni në radio! - i tha sekretarit të partisë një nga stjuardesat - Flasin nga Rinasi.

Ky brofi në këmbë dhe hyri në dhomën e pilotëve.

Pas pak u kthye i qeshur.

-Shokë, - tha - Udhëheqja ju përshëndet me fjalët “Kapa e Skënderbeut ngeli gjithmonë krenare mbi kokën tuaj.

U dëgjuan duartrokitje.

Kastrioti nuk i ndjente më duart e tij. I kishte përplasur ato, por iu duk se nuk dhanë asnjë zhurmë.

Qe si në një zhgëndërr. Në një kllapi që kishte ngjarë midis Moskës dhe Tiranës.

Pas pak morën kursin e uljes.

Të gjithë qenë rrëmbyer pas pamjes së pistës të Rinasit që po afrohej me shpejtësi.

Përveç sekretarit të partisë.

Ai shihte me bisht të syrit Kastriot Lekën.

Biri i ambasadorit nuk e dinte se i ati i tij para disa ditësh ishte arrestuar si “agjent i rusëve” dhe burgosja pati bërë bujë.

Kishte edhe nëpunës të lartë të shtetit komunist që përfllisnin se arrestimi i ishte bërë sepse në të vërtetë dyshohej si njeri i Perëndimit.

-Ja Shqipëria, ja Shqipëria! - thërriste një zë me gëzim.

Berat, 31 dhjetor 1996, pasdite.